



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Libohovë

RAPORT PËRFUNDIMTAR
I AUDITIMIT
“FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRISË”
TË USHTRUAR NË BASHKINË LIBOHOVË

TIRANË SHTATOR 2023

| Përmbajtja | Faqe |
|--|-------------|
| Legjenda dhe shkurtime | 1-3 |
| I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE | |
| 1. Përshkrim i shkurtër i projektit të auditimit | 4-10 |
| 2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve | |
| 3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe opinioni i auditimit | |
| II. HYRJA | |
| Objekti i auditimit | 12-13 |
| Qëllimi i auditimit | |
| Identifikimi i çështjes | |
| Përgjegjësitë e strukturave drejtuese | |
| Përgjegjësitë e audituesve | |
| Kriteret e vlerësimit | |
| Standardet e auditimit | |
| Metodat e auditimit | |
| Dokumentimi i auditimit | |
| III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT | |
| -Informacion i përgjithshëm mbi subjektin | 14-14 |
| -Përshkrimi sipas drejtimeve të auditimit: | |
| 1. Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik. | 14-27 |
| 2.1-2.5 Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit | 27-39 |
| 2.6. Burimi i krijimit të të ardhurave, vlerësimi i mbledhjes së tyre. Auditim mbi administrimin e aseteve. | 39-49 |
| 3. Vlerësimi i raportimit financiar | 49-73 |
| 4.1- 4.3. Mbi planifikimin, realizimin, zhvillimin e procedurave të prokurimeve publike. | 73-80 |
| 4.4. Mbi zbatimin e kontratave të punëve dhe shërbimeve publike | 80-83 |
| 5. Mbi planifikimin dhe zhvillimin e territorit | 83-88 |
| 6. Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore (IMTV) | 88-89 |
| 7. Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm | 90-99 |
| Të ndryshme të dala gjatë auditimit | 99-103 |
| IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET | 104-119 |
| V. ANEKSE | 120-135 |

| | |
|---------|--|
| | Kontrolli i Lartë i Shtetit. |
| KLSh | |
| MFK | Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli. |
| NA | Nëpunës Autorizues. |
| NZ | Nëpunës Zbatues. |
| GSM | Grupi i Menaxhimit Strategjik. |
| NJAB | Njësia e Auditimit të Brendshëm. |
| AB | Auditi i Brendshëm |
| MAB | Manuali i Auditimit të Brendshëm. |
| FZhR | Fondi i Zhvillimit të Rajoneve |
| AQT | Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara. |
| UMF | Udhëzim i Ministrisë së Financave |
| VKM | Vendim i Këshillit të Ministrave. |
| VKB | Vendim i Këshillit Bashkiak. |
| ISSAI | Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit. |
| INOTSAI | Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit. |
| ISA | Standardet Ndërkombëtare të Auditimit |
| IFAC | Federatës Ndërkombëtarë të Kontabilistëve |
| IPSAS | Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik |
| IT | Teknologjia e Informacionit. |
| NjA | Njësi Administrative. |
| ShA | Shoqëri Anonime. |
| BOE | Bashkim i Operatorëve Ekonomikë. |
| OE | Operator Ekonomik. |
| TVSh | Tatimi mbi Vlerën e Shtuar |

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” dhe në zbatim të Programit të Auditimit nr. 425/1 Prot., datë 19.05.2023,, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 24.05.2023, deri në datën 27.06.2023, në subjektin Bashkia Libohovë u krye në teren auditimi “Financiar dhe i Përputhshmërisë”.

Auditimi financiar mbuloi periudhën prej datës 01.01.2022, deri më 31.12.2022, ndërsa auditimi i përputhshmërisë prej datës 01.01.2021, deri më 31.12.2022.

Auditimi u shtri mbi çështjet kryesore të veprimtarisë së institucionit si: menaxhimi financiar dhe kontrolli i brendshëm, planifikimi dhe zbatimi i buxhetit, vlerësimi i pasqyrave financiare, prokurimet publike, zbatimi i kontratave të punimeve, lejet e ndërtimit, aktiviteti i IMT, zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditime mëparshëm.

Për përfitimin e rezultateve të auditimit, grupi i auditimit u mbështet mbi dy elementë: në sistemin e kontrollit të brendshëm dhe në punën konkrete mbi evidencat e auditimit, por kryesisht mbi këtë të fundit. Audituesit janë kujdesur që evidencat me të cilat kanë punuar për të argumentuar rezultatet e auditimit, të plotësonin tre cilësi: të ishin të përshtatshme (të kishin lidhje me çështjen që auditohet), të besueshme (burimi nga vjen evidenca të ketë besueshmëri) dhe të mjaftueshme (sasia e evidencës të jetë e mjaftueshme për arritjen e konkluzioneve të auditimit). Subjekti ka konfirmuar me shkresë për njohjen me projektraportin dhe nuk ka treguar interes për të zhvilluar takim përmbyllës në KLSH, për diskutimin mbi rezultatet e auditimit.

2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve

| NR. | Përmbledhje e gjetjes | Referenca në raportin përfundimtar (faqe) | Rëndësia | Rekomandimi |
|-----|---|---|----------|--|
| | <p>Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Bashkia Libohovë nuk ka ngritur një sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos hartuar një kuadër të plotë rregullash dhe procedurash të shkruara për këtë qëllim.</p> <p>-Nuk ka hartuar programe trajnimi për ngritjen dhe zhvillimin profesional të stafit.</p> <p>-Nuk ka kryer procesin e vlerësimit të punonjësve për periudhën në auditim.</p> <p>-Në procedurat e marrjes në punë të punonjësve, marrëdhëniet e punës të së cilëve rregullohet me Kodin e Punës, u konstatua se nuk janë hartuar kriteret e nevojshme për përzgjedhjen e tyre në punë.</p> <p>- Nuk është hartuar regjistër i rrisikut, duke mos marrë masa për evidentimin e rrisqeve që rrezikojnë objektivat e institucionit dhe minimizimin e efekteve negative të tyre.</p> <p>Nuk është hartuar, miratuar dhe arkivuar harta</p> | 14-27 | E lartë | <p>Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Libohovë të marrë masa që nga secili sektor të hartohet rregjistri i rrisikut, për evidentimin e rrisqeve që rrezikojnë objektivat e institucionit dhe minimizimin e efekteve negative të tyre dhe, mbi bazën e tyre të hartohet rregjistri i rrisikut për institucionin. Të hartohet harta e proceseve të punës dhe gjurma e auditimit për këto procese. Këto dokumente të miratohen nga Kryetari i Bashkisë.</p> <p>1.2. Rekomandim: Nga Bashkia Libohovë, Sektori i Burimeve Njerëzore të hartohen rregulla të shkruara lidhur me zhvillimin dhe administrimin e procesit të rekrutimeve të reja për punonjësit, marrëdhëniet e punës së të cilëve</p> |

| | | | |
|---|---------------------|-----------------------|---|
| <p>(lista) e proceseve të punës, si dhe gjurma e auditimit për këto procese, e cila përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërkujtojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to.</p> <p>-Nuk ka të përcaktuara në rregulloren e brendshme të institucionit procedurat anti-korrupsion dhe të sinjalizimit të parregullsive.</p> | | | <p>rregullohen me Kodin e Punës.</p> |
| <p>Gjetje nga auditimi: Bashkia Libohovë nuk ka marrë masa të plota për likuidimin e detyrimeve të prapambetura, pasi niveli i shlyerjes së tyre gjatë vitit buxhetor 2022 është i ulët krahasuar me vlerën e planifikimin në buxhet, si dhe janë krijuar gjatë vitit detyrime të reja të prapambetura. Vlera progresive e detyrimeve të prapambetura në datën 01.01.2022, si çelje e vitit ushtrimor, me burim financimi nga të ardhurat e veta, duke përfshirë edhe transfertën e pa kushtëzuar, është 5,698,722 lekë, e cila është planifikuar e gjithë për likuidim në planin e buxhetit vjetor 2022, por në fakt është likuiduar gjatë këtij viti vetëm vlera 2,782,599 lekë, ose 49% e vlerës së planifikuar, ngelur pa u likuiduar më 31.12.2022 vlera 2,916,123 lekë. Gjithashtu gjatë vitit 2022 janë krijuar detyrime të reja të prapambetura prej 25,977,933 lekë, duke e çuar në total këtë vlerë më 31.12.2022 në 28,894,056 lekë. Peshën kryesore të këtyre detyrimeve e zënë detyrimet për vendimet gjyqësore në vlerën 14,585,976 lekë, detyrimet për shërbime në vlerën 10,918,618 lekë dhe detyrimet për investime në vlerën 2,653,642 lekë.</p> | <p>27-39</p> | <p>E lartë</p> | <p>Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Libohovë dhe Sektori i Financës të marrin masa që të eliminohet fenomeni i krijimit të detyrimeve të reja të prapambetura gjatë vitit buxhetor. Për këtë të bëhet likuidimi i vlerës së kontratës të lidhur midis Bashkisë Libohovë dhe kontraktorëve, sipas afateve të përcaktuara në kontratë, duke eliminuar në këtë mënyrë shkakun e krijimit të detyrimeve të prapambetura. Lidhja e kontratës të bëhet vetëm pasi fondi që parashikon procedura e prokurimit do të jetë në dispozicion (në llogarinë e thesarit) të autoritetit kontraktor. Gjithashtu të marrë masa që gjatë planifikimit dhe zbatimit të buxhetit, prioritet të kenë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës.</p> |
| <p>Gjetje nga auditimi: Realizimi i shpenzimeve buxhetore vetëm me të ardhurat e veta të Bashkisë Libohovë së bashku me transfertat e pa kushtëzuara për vitin 2022, ka diferenca të dukshme me vlerën e planifikuar. Për vitin 2022 planifikimi i shpenzimeve është në vlerën 266,228 mijë lekë ndërsa realizimi në vlerën 218,784 mijë lekë ose në masën 82.1%, pra kemi një mosrealizim të fondeve në vlerën 47,444 mijë lekë.</p> <p>Zërat kryesor që kanë ndikuar në këtë mos realizim janë:</p> <p>- Zëri 600 “Paga dhe përfitimet e punonjësve”, është planifikuar në vlerën 78,611 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 51,612 mijë lekë, ose në</p> | <p>27-39</p> | <p>E lartë</p> | <p>Rekomandim: Bashkia Libohovë, nëpërmjet Sektorit të Financës dhe Sektorit të Tatim Taksave, të marrë masa për një planifikim të studiuar të të ardhurave të veta, duke u mbështetur mbi parashikime të studiara dhe realiste. Mbi bazën e këtyre të ardhurave të parashikohet edhe plani i shpenzimeve, me qëllim që shpenzimet e planifikuara në buxhet të kenë burime financimi të sigurta për tu realizuar. Nëse gjatë vitit ka mosrealizim të të ardhurave të planifikuara, atëherë me vendim të këshillit bashkiak,</p> |

| | | | |
|--|---------------------|-----------------------|--|
| <p>masën 65.6%. Nga auditimi i zbatimit të strukturës organizative konstatohet se struktura është e përbërë nga 92 punonjës ndërsa realizimi është mesatarisht 90 punonjës. Pra mos realizimi i mësipërm vjen kryesisht nga anomalitë në fazën e planifikimit, pasi struktura organizative funksionon pothuajse me kapacitet të plotë.</p> <p>- Zëri 601 “Kontributi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”, është planifikuar në vlerën 12,059 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 8,611 mijë lekë, ose në masën 71.4%.</p> <p>- Zëri 602 “Blerje mallra dhe shërbime” dhe zëri 230-231 “Investime”, është planifikuar në vlerën 33,309 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 21,494 mijë lekë ose në masën 64.5%.</p> <p>Kjo situatë vjen si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave, që do të thotë se nga Bashkia Libohovë në fillim të vitit buxhetor planifikohen angazhime buxhetore, duke mos u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifatat vendore dhe ky planifikim nuk korrigjohet gjatë vitit, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat reale të realizuara.</p> | | | <p>duhet të korrigjohet edhe plani i shpenzimeve, brenda afateve që përcakton kuadri rregullator në fuqi.</p> |
| <p>Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i tre kontratave të cilat i përkasin viteve 2021-2022 për dhënien me qira të ndërtesave/objekteve, janë konstatuar mangësi në dokumentacionin e paraqitur nga subjektet në fazën para lidhjes së kontratave si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Nuk disponohet kërkesa e subjektit për marrje me qira të pasurisë shtetërore; -Nuk disponohet plan biznesi në mënyrë të hollësishme për vënien në funksionim të objektit, ku të përshkruhen qartë: plani i punësimit, plani i investimeve, si dhe treguesit që do të realizohen; -Nuk disponohet oferta për vlerën e detyrimit mujor të qirasë; -Nuk disponohet certifikata e regjistrimit të subjektit në QKR; -Nuk disponohet NUIS-i dhe vërtetimi nga dega e tatimeve se subjekti ka shlyer detyrimet tatimore dhe sigurimet shoqërore; -Nuk disponohet vërtetimi nga institucionet përkatëse që subjekti nuk është në ndjekje penale, nuk ka procese gjyqësore në lidhje me aktivitetin. - Nuk është përcaktuar në kontratë se pala qiramarrëse ka detyrimin për pagesën e energjisë elektrike dhe të ujit, sipas faturës mujore të | <p>39-49</p> | <p>E lartë</p> | <p>1. Rekomandim: Bashkia Libohovë të marrë masa që gjatë procesit të dhënies së ndërtesave me qira, të bëjë skualifikimin e të gjithë subjekteve konkurruese të cilët nuk vërtetojnë se plotësojnë dokumentacionin e kërkuar nga Bashkia Libohovë.</p> <p>2. Rekomandim: Bashkia Libohovë të marrë masa që në hartimin e kontratave për dhënien me qira të ndërtesave/objekteve, të përcaktojë se detyrimet për konsumin mujor të energjisë elektrike dhe të ujit, janë të qiramarrësit. Të përcaktohet person apo strukturë për monitorimin e kontratave të dhënies me qira të ndërtesave.</p> |

| | | | |
|--|---------------------|-----------------------|---|
| <p>gjeneruar nga shitësit e këtyre mallrave. -Gjithashtu pas lidhjes së kontratës nga Bashkia Libohovë nuk është ngritur grup pune për monitorimin e tre kontratave për dhënien me qira të ndërtesave/objekteve.</p> | | | |
| <p>Bashkia Libohovë nuk ka marrë masa për rregjistrimin e aseteve në ASHK. Për aktivet që i përkasin llogarisë 210 “Toka, troje, terrene”, 211 “Pyje, plantacione”, 212 “Ndërtesa konstruksione” dhe 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, për koston historike 935,219,591 lekë, Bashkia Libohovë posedon titull pronësie/pasuri të regjistruara në ASHK Gjirokastër sipas zonave kadastrale vetëm për tre objekte si më poshtë: -Pasuria nr. 14/8 (Muzeu “Avni Rustemi”); -Pasuria nr. 8/185 (Ndërtesa e Bashkisë); -Pasuria nr. 2/27 (Kopshti Fëmijëve Hoxhallarë) Ndërsa për pjesën tjetër të llogarive të sipërpërmendura nuk posedon titull pronësie. Për llogaritë 210 “Toka, troje, terrene”, 211 “Pyje, plantacione”, 212 “Ndërtesa e konstruksione”, 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, 214 “instalime teknike, makineri pajisje vegla pune”, nuk ka një regjistër kontabël të aktiveve, në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 26-30, pika 74. Këto llogari nuk pasqyrojnë vlerat e sakta në pasqyrat financiare, pasi ka një numër të konsiderueshëm pasurie të cilat janë të pa evidentuara.</p> | | | <p>Rekomandim: Nga Nëpunësi Zbatues ë hartohet rregjistri kontabël i aktiveve sipas llogarive kontabël, duke evidentuar të gjithë elementët e nevojshëm si vendndodhjen e pronës, sipërfaqen e saj etj., për të gjitha pronat që administron Bashkia Libohovë. 2. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Libohovë të marrë masa për ngritjen e grupit të punës për inventarizimin në teren e të gjitha pronave që administron Bashkia Libohovë, për të përcaktuar dhe verifikuar situatën faktike, nëse ekzistojnë në teren të gjitha pronat ashtu si ato paraqiten ne VKM përkatëse nëpërmjet të cilave janë transferuar në Bashkinë Libohovë. Në përfundim të procesit të inventarizimit të informohet Kryetari i Bashkisë për rezultatet e këtij procesi. 3. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Libohovë të marrë masa që nga strukturat përkatëse të përgatiten dosjet me dokumentacionin e duhur për regjistrim në ASHK të të gjitha pronave që administron. Sektori i Financës të përlllogaritë kostot për kryerjen e këtij shërbimi, me qëllim pajisjen sa më parë të pasurive të paluajtshme me titull pronësie.</p> |
| <p>Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit dhe të infrastrukturës u konstatua se në dy raste ka mangësi dhe mungesa në projektet që përbëjnë projektin ndërtimor, siç janë plani i vendosjes së ndërtimit mbi fragmentin e hartës në gjendjen ekzistuese i firmosur nga të gjithë projektuesit, deklaratat e projektuesve të licencuar, polica e sigurimit, licencat e projektuesve, në plan vendosjen e miratuar nuk pasqyrohen distancat e</p> | <p>83-88</p> | <p>E mesme</p> | <p>Rekomandim: Nga DPZHT Libohovë të merren masa për të mos miratuar asnjë leje ndërtimi në mungesë të dokumentacionit të detyrueshëm sipas ligjit, dokumentacionit shoqërues, si dhe ky dokumentacion duhet të jetë i saktë dhe të përmbajë gjithë informacionin e nevojshëm, sipas rregulloreve mbi të cilat hartohen.</p> |

| | | | |
|--|--------------|----------------|--|
| objektit nga kufiri i pronës dhe distancat ndërmjet objekteve, në projektin arkitektonik dhe projektin konstruktiv nuk pasqyrohet gjendja ekzistuese e objektit dhe ndërhyrjet që do të realizohen pas rikonstruksionit e shtesës së katit, vlerësimi i ndikimit në mjedis. | | | |
| <p>Gjetje nga auditimi: Bashkia Libohovë nuk ka marrë masa të plota për arkëtimin e debitorëve. Mbështetur në të dhënat e sektorit të taksave dhe tarifave vendore, vlera e debitorëve në datën 31.12.2022 është 25,044,459 lekë, e cila është e ardhur e planifikuar por e pa arkëtuar nga Bashkia Libohovë nga e cila vlera prej 3,342,835 lekë është krijuar gjatë vitit 2022 nga mos shlyerja e detyrimeve të këtij viti, ndërsa vlera prej 21,701,624 lekë i përket detyrimeve të trashëguara përpara vitit 2022.</p> <p>Krahasuar me vlerën e debitorëve në datën 31.12.2021, e cila është 23,317,720 lekë, konstatohet se vlera e debitorëve në vitin 2022 është rritur krahasuar me vitin 2021, e cila tregon se nuk janë marrë masa të plota për arkëtimin e debitorëve, si dhe masat e marra kanë patur rezultate jo shumë të mira.</p> <p>Në vlerën e detyrimit progresiv në fund të vitit buxhetor 2022 prej 25,044,459 lekë, peshën kryesore e zënë detyrimet nga taksapaguesit familjarë, të cilat kanë vlerën 19,273,554 lekë, ose në masën 77% të detyrimit total.</p> | 39-49 | E lartë | Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Libohovë, zyra e taksave vendore dhe zyra juridike, të marrin të gjitha masat e duhura ligjore për arkëtimin e detyrimeve të paguara nga kategoria e taksapaguesve privat dhe familjar në vlerën 25,044,459 lekë. |

3. Konkluzioni dhe opinionin i auditimit

OPINIONI I AUDITIMIT

Opinion mbi pasqyrat financiare të vitit 2022:

Ne kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Bashkisë Libohovë për vitin ushtrimor 2022, ku përfshihet pasqyra e pozicionit financiar, performancës financiare, pasqyra e flukseve monetare, shënimet shpjeguese, ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto etj.,

Sipas mendimit tonë, pasi kemi marrë evidenca të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të besueshme të auditimit, shprehim një opinion të modifikuar me rezervë për llogaritë vjetore të Bashkisë Libohovë, duke arritur në përfundimin se anomali të e konstatuara apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale por jo të përhapura në llogaritë vjetore të vitin 2022, të shprehura në bazën për opinion.

Baza për opinionin mbi pasqyrat financiare:

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik. Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare”, pjesë e raportit tonë përfundimtar. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik, apo edhe çështje

të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare të një institucioni ndërkombëtar, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 5000- Auditimi i Institucioneve Ndërkombëtare- Udhëzues për SAI. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.

Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë vlerën e materialitetit prej 3.5 milion lekë, llogaritur mbi shpenzimet faktike të vitit 2022, si dhe anomalitë e mëposhtme:

-Për llogarinë 202 “Studime dhe kërkime” pasqyrohen aktive në vlerën 5,645,745 lekë, me emërtimin “Vlerë tjetër”, në llogarinë 212 “Ndërtime konstruksione” pasqyrohen aktive në vlerën 4,687,737 lekë, me emërtimin “Vlerë tjetër”, në llogarinë 213 “Rrugë rrjete vepra ujore” pasqyrohen aktive në vlerën 8,296,835 lekë, me emërtimin “Vlerë tjetër” dhe në llogarinë 214 “Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune” pasqyrohen aktive në vlerën 742,167 lekë, me emërtimin “Vlerë tjetër”. Për këto katër zëra sipas klasave respektive në shumën totale 19,372,484 lekë nuk disponohet dokumentacion kontabël, mbi origjinën e tyre, duke mos evidentuar se çfarë përfaqësojnë këto vlera në kontabilitet dhe në inventarin fizik.

-Për llogarinë 202 “Studime dhe kërkime” dhe llogarinë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” për vitin ushtrimor 2022 nuk është përlllogaritur vlera e amortizimit.

-Llogaria 210 “Toka, troje, terrene” nuk paraqet gjendjen reale, pasi në këtë llogari nuk përfshihet vlerave të trojeve nën objekt, si trualli i godinës së bashkisë, trojet e ndërtesave të shkollave, kopshteve e çerdhe, shtëpisë së kulturës, të zyrave në Njësi Administrative etj.

-Llogaria 211 “Pyje, kullota, plantacione”, e cila është në vlerën 0 lekë, nuk paraqet gjendjen reale pasi në këtë llogari nuk pasqyrohet vlera e 12,140 ha prona, nga të cilat 7,918 ha kullotë verore, 3,006 ha pyll, 1,027 ha kullotë dimërore, 146 ha tokë inproduktive, 42 ha djerrë, 1 ha tokë buke, 814 ha kullotë dimërore, 864 ha kullotë të transferuara sipas VKM-ve përkatëse.

-Llogaria 212 “Ndërtime e Konstruksione” paraqitet në vlerën 268,387,859 lekë, por kjo llogari nuk paraqet gjendjen reale të pasurisë së njësisë vendore, sepse për një pjesë e objekteve të mbartura nga ish komunat nuk disponohet dokument pronësie.

-Llogaria 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, nuk paraqet vlerën reale pasi nuk është vlerësuar dhe evidentuar në këtë llogari vlera e rrugës prej 29 kilometra, kaluar në pronësi të Bashkisë Libohovë me VKM nr. 915, datë 11.11.2015.

-Vlera e kontabilizuar në llogarinë “Detyrime ndaj personelit” është 4,240,112 lekë ndërkohë që duke u bazuar në urdhër shpenzimet e realizuara nëpërmjet Degës së Thesarit Gjirokastër vlera e kësaj llogarie është 3,647,634 lekë, pra pasqyruar më shumë në pasqyrat financiare vlera prej 592,478 lekë.

II. Opinioni mbi përputhshmërinë

Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion, kemi konstatuar se në veprimtarinë e Bashkisë Libohovë, janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin”, të cilat në gjykimin profesional të audituesit të pavarur, janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinionit të modifikuar të përputhshmërisë.

Baza për dhënien e opinionit mbi përputhshmërinë

Ne besojmë se evidencat e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin tonë, si më poshtë:

-Nuk është ngritur një sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos hartuar një kuadër të plotë rregullash dhe procedurash të shkruara për këtë qëllim.

- Nuk janë marrë masa të plota për arkëtimin e debitorëve. Mbështetur në të dhënat e sektorit të taksave dhe tarifave vendore, vlera e debitorëve në datën 31.12.2022 është 25,044,459 lekë, nga e cila vlera prej 3,342,835 lekë është krijuar gjatë vitit 2022 nga mos shlyerja e detyrimeve të këtij viti, ndërsa vlera prej 21,701,624 lekë i përket detyrimeve të trashëguara përpara vitit 2022. Gjithashtu u konstatua një vlerë debitorë e pa arkëtuar prej 319,330 lekë për 5 kontrata për dhënien me qira të tokës bujqësore.

-Për vitin 2022 planifikimi i shpenzimeve është në vlerën 266,228 mijë lekë ndërsa realizimi në vlerën 218,784 mijë lekë ose në masën 82.1%, pra kemi një mosrealizim të planit në vlerën 47,444 mijë lekë.

-Nuk janë marrë masa të plota për shlyerjen e detyrimeve ndaj të tretëve. Gjatë vitit 2022 janë krijuar detyrime të reja ndaj të tretëve në vlerën 12,600,684 lekë, ku vlera totale progresive e detyrimeve të prapambetura me burim financimi nga të ardhurat e veta më datën 31.12.2022, shkon në vlerën 28,894,056 lekë.

-Për vitin 2022 konstatohet se 2 punonjës janë trajtuar me pagë grupi në kundërshtim me kuadrin ligjor në fuqi, në vlerën 76,000 lekë e cila përbën dëm ekonomik për buxhetin e Bashkisë Libohovë.

- Për 2 objekte të përfunduara dhe të marra në dorëzim nga Bashkia Libohovë të cilat i përkasin llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”, janë ngurtësuar fonde në vlerën 99,458 lekë, për të cilat është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës. Për këto fonde nuk janë marrë masa për xhirimin e tyre te kontraktori, apo për verifikimin e investimit nëse ka patur problematika gjatë periudhës së garancisë, me qëllim rakordimin dhe mbajtjen e vlerës që lidhet me problematikën e konstatuar.

Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë Libohovë:

Drejtimi i njësisë vendore, është përgjegjës për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi të raportimit financiar. Drejtimi është përgjegjës për ngritjen dhe monitorimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, me qëllim shmangien e gabimeve apo mashtrimet e mundshme, për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e miratuara, për kontrollin e procesit të raportimit financiar dhe realizimit të të ardhurave nga taksat e tarifave vendore, planifikimin dhe realizimin e buxhetit dhe të gjithë veprimtarisë që zhvillon Bashkia Libohovë.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH-së:

Përgjegjësia e audituesit të KLSH-së është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijojmë bindje, të cilat do të shprehen në opinionin e grupit të auditimit mbi saktësinë, vërtetësinë dhe besueshmërinë e hartimit të pasqyrave financiare dhe raportimit financiar, nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale në përputhje me kuadrin e rregullator të raportimit financiar.

Përgjegjësia e audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme për shkallën e përputhshmërisë së aktivitetit të institucionit të audituar me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi dhe të jap opinion për këtë.

Audituesi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare dhe auditimin e përputhshmërisë për fushat e auditimit dhe, i përshkruan ato në raportin e auditimit. Siguria që jepet nga audituesi është një siguri e arsyeshme e cila është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet, mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë.

II. HYRJA (Të dhëna mbi Projektin e Auditimit)

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të programit të auditimit nr. 425/1prot., datë 19.05.2023, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 24.05.2023, deri më 27.06.2023, në institucionin Bashkia Libohovë u krye auditimi “Financiar dhe i Përputhshmërisë”.

Auditimi financiar mbuloi periudhën prej datës 01.01.2022, deri më 31.12.2022, ndërsa auditimi i përputhshmërisë prej datës 01.01.2021, deri më 31.12.2022.

Auditimi u krye nga grupi i auditimit me përbërje:

- 1.B.M. (Përgjegjës grupi)
- 2.S.M., anëtar
- 3.M.H., anëtar
- 4.J.G., anëtar

Auditimi u krye me zgjedhje, mbi bazë rrishtu.

OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA

1. Objekti i auditimit. Objektivi i auditimit financiar është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, nëse për vitin 2022 transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi.

- Në auditimin e përputhshmërisë objektivi është dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, si dhe opinionit mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, lidhur me veprimtarinë e subjektit.

2. Qëllimi i auditimit. Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve janë paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe të shpenzimeve.

- Për auditimin e përputhshmërisë, qëllimi është të përcaktohet niveli i zbatimit nga subjekti, të kuadrit ligjor në fuqi për fushat e veprimtarisë së subjektit të audituar.

3. Identifikimi i çështjes.

Referuar analizës së riskut, në fazën e planifikimit të auditimit, u identifikuan fushat me risk të cilat përbëjnë drejtimet e auditimit, të miratuara me programin e auditimit, si më poshtë:

Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik.

2. Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.

3. Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për pasqyrat financiare për vitin 2022.

4. Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve.

5. Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e territorit.

6. Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit (IMTV).

7. Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese:

(Trajtuar në Opinionin mbi auditimin)

5. Përgjegjësitë e audituesve

(Trajtuar në Opinionin mbi auditimin)

6. Kriteret e vlerësimit. Kriter vlerësimi është i gjithë kuadri rregullator në fuqi (baza ligjore, aktet e brendshme të institucionit, kushtet e kontratës etj., me të cilat krahasohet aktiviteti i njësisë vendore që auditohet) dhe kryesisht:

Standardet e Auditimit:

- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI 200; 400 etj;
- Manuali i Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve (ECA);
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC);
- Manuali i Auditimit Financiar, KLSH;
- Manuali i Auditimit të Zbatimit të Rekomandimeve në KLSH;
- Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë, KLSH;
- Manuali i Auditimit të Brendshëm, etj.

Akte ligjore:

- Ligji nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”;
- Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;
- Ligji nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, etj.
- Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar;
- Ligji nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”;
- Ligji nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligjit 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar.

Akte nënligjore

- VKM nr. 500, datë 14.8.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në Njësitë e Qeverisjes Vendore”;
- VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”;
- VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim.

Udhëzime, Urdhra dhe Rregullore:

- Udhëzimi MFE nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësisë të Qeverisjes së Përgjithshme” ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr. 5, datë 21.02.2022;
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2012 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik";
- Udhëzimi MF nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësisë të vetëqeverisjes vendore” etj.;
- Rregullore e Brendshme “Mbi organizimin dhe funksionimin administrativ KLSH-së”;
- Rregullore e Procedurat të Auditimit në KLSH;

- Rregullore mbi organizimin dhe funksionimin e Bashkisë Libohovë, etj.

7. Standardet e auditimit

- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI 200; 400 etj;
- Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI^t, INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit”;
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC);
- Standardet Kombëtare të Kontabilitetit;
- Manuali i Auditimit Financiar, KLSH me ndryshime;
- Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë, KLSH me ndryshime;
- Manuali i zbatimi të rekomandimeve të KLSH;
- Manuali i Auditimit të Brendshëm, etj.

8. Metodrat (Procedurat) e auditimit.

Procedurat e auditimit kanë për qëllim të sigurojnë evidenca të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të besueshme cilat do të përbëjnë një bazë të arsyeshme për vlerësimet dhe përfundimet e auditimit (ISSAI 300, 3.5.1).

Audituesit përzgjedhin ato procedura auditimi të cilat sipas gjykimit të tyre profesional janë më të përshtatshme në varësi të rrethanave (ISSAI 300, 3.4.5).

Përzgjedhja e metodave të përdorura, u mbështet në vlerësimin e riskut, materialitetit, kostos dhe efikasitetit të auditimit, duke patur në fokus përbushjen e qëllimit të procedurës së auditimit.

Duke qenë se Menaxhimi financiar dhe kontrolli është një sistem politikash, procedurash, veprimtarish dhe kontrollesh, të cilat vendosen, ruhen dhe përditësohen rregullisht nga titullari i njësisë publike dhe vihen në zbatim nga i gjithë personeli, me qëllim për të adresuar risqet e për të dhënë garanci të mjaftueshme se objektivat e njësisë publike do të arrihen nëpërmjet:

1. Veprimtarive efektive, efikente dhe me ekonomi;
2. Pajtueshmërisë me legjislacionin dhe me aktet e brendshme e kontratat;
3. Informacioneve operative e financiare të besueshme e të plota;
4. Mbrojtjes së informacionit e të aktiveve, së pari u vlerësua ngritja dhe zbatimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, funksionimi i 5 komponentëve të MFK nga njësi e audituar dhe dhe u vlerësua veprimtaria e auditit të brendshëm, si një prej elementëve kryesorë të vlerësimit të riskut të auditimit.

Përsa i përket funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, zbatueshmërisë nga ana e subjektit të audituar të MFK-së, grupi i auditimit ka kryer intervista verbale, ka kryer teste kontrolli.

Për arsye se në bazë të vlerësimit sistemi i kontrollit të brendshëm është përcaktuar jo në nivelin e duhur (risku në nivelin mesatar), grupi i auditimit u mbështet më shumë në procedurat thelbësore dhe më pak në qasjen e mbështetur në sistemin e kontrollit të brendshëm. Siguria e auditimit është marrë më shumë nga procedurat thelbësore, si:

Kontrolli aritmetik, kontrolli me anë të pjesëve justifikuese, inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese, kontrolli i vlerësimit, konfirmim nga të tretët, kontrolli sipas një treguesi, intervistimi, raporte dhe informacione, pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm etj.

9. Dokumentimi i auditimit

Dokumentimi i auditimit është mbështetur në kërkesat e Manualeve të Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë dhe në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Grupi i auditimit ka dokumentuar punën audituese në të gjitha fazat e auditimit. Janë plotësuar të gjitha dokumentet standarde të auditimit.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin

Bashkia Libohovë kufizohet në veri me Bashkinë Këlcyrë, në lindje me Bashkinë Përmet, në jug me Bashkinë Dropull dhe në perëndim me Bashkinë Gjirokastrë. Popullsia: Sipas Censurit të vitit 2011 ka një popullsi prej 3.667 banorësh. Ndërkohë që sipas Regjistrimit Civil, kjo bashki ka 7.158 banorë. Libohova shtrihet në një sipërfaqe prej 248.24 km² me një densitet prej 28.83 banorë/km². Bashkia Libohovë ka qenë që prej vitit 1914 nënprefekturë. Zona që përfshihet në bashkinë e re është e pasur me monumente arkeologjike, historike, monumente kulturi dhe natyrore, me vlera unike në llojin e vet, të vizitueshme në çdo kohë dhe të njohura ndërkombëtarisht.

Bashkia Libohovë shquhet në Shqipëri për shumëllojshmërinë e bimëve medicinale. Pozicioni gjeografik e bën Libohovën një qendër potenciale, duke u bashkuar me zonat e tjera përreth si njësinë administrative Qendër- Libohovë dhe Zagorie.

Misioni i Bashkisë Libohovë është të sigurojë qeverisjen në një nivel sa më afër qytetarëve. duke garantuar vetë-qeverisje në përputhje me kërkesat e Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore. Synimi kryesor është plotësimi sa më i mirë i nevojave dhe kërkesave të komuniteteve përkatëse, nëpërmjet arritjes së një niveli sa më të lartë shërbimesh, në dobi të një zhvillimi të balancuar me qëllim përfundimtar standarde të larta të cilësisë së jetesës në territorin nën administrim.

PËRSHKRIMI I AUDITIMIT SIPAS PIKAVE TË PROGRAMIT

Pika 1. Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik.

| | |
|------------------------------|--|
| 1. Titulli i gjetjes: | Mangësi në funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm. |
| Situata: | <p>Nga auditimi u konstatua se Bashkia Libohovë nuk ka ngritur një sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos hartuar një kuadër të plotë rregullash dhe procedurash të shkruara për këtë qëllim.</p> <ul style="list-style-type: none">-Nuk ka hartuar programe trajnimi për ngritjen dhe zhvillimin profesional të stafit.-Nuk ka kryer procesin e vlerësimit të punonjësve për periudhën në auditim.-Në procedurat e marrjes në punë të punonjësve, marrëdhëniet e punës të së cilëve rregullohet me Kodin e Punës, u konstatua se nuk janë hartuar kriteret e nevojshme për përzgjedhjen e tyre në punë.-Nuk ka hartuar dhe miratuar Strategjinë e Riskut, e cila rishikohet çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut. Nuk janë analizuar dhe përditësuar kontrollet që synojnë minimizimin e riskut, pra nuk është identifikuar dhe krijuar një regjistër risku, vlerësimi, për kontrollin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave.-Nuk ka hartuar, miratuar, arkivuar gjurmët e auditimit e cila përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkrojë të |

| | |
|------------------------|---|
| | <p>gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to.</p> <p>-Nuk ka të përcaktuara në rregulloren e brendshme të institucionit procedurat anti-korrupsion dhe të sinjalizimit të parregullsive.</p> <p>-Nuk ka procedurë të veçantë për mbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve, ankesave për analizën e tyre, identifikimin e shkaqeve dhe për eliminimin e problemeve të dala gjatë kryerjes së detyrave.</p> <p>-Bashkia Libohovë me shkresën nr. 368 prot., datë 15.03.2023, ka hartuar dhe dërguar në MFE deklaratën për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm, raportin vjetor për funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe pyetësonin e vetëvlerësimit për komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, në funksion të realizimit të pesë fushave në të cilat funksionon MFK, por jashtë afateve.</p> <p>-Në raportin vjetor për funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm nuk janë përfshirë të gjithë elementët në funksion të menaxhimit financiar dhe kontrollit.</p> |
| Kriteri: | <p>Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 4, pika 20, neni 16, pikat 2-3, neni 17, pika 1, nenin 18, pika 1, neni 21, pika 2, Ligji nr. 152/2013, datë 17.10.2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, VKM nr. 109, datë 26.02.2014, “Për vlerësimin e rezultateve në punë” dhe Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, Udhëzimi nr. 16, datë 20.07.2016, “Përgjegjësitë dhe detyrat e Koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të riskut në njësitë publike”, Aneksi 2, Udhëzimi nr. 28, datë 15.12.2011, “Mbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike”, Shtojca nr. 2, Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin i miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 108, datë 17.11.2016, Kapitulli III, pika 3.1, pika 3.2 dhe pika 3.3.</p> |
| Ndikimi/Efekti: | <p>Mos njohja e plotë si dhe sa duhet e koncepteve të ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin duke sjellë një nivel mesatar të riskut të funksionimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm.</p> |
| Shkaku: | <p>Mungesa e trajnimeve të dedikuara për të gjithë stafin menaxhues në drejtim të njohjes së dispozitave të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe të menaxhimit të sistemit financiar.</p> |
| Rëndësia: | <p>E lartë.</p> |
| Rekomandim: | <p>Nga Kryetari i Bashkisë Libohovë të merren masa për njohjen nga stafi të ligjit për MFK dhe manualit përkatës të tij, për hartimin dhe miratimin e strategjisë të risqeve, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit, të hartohet dhe të miratohet gjurma e auditimit me qëllim menaxhimin e riskut.</p> |
| Rekomandim: | <p>Nga Bashkia Libohovë, Sektori i Burimeve Njerëzore të hartohen rregulla të shkruara lidhur me zhvillimin dhe administrimin e procesit të rekrutimeve të reja për punonjësit të cilët i rregullojnë marrëdhëniet me anë të Kodit të Punës.</p> |

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: znj. L.M. me detyrë Kryetar i Bashkisë Libohovë.

Më hollësisht rezultatet e auditimit paraqiten si më poshtë:

1.1. Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK: Mjedisi i kontrollit, Menaxhimi i riskut, Veprimtaritë e kontrollit, Informimi dhe komunikimi, Monitorimi. Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike.

Në zbatim të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, akteve ligjore e nënligjore të dala në zbatim të tij, kryhet ky auditim për të vlerësuar nëse sistemi i drejtimit, politikat, procedurat, veprimtaritë, kontrollet, kanë arritur nëpërmjet planifikimit dhe përdorimit të burimeve financiare, të ofrojnë shërbimet publike dhe të bëjnë adresimin e risqeve me efikasitet dhe efektshmëri, duke dhënë garanci të mjaftueshme se objektivat e njësisë publike do të realizohen nëpërmjet:

- i. Pajtueshmërisë me legjislacionin, aktet e brendshme dhe kontratat.
- ii. Informacioneve operative e financiare të besueshme dhe të plota.
- iii. Mbrojtjes së informacionit e të aktiveve.

Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për menaxhimin financiar dhe kontrollin u konstatua se, bazuar në të dhënat e paraqitura në vetëvlerësimin e bërë nga ana e Bashkisë Libohovë, informacionin e mbledhur nga përgjigjet e pyetësorit të realizuar nga grupi i auditimit, si dhe rezultatet e testimeve të kryera, komponentët e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit kuptohen dhe funksionojnë jo mjaftueshëm përgjatë gjithë strukturave të njësisë, pavarësisht përpjekjeve të këtij institucioni për të shkuar drejt konsolidimit.

Më poshtë, në mënyrë të detajuar argumentohet puna e bërë nga ky institucion dhe mangësitë e konstatuara në plotësimin e kërkesave që kërkojnë komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit në drejtim të, funksionimit me përgjegjshmëri menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit dhe përdorimit me efektivitet të fondeve të tij.

1. Mjedisi i kontrollit

Mjedisi i kontrollit është bazë për menaxhimin e fondeve në njësinë publike, ai përbën themelin ku ngrihen të gjithë komponentët e tjerë të kontrollit të brendshëm.

Ky komponent përbëhet nga:

1.1. Integriteti dhe Vlerat Etike

Nëpunësit e Bashkisë Libohovë duhet të respektojnë rregullat dhe parimet e përcaktuara në Ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”, Ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” dhe Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

-Bashkia Libohovë nuk disponon Kodin e Etikës, por në Rregulloren e Brendshme të miratuar me Urdhrin nr. 700, datë 20.06.2016, të Kryetarit të Bashkisë, janë të përfshira rregullat e etikës për zbatim nga stafi i punonjësve të bashkisë gjatë veprimtarisë në këtë institucion, konkretisht në nenin 22 “Disiplina formale dhe administrative” dhe nenin 23 “Rregullat e etikës në administratë”.

-Bashkia Libohovë nuk ka hartuar programe trajnimi për ngritjen dhe zhvillimin profesional të stafit, veprime këto në kundërshtim me Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 108, datë 17.11.2016, Kapitulli

III, “Komponentët e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit”, pika 3.1, “Mjedisi i kontrollit të brendshëm”.

-Në Bashkinë Libohovë ankesat dhe kërkesat e ndryshme të paraqitura pranë saj, regjistrohen në Zyrën e Protokollit të institucionit me një ndalesë dhe më pas bëhen raportimet e nevojshme në sektorët përkatës. Në vazhdim të procesit, bëhet kthimi i përgjigjeve sipas afateve të përcaktuara në përputhje me Ligjin nr. 119/2014, datë 18.09.2014, “Për të drejtën e informimit” dhe Urdhrin e Komisionerit për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale “Për miratimin e programit model të transparencës për njësitë e vetëqeverisjes vendore”.

-Bashkia Libohovë nuk ka kryer procesin e vlerësimit të punonjësve për periudhën në auditim, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 152/2013, datë 17.10.2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, VKM nr. 109, datë 26.02.2014, “Për vlerësimin e rezultateve në punë” dhe Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar.

1.2.Titullari/Nëpunësi Autorizues (NA)/Bordi apo Këshilli i Drejtuesve demonstrojnë pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikëqyrje.

Në rregulloren e brendshme të institucionit janë të përcaktuara procedurat për ushtrimin e përgjegjësisë mbikëqyrëse të cilat, përcaktojnë rolin, fushëveprimin e nëpunësit autorizues dhe të stafit menaxherial. Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion prej institucionit konstatohet se:

-Bashkia Libohovë ka të përcaktuar dhe kryen sipas procedurës së miratuar në rregulloren e brendshme hartimin, miratimin, ndjekjen dhe raportimin e brendshëm sa i përket realizimit të planeve mujore nga sektorët në Aparatin e Bashkisë, Administratorët e Njësive Administrative për informacion të titullarit të bashkisë sipas fushave që ato mbulojnë në përputhje me Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 108, datë 17.11.2016, Kapitulli III, “Komponentët e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit”, pika 3.1, “Mjedisi i kontrollit të brendshëm”.

-Bashkia Libohovë ka paraqitur raport vjetor monitorimi pranë Këshillit Bashkiak dhe në Ministrinë e Financave për realizimin buxhetin vjetor.

-Në Bashkinë Libohovë mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm, nuk ka plan menaxhimi për veprime korrigjuese lidhur me mangësitë e evidentuara në këtë drejtim. Nga njësitë e varësisë nuk ka raporte për performancën e përmbushjes së detyrave gjatë ushtrimit të veprimtarisë.

-Nga Ujësjiellës Kanalizime Libohovë Sh.a, Bashkia merr raportime në lidhje me vendim-marrjen e këshillit të administrimit dhe raportimit financiar për efekt argumentim subvencioni sepse bashkia është aksionari kryesor, por mungojnë raportimet periodike për performancën e veprimtarisë dhe risqet kryesore lidhur me objektivat.

-Titullari i institucionit merr opinione për performancën e institucionit dhe funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm nga Auditi i Brendshëm, nëpërmjet veprimtarisë audituese që ai kryen.

-Këshilli Bashkiak me kompetencat e tij ushtron përgjegjësitë e mbikëqyrjes dhe kontrollit të veprimtarisë së Bashkisë nëpërmjet vendim-marrjes.

1.3.Titullari/Nëpunësi Autorizues (NA) krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë.

-Bashkia Libohovë ka hartuar dhe miratuar deklaratën e misionit dhe dokumentin e PBA-së. Në dokumentet e PBA-ve, nga ana e këtij institucioni është miratuar strategjia me objektivat dhe

prioritetet strategjike, në përputhje me ligjin organik të buxhetit si dhe plan veprimi i menaxhimit të financave, të cilat janë dërguar pranë MFE me shkresat përkatëse.

-Janë kryer konsultime me palët e treta, grupet e interesit si dhe dëgjuesat me publikun në njësinë e vetëqeverisjes vendore.

-Mënyra e njohjes së punonjësve me rregulloren e brendshme, është kryer me metodën shkresore dhe elektronike.

-Struktura organizative e Bashkisë Libohovë është në përputhje me madhësinë dhe aktivitetet e këtij institucioni. Numri i përgjithshëm i punonjësve është miratuar me VKB nr. 66, datë 29.12.2021, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Gjirokastrë me shkresën nr. 13/1 prot., datë 17.01.2022. Kjo strukturë është miratuar me Urdhrin nr. 17, datë 17.02.2022, të Kryetarit të Bashkisë znj. L.M. Realizimi i strukturës për periudhën objekt auditimi paraqitet si më poshtë:

| Viti | Muajt | Plani/Numër punonjës | Fakt/Numër punonjës | Diferenca |
|------|---------|----------------------|---------------------|-----------|
| 2022 | Janar | 92 | 90 | -2 |
| 2022 | Shkurt | 92 | 90 | -2 |
| 2022 | Mars | 92 | 92 | 0 |
| 2022 | Prill | 92 | 91 | -1 |
| 2022 | Maj | 92 | 91 | -1 |
| 2022 | Qershor | 92 | 92 | 0 |
| 2022 | Korrik | 92 | 92 | 0 |
| 2022 | Gusht | 92 | 92 | 0 |
| 2022 | Shtator | 92 | 91 | -1 |
| 2022 | Tetor | 92 | 89 | -3 |
| 2022 | Nëntor | 92 | 90 | -2 |
| 2022 | Dhjetor | 92 | 90 | -2 |

Burimi i të dhënave: Bashkia Libohovë.

1.4. Njësia publike demonstroi angazhim në realizimin e kompetencave.

Nëpunësit e Bashkisë Libohovë i rregullojnë marrëdhëniet e punës në nivel sektori, përgjegjës sektori apo specialist me Ligjin nr. 152/2013, datë 17.10.2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, dhe aktet nënligjore të tij, për sa i përket punonjësve administrativ dhe terrenit i rregullojnë marrëdhëniet e punës me Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar.

Referuar Kreut III, pika 3.1, “Mjedisi i kontrollit të brendshëm”, të Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit i miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 108, datë 17.11.2016, përcaktohet që:

Politikat e burimeve njerëzore duhet të garantojnë:

- Një procedurë transparente për rekrutimin dhe emërimin e punonjësve.
- Krite dhe kërkesa të përshtatshme në drejtim të kualifikimit dhe përvojës profesionale në procesin e rekrutimit dhe të emërimit të stafit, që synojnë të fuqizojnë kapacitetin administrativ të njësisë dhe të krijojnë një ekip pune të besueshëm dhe kompetent.
- Zhvillimin dhe miratimin e politikave, rregullave dhe procedurave të zbatueshme, që janë në harmoni me dispozitat ligjore të vlefshme për rekrutimin, emërimin, vlerësimin, trajnimin, shpërbllimin dhe motivimin e stafit.

Në rregulloren e brendshme të institucionit për punonjësit të cilët i rregullojnë marrëdhëniet me Kod Pune nuk është përcaktuar mënyra e rekrutimit të tyre si dhe nuk janë përcaktuar kriteret e nevojshme për përzgjedhjen/rekrutimin në pozicionet e lira.

1.5. Njësia publike vepron në përputhje me përgjegjshmërinë menaxheriale.

Titullari i njësisë publike duhet të krijojë Grupin e Menaxhimit Strategjik, (në vijim GMS) me pjesëmarrjen e nivelit menaxherial ekzistues të njësisë. GMS është një element integral i

përgjegjshmërisë dhe qeverisjes publike, dhe luan një rol kyç për sa i takon, integritetit të informacionit financiar të njësisë publike, sistemit të saj të kontrollit të brendshëm dhe sjelljes etike. GMS ofron mbështetje dhe këshilla për titullarin e njësisë si dhe përkujdeset për performancën e njësisë publike.

GMS duhet të kuptojë sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë, të garantojë se komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe menaxhimi efektiv i riskut janë të pranishëm dhe funksionojnë me efektivitet brenda njësisë.

Me Urdhrin nr. 45, datë 10.05.2022, të Kryetarit të Bashkisë znj. L.M. është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik për vitin 2022 i përbërë nga 6 punonjës, në përputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 8, gërma “b”, neni 24, pika 2.

Duke u bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga institucioni u konstatua se, ky grup (GMS) nuk është mbledhur për hartimin e planit strategjik dhe PBA-së, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 8, pika 8, gërma “b”, neni 27, pikat 1-2, dhe Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin i miratuar me Urdhrin nr. 108, datë 17.11.2016, Kapitulli II, pika 2.2.6, dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 16, datë 20.07.2016, “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”, pika 2.2.4, nën pikat 1-5. Lidhur me delegimin e kompetencave, nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues dhe menaxherë të tjerë të njësisë, kanë të drejtë të delegojnë disa nga të drejtat dhe detyrat e tyre. Mënyra e delegimit të detyrave është e përcaktuar në rregulloren e brendshme të institucionit.

2. Menaxhimi i riskut

Risku zakonisht përcaktohet si pasiguria e rezultatit, qoftë kjo mundësi pozitive apo negative e veprimeve dhe ngjarjeve. Kjo është mundësia që një ngjarje e caktuar, e cila do të ketë ndikim në arritjen e objektivave të njësisë, mund të ndodhë. Risku matet me efektin e tij dhe shkallën e mundësisë së ndodhjes.

Menaxhimi i riskut përfshin identifikimin, vlerësimin, kontrollin dhe monitorimin e ngjarjeve të mundshme apo situatave të cilat mund të kenë një efekt negativ në arritjen e objektivave të njësive dhe është projektuar për të dhënë siguri të arsyeshme se objektivat do të arrihen.

Titullari i njësisë publike është përgjegjës për, zhvillimin e politikave, miratimin dhe monitorimin e strategjisë për menaxhimin e riskut brenda njësisë së tij, analizimin dhe rifreskimin e kontrolleve që synojnë minimizimin e riskut, sipas strategjisë së riskut të miratuar.

Menaxhimi i riskut mundëson vendimmarrjen cilësore, parashikimin më të mirë dhe optimizimin e burimeve në dispozicion, hapa këto të cilat kanë të bëjnë me përcaktimin e prioriteteve lidhur me shmangien e problemeve të ardhshme që mund të shfaqen gjatë punës për arritjen e objektivave të vendosura.

Strategjia e riskut është përcaktuar si qasje organizative në drejtim të menaxhimit të riskut nga ana e titullarit të institucionit dhe e pasqyruar në politikat e nivelit të lartë të njësisë e më tej. Strategjia e riskut përcakton mënyrën se si duhet të silllet institucioni ndaj risqeve dhe vendos kuadrin e përgjithshëm të procesit të menaxhimit të riskut.

Strategjia e riskut të njësisë duhet të përcaktojë në mënyrë të qartë strukturat për menaxhimin dhe kontrollin e risqeve, si duhet të trajtohen risqet në nivel strategjik, në nivel programi dhe në nivel aktiviteti, strukturat për monitorimin dhe vlerësimin e tij, kriteret për përcaktimin e risqeve madhore, mekanizmat e regjistrimit të riskut si dhe kriteret për matjen e riskut.

-Bashkia Libohovë nuk ka hartuar dhe miratuar Strategjinë e Riskut, e cila rishikohet çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut. Nuk janë analizuar dhe përditësuar kontrollet që synojnë minimizimin e riskut, pra nuk është identifikuar dhe krijuar një regjistër risku, vlerësimi, për kontrollin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 21, pika 2, Udhëzimin nr. 16, datë 20.07.2016, “Përgjegjësitë dhe detyrat e Koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të riskut në njësitë publike”, Aneksi 2, “Regjistri dhe matrica e riskut” si dhe Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin i miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 108, datë 17.11.2016, Kapitulli III, pika 3.2, “Menaxhimi i riskut”.

3. Aktivitet e kontrollit

Sistemi me dy firma është një procedurë e cila kryhet për të vërtetuar saktësinë e të dhënave të përfshira në dokument. Detyrimet financiare si nënshkrimi i kontratave, urdhër-shërbimet dhe kryerja e pagesave, sistemi i firmës së dyfishtë jep garancinë se marrja përsipër e detyrimit financiar apo pagesa bëhet nga personi i autorizuar dhe se nuk ka shkelje të disiplinës financiare për pagesat.

Qëllimi i kësaj procedure është të garantojë se personi përgjegjës për regjistrimet në kontabilitet është i informuar për detyrimin financiar që do të merret përsipër apo që do të paguhet dhe do të kryejë saktë veprimet e kontabilitetit.

Likuidimet e transaksioneve nënshkruhen nga nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues të cilët janë konfirmuar nga MFE për autorizimin/kryerjen e veprimeve me Degën e Thesarit.

Gjurma e auditimit është një instrument menaxhimi që mundëson nga njëra anë ndjekjen e ecurisë së një procesi nga fillimi në fund dhe në anën tjetër, ndjekjen e ecurisë së këtij procesi përgjatë strukturave të njësisë, apo ndërmjet vetë njësisë dhe institucioneve të jashtme.

Përveç kësaj gjurma e auditimit jep informacione për të rindërtuar transaksione dhe operacione të veçanta në kuadër të një procesi të caktuar si dhe për t'i verifikuar këto transaksione dhe operacione.

Titullari i njësisë publike, miraton gjurmën e auditimit për procedura që lidhen me veprimtaritë kryesore të njësisë dhe siguron që, të gjitha operacionet e njësisë dokumentohen në atë formë, që u mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm apo autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit. Gjurma e auditimit duhet të ketë në përbërje të paktën proceset kryesore që kontribuojnë në arritjen e objektivave të njësisë dhe që përfshijnë zbatimin e aktiviteteve, programeve dhe projekteve më të rëndësishme të saj. Gjurma e auditimit duhet të rifreskohet në mënyrë të vazhdueshme, për të garantuar pasqyrimin e ecurisë së aktiviteteve dhe dokumenteve që përmban një proces.

Në Udhëzimin nr. 16, datë 20.07.2016, “Përgjegjësitë dhe detyrat e Koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të riskut në njësitë publike” përcaktohet se, “Nëpunësi Autorizues i njësisë publike është përgjegjës për zbatimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në të gjitha njësitë, struktura, programet, aktivitetet dhe proceset e drejtuara prej tij në përputhje me parimet e ligjshmërisë, menaxhimit të shëndoshë financiar dhe transparencës”.

Nëpunësi Autorizues duhet të sigurojë që do të ndiqet qasja e përgjithshme e rekomanduar për ngritjen, vlerësimin dhe përmirësimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit, të sigurojë se në përgatitjen e “Gjurmës së auditit për proceset kryesore të punës” do të përfshihen hapat kryesorë të vlerësuara të rëndësishëm për një sistem të shëndoshë të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

-Për vitin 2022, Bashkia Libohovë nuk ka hartuar, miratuar dhe arkivuar gjurmën e auditimit e cila përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre dhe synon të ripërshkrojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 16, pika 2-3 dhe Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin i miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 108, datë 17.11.2016, Kapitulli III, pika 3.3, “Aktivitetet e kontrollit”.

Titullari i njësisë ka përgjegjësi për vendosjen e rregullave dhe procedurave për njoftimin, shqyrtimin, zbulimin dhe raportimin e dobësive administrative, mospërputhjeve dhe shkeljeve, që krijojnë terren për korrupsion, mashtrime, apo parregullsi. Procedurat antikorrupsion, përfshijnë:

- Kontrollat parandaluese;
- Një sistem për investigim të brendshëm të paralajmërimeve të hershme për korrupsion, mashtrime dhe parregullsi;
- Një sistem për zbulimin e mashtrimeve dhe parregullsive;
- Një sistem për raportimin e parregullsive të gjetura, i cili duhet të përshkruajë qartësisht linjën e brendshme dhe të jashtme të raportimit, pa rënë ndesh me të drejtën kushtetuese të individit.;
- Procedurat e sinjalizimit.

-Bashkia Libohovë nuk ka të përcaktuara në rregulloren e brendshme të institucionit procedurat anti-korrupsion dhe të sinjalizimit të parregullsive, veprime këto në kundërshtim me, Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 17, pika 1.

-Bashkia Libohovë nuk ka një procedurë të veçantë lidhur me mbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve, ankesave dhe analizën e tyre, për të bërë të mundur identifikimin e shkaqeve dhe eliminimin e problemeve të dala gjatë kryerjes së detyrave, veprime këto në kundërshtim me, Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 4, pika 20.

4. Monitorimi

Kontrolli i brendshëm mbulon vlerësimin e efektivitetit të sistemeve të kontrollit të brendshëm. Sistemi dhe komponentët e tij mund të vlerësohen nëpërmjet procesit të vazhdueshëm të monitorimit dhe nëpërmjet një sistemi vlerësimesh të shkëputura.

Sistemi i menaxhimit financiar dhe kontrollit kërkon monitorim të vazhdueshëm për të mundësuar vlerësimin sa më të mirë të funksionimit të këtij sistemi, për të bërë përditësimet në kohën e duhur në rast të ndryshimit të rrethanave dhe mënyrave të operacioneve, si dhe për të identifikuar masat që synojnë një zhvillim të vazhdueshëm të sistemit.

Monitorimi është tërësia e proceseve të rishikimit të aktivitetit të njësisë, monitorimi synon të ofrojë garanci të arsyeshme se aktivitetet e kontrollit funksionojnë, sipas qëllimit për të cilin janë krijuar dhe mbeten eficientë me kalimin e kohës.

Monitorimi i sistemit të kontrollit të brendshëm bëhet për të vlerësuar cilësinë e sistemit dhe të performancës në kohë. Vlerësimi dhe monitorimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit duhet të bëhet nëpërmjet: monitorimit të vazhdueshëm, vetëvlerësimit, Auditit të Brendshëm.

Nëpërmjet vetëvlerësimit një përdorues i buxhetit përcakton nëse ka apo jo një sistem të përshtatshëm të menaxhimit financiar dhe kontrollit, në të cilin rregullat dhe procedurat sigurojnë se operacionet janë duke u kryer rregullisht, në mënyrë etike, ekonomike, efikase dhe

efektive. Duke plotësuar pyetësin e vetëvlerësimit çdo nëpunës autorizues për çdo vit përgatit një deklaratë “Deklarata për cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm”, në të cilën ai deklaron se si sistemi i kontrollit të brendshëm mbështet arritjen e politikave të njësisë, qëllimet dhe objektivat, ndërsa ruan fondet publike dhe pasurinë e njësisë ekonomike. Kjo deklaratë duhet të mbulojë vitin financiar paraardhës.

Në deklaratë, nëpunësi autorizues i njësisë publike duhet të përshkruajë dobësitë e sistemit të kontrollit dhe planet për trajtimin e tyre. Me nënshkrimin e deklaratës, drejtuesi i njësisë merr përgjegjësinë për vërtetësinë e informacionit të deklaruar.

Qëllimi i kësaj deklarate është rritja e llogaridhënies së menaxhimit dhe inkurajimi i përpjekjeve për përmirësime në sistemin e kontrollit të brendshëm.

Çdo vit, nëpunësi autorizues i çdo njësie publike duhet të kryejë një vetëvlerësim mbi gjendjen dhe cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm të njësisë, dhe të paraqesë një raport mbi gjetjet e këtij vetëvlerësimi të nëpunësi i parë autorizues në Ministrinë e Financave.

-Bashkia Libohovë me shkresën nr. 368 prot., datë 15.03.2023, ka hartuar dhe dërguar në MFE deklaratën për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm, raportin vjetor për funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe pyetësin e vetëvlerësimit për komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, në funksion të realizimit të pesë fushave në të cilat funksionon MFK, por jashtë afateve të përcaktuara në nenin 18, pika 1, të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar.

Në raportin vjetor për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm të Bashkisë Libohovë për vitin 2022, citohet se:

Gjatë vitit 2022 ashtu si edhe në vitet e kaluara, në Bashkinë Libohovë është kryer auditimi i brendshëm nga grupi i kontrollit të brendshëm.

Gjatë këtij viti, analiza e problemeve financiare u mbështet në raportet periodike mujore, tremujore, dhe vjetore nga drejtuesit e sektorëve përkatës.

Gjatë këtij viti është punuar për realizimin e objektivave dhe detyrimeve ligjore, për identifikimin e fushave në të cilat shkalla e riskut është më e lartë, bërjen e analizave të ndryshme, rishikimeve të transaksioneve dhe aktiviteteve operative dhe propozimin e masave të duhura.

Nga raportet periodike rezultojnë se në institucionin tonë janë respektuar dispozitat ligjore dhe vendimet e këshillit për transaksionet financiare, hartimin dhe zbatimin e buxhetit, si dhe administrimin e aseteve financiare dhe jo financiare.

Grupi i auditimit ka vlerësuar zbatimin e rekomandimeve, i cili do të ndikojë në arritjen e objektivave, si dhe po punojmë në vazhdimësi për zbatimin e këtyre rekomandimeve .

Për sa trajtuar më sipër konstatohet se, në formatin e këtij raporti nuk përfshihen të gjithë kapitujt/elementët e parashikuar në Udhëzimin nr. 28, datë 15.12.2011, “Mbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike”, Shtojca nr. 2, konkretisht:

➤ II. Vlerësimin e sisemit të MFK-së në të cilën përfshihet:

Gjendja aktuale e sistemit të MFK-së; objektivat e përmbushura gjatë periudhës së raportimit si dhe vlerësimin i cili duhet të paraqitet për çdo komponent të menaxhimit financiar dhe kontrollit me fokus kryesisht tek: mjedisi i kontrollit; vendosja e objektivave; identifikimi i ngjarjeve, vlerësimi i riskut; përgjigjja ndaj riskut; aktivitetet e kontrollit; informacioni dhe komunikimi; monitorimi.

➤ III. Gjetjet dhe rekomandimet e auditimit të brendshëm dhe të jashtëm në të cilën përfshihet:

Gjetjet kryesore të auditimit të brendshëm dhe të jashtëm për vitin e raportimit, si dhe rekomandimet kryesore të dhëna nga audituesit për përmirësimet e sistemit të kontrollit të brendshëm.

- IV. Masat e marra gjatë vitit për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësi dhe plan veprimi për të ardhmen në të cilën përfshihet:
Masat e marra nga titullari dhe vetë nëpunësi autorizues gjatë vitit raportues për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, minimizimin e risqeve prioritare që pengojnë përmbushjen e objektivave dhe plan veprimet për të ardhmen bazuar në rekomandimet auditit të brendshëm apo të jashtëm, si dhe menaxherët e njësisë.
- V. Rekomandime të përgjithshme për përmirësimin e kuadrit ligjor dhe nënligjor mbi sistemin e kontrollit të brendshëm në të cilën përfshihet:
Rekomandimet për përmirësimin e legjislacionit në fuqi në fushën e kontrollit të brendshëm, për ndjekje të mtejshme nga njësitë qendrore të harmonizimit të Ministrisë së Financave.
Pjesë e shkresës përcjellëse nr. 368 prot., datë 15.03.2023, është edhe plani i veprimit për menaxhimin financiar dhe kontrollit në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 16, datë 20.07.2016, “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”, pika 2.2, dhe Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin i miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 108, datë 17.11.2016, Kapitulli III.

5. Informimi dhe komunikimi

Titullari i njësisë publike miraton dhe vë në funksionim sisteme informacioni dhe komunikimi që sigurojnë:

- Identifikimin, mbledhjen dhe përhapjen e një informacioni të vërtetë dhe të besueshëm në një format të përshtatshëm, brenda afateve të duhura, duke bërë të mundur që çdo punonjës të marrë përsipër përgjegjësitë përkatëse.
- Një komunikim efektiv, si vertikal ashtu edhe horizontal, në të gjitha nivelet e hierarkisë së njësisë.
- Ngritjen dhe zhvillimin e një sistemi të përshtatshëm të informacionit për menaxhimin e njësisë që ka si qëllim shpërndarjen e udhëzimeve dhe urdhrave të qartë dhe të saktë për rolet e çdo punonjësi të përfshirë në menaxhimin financiar dhe kontrollin.
- Ngritjen e një sistemi për dokumentimin dhe qarkullimin e dokumenteve, që përmbajnë rregullat për përgatitjen, formatimin, lëvizjen, përdorimin dhe arkivimin e dokumenteve, në bazë të rregullave të nxjerra nga Ministri i Financave.
- Dokumentimin e të gjitha këtyre veprimtarive, proceseve dhe transaksioneve, me qëllim që të sigurohet gjurma e duhur e auditimit për vijueshmërinë dhe monitorimin.
Komunikimi është shkëmbimi i informacioneve të dobishme ndërmjet punonjësve të të gjitha niveleve të njësisë publike, si horizontalisht dhe vertikalisht, si dhe ndërmjet njësive publike për të mbështetur vendimet dhe për të koordinuar aktivitetet.
Menaxhimit duhet t’i jepen raporte të nevojshme mbi performancën (përmbushjen e detyrave) e njësisë në raport me objektivat e caktuara, për të bërë të mundur që ata të marrin përsipër përgjegjësitë e tyre me efikasitet dhe efektivitet.
Zhvillimi ose rishikimi i sistemeve të informacionit duhet të bazohet në një plan strategjik për sistemet e informacionit të lidhur me strategjinë e njësisë dhe që ti përgjigjet përmbushjes së objektivave në nivel aktiviteti dhe në nivel objektivash të përgjithshme për mbarë njësinë publike. Mbështetja e menaxhimit për zhvillimin e sistemeve të nevojshme të informacionit duhet të shfaqet me angazhimin e burimeve të përshtatshme njerëzore dhe financiare. Informacioni është i dobishëm vetëm nëse arrin në kohën e duhur, përmban hollësi të mjaftueshme dhe është i përshtatshëm për përdoruesin.

Shkëmbimi i informacionit në Bashkinë Libohovë dhe kanalet e komunikimit të institucionit, si horizontalisht ashtu dhe vertikalisht, funksionojnë, sipas nivelit të hierarkisë në mënyrë shkresore dhe elektronike. Sistemi aktual i komunikimit të institucionit ka nevojë për përmirësim, pavarësisht se informacioni është i mjaftueshëm për zbatimin e detyrave.

Në zbatim të nënpikës nr. 1.2 dhe 1.3, të programit të auditimit nr. 425/1 prot., datë 19.05.2023, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Karta e Auditimit të Njësia e Auditit të Brendshëm në Bashkinë Libohovë.
2. Plani strategjik për vitin 2022 dhe pasqyrat shoqëruese.
3. Planifikimi vjetor për vitin 2022 dhe pasqyrat shoqëruese.
4. Raportimi Vjetor dërguar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Auditit të Brendshëm në MFE për vitin 2022 dhe pasqyrat shoqëruese.
5. Dosjet e përhershme të subjekteve të audituara.
6. Dosjet koherente të subjekteve të audituara.
7. Projekt Raportet dhe Raportet Përfundimtare të realizuara nga Njesia e Auditit të Brendshëm në Bashkinë Libohovë.
8. Rekrutimi i punonjësve në NJAB si dhe ngritja e nivelit profesional të tyre.
9. Akt marrëveshja për organizimin dhe funksionimin e Auditit të Brendshëm në Bashkinë Libohovë.

Organizimi dhe funksionimi i njësisë së auditit të brendshëm publik, kapacitetet audituese që mbulojnë këtë aktivitet, planifikimi, realizimi i programit vjetor të auditimit si dhe kapacitetet audituese të sektorit të auditimit, ndjekja e zbatimit të masave të rekomanduara nga drejtimi.

Pika 1.2. Organizimi i njësisë së auditit të brendshëm.

Auditimi i brendshëm në Bashkinë Libohovë, është siguruar si shërbim auditimi me akt marrëveshjen e lidhur ndërmjet titullarëve të Bashkisë Dropull dhe Libohovë protokolluar respektivisht me nr. 328/1 prot., datë 15.03.2016, dhe nr. 319 prot., datë 15.03.2016, miratuar nga Ministri i Financave me shkresën nr. 4152/1 prot., datë 01.04.2016, dhe rikonfirmuar prej Tij me shkresën nr. 8447 prot., datë 12.05.2021, në zbatim të Ligjit nr. 114/2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, neni 10, shkronja “c”, si dhe neni 64, shkronja “a” të Ligjit nr. 139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, pikat 3 dhe 6, të VKM nr. 83, datë 3.2.2016, “Për miratimin e Kriteve të Krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”, pika 6, gërma “a”.

Struktura e Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Dropull jep shërbim në Bashkinë Libohovë në mbështetje të akt marrëveshjes të sipërpërmendur, kjo strukturë ka filluar funksionimin e saj nga muaji prill 2016, me emërtesën “Njësia e Auditimit të Brendshëm”.

Për vitin 2022 struktura e NJAB funksionon në nivel drejtorie sipas VKB nr. 62, datë 24.11.2021, konfirmuar edhe nga Prefekti i Qarkut Gjirokastrë me shkresën nr. 1075/1 prot., datë 09.12.2021.

Struktura e NJAB është e përbërë nga 5 punonjës konkretisht:

| Numri i punonjësve | Struktura organizative e NJAB për vitin 2022 |
|--------------------|--|
| 1 | Drejtes Njësie |
| 1 | Përgjegjës Njësie |
| 3 | Auditues |

Nga auditim i zbatimit të strukturës organizative të NJAB konstatohet se, kjo strukturë nga 5 punonjës në përbërje të saj, në marrëdhënie pune janë vetëm 3 punonjës konkretisht 1 drejtues njësie, 1 përgjegjës njësie dhe 1 specialist auditimi. Kualifikimet përkatëse sipas fushave të arsimit, certifikimit dhe trajnimit për secilin punonjës të NJAB paraqiten në mënyrë të hollësishme si më poshtë:

| Nr. | Periudha | Funksioni | Arsimimi | Vjetërsi në punë | Vjetërsi në auditim/vite | Çertifikimi | Trajnime të vijueshme |
|-----|----------|--------------------|------------|------------------|--------------------------|---------------|-----------------------|
| 1 | S.K | Drejtori i njësisë | Ekonomist | 37 | 30 | Në vitin 2005 | Po |
| 2 | M.M | Përgjegjës sektori | Ekonomiste | 31 | 26 | Në vitin 2005 | Po |
| 3 | A.P | Auditues | Financier | 13 | 4 | Në vitin 2019 | Po |

Burimi i të dhënave: Bashkia Libohovë.

1. Karta e Auditimit të Brendshëm për NJAB të Bashkisë Dropull (që kryhen shërbim edhe në Bashkinë Libohovë) e cila është aplikuar për vitin 2022 është miratuar me Vendimin nr. 3, datë 18.10.2017. Karta e Auditimit të Brendshëm ka pësuar disa ndryshime miratuar me Vendimin nr. 1, datë 08.10.2020, e cila është dërguar pranë Drejtorisë së Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në MFE me shkresën nr. 1916/1 prot., datë 13.10.2020, në përputhje me Manualin e Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitulli II, pika 2.5.

2. Plani Strategjik është përgatitur dhe dërguar në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në MFE për vitet 2022-2024 me shkresën nr. 1362 prot., datë 19.10.2021, në përputhje me standardin e përcaktuar në Manualin e Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitulli III, pika 3.2. Referuar planit strategjik për vitin 2022 synohen të realizohen 5 auditime.

3. Raporti Vjetor i Veprimtarisë Audituese i miratuar nga titullari i institucionit për vitin 2022, është dërguar me shkresën nr. 319 prot., datë 14.02.2023, në Drejtorinë e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në MFE, bashkëlidhur ndodhen edhe pasqyrat shoqëruese. Dokumentacioni është dërguar në afat shoqëruar edhe me pjesën përshkruese të raportit i përgatitur sipas standardeve që përcakton Manuali i Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitulli III, Pika 3.6.

4. Struktura e Projekt Raporteve dhe Raporteve Përfundimtare të Auditimit për vitin 2022 është hartuar e plotësuar sipas standardeve të vendosura në Manualin e Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitulli IV, Pika 4.1.12, Hapi 11.

5. Dosjet koherente të NJAB për auditimet e realizuara për periudhën objekt auditimi në përgjithësi janë mbajtur të plotësuar në përputhje me kërkesat e Manualit të Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitulli VI, në to është i përfshirë i gjithë informacioni dhe dokumentet e nevojshme. Analiza e detajuar mbi dokumentacionin që përmbajnë dosjet e angazhimeve të realizuara për vitin 2022 nga NJAB paraqiten në aneksin nr. 1, tabela nr. 1, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

Pika 1.3. Vlerësimi mbi veprimtarinë e njësisë së auditit të brendshëm.

Duke u bazuar në Planin Vjetor për vitin 2022, për auditimet të cilat do të realizohen nga NJAB i cili është miratuar me shkresën nr. 319 prot., datë 14.02.2023, kanë qenë objekt auditimi subjektet si më poshtë:

1. Drejtoria e Financës Bashkia Libohovë/Auditimi i detyrimeve të prapambetura.
2. Bashkia Libohovë (Mbi monitorimin e zbatimit të rekomandimeve).
3. Shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Libohovë mbi funksionimin e Shoqërisë.
4. Drejtoria e Financës Ujësjetllës Kanalizime Sh.a Libohovë/Auditimi i detyrimeve të prapambetura.
5. Shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Libohovë (Mbi monitorimin e zbatimit të rekomandimeve).

Vlerësojmë se sipas përcaktimeve të bëra në Manualin e Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin e Ministrisë të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, Seksioni VI, Kreu III, pika 1, programet kanë përmbledhur orientimet kryesore të veprimit në përputhje me risqet dhe problematikat e subjekteve dhe përmbajnë në mënyrë të qartë emërtimin e subjektit, llojin e auditimit, periudhën dhe afatin e misionit, drejtimet dhe grupin e punës. Referuar ligjore të vendosura në programet e auditimit kanë reflektuar dispozitat dhe kuadrin ligjor në fuqi.

Për vitin 2022 referuar planifikimit vjetor janë planifikuar për t'u kryer 5 auditime dhe janë realizuar 5 auditime në masën 100%.

Pasqyra e rekomandimeve të dhëna nga auditimet e realizuara nga NJAB për vitin 2022 dhe faza e zbatueshmërisë së tyre paraqitet në mënyrë të hollësishme si më poshtë:

| VITI 2021 | | | | | | | |
|---------------|--|-----------------------|---------|---------|--------------------|-----------|------------|
| Nr. | Subjekti i Audituar | Numri i rekomandimeve | Pranuar | Zbatuar | Zbatuar pjesërisht | Në proces | Pa zbatuar |
| 1 | Drejtoria e Financës Bashkia Libohovë/Auditimi i detyrimeve të prapambetura. | 3 | 3 | 2 | 0 | 1 | 0 |
| 2 | Bashkia Libohovë (Mbi monitorimin e zbatimit të rekomandimeve). | - | - | - | - | - | - |
| 3 | Shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Libohovë mbi funksionimin e Shoqërisë. | 22 | 22 | | | | |
| 4 | Drejtoria e Financës Ujësjetllës Kanalizime Sh.a Libohovë/Auditimi i detyrimeve të prapambetura. | 2 | 2 | | | | |
| 5 | Shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Libohovë (Mbi monitorimin e zbatimit të rekomandimeve). | - | - | - | - | - | - |
| Totali | | | | | | | |

Burimi i të dhënave: Bashkia Libohovë.

Shënim: 1. Në lidhje me rekomandimet e lëna në auditimet e mëparshme të realizuara në Shoqërinë “Ujësjetllës Kanalizime” Sh.a Libohovë, gjatë vitit 2022, nga NJAB nuk është verifikuar zbatimi/realizimi i tyre, për faktin se me VKM nr. 302, datë 11.05.2022, në të cilën janë përcaktuar politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë, largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujrave të ndotur, për të cilat janë nënshkruar aktmarrëveshjet për funksionimin e tyre në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjitikës, sipas vendimeve respektive të Këshillave Bashkiak të marra për këtë qëllim, janë hequr si objekt auditimi i kësaj njësie.

2. Për sa i përket auditimeve të realizuara “Mbi monitorimin e zbatimit të rekomandimeve”, nuk ka dhënie rekomandimesh, por në zbatim të Udhëzimit të MFE nr. 42, datë 27.10.2020, “Mbi ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga auditimi i brendshëm në sektorin publik”, nga NJAB i rekomandon titullarit të njësisë së audituar, për të marrë masat e nevojshme për zbatimin e tyre.

Vlerësimi i procedurave dhe standardeve të kryerjes së auditimit të brendshëm.

-Nga auditimi i dokumentacionit të dosjeve të përzgjedhura në përgjithësi janë zbatuar kërkesat e Ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe

Manualit të Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016.

-Subjektet e audituara kanë paraqitur Planin e Veprimit për zbatimin e rekomandimeve, në zbatim të Ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe Manualit të Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitulli IV, Pika 4.1.12. Hapi 11, “Raportet e auditimit dhe plotësimi i plan veprimit nga njësia e audituar”.

-Hartimi i Projekt Raporteve dhe Raporteve Përfundimtare është bërë sipas strukturës së miratuar në manualin e auditimit. Për çdo rast si Projekt Raportet edhe Raportet Përfundimtare të Auditimit janë dërguar pranë subjekteve të audituara me shkresa të protokolluara dhe brenda afateve ligjore të përcaktuara në manual. Në dosje janë të administruara komentet në lidhje me gjetjet dhe rekomandimet.

-Me shkresën nr. 294 prot., datë 22.02.2022, është hartuar dhe miratuar Programi i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në Njësisë e Auditimit të Brendshëm për vitin 2022 i cili është dërguar pranë Strukturës Përgjegjëse të Harmonizimit në MFE me shkresën nr. 294/1 prot., datë 22.02.2022.

-Me shkresën nr. 294/2 prot., datë 22.02.2022, është hartuar dhe miratuar Regjistri i Riskut.

-Vlerësimi i Performancës së Veprimtarisë së Auditimit të Brendshëm është dërguar pranë Strukturës Përgjegjëse të Harmonizimit në MFE me shkresën nr. 407/1 prot., datë 03.03.2023.

Pika 2. Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.

2.1. Programimi PBA dhe programimi i buxhetit vjetor për vitin 2022.

Nga auditimi i procedurave për përgatitjen PBA-së për vitet 2022-2024, u konstatua se janë realizuar fazat e përgatitjes konkretisht, është bërë ngritja e grupit të punës, është bërë marrja e kërkesave për nevojat për punë, mallra e shërbime, llogaritja e planifikimit për të ardhurat e veta, përcaktimi i taveve të shpenzimeve sipas programeve, etj.. Nga Bashkia Libohovë janë dokumentuar dhe ndjekur të gjitha hapat e tjera në vijim si dhe është publikuar dokumenti i parë i PBA-së. Në dokumentin e PBA-së janë përcaktuar tendencat e politikave të shpenzimeve sipas funksioneve, si dhe është bërë analiza e zërave të buxhetit në tre vite dhe tendencat nga viti në vit për tre vitet që përfshin kjo PBA.

Për hartimin e programit buxhetor afatmesëm dhe projektbuxhetit vjetor janë kryer konsultime me komunitetin dhe grupet e interesit në njësinë e vetëqeverisjes vendore. Buxhetet janë hartuar mbi bazën e kërkesave shkresore nga njësitë administrative, drejtoritë e shkollave, sektorët e bashkisë, Ujësjellës Kanalizime Libohovë Sh.a etj., gjë e cila vërteton se prej tyre janë marrë kërkesat për nevojat reale e mbi bazën e tyre dhe të buxhetit faktik të mundshëm janë përzgjedhur ato më prioritare.

| | |
|------------------------------|---|
| 2. Titulli i gjetjes: | Nga Kryetari i Bashkisë Libohovë nuk janë marrë masat e duhura për ngritjen e Ekipeve të Menaxhimit të Programeve për hartimin dhe planifikimin e PBA-së. |
| Situata: | Me Urdhrin nr. 15, datë 10.03.2021, të Kryetarit të Bashkisë znj. L.M është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) i përbërë nga 6 anëtarë për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm për vitet 2022-2024. Në urdhrin për ngritjen e GMS nuk janë ngritur Ekipeve të |

| | |
|------------------------|---|
| | Menaxhimit të Programeve (EMP) për Bashkinë Libohovë të cilat përfaqësojnë nivelin teknik menaxhial të procesit të planifikimit të Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA), ku fokusohen në dy çështje kryesore së pari, roli i ri i stafit teknik në procesin buxhetor (përgatitje e PBA) dhe së dyti aspektet konceptuale të programeve buxhetore, definimi i qëllimeve të politikave që lidhen me funksionet që mbulon një program i caktuar buxhetor, objektivat specifike për 3 vitet e PBA-së, produktet dhe shërbimet konkrete që duhen realizuar për arritjen e tyre, si dhe treguesit përkatës të performancës. |
| Kriteri: | Udhëzimi nr. 23, datë 30.07.2018, “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësisë të vetëqeverisjes vendore”, pikat 34-41. |
| Ndikimi/Efekti: | Mungesa e Ekipeve të Menaxhimit të Programeve ndikon në mos funksionimin e të gjitha hallkave të njësisë për hartimin dhe planifikimin e PBA-së. |
| Shkaku: | Mos zbatimi i dispozitave ligjore përkatëse. |
| Rëndësia: | E mesme. |
| Rekomandim: | Nga Kryetari i Bashkisë Libohovë të merren masa që për hartimin dhe planifikimin e programit afatmesëm buxhetor, së bashku urdhrin për krijimin e grupin e menaxhimit strategjik të ngrihen Ekipeve të Menaxhimit të Programeve. |

| | |
|------------------------------|--|
| 3. Titulli i gjetjes: | Nga Bashkia Libohovë projekt-vendimi dhe relacioni për buxhetin e vitit 2022 është dërguar jashtë afateve pranë Këshillit Bashkiak. |
| Situata: | <p>Për vitin 2022, buxheti bazë/fillestar vjetor (në bazë të vlerësimit të të ardhurave dhe të transfertave të pakushtëzuara, të përcaktuara në ligjin e buxhetit vjetor) është në vlerën 146,407,000 lekë, i miratuar me VKB nr. 64, datë 29.12.2021, “Për miratimin e buxhetit për vitin 2022”, por jashtë afateve të parashikuara në Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 41, “Përgatitja dhe miratimi i buxhetit vjetor”, pika 3, ku përcaktohet që: “Bazuar në vlerësimin e të ardhurave dhe të transfertave të pakushtëzuara të përcaktuara në ligjin e buxhetit vjetor, këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore, jo më vonë se data 25 dhjetor, miraton projektbuxhetin sipas përcaktimeve në shkronjat “a”, “b”, “c” e “ç”, të pikës 3, të nenit 40, të këtij ligji”.</p> <p>Vendimi i miratuar nga Këshilli Bashkiak është bazuar në projektvendimin dhe relacionin e hartuar nga Shefi i Sektorit të Financës znj. E.P dhe miratuar nga Kryetari i Bashkisë znj. L.M sipas shkresës me nr. 1729 prot., datë 22.12.2021, “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Libohovë për vitin 2022 dhe PBA përfundimtare 2022-2024”. Ky dokumentacion është dërguar pranë Këshillit Bashkiak jashtë afateve të parashikuara në Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 41, “Përgatitja dhe miratimi i buxhetit vjetor”, pika 1, ku përcaktohet që: “Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore paraqet për miratimin në këshill projektbuxhetin vjetor, sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 40, të këtij ligji, jo më vonë se data 30</p> |

| | |
|------------------------|--|
| | nëntor e vitit buxhetor”. |
| Kriteri: | Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 41, “Përgatitja dhe miratimi i buxhetit vjetor”, neni 41, pika 1 dhe 3. |
| Ndikimi/Efekti: | Dërgimi i projektvendimit dhe relacionit për miratimin e buxhetit jashtë afateve ligjore ndikon në vendimarrjen e gabuar për shkak të afateve kohore jo të mjaftueshme. |
| Shkaku: | Mos respektimi i afateve për miratimin e buxhetit. |
| Rëndësia: | E mesme. |
| Rekomandim: | Nga Kryetari i Bashkisë Libohovë dhe Sektori i Financës të merren masa që projektvendimi dhe realicioni për buxhetin vjetor të dërgohet për miratim pranë Këshillit Bashkiak brenda afateve ligjore. |

Gjithashtu VKB nr. 64, datë 28.12.2021, “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Libohovë për vitin 2022”, është konfirmuar nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Gjirokastrë me shkresën nr. 13/1 prot., datë 17.01.2022.

Në këtë VKB janë miratuar “Të ardhura nga burimet e veta të planifikuara për vitin 2022” në vlerën 23,616,000 lekë, “Transferta e pakushtëzuar” në vlerën 49,802,000 lekë dhe “Transferta specifike” në vlerën 72,990,000 lekë. Në total të ardhurat kanë vlerën 146,407,000 lekë po ashtu edhe shpenzimet kanë vlerën 146,407,000 lekë.

Të dhënat për PBA dhe projekt buxhetin për vitin 2022 paraqitet sipas tabelave në vijim:

Në mijë lekë

| Llogaria | Emërtimi | Buxheti Faktik 2021 | Faza e I PBA 2022 | Faza e II PBA 2022 | Projekt Buxhet 2022 |
|------------|--|---------------------|-------------------|--------------------|---------------------|
| 600 | Paga | 51,198 | 0 | 85,984 | 85,655 |
| 601 | Sigurime Shoqërore | 8,335 | 0 | 13,503 | 13,419 |
| 602 | Mallra dhe Shërbime të Tjera | 21,268 | 0 | 28,096 | 28,317 |
| 603 | Subvencione | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 604 | Transferta Korente të Brendshme | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 605 | Transferta Korente të Huaja | 100 | 0 | 0 | 3,803 |
| 606 | Transferta për Buxhete Familjarë & Individë | 27,175 | 0 | 350 | 0 |
| I | Shpenzime Korrente | 108,076 | 0 | 127,933 | 131,195 |
| 230 | Kapitale të Patrupëzuara | 410 | 0 | 250 | 250 |
| 231 | Kapitale të Trupëzuara | 155,501 | 0 | 12,570 | 14,963 |
| | Shpenzime Kapitale me financim të brendshëm | 155,911 | 0 | 0 | 0 |
| 230 | Kapitale të Patrupëzuara | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | Shpenzime Kapitale me financim të huaj | 0 | 0 | 12,820 | 15,213 |
| II | Shpenzime Kapitale | 0 | 0 | 0 | 0 |
| III | Shpenzime nga Të ardhurat jashtë limiti | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | I+II +III Totali i Shpenzimeve | 263,987 | 0 | 140,753 | 146,407 |

Burimi i të dhënave: Bashkia Libohovë.

Në mijë lekë

| Emërtimi | Viti 2019 | Viti 2020 | Viti 2021 | Viti 2022 |
|---------------------|-----------|-----------|-----------|-----------|
| Të ardhurat faktike | 159,944 | 187,421 | 152,410 | 266,228 |
| Shpenzimet faktike | 120,659 | 154,143 | 112,598 | 218,785 |

Burimi i të dhënave: Bashkia Libohovë.

Përgjatë vitit 2022, janë marrë gjithashtu edhe disa vendime të tjera të Këshillit Bashkiak të cilat kanë bërë që të ndryshojnë vlerat e buxhetit bazë (të miratuar në muajin dhjetor të vitit 2022 me VKB nr. 64, datë 29.12.2022). Këto ndryshime paraqiten si më poshtë:

-Me Vendimin nr. 13, datë 08.04.2022, të Këshillit Bashkiak protokolluar me shkresën nr. 475 prot., datë 08.04.2022, është miratuar buxheti shtesë mbi rialokimin e fondeve të trashëguara nga viti 2021, duke planifikuar të ardhura dhe shpenzime për transfertë të pakushtëzuar dhe transfertë të pa kushtëzuar sektoriale në vlerën -4,292,775 lekë dhe shtesë në të ardhurat e veta në vlerën 1,210,466 lekë.

-Me Vendimin nr. 22, datë 12.05.2022, të Këshillit Bashkiak protokolluar me shkresën nr. 659 prot., datë 13.05.2022, janë miratuar ndryshmet fondesh në disa artikuj buxhetor konkretisht, pakësohet Grupi 00, Kapitulli 05, Titulli 01110, Artikulli 230 “Hartim projektesh” në vlerën 250,000 lekë, Grupi 00, Kapitulli 05, Titulli 08220, Artikulli 231 “Restaurimi i Shtëpisë së Kulturës Libohovë” në vlerën 100,000 lekë, Grupi 00, Kapitulli 01, Titulli 04530, Artikulli 231 “Restaurim i çezmës së fshatit Nepravisht” në vlerën 400,000 lekë, Grupi 00, Kapitulli 01, Titulli 01110, Artikulli 600 “Paga bazë” në vlerën 557,000 lekë, Grupi 00, Kapitulli 01, Titulli 01110, Artikulli 601 “Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore” në vlerën 89,000 lekë, Grupi 00, Kapitulli 05, Titulli 01110, Artikulli 600 “Pagë bazë” në vlerën 132,000 lekë, Grupi 00, Kapitulli 05, Titulli 01110, Artikulli 601 “Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore” në vlerën 21,000 lekë, Grupi 00, Kapitulli 01, Titulli 09120, Artikulli 231 “Rikonstruksion dhe ndërtim palestere në Shkollën 9 vjeçare “Avni Rustemi”” në vlerën 937,387 lekë dhe shtohet Grupi 00, Kapitulli 01, Titulli 01110, Artikulli 6027 “Shpenzime për kompensime të tjera të papaguara” në vlerën 2,486,387 lekë.

-Me Vendimin nr. 25, datë 18.05.2022, të Këshillit Bashkiak protokolluar me nr. 680 prot., datë 18.05.2022, janë miratuar ndryshmet fondesh në disa artikuj buxhetor konkretisht, pakësohet Grupi 00, Kapitulli 01, Titulli 05100, Artikulli 231 “Blerje mjet pastrimi dhe kontenier” në vlerën 9,743,676 lekë dhe shohet Grupi 00, Kapitulli 05, Titulli 05100, Artikulli 231 “Blerje mjet pastrimi dhe kontenier” në vlerën 9,743,676 lekë.

-Me Vendimin nr. 38, datë 05.07.2022, të Këshillit Bashkiak protokolluar me nr. 929 prot., datë 06.07.2022, është miratuar përdorimi i fondit rezervë konkretisht, pakësohet Grupi 00, Kapitulli 05, Titulli 04980, Artikulli 609 në vlerën 100,000 lekë dhe shtohet Grupi 00, Kapitulli 05, Titulli 06330, Artikulli 604 “Blerje elektropompe” në vlerën 100,000 lekë.

-Me Vendimin nr. 51, datë 26.09.2022, të Këshillit Bashkiak protokolluar me nr. 1312 prot., datë 03.10.2022, është miratuar përdorimi i fondit rezervë konkretisht, pakësohet Grupi 00, Kapitulli 05, Titulli 04980, Artikulli 609 në vlerën 267,803 lekë dhe shtohet Grupi 00, Kapitulli 05, Titulli 01110, Artikulli 231 “Rikonstruksion ndërtese” në vlerën 267,803 lekë.

-Me Vendimin nr. 52, datë 26.09.2022, të Këshillit Bashkiak protokolluar me nr. 1313 prot., datë 03.10.2022, është miratuar përdorimi i fondit të emergjencës konkretisht, pakësohet Grupi 00, Kapitulli 05, Titulli 04980, Artikulli 609 në vlerën 150,000 lekë dhe shtohet Grupi 00, Kapitulli 05, Titulli 01110, Artikulli 602 “Shpenzime prerje rrafi” në vlerën 150,000 lekë.

-Me Vendimin nr. 67, datë 14.12.2022, të Këshillit Bashkiak protokolluar me nr. 1702 prot., datë 14.12.2022, është miratuar një shtesë fondesh në Vendimin nr. 64, datë 29.12.2021, të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Libohovë për vitin 2022” konkretisht, shtohet Grupi 00, Kapitulli 01, Titulli 09120, Artikulli 2312 “Shpenzime për ndërtime e konstruksione” në vlerën 937,387 lekë dhe Grupi 00, Kapitulli 05, Titulli 01110, Artikulli 6027, “Shpenzime për kompesime të tjera të papaguara” në vlerën 375,613 lekë.

-Lista e investimeve të reja të parashikuara në buxhetin vjetor të vitit 2022 nga të ardhurat e veta janë në vlerën 11,170 mijë lekë dhe nga granti në vlerën 600 mijë lekë. Analiza e detajuar paraqitet në aneksin nr. 2, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

-Planifikimi i të ardhurave për vitin 2022 është në vlerën 42,729 mijë lekë ndërsa shpenzimet në vlerën 146,407 mijë lekë. Analiza e detajuar paraqitet në aneksin nr. 2, tabela nr. 1, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

-Planifikimi i detyrimeve të prapambetura në planin e vitit buxhetor për vitin 2022, paraqitet në aneksin nr. 2, tabela nr. 1, dhe nr. 2, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

2.2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fonde të çelura.

Krahasimi planeve buxhetore me PBA respektive:

PBA 2022-2024 me planin buxhetor 2022, paraqitet në tabelën e mëposhtme:

| Në mijë lekë | | | | |
|-------------------------------------|---|------------------------|---------------------|---------------|
| Nr. | Emërtimi | Plan përfundimtar 2022 | Sipas PBA 2022-2024 | Ndryshimi |
| 1 | Shpenzime për pagat (600; 601) (nga të ardhurat e grantit të pakushtëzuar specifik) | 35,052 | 39,619 | (4,567) |
| 2 | Shpenzime (602; 604; 609) (nga të ardhurat e grantit të pakushtëzuar e specifik) | 19,624 | 13,261 | 6,003 |
| 3 | Investime Bashkia (nga të ardhurat e grantit të pakushtëzuar) | 1,944 | 900 | 1,044 |
| 4 | Investime nga FZSH | 0 | 0 | 0 |
| Total i planit fillestar | | 56,620 | 53,780 | 2,840 |
| 5 | Investime grant i kushtëzuar | 95,386 | 11,920 | 83,466 |
| 6 | Shpenzime për pagat (600; 601) | 55,618 | 59,868 | -4,250 |
| 7 | Shpenzime (602; 604; 609) | 16,719 | 15,234 | 1,485 |
| 8 | Grant i kushtëzuar (230-231) | 0 | 0 | 0 |
| Shtesat nga Pushteti Qendror | | 167,723 | 87,022 | 80,701 |
| Grand totali | | 223,983 | 140,807 | 83,181 |

Burimi i të dhënave: Bashkia Libohovë.

Plani buxhetor vjetor 2022 është më i lartë se plani vjetor 2022 në PBA, në shumën 83,181 mijë lekë për arsye se:

-Në planin përfundimtar të vitit 2022 janë pasqyruar shpenzimet e financuara me fondet nga pushteti qendror, investime nga grant i kushtëzuar, shpenzime për paga dhe operative, në shumën 167,723 mijë lekë. Në fazat e përgatitjes së PBA fondet e kushtëzuara nuk janë të njohura/akorduara dhe nuk janë të llogaritura/të përfshira në planin buxhetor.

-Në planin përfundimtar të vitit 2022 janë pasqyruar shtesat e ndryshimet e bëra në buxhet gjatë vitit 2022, me burim financimi fondet e veta dhe nga grant i pakushtëzuar specifik, në total 56,620 mijë lekë. (Sipas VKB-ve të përmenduar në paragrafet e mëparshëm).

Në programet buxhetore është bërë shpërndarja e fondeve të vënë në dispozicion nga Pushteti Qendror të grandeve nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar, transfertës së kushtëzuar dhe fondeve të krijuar nga burimet e veta, për kryerjen e funksioneve të veta, ato të deleguara dhe të përbashkëta si dhe shpërndarjen e fondeve të grandeve.

Ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit. Gjatë vitit si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për funksionet e deleguara, grandeve qeveritare, ndihma ekonomike, gjendja civile, shpërblime lindje, etj., të cilat nuk kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestare të vitit.

Gjatë viteve janë kryer ndryshime në buxhet (shtesa/paksime). Këto lëvizje në rastet e lëvizjeve brenda të njëjtit artikull dhe brenda programit janë kryer me urdhër të Titullarit e përcaktuar kjo me VKB, ndërsa lëvizjet nga programi në program dhe nga një artikull në tjetrin janë kryer me Vendim të KB.

-Në hartimin e projekt buxhetit vjetor, janë marrë në konsideratë kërkesat e dokumentuara të sektorëve, por kryesisht realizimi i artikujve buxhetorë për vitin buxhetor paraardhës.

-Planifikimi dhe detajimi i buxhetit në nivel artikulli dhe nënartikulli, është bërë sipas nevojave të paraqitura dhe kërkesave për fonde buxhetore, duke u bazuar në kërkesat e udhëzimeve përkatëse “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.

-Akordimi fillestar i buxhetit dhe ndryshimet që kanë pësuar zërat e tij gjatë vitit, janë të rakorduar me Degën e Thesarit Gjyrokastër dhe janë të raportuara periodikisht pranë degës së Thesarit dhe në MFE. Situacionet e shpenzimeve janë të plotësuara sipas klasifikimit buxhetor për të gjithë periudhën e audituar. Fondet e akorduara në planet buxhetore dhe ndryshimet e bëra në periudha të ndryshme, janë evidentuar dhe janë ndjekur në dinamikë, në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nënartikulli sipas shërbimeve dhe më vete për çdo njësi vartëse e sipas periudhave të planifikuara.

-Analiza e shpenzimeve buxhetore për artikuj dhe nënartikuj është bërë periodikisht mbi bazën e situacioneve mujore të konfirmuara nga Dega e Thesarit. Raportimi i realizimit të buxhetit është i shoqëruar me relacionin e realizimit të buxhetit duke argumentuar edhe shtesat e buxhetit gjatë periudhës ushtrimore për zërat e buxhetit të planifikuara dhe që nuk janë alokuar fonde që në fillim të çeljes së buxhetit.

Janë kryer ndryshime të vazhdueshme në buxhetin vjetor, veprime që tregojnë se planifikimi i buxhetit duhet të bëhet më i argumentuar, në mënyrë që gjatë vitit ndryshimet të jenë sa më të vogla.

Të dhënat mbi ndryshimin e buxhetit paraqitet si më poshtë:

Lekë

| Periudha buxhetore | Ndryshime gjatë vitit | | Artikujt në të cilët kanë ndodhur ndryshimet buxhetore | | | |
|-------------------------|-------------------------|-----------|--|-----------|----------|-----------|
| | Numër/Datë | Vlera | Pakësimet dhe shtesat e artikujve | | | |
| | | | Shtesë | Vlera | Pakësim | Vlera |
| 2022 | | | | | 230 | 250,000 |
| | | | | | 231 | 1,437,387 |
| | | | | | 600 | 689,000 |
| | Nr. 22, datë 12.05.2022 | 2,486,387 | 231 | 2,486,387 | 601 | 110,000 |
| | Nr. 25, datë 18.05.2022 | 9,743,676 | 231 (1) | 9,743,676 | 2321 (5) | 9,743,676 |
| | Nr. 38, datë 05.07.2022 | 100,000 | 604 | 100,000 | 609 | 100,000 |
| | Nr. 52, datë 26.09.2022 | 150,000 | 602 | 150,000 | 609 | 150,000 |
| Nr. 52, datë 26.09.2022 | 267,803 | 231 | 267,803 | 609 | 267,803 | |

Burimi i të dhënave: Bashkia Libohovë.

Shënim: Në mënyrë analitike paraqiten sipas VKB-ve përkatëse në nënpikën nr. 2.1. “Programimi PBA dhe programimi i buxhetit vjetor për vitin 2022”, të këtij aktkonstatimit.

2.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit. Mënyra e përdorimit të të ardhurave.

Për zbatimin e buxhetit është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit Gjyrokastër, si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt-rakordimet përkatëse. Janë ruajtur kufijtë e miratuar të shpenzimeve në total për çdo artikull e nënartikull sipas klasifikimit ekonomik. Pasqyra e realizimit të treguesve të buxhetit për vitin 2022, referuar akt-rakordimeve me Thesarin paraqiten në mënyrë analitike si më poshtë:

Në mijë lekë

| Emërtimi i shpenzimeve | Artikulli | Plani | Fakti |
|--|-----------|--------|--------|
| Paga | 600 | 78,611 | 51,612 |
| Sigurime shoqërore | 601 | 12,059 | 8,611 |
| Shpenzime operative | 602 | 33,308 | 21,494 |
| Transferime korrente tek nivele të tjera të Qeverisë | 604 | 600 | 201 |
| Transferata në buxhete familjare | 606 | 40,234 | 40,120 |
| Fondi rezervë | 609 | 2,435 | 0 |
| Investime | 231 | 97,329 | 95,136 |

| | | | |
|--|-----|----------------|----------------|
| Shuma nga plani i Bashkisë | | 264,576 | 217,174 |
| Transferta buxhetore paaftësi e ndihmë ekonomike | 606 | 1,650 | 1,610 |
| Shuma totale Bashkia | | 266,227 | 218,784 |

Burimi i të dhënave: Bashkia Libohovë.

Në mijë lekë

| Buxheti përfundimtar Plan-Fakt Bashkia Libohovë, për vitin 2022 | | | | | | | | | | | |
|--|--------------------------------------|----------------|----------------|----------------|------------------------|---------------|---|--------------------------------|--|---|---|
| Burimi i financimit të shpenzimit | | | | | | | | | | | |
| Nr. | Përshkrimi Shpenzimeve | Plani | Fakti | Realizimi në % | Nga të ardhurat e veta | | % e realizimit të buxhetit nga të ardhurat e veta | Nga Granti Qeveritar | | | |
| | | | | | Plan | Fakt | | Nga transfertat e pakushtëzuar | Nga transfertat e kushtëzuar specifike | Nga transfertat e kushtëzuar për funksionet e deleguara | Nga transfertat e kushtëzuar për investimet |
| 1 | Paga 600 | 78,611 | 51,612 | 65.6% | 6,271 | 2,873 | 45.8% | 24,122 | 0 | 24,617 | 0 |
| 2 | Sigurime shoqërore 601 | 12,059 | 8,611 | 71.4% | 1,094 | 810 | 74% | 3,778 | 0 | 4,023 | 0 |
| 3 | Shpenzime operative 602 | 33,309 | 21,494 | 64.5% | 3,528 | 2,147 | 60.7% | 12,995 | 0 | 6,354 | 0 |
| 4 | K. Q Emergj Civile 604 | 600 | 201 | 33.5% | 600 | 201 | 33.5% | 0.03 | 0 | 0 | 0 |
| 5 | Ndihmë Ekonomike dhe Invaliditet 606 | 41,884 | 41,730 | 99.6% | 950 | 348 | 36.6% | 8,80 | 0 | 40,502 | 0 |
| 6 | Fondi Rezervë 609 | 2,435 | 0 | 0 | 2,435 | | - | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 7 | Investime 230-231 | 97,330 | 95,136 | 97.7% | 12,963 | 11,218 | 86.5% | 83,918 | 0 | | 0 |
| Totali | | 266,228 | 218,784 | 82.1% | 27,242 | 17,595 | 64.5% | 125,693 | 0 | 75,496 | 0 |

Burimi i të dhënave: Bashkia Libohovë.

| | |
|------------------------------|--|
| 4. Titulli i gjetjes: | Diferenca të dukshme midis vlerës së planifikuar të shpenzimeve buxhetore dhe vlerës së realizuar, për zërat të cilët mbulohen nga të ardhurat e veta. |
| Situata: | <p>Realizimi i shpenzimeve buxhetore vetëm me të ardhurat e vetë Bashkisë Libohovë së bashku me transfertat e pa kushtëzuara për vitin 2022, ka diferencë të dukshme me vlerën e planifikuar. Për vitin 2022 planifikimi i shpenzimeve është në vlerën 266,228 mijë lekë ndërsa realizimi në vlerën 218,784 mijë lekë ose në masën 82.1% pra kemi një mosrealizim të fondeve në vlerën 47,444 mijë lekë.</p> <p>Në mosrealizim e buxhetit ka ndikuar niveli i realizimit të artikujve si, 600 “Paga dhe përfitimet e punonjësve”, 601 “Kontributi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”, 602 “Blerje mallra dhe shërbime” dhe 230-231 “Investime”.</p> <p>Kjo situatë vjen si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave, që do të thotë se nga Bashkia Libohovë në fillim të vitit buxhetor planifikohen angazhime buxhetore, duke mos u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifatat vendore dhe ky planifikim nuk korrigjohet gjatë vitit, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat reale të realizuara. Në mënyrë të detajuar paraqitet analiza mbi realizimin e fondeve buxhetore për secilin artikull si më poshtë:</p> <p>-Artikulli 600 “Paga dhe përfitimet e punonjësve” është planifikuar në vlerën 78,611 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 51,612 mijë lekë ose në masën 65.6% pra kemi një mosrealizim të fondeve buxhetore për këtë artikull në vlerën 26,999 mijë lekë. Nga auditimi i zbatimit të strukturës organizative konstatohet se, struktura është e përbërë nga 92 punonjës</p> |

| | |
|------------------------|---|
| | <p>ndërsa realizimi është mesatarisht 90 punonjës për çdo muaj me një diferencë prej vetëm 2 punonjës. Diferenca në vlerën 26,999 mijë lekë për këtë artikull është e pa argumentuar për shkak se, struktura oragnizative funksionon me kapacitet të plotë.</p> <p>-Artikulli 601 “Kontributi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore” është planifikuar në vlerën 12,059 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 8,611 mijë lekë ose në masën 71.4% pra kemi një mosrealizim të fondeve buxhetore për këtë artikull në vlerën 3,448 mijë lekë.</p> <p>-Artikulli 602 “Mallra dhe shërbime të tjera” është planifikuar në vlerën 33,309 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 21,494 mijë lekë ose në masën 64.5% pra kemi një mosrealizim të fondeve buxhetore për këtë artikull në vlerën 11,815 mijë lekë.</p> <p>-Artikulli 230-231 “Investime” është planifikuar në vlerën 97,330 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 95,136 mijë lekë ose në masën 97.7% pra kemi një mosrealizim të fondeve buxhetore për këtë artikull në vlerën 2,194 mijë lekë.</p> |
| Kriteri: | <p>Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar me Ligji nr. 114/2012, datë 07.12.2012, dhe Ligji nr. 57/2016, datë 02.06.2016, nenet 2, 3, 6, 9, 10, 15, 27 dhe 32, Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 9 pika 1.3 gërma “c” dhe “ç”, Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore” nenet 3-4, neni 46, UMFE nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, nenet 79, 80 dhe 81, UMFE nr. 22, datë 30.07.2018, “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetëqeverisjes vendore”; UMFE nr. 23, datë 22.11.2016, “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm” dhe VKB përkatëse.</p> |
| Ndikimi/Efekti: | <p>Planifikimi i zërave të shpenzimeve dhe mos realizimi i tyre për shkak të planifikimit jo të mbështetur në të ardhurat reale, bënë që pritshmëritë sidomos në investime të mos përputhen me planifikimin, plotësimin e nevojave reale të planifikuara dhe ulje të performancës të njësisë vendore.</p> |
| Shkaku: | <p>Planifikim i pa studiuar mirë i buxhetit.</p> |
| Rëndësia: | <p>E lartë.</p> |
| Rekomandim: | <p>Bashkia Libohovë, nëpërmjet Sektorit të Financës dhe Sektorit të Tatim Taksave, të marrë masa për një planifikim të studiuar të të ardhurave të veta, duke u mbështetur mbi parashikime të studiuara dhe realiste. Mbi bazën e këtyre të ardhurave të parashikohet edhe plani investimeve publike, me qëllim që investimet e planifikuara në buxhet të kenë burime financimi të sigurt për tu realizuar. Nëse gjatë vitit ka mosrealizim të të ardhurave të planifikuara, atëherë me vendim të këshillit bashkiak, duhet të korrigjohet edhe plani i shpenzimeve, brenda afateve që përcakton kuadri rregullator në fuqi.</p> |

Miratimi dhe përdorimi i fondit rezervë dhe fondit për emergjencën civile: Vlerat e llogaritura për këtë qëllim: Fondi rezervë dhe i emergjencës paraqitet në shumën 3,035 mijë lekë.

Fondi Rezervë: Bazuar në Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore” dhe Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 6, për të përballuar shpenzime të paparashikuara në buxhetin e njësisive të qeverisjes vendore, është krijuar fondit rezervë. Në buxhetin e vitit 2022 është planifikuar fond rezervë në vlerën 2,435 mijë lekë. Fondi rezervë nuk është përdorur për periudhën janar-dhjetor 2022.

Fondet e Emergjencës dhe për Mbrojtjen Civile: Në zbatim të Ligjit nr. 45/2019, datë 18.07.2019, “Për mbrojtjen civile”, neni 65, fondi i emergjencave civile planifikohet në shumën totale minimalisht 4% të totalit të buxhetit të Bashkisë, të cilat sigurohen nga fondet e kushtëzuara të buxhetit të shtetit. Në buxhetin e Bashkisë janë parashikuar nga të ardhurat e veta fonde për emergjencën në shumën 600 mijë lekë. Për periudhën janar-dhjetor 2022 është përdorur fondi i emergjencës civile në vlerën 201 mijë lekë ose në masën 33.5%, sipas VKB përkatëse.

Subvencione: Për periudhën janar-dhjetor 2022 Bashkia Libohovë nuk ka përfituar subvencione si dhe nuk ka subvencionuar.

Kredi të marra: Për periudhën janar-dhjetor 2022 nga Bashkia Libohovë nuk ka marrë kredi.

Raportimi mbi realizimin e buxhetit:

| | |
|------------------------------|--|
| 5. Titulli i gjetjes: | Mos hartimi i raporteve 4 mujore të monitorimit për zbatimin e buxhetit. |
| Situata: | Nga auditimi konstatohet se, nuk janë zbatuar detyrimet ligjore për hartimin e raporteve të monitorimit të zbatimit të buxhetit për vitin 2022, pasi nuk janë hartuar raporte 4 mujore gjatë vitit, por është hartuar vetëm raporti vjetor sipas shkresës nr. 300 prot., datë 28.02.2023, duke mos informuar Këshillin Bashkiak dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për situatën e zbatimit të buxhetit gjatë vitit buxhetor. |
| Kriteri: | Udhëzimi nr. 22, datë 30.07.2018 “ Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e vetëqeverisjes vendore”, pika 19 dhe pikat 22-23. |
| Ndikimi/Efekti: | Mos informimi i Këshillit Bashkiak dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për situatën e zbatimit të buxhetit gjatë vitit buxhetor. |
| Shkaku: | Mos zbatim i dispozitave ligjore përkatëse. |
| Rëndësia: | E mesme. |
| Rekomandim: | Nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues të marrin masa që gjatë vitit buxhetor të hartohen raporte 4 mujore të monitorimit të zbatimit të buxhetit për performancën financiare, me të cilat të njihet këshilli bashkiak dhe njëkohësisht të dërgohen edhe në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë. |

2.4. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikuiduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve; (Faturat e palikuiduara të shoqërohen me listë analitike, të detajuara me numër fature dhe datë krijimi etj., sipas raportimit në MF, ku të evidentohen detyrimet nga mungesa e burimeve të veta dhe detyrimet nga mungesa e alokimit të granteve si FZHR, Ministrinë e linjës etj.,).

Vlera e raportuar nga Bashkia Libohovë në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për detyrimet e prapambetura deri më datën 31.12.2022, është në vlerën 28,894,056 lekë.

Detyrimet e prapambetura për vitin 2022:

| | |
|------------------------------|--|
| 6. Titulli i gjetjes: | Mos marrja e masave të duhura për uljen e vlerës së detyrimeve të prapambetura për vitin 2022. |
| Situata: | <p>Bashkia Libohovë nuk ka marrë masa të plota për likuidimin e detyrimeve të prapambetura, pasi niveli i shlyerjes së tyre gjatë vitit buxhetor 2022 është i ulët krahasuar me vlerën e planifikimin në buxhet, si dhe janë krijuar gjatë vitit detyrime të reja të prapambetura.</p> <p>Vlera progressive e detyrimeve të prapambetura në datën 01.01.2022, si çelje e vitit ushtrimor, me burim financimi nga të ardhurat e veta, duke përfshirë edhe transfertën e pa kushtëzuar, është 5,698,722 lekë, e cila është planifikuar e gjithë për shlyerje në planin e buxhetit vjetor 2022, por në fakt është likuiduar gjatë këtij viti vetëm vlera 2,782,599 lekë, ose 49% e vlerës së planifikuar, ngelur pa u likuiduar më 31.12.2022 vlera 2,916,123 lekë. Gjithashtu gjatë vitit 2022 janë krijuar detyrime të reja të prapambetura në vlerën 25,977,933 lekë, duke e çuar në total këtë vlerë më 31.12.2022 në 28,894,056 lekë. Peshën kryesore të këtyre detyrimeve e zënë detyrimet për vendimet gjyqësore në vlerën 14,585,976 lekë, detyrimet për shërbime në vlerën 10,918,618 lekë dhe detyrimet për investime në vlerën 2,653,642 lekë.</p> <p>Të dhëna në formë tabele për detyrimet e prapambetura jepen në tabelën në vijim. Sipas të dhënave nga Bashkia Libohovë, nuk ka detyrime të prapambetura me burim financimit grantin qeveritar të kushtëzuar.</p> |
| Kriteri: | Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 52, Udhëzimi nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 153-162, Rubrika-Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike, detyrimet kontraktuale midis palëve dhe Udhëzimi nr. 5, datë 27.12.2014, “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, pikat 82-91. |
| Ndikimi/Efekti: | Likuidimi me ritme të ngadalta të detyrimeve të prapambetura, përveçse është moszbatim i kuadrit rregullator në fuqi, e vë nën shprehje vendore në kushtet e palës përgjegjëse ndaj kreditorëve. Ndodhur në kushtet kur është shkelur marrëveshja e përcaktuar në kontratë me kreditorët për afatin e kryerjes së këtyre pagesave, krijohen premisa që kreditorët nëpërmjet proceseve gjyqësore, përveç vlerës së detyrimit sipas situacionit dhe kontratës, të kërkojnë edhe përqindje të interesave etj., gjë e cila rrit kostot financiare në mënyrë artificiale. |
| Shkaku: | Mos vendosja e fondeve buxhetor në masën e duhur në likuidimin e |

| | |
|--------------------|---|
| | detyrimeve të prapambetura, si dhe krijimi i detyrimeve të reja gjatë vitit buxhetor. |
| Rëndësia: | E lartë. |
| Rekomandim: | Kryetari i Bashkisë Libohovë dhe Sektori i Financës të marrin masa për likuidimin e vlerës së kontratave të lidhura midis Bashkisë Libohovë dhe kontraktorëve, sipas afateve të përcaktuar në kontratë, duke eliminuar në këtë mënyrë shkakun e krijimit të detyrimeve të prapambetura. Lidhja e kontratës të bëhet vetëm pasi fondi që parashikon procedura e prokurimit do të jetë në dispozicion (në llogarinë e thesarit) të autoritetit kontraktor. Gjithashtu të marrë masa që gjatë zbatimit të buxhetit, prioritet të kenë detyrimet e paguara të vitit paraardhës. |

Në formë table, detrimet e prapambetura paraqiten si vijon

| Kodi i detyrimit të prapambetur | Emërimi i detyrimit të prapambetur | Detyrimi prapambetur progresiv më 31.12.2021 | Vlera e paguar gjatë vitit 2022 për detyrimin e prapambetur (vlera e paguar për kolonën 3) | Vlera e detyrimeve të trashëguara të pa paguara më 31.12.2022 (pa detyrimet e krijuara gjatë 2022) | Detyrim i prapambetur i krijuar vetëm gjatë vitit 2021 (situata më 31.12.2022) | Vlera totale e detyrimeve të prapambetur pa më 31.12.2022 |
|---|------------------------------------|--|--|--|--|---|
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5=3-4 | 6 | 7=5+6 |
| Detyrimet me burim financimi nga të ardhurat e veta | | | | | | |
| | Shërbime | 77,081 | | 77,081 | 10,841,537 | 10,918,618 |
| | Mirëmbajtje | 351,600 | | 351,600 | 384,220 | 735,820 |
| | Vendime gjyqësore | - | - | - | 14,585,976 | 14,585,976 |
| | Investime | 5,270,041 | 2,782,599 | 2,487,442 | 166,200 | 2,653,642 |
| | Shërbime | 77,081 | | 77,081 | 10,841,537 | 10,918,618 |
| | Detyrime ne total | 5,698,722 | 2,782,599 | 2,916,123 | 25,977,933 | 28,894,056 |
| Shënim: Bashkia Libohovë nuk ka detyrime të cilat financohen nga granti i kushtëzuar qeveritar | | | | | | |

Raportimi i detyrimeve të prapambetura sipas raporteve të monitorimit:

Me shkresën nr. 290 prot., datë 27.02.2023, nga Bashkia Libohovë janë raportuar detyrimet e prapambetura në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë. Analiza e detyrimeve të prapambetura sipas formatit të raportuar në MFE paraqitet si më poshtë:

Lekë

| Nr. | Emërtimi | Stoku në vlerë | Totali i shpenzimeve të miratuara për NJVQV-në | Stoku/Shpenzimeve totale të miratuara të NJVQV-së |
|-----------|-------------------------|-------------------|--|---|
| I | Borxhe (a+b) | 0 | | |
| a | Hua afatgjatë | 0 | | |
| b | Hua afatshkurtër | 0 | | |
| II | Detyrime (a+b+c) | 28,894,056 | | 19,74 % |
| a | Shpenzime korrente | 28,894,056 | | |
| a.1 | Mallra dhe shërbime | 28,894,056 | | |
| a.3 | Të tjera | 0 | | |
| b | Shenzime kapitale | 0 | | |
| b.2 | Subjekte private | 0 | | |
| c | Vendime gjyqësore | 0 | | |

| | | | | |
|------------|----------------------|-------------------|--------------------|----------------|
| c.1 | Marrëdhënie pune | 0 | | |
| c4 | Të tjera | 0 | | |
| III | Totali (I+II) | 28,894,056 | 146,407,394 | 19,74 % |

Burimi i të dhënave: Bashkia Libohovë.

Totali i shpenzimeve të miratuara nga të ardhurat e veta me VKB-në e sipërpërmendur për vitin 2021 ka vlerën 146,407,394 lekë, ndërsa stoku i detyrimeve të prapambetura nga të ardhurat e veta më 31.12.2022 (pa përfshirë detyrimet e FZHR), ka vlerën 28,894,056 lekë. Raporti i këtyre treguesve, pra raporti i stokut të detyrimeve të prapambetura me shpenzimeve totale të miratuara, ka vlerën 19.74%. Analiza e detajuar mbi detyrimet e prapambetura deri më datën 31.12.2022, për Bashkinë Libohovë sipas faturave përkatëse paraqiten në aneksin nr. 2, tabelat nr. 4, 5, 7 dhe 7, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

Lista analitike e detyrimeve për vendimet gjyqësore

-Bashkia Libohovë deri më datën 31.12.2022, nuk ka kryer likuidime për dëmshpërblime page për punonjës të larguar nga puna.

| | | | | | |
|------------------------------|--|---|---|--|---------------------------------------|
| 7. Titulli i gjetjes: | Efekte negative ne buxhet si rezultat i zbatimit të vendimeve gjyqësore. | | | | |
| Situata: | <p>Nga auditimi i veprimeve të kryera me bankë konstatohet se, për zbatimin e vendimeve gjyqësore për periudhën janar-dhjetor 2022 nga Bashkia Libohovë është shpenzuar vlera 5,962,000 lekë e cila konsiderohet efekt negativ financiar që i përket likuidimit të tre vendimeve gjyqësore me objekt dëmshpërblime për dëmtim prone apo humbje jete.</p> <p>Të dhënat në mënyrë analitike paraqiten si më poshtë:</p> | | | | |
| | | | | | Lekë |
| | Numri i vendimeve gjyqësore si çelje më 01.01.2022 | Vlera e vendimeve gjyqësore si çelje më 01.01.2022 | Numri i vendimeve gjyqësore të ardhura në financë gjatë vitit 2022 | Pagesa në lekë të kryera gjatë vitit 2022 | Detyrimi në lekë më 31.12.2022 |
| | 1 | F.R | | 975,613 | 7,940,037 |
| | 2 | A.D, D.D, K.D | | 2,500,000 | 5,437,212 |
| | 3 | A | 1 | 2,486,387 | 1,208,727 |
| | Totali | | | 5,962,000 | 14,585,976 |
| | Burimi i të dhënave: Bashkia Libohovë. | | | | |
| Kriteri: | Mos kryerja e kësaj analize nga Titullari është në kundërshtim me pikën nr. 60, të UMFE nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar. | | | | |
| Ndikimi/Efekti: | Proceset gjyqësore dhe humbja e çështjes së tyre nga njësia vendore, krijojnë efekte negative në buxhet. | | | | |
| Shkaku: | Mos zbatimi i dispozitave ligjore në fuqi gjë e cila sjellë hapjen e proceseve gjyqësore. | | | | |
| Rëndësia: | E lartë. | | | | |
| Rekomandim: | Kryetari i Bashkisë Libohovë të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatohë, me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kane sjellë humbjen e çështjes gjyqësore. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen të procedurave të gabuara të ndjekura për çështjen e dëmshpërblimit për dëmtim prone apo humbje jete, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet. | | | | |

2.5. Çelja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes FZHR, saktësia e raportimit buxhetor të tyre.

Për vitin 2022 është financuar me fonde të Buxhetit të Shtetit investimi si më poshtë:

1. “Rikonstruksioni i rrjetit të Ujësjetës të qytetit të Libohovës”. Kontrata e lidhur me nr. 626 prot., datë 11.05.2020, me subjektin E në vlerën 312,871,812 lekë me Tvsh. Në total fondet e çelura nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë janë në vlerën 312,871,812 lekë po kaq është edhe vlera e kontratës. Vlera progresive e likuiduar nga fondet e Buxhetit të Shtetit deri më datën 31.12.2022, për këtë kontratë është 276,972,260 lekë si dhe mbetet ende për t’u likuiduar vlera 35,899,552 lekë për arsye se situacioni përfunditar ende nuk është dërguar pranë Sektorit të Financës, Bashkia Libohovë.

Lekë

| Nr. | Objekti i prokurimit | Kontrata | Vlera e plotë e kontratës me TVSH | Vlera e likuiduar | Vlera e pa likuiduar | Arsyet e mos likuidimit |
|-----|---|--------------------------------|-----------------------------------|-------------------|----------------------|-------------------------|
| 1 | Rikonstruksion i rrjetit të ujësjetës të qytetit të Libohovës | Nr. 626 prot., datë 11.05.2020 | 312,871,812 | 276,972,260 | 35,899,552 | Në proces |

Burimi i të dhënave: Bashkia Libohovë.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: znj. L.M. me detyrë Kryetar i Bashkisë Libohovë dhe znj. E.P me detyrë Shef i Sektorit të Financës.

Pika 2.6. Burimi i krijimit të të ardhurave. Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Ligjshmëria e lidhjes së kontratës për dhënien me qira të aseteve dhe arkëtimi i detyrimeve. Evidentimi i detyrimeve tatimore të pa arkëtuara progresive dhe për secilin vit buxhetor sipas programit të auditimit.

Në zbatim të programit të auditimit të sipërcituar, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Vendimi i Këshillit Bashkiak Libohovë për miratimin e paketave fiskale për vitin 2022.
2. Pasqyrat financiare në lidhje me kontabilizimin dhe pasqyrimin e të ardhurave.
3. Aktet e rakordimit me degën e thesarit për të ardhurat.
4. Dokumentacioni shkresor dhe elektronik i dhënë nga subjekt.
5. Regjistrimi i taksapaguesve etj.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet:

Parashikimi dhe realizimi i taksave dhe tarifave vendore

Për vitin 2022 paketa fiskale për taksat dhe tarifave vendore në Bashkisë Libohovë është miratuar me VKB nr. 52, datë 26.11.2021, “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Libohovë”.

| | |
|------------------------------|--|
| 8. Titulli i gjetjes: | Mos përcaktimi në paketën fiskale i afateve për pagesën e taksave dhe tarifave vendore për taksapaguesit privat dhe familjar. |
| Situata: | Nga auditimi i paketës fiskale u konstatua se në këtë dokument nuk janë përcaktuar afate për pagesën e taksave dhe tarifave vendore për taksapaguesit privat dhe familjar Këto afate përcaktohen me daljen e njoftim vlerësimit tatimor, gjë që tregon se afati i përcaktimit të pagesës |

| | |
|------------------------|--|
| | së detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore, mbetet të përcaktohet nga kjo zyrë dhe jo nga këshilli bashkiak. Afatit të pagesës duhet të jetë pjesë integrale e paketës fiskale, pasi është një element i rëndësishëm i taksave dhe tarifave vendore dhe si i tillë duhet ti nënshtrohet gjykimit të këshillit bashkiak. Përcaktimi i afatit të pagesës, duhet të jetë i tillë që të garantojë mbledhjen e të ardhurave brenda një kohe të caktuar, me qëllim që me këto të ardhura të sigurohet financimi i shpenzimeve të miratuara në planin vjetor të buxhetit. |
| Kriteri: | Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, nenit 5, pika (c) ku thuhet: Me përjashtim të rasteve kur në këtë ligj përcaktohet shprehimisht ndryshe, bashkia, nëpërmjet këshillit bashkiak përcakton <u>numrin e kësteve të pagimit të taksës dhe afatet e kryerjes së tyre</u> , si dhe kushtet lehtësuese në rastet e pagesës së plotë dhe përpara afateve të detyrimeve fiskale. |
| Ndikimi/Efekti: | Përcaktimi i afatit të pagesës i pa miratuar nga këshilli bashkiak. |
| Shkaku: | Mos parashikimi në paketën fiskale të afatit të pagesës për taksat dhe tarifave vendore. |
| Rëndësia: | E mesme. |
| Rekomandim: | Kryetari i Bashkisë Libohovë dhe Sektori i Tatim Taksave të marrin masa për përcaktimin në paketën fiskale të afateve të pagimit për taksat vendore për taksapaguesit privat dhe familjar. |

Nga auditimi u konstatua se është hartuar rregjistri i taksapaguesve privat dhe familjar.

Për vitin 2022 në Bashkinë Libohovë në fillim të viti ushtrimor kanë zhvilluar aktivitet 68 biznese, nga të cilat 62 biznese të vogla dhe 6 biznese të mëdha. Nuk ka patur rregjistrime të subjekteve të reja gjatë vitit. Përgjatë vitit janë mbyllur 3 biznese të vogla duke e çuar numrin e bizneseve të fund të vitit në 65, sipas tabelës në vijim:

| Lloji i biznesit | Numri në fillim të vitit | Regjistrime të reja | Mbyllur aktiviteti gjatë vitit | Numri në fund të vitit |
|------------------|--------------------------|---------------------|--------------------------------|------------------------|
| | 2022 | | | |
| Biznes i vogël | 62 | | 3 | 59 |
| Biznes i madh | 6 | | | 6 |
| Totali | 68 | | 3 | 65 |

Burimi i të dhënave: Bashkia Libohovë.

| | |
|------------------------------|---|
| 9. Titulli i gjetjes: | Mos përcaktimi i mënyrave efektive për arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore për taksapaguesit familjar. |
| Situata: | Për taksapaguesit familjar, Bashkia Libohovë nuk ka përcaktuar mënyra efektive për arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore. Edhe pse gjatë kësaj periudhe ka qenë aksionare e Shoqërisë “Ujësjellësi Libohovë” ShA dhe bazuar në pikën (ii), neni 5 të Ligjit nr. 9642, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, ka të drejtën dhe detyrimin e përcaktimit të mënyrës së mbledhjes së taksës dhe zgjedhjen e agjentit fiskal, nuk ka realizuar përfshirjen e detyrimeve të |

| | |
|------------------------|--|
| | <p>taksave dhe tarifave vendore familjare në faturën mujore të ujit të pijshëm, veprim i cili do të rriste të ardhurat vendore dhe do të shtonte mundësinë e rritjes së investimeve dhe shërbimeve ndaj komunitetit.</p> <p>Nga Sektori i Tatim Taksave u paraqit relacioni nr.1800 prot., datë 11.11.2019, nëpërmjet të cilit i propozohet këshillit bashkiak për lidhjen e akt marrëveshjes midis Bashkisë Libohovë dhe Ujësjellës Kanalizime Libohovë ShA, për caktimin e këtij të fundit si agent tatimor. Por ky propozim nuk është miratuar dhe gjithashtu nuk është vijuar më me propozim tjetër në vijim në këshillin bashkiak gjatë vitit 2020 dhe 2021 dhe 2022.</p> |
| Kriteri: | <p>Në nenin 5 të Ligji nr. 9642, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika (ii) përcaktohet se:</p> <p>“Me përjashtim të rasteve kur në këtë ligj përcaktohet shprehimisht ndryshe, bashkia, nëpërmjet këshillit bashkiak përcakton mënyrën e mbledhjes së taksës, përfshirë zgjedhjen e agentit fiskal dhe detyrimet e ndërsjellta”.</p> |
| Ndikimi/Efekti: | Arkëtim i ulët i taksave dhe tarifave vendore për kategorinë familjare |
| Shkaku: | Mos miratim i aktmarrëveshjes nga këshilli bashkiak dhe ndërprerje e përpjekjeve për këtë qëllim nga ana e vetë bashkisë pas vitit 2019. |
| Rëndësia: | E mesme. |
| Rekomandim: | Kryetari i Bashkisë dhe Sektori i Tatim Taksave për kategorinë e taksapaguesve familjar, të paraqesin për miratimin në Këshillin Bashkiak aktmarrëveshjen me Shoqërinë “Ujësjellës Kanalizime Libohovë” Sh A, duke kërkuar prej saj të kryhej rolin e agentit tatimor, me përfshirjen në faturën e ujit të pijshëm edhe detyrimin për taksat dhe tarifatat vendore familjare. |

Për vitin ushtrimor 2022, plani i të ardhurave është miratuar në shumën 13,054,762 lekë dhe është realizuar 21,952,116 lekë. Kjo shumë është rakorduar me Degën e Thesarit Gjirokastrë. Realizimi sipas zërave është i pasqyruar në tabelën në vijim:

| Lekë | | | | |
|------|---|------------------|------------------|------------------------|
| Nr. | Emërtimi i të Ardhurave | Plani vjetor | Relizimi vjetor | Përqindja e realizimit |
| 1 | Taksë mbi ndërtesat | 2,102,189 | 1,545,641 | 73.5% |
| | a) Taksë mbi ndërtesat nga banesa | 1,435,959 | 904,159 | |
| | b) Taksë mbi ndërtesat nga biznesi | 666,230 | 641,482 | |
| 2 | Taksë mbi tokën bujqësore | 2,019,072 | 1,800,608 | 89.1% |
| 3 | Taksë vendore mbi biznesin e vogël | | 194,205 | |
| 4 | Taksë mbi ndërtimet | 500,000 | 455,753 | 91.1% |
| | a) Taksë e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet | 200,000 | | |
| | b) Taksë e ndërtimit të ri | 300,000 | | |
| 5 | Grand nga nivele të tjera qeverisë | 2,100,000 | 2,382,972 | 113.4% |
| 6 | Taksë tabelle | | | |
| 7 | Taksë vendore mbi truallin | 337,091 | 271,907 | 80.6% |
| | a) Taksë trualli banese | 161,271 | 85,817 | |
| | b) Taksë trualli biznese | 175,820 | 186,090 | |
| 8 | Taksë vjetore e tonazhit të autmjetëve | | | |
| 9 | Tatim/Thjeshtuar mbi fitimin | | | |
| 10 | Tarifë vendore mbi ndriçimin | 309,260 | 259,300 | 83.8% |
| | a) Tarifë ndriçimi rrugor familjar | 235,560 | 179,760 | |
| | b) Tarifë ndriçimi rrugor biznese | 73,700 | 79,540 | |
| 11 | Tarifë pastrimi dhe higijene | 1,876,300 | 1,289,370 | 68.7% |
| | a) Tarifë pastrimi nga familjar | 1,207,200 | 570,580 | |
| | b) Tarifë pastrimi nga biznesi | 669,100 | 718,790 | |

| | | | | |
|----|--|-------------------|-------------------|---------------|
| 12 | Tarifë nga te ardhurat per leje sherbimi | | | |
| 13 | Kullotat + shitja e produkt heterogjene | 600,000 | 661,800 | 110.3% |
| 14 | Grand nga qeveritë e huaja | | 9,744,480 | |
| 15 | Qiratë nga ndërtesa | 28,800 | 4,800 | 16.6% |
| 16 | Shërbimet | 20,000 | 16,050 | 80.2% |
| 17 | Taksë vendore mbi ujin | 900,000 | 272,000 | 30.2% |
| 18 | Tarif ëvendore për Z.H.P. | 31,000 | 413,505 | |
| 19 | TV për lejen e shitjes së karburanteve | 200,000 | 200,000 | 100% |
| 20 | Kamat vones | | 11,761 | |
| 21 | Të ardhura nga qiraja e tokës bujqëore | 361,050 | 276,973 | 76.7% |
| 22 | Të ardhura nga qira për troje | 670,000 | 520,000 | 68.4% |
| 23 | Spons nga të ardhura jo qeveritare | 850,000 | 210,060 | 24.7% |
| 24 | Tarifë për leje ushtrim profesioni | | | |
| | Grand NjV mbi të ardhura personale | | 1,258,382 | |
| 25 | Të ardhura të tjera jo tatimore | 150,000 | 162,549 | 108.3% |
| | Totali | 13,054,762 | 21,952,116 | 168.1% |

Të ardhurat janë planifikuar në vlerën 13,054,762 lekë dhe janë realizuar në vlerën 21,952,116 lekë, ose në masën 168.1%. Nga auditimi konstatohet se në vlerën totale të realizimit përfshihen edhe vlerat të cilat janë arkëtuar për llogari të detyrimeve të prapambetura, të cilat bazuar në informacionin e dhënë nga Sektori i Tatim Taksave kanë vlerën 1,671,753 lekë. Duke zbritur këtë vlerë nga vlera totale e të ardhurave, arkëtimet për llogari të vitit fiskal 2022 kanë vlerën 20,280,363 lekë.

Tejkalimi i planit të të ardhurave dhe realizimi tyre në masën 168%, ka ardhur kryesisht si rezultat i vlerës se paplanifikuar në të ardhurat vjetore nga grandit nga qeveritë e huaja, planifikimi i të cilave ka qenë i pa mundur për t'u kryer. Bashkia Libohovë, në momentin e marrjes së grantit nga qeveritë e huaja, duhet të kishte korrigjuar edhe vlerën e planit të të ardhurave.

Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet administrohet nga sektori i shërbimit urban dhe sektori i të ardhurave.

Bazuar në shkresat që ASHK dërgon në Bashkinë Libohovë, për vitin 2021 janë legalizuar gjithsej 15 objekte për të cilat Sektori i Shërbimit Urban ka llogaritur detyrimin për taksën e ndikimit në infrastrukturë në shumën 411,869 lekë, nga të cilat nuk kanë shlyer detyrimin 3 prej tyre në vlerën 99,424 lekë, si vijon:

| Emërtimi | Emër Mbiemër | Vendndodhja | Vlera |
|---------------|--------------|-------------|---------------|
| Banimi | Dh.N | Nepravishtë | 27,265 |
| Banimi | B.Ç | Nepravishtë | 48,269 |
| Banimi | F.A etj., | Bulo | 23,890 |
| Totali | | | 99,424 |

Për qytetarët që paguajnë këtë taksë, si dhe për ata që nuk paguajnë, Sektori i Shërbimit Urban ka njoftuar Sektorin e Tatim Taksave i cili ka rregjistruar detyrimin.

Për vitin 2022 Bashkia Libohovë nuk ka korespondencë me ASHK për numrin e objekteve të legalizuara, me qëllim evidentimin e vlerës së taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Debitorët dhe masat për arkëtimin e tyre

Në mënyrë të përmbledhur gjendja e debitorëve sipas llojit të taksapaguesve, numrit dhe vlerës së tyre jepet në tabelën në vijim:

| Emërtimi | Tatim paguesi | Numri i debitorëve progresiv më 31.12.2022 | Vlera e debisë progresivë më 31.12.2022 | Numri i debitorëve për detyrimet e vitit 2022 | Vlera e debisë për detyrimet e vitit 2022 |
|----------|----------------|--|---|---|---|
| | Biznesi i madh | 1 | 299,593 | | |

| | | | | | |
|-------------------|---|-----------|-------------------|----------|------------------|
| | Biznes i vogël | 57 | 5,471,312 | 2 | 33,578 |
| Totali 1 | | 58 | 5,770,905 | 2 | 33,578 |
| | Familjarët për tokën bujqësore | | 8,960,646 | | 897,659 |
| | Familjarët për taksat dhe tarifatat e tjera | 814 | 10,312,908 | | 2,411,598 |
| Totali 2 | | | 19,273,554 | | 3,309,257 |
| Totali 1+2 | | | 25,044,459 | | 3,342,835 |

Burimi i të dhënave: Bashkia Libohovë.

Debitorët për taksat dhe tarifatat vendore janë përcjellë në financë për kontabilizim me shkresën nr.179 prot., datë 06.02.2023.

10. Titulli i gjetjes: Mos marrja e masave të plota për arkëtimin e debitorëve.

Situata: Mbështetur në të dhënat e Sektorit të Tatim Taksave, vlera progresive e debitorëve privat dhe familjar në datën 31.12.2022, është 25,044,459 lekë, nga e cila vlera prej 3,342,835 lekë është krijuar gjatë vitit 2022 nga mos shlyerja e detyrimeve të këtij viti, ndërsa vlera prej 21,701,624 lekë i përket detyrimeve të trashëguara përpara vitit 2022.

Krahasuar me vlerën e debitorëve në datën 31.12.2021, e cila është 23,317,720 lekë, konstatohet se vlera e debitorëve në vitin 2022 është rritur krahasuar me vitin 2021, e cila tregon se nuk janë marrë masa të plota për arkëtimin e debitorëve, si dhe masat e marra kanë patur rezultate jo shumë të mira.

Krahasuar me vitin 2021, në vitin 2022 konstatohet rritje e vlerës së debitorëve të krijuar gjatë vitit 2022, e cila ka sjellë edhe rritjen e vlerës progresive të debitorëve, përfshirë edhe periudhën përpara vitit 2022, pasi vlera e debitorëve në datën 31.12.2021, është 23,317,720 lekë, nga e cila vlera prej 1,889,310 lekë është krijuar gjatë vitit 2021 nga mos shlyerja e detyrimeve të këtij viti, ndërsa vlera prej 21,428,410 lekë i përket detyrimeve të trashëguara përpara vitit 2021.

Në mënyrë të përmbledhur vlerat e debitorëve progresiv dhe debitorëve të krijuar vetëm gjatë vitit buxhetor, për dy vitet 2021 dhe 2022, jepen në tabelën e mëposhtme:

Lekë

| Nr. | Emërtimi | | | |
|-----|--|--|---|---|
| | Vlera e debitorëve progresiv më 31.12.2021 | Vlera e debitorëve progresiv më 31.12.2022 | Vlera e debitorëve vetëm për detyrimet e vitit 2021 | Vlera e debitorëve vetëm për detyrimet e vitit 2022 |
| | 23,317,720 | 25,044,459 | 1,889,310 | 3,342,835 |

Burimi i të dhënave: Bashkia Libohovë.

Nga këto të dhëna konstatohet se për vitin 2022 rritja e debitorëve progresiv ka vlerën 1,726,739 lekë, ndërsa rritja e debitorëve të krijuar vetëm gjatë vitit 2022 ka vlerën 1,453,525 lekë, e cila tregon se nuk janë marrë masa të plota për arkëtimin e debitorëve të krijuar gjatë vitit 2022.

Në vlerën e detyrimit progresiv në fund të vitit buxhetor 2022 prej 25,044,459 lekë, peshën kryesore e zënë detyrimet nga taksapaguesit familjarë, të cilat kanë vlerën 19,273,554 lekë, ose në masën 77% të detyrimit total.

Përmbledhësja a subjekteve debitor privat sipas llojit të taksave dhe tarifave për vitin 2022 dhe të prapambeturat:

Lekë

| Nr. | Emërtimet | Biznes i Madh | Biznes i Vogël | Shuma |
|--------------|--------------------------|----------------|------------------|------------------|
| 1 | Taksë ndërtese | | 17,178 | 17,178 |
| 2 | Taksë truall | | | |
| 3 | Tarifë ndriçimi | | 2,400 | 2,400 |
| 4 | Tarifë pastrimi | | 20,000 | 20,000 |
| 5 | Detyrime të prapambetura | 299,593 | 5,437,734 | 7,737,327 |
| Shuma | | 299,593 | 5,477,312 | 5,770,905 |

Burimi i të dhënave: Bashkia Libohovë.

Debija progresive per taksat dhe tarifat vendore familjare deri ne 31.12.2022:

Lekë

| Nr | NJA | Tokë | | Ndërtësë | | truall | | Ndriçim | | Pastrim | | Të tjera | Shuma |
|--------------|---------------|------------|------------------|------------|------------------|------------|----------------|------------|------------------|------------|------------------|------------------|-------------------|
| | | Nr.F | Vlera | Nr.F | Vlera | Nr.F | Vlera | Nr.F | Vlera | Nr.F | Vlera | | |
| 1 | Libohovë | 426 | 4,212,579 | 363 | 2,350,022 | 375 | 407,604 | 328 | 595,200 | 328 | 1,381,400 | 1,802,613 | 10,749,418 |
| 2 | Njesia Qendër | 236 | 2,268,719 | 228 | 888,729 | 215 | 44,534 | 135 | 602,400 | 137 | 509,400 | 1,377,278 | 5,691,060 |
| 3 | Njësia Zagori | 152 | 1,065,635 | 247 | 690,170 | 250 | 39,952 | 25 | 10,320 | | | 1,026,999 | 2,833,073 |
| Shuma | | 814 | 7,546,933 | 838 | 3,928,921 | 840 | 492,090 | 486 | 1,207,920 | 465 | 1,890,800 | 4,206,890 | 19,273,554 |

Burimi i të dhënave: Bashkia Libohovë.

Masat e mara nga ana e Sektorit të Tatim Taksave për arkëtimin e debisë se prapambetur janë mbyllja e llogarive bankare me shkresë nr. 572 prot., datë 04.05.2022, vendosja e barrës hipotekore në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës me shkresë nr. 573 prot., datë 04.05.2022, vendosja e barrës së sigurisë në DRTRRGJ me nr. 588 prot., datë 05.05.2022, lëshimi i urdhër ekzekutimeve për subjektet private me nr. 691,692 prot., datë 20.05.2022, dhe nr. 724, 725 prot., date 24.05.2022, lidhja e dy kontratave për pagesë me këste mos dhënia e shërbimeve nga ana e bashkisë në formën e masës shtrënguese. Si rezultat i masave të mara gjatë vitit ushtrimor 2022 nga detyrimet e prapambetura janë arkëtuar 1,671,753 lekë, nga të cilat 543,545 lekë nga bizneset dhe 1,128,208 lekë nga familjarët. Janë dërguar njoftimet për 8 (tetë) debitorët e taksës së ndikimit në infrastrukturë me shkresë nr.1096/29 prot., datë 22.02.2022, bashkangjitur shkresës janë dërguar dhe faturat për arkëtim, si rezultat kanë arkëtuar 2 (dy) subjekte.

| | |
|------------------------|--|
| Kriteri: | Konstatohet se masat shtrënguese të marra për debitorët nuk janë të plota në rend shterues, pasi nuk janë aplikuar masa për vendosjen e barrës siguroese në Drejtorinë Rajonale të Shërbimit të Transportit Rrugor, vendosjen e masës së sigurimit të detyrimit tatimor në Regjistrin të Barreve Siguroese, nuk janë aplikuar sekuestrim dhe konfiskim i pasurisë apo kallëzime penale, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 93 -Sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurisë, neni 94 - Urdhri i sekuestrimit, neni 95 -Pasuria, objekt i sekuestrimit, neni 131 Vepra penale, të parashikuara në Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar. |
| Ndikimi/Efekti: | Mos arkëtim i plotë i detyrimeve. |
| Shkaku: | Mos zbatimi i të gjithë kuadrit rregullator në fuqi |
| Rëndësia: | E lartë. |
| Rekomandim: | Kryetari i Bashkisë Libohovë, Sektori i Tatim Taksave dhe Sektori Juridik, të marrin të gjitha masat e duhura ligjore për arkëtimin e detyrimeve të pa paguara nga kategoria e taksapaguesve privat dhe familjar në vlerën 25,044,459 lekë. |

Gjatë vitit ushtrimor 2022 nga detyrimet e prapambetura në vlerën progresive 23,317,720 lekë janë arkëtuar 1,671,753 lekë ose 7% e detyrimeve, si vijon:

Lekë

| Nr. | Emërtimi i taksës | Shuma |
|--------------|------------------------------|------------------|
| 1 | Tokë bujqësore | 662,870 |
| 2 | Taksa vendore nga familjarët | 465,338 |
| 3 | Taksa vendore nga biznesi | 543,545 |
| Shuma | | 1,671,753 |

Burimi i të dhënave: Bashkia Libohovë.

Debitorët progresiv për bizneset deri më datën 31.12.2022, paraqiten në aneksin nr. 2, tabela nr. 14, bashkangjitur Projekt Raportit të Auditimit.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi: z. XH.S., me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Tatim Taksave.

Ligjshmëria e lidhjes së kontratës për dhënien me qira të aseteve.

Për periudhën nga data 01.01.2021, deri më 31.12.2022, në total janë aktive 91 kontrata (vetëm 2 prej tyre janë kontrata të reja të lidhura përgjatë viteve 2021-2022) për dhënien me qira të aseteve nga të cilat 46 kontrata i përkasin vitit 2021 dhe 45 kontrata i përkasin vitit 2022, që administrohen nga Bashkia Libohovë konkretisht si më poshtë:

a. Viti 2021

- 30 kontrata për dhënien me qira të pyjeve dhe kullotave;
- 12 kontrata për dhënien me qira të tokave bujqësore;
- 1 kontratë për dhënien me qira të ndërtesave/objekteve;
- 3 kontrata për dhënien me qira të hapësirave/sipërfaqeve për vendosjen e antenave telefonike.

b. Viti 2022

- 30 kontrata për dhënien me qira të pyjeve dhe kullotave;
- 11 kontrata për dhënien me qira të tokave bujqësore;
- 1 kontratë për dhënien me qira të ndërtesave/objekteve;
- 3 kontrata për dhënien me qira të hapësirave/sipërfaqeve për vendosjen e antenave telefonike.

Për sa i përket aseteve të cilat janë dhënë me qira referuar kontratave të sipërpërmendura, Bashkia Libohovë nuk posedon titull pronësie (kjo problematikë është trajtuar më gjerësisht në nënpikën nr. 3.4, të programit të auditimit me objekt “Auditim mbi administrimin e aseteve, procedura e inventarizimit si dhe regjistrimin tyre në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës”).

Për vendosjen e tarifave për dhënien me qira të aseteve nga Bashkia Libohovë janë aplikuar çmimet e parashikuara në VKM nr. 54, datë 05.02.2014, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” i ndryshuar, dhe UKM nr. 1, datë 18.07.2012, “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara”, si më poshtë:

Lekë

| Viti 2021 | | | |
|-----------|---|-------------------------------------|------------------------------------|
| Nr. | Emërtimi | Bashkia | Njësia Administrative |
| | | Niveli i tarifës | |
| 1 | Tarifë për dhënien me qira objekt | | 50 lekë për m ² në muaj |
| 2 | Tarifë për dhënien me qira truall | 100 lekë për m ² në muaj | 50 lekë për m ² në muaj |
| 3 | Tarifa e dhënies me qira tokë bujqësore | 6000 lekë për ha në vit | 6000 lekë për ha në vit |
| 4 | Tarifa e dhënies me qira pyjeve dhe kullotave | 27,000 lekë për ha në vit | 27,000 lekë për ha në vit |

Burimi i të dhënave: Bashkia Libohovë.

Lekë

| Viti 2022 | | | |
|-----------|---|-------------------------------------|------------------------------------|
| Nr. | Emërtimi | Bashkia | Njësia Administrative |
| | | Niveli i tarifës | |
| 1 | Tarifë për dhënien me qira objekt | | 50 lekë për m ² në muaj |
| 2 | Tarifë për dhënien me qira truall | 100 lekë për m ² në muaj | 50 lekë për m ² në muaj |
| 3 | Tarifa e dhënies me qira tokë bujqësore | 6000 lekë për ha në vit | 6000 lekë për ha në vit |
| 4 | Tarifa e dhënies me qira pyjeve dhe kullotave | 27,000 lekë për ha në vit | 27,000 lekë për ha në vit |

Burimi i të dhënave: Bashkia Libohovë.

a. Kontrata për dhënien me qira të pyjeve dhe kullotave.

Për periudhën nga data 01.01.2021, deri më 31.12.2022, Bashkia Libohovë nuk ka lidhur asnjë kontratë të re për dhënien me qira të pyjeve dhe kullotave, por janë aktive 30 kontrata të cilat

janë lidhur përpara periudhës objekt auditimi (kontratat të cilat kanë qenë aktive, janë rilidhur përsëri duke u shtuar afatin për përdorimin e tyre). Për vitin 2021 kanë qenë aktive 30 kontrata me sipërfaqe totale 1,690.52 ha me vlerë kontrate 554,250 lekë ndërsa për vitin 2022 kanë qenë aktive 30 kontrata me sipërfaqe 1,598.23 ha me vlerë kontrate 504,250 lekë. Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion konstatohet se, për këto kontrata për vitet 2021-2022 janë shlyer të gjitha detyrimet. Analiza e detajuar mbi personat të cilët kanë nënshkruar kontratë qiraje për pyjet dhe kullotat me Bashkinë Libohovë si dhe likudimet e detyrimeve për këto kontrata për vitet 2021-2022, paraqiten në aneksin nr. 2, tabela nr. 8, dhe nr. 9, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

b. Kontrata për dhënien me qira të tokave bujqësore.

| | |
|-------------------------------|---|
| 11. Titulli i gjetjes: | Detyrime të pa arkëtuara nga dhënia me qira e tokave bujqësore. |
| Situata: | Për periudhën nga data 01.01.2021, deri më 31.12.2022, Bashkia Libohovë ka lidhur 2 kontrata për dhënien me qira të tokave bujqësore, si dhe janë aktive 10 kontrata të cilat janë lidhur përpara periudhës objekt auditimi (kontratat të cilat kanë qenë aktive, janë rilidhur përsëri duke u shtuar afatin për përdorimin e tyre). Për vitin 2021 kanë qenë aktive 12 kontrata me sipërfaqe totale 59,659 m ² me vlerë kontrate 358,170 lekë ndërsa për vitin 2022 kanë qenë aktive 11 kontrata me sipërfaqe 51.975 m ² dhe me vlerë kontrate 311,850 lekë. Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion konstatohet se deri më datë 31.12.2022, për 5 kontrata nuk janë shlyer detyrimet në vlerën totale 319,330 lekë (debitorë në vlerën 261,960 lekë + kamatëvonesë në vlerën 57,370 lekë = 319,330 lekë) e cila konsiderohet detyrim i pa arkëtuar nga debitorët e Bashkisë Libohovë. Analiza e detajuar mbi personat të cilët kanë nënshkruar kontratë qiraje për tokat bujqësore me Bashkinë Libohovë si dhe likudimet e detyrimeve për këto kontrata për vitet 2021-2022, paraqiten në aneksin nr. 2, tabela nr. 10, dhe nr. 11, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit. |
| Kriteri: | Ligji nr. 7850, datë 29.07.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, Ligji nr. 48/2014, datë 24.04.2014, “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, Ligji nr. 7501, datë 19.07.1991, “Për tokën” i ndryshuar, Ligji nr. 8312, datë 26.03.1998, “Për tokat bujqësore të pandara”, VKM nr. 531, datë 21.08.1998, “Për tokat bujqësore të pandara” i ndryshuar me VKM nr. 176, datë 30.03.2001, VKM nr. 373, datë 20.06.2018, “Për përcaktimin e kriterëve, të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit”, ku përcaktohet edhe Kontrata tip për t’u lidhur me qiramarrësit, përfshirë sanksionet, VKM nr. 54, datë 05.02.2014, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfitëozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, UKM nr. 1, datë 18.07.2012, “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara”. |
| Ndikimi/Efekti: | Detyrime të pa arkëtuara nga dhënia me qira e tokave bujqësore në vlerën 319,330 lekë. |

| | |
|--------------------|---|
| Shkaku: | Mos likuidimi i detyrimeve brenda afateve të përcaktuara në kontratat e dhënies me qira të tokave bujqësore. |
| Rëndësia: | E lartë. |
| Rekomandim: | Bashkia Libohovë, Sektori i Tatim Taksave të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimeve të papaguara nga dhënia me qira e tokave bujqësore në total në vlerën 319,330 lekë . |

Kontrata për dhënie e tokës bujqësore me qira me nr. 509/3 prot., datë 05.05.2021, lidhur ndërmjet Bashkisë Libohovë përfaqësuar nga znj. L.M. Kryetar i Bashkisë dhe z. B.Q., dhe kontrata me nr. 1375/3 prot., datë 12.10.2022, lidhur ndërmjet Bashkisë Libohovë përfaqësuar nga znj. L.M. Kryetar i Bashkisë dhe z. H.Q. në vendin me emërtimin “Fusha e Çajupit” konstatohet se, nuk janë zbatuar zbatuar si kontrata pasi nuk është bërë akt dorëzimi i tyre, shkak për këtë situatë është bërë:

1. Nuk disponohet certifikata e pronësisë;
2. Nuk ka HTR të parcelës;
3. Plan vendosja e përgatitur nga topografi i licensuar është e pasaktë;
4. Nuk është përcaktuar sipërfaqja, kufizimet, përmasat si dhe vija e piketimit në koordinata në projektionin cilindriko tërthor konform sistemit Gauss-Kryger.
5. Formulari 6, i sipërfaqes së ndarë nuk është i saktë dhe për këtë arsye ka mospërputhje ndërmjet azhornimit të ASHK Gjirokastër dhe vendosjen në fakt nga ndarja që i përket Ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991, “Për tokën” i ndryshuar.

Në lidhje me këtë situatë është mbajtur procesverbali me nr. 892 prot., datë 24.06.2021, gjithashtu nga konfirmimi i dërguar me shkresën nr. 715prot., datë 02.11.2022, nga DAMT Këshilli i Qarkut Gjirokastër, në sipërfaqen e kontraktuar në parcelën me nr. 409, në fshatin Lilar dhe me nr. 715, në fshatin Zhej rrugë e re e hapur në Zagorie cënon sipërfaqen e tyre. Gjithashtu për çështjen e mësipërme nga kryetari i fshatit Zhej më shkresën nr. 1422/1 prot., datë 20.10.2022, ka kërkuar që nga ana e Bashkisë Libohovë të mos jepet me qira sipërfaqja e sipërpërmendur pasi në këtë sipërfaqe ka mbivendosje për arsye se:

Ky fshat ka Vendim Gjykatë nr. 932/111, të aktit dhe nr. 330, datë 30.05.2002, si dhe për këtë vendim është aplikuar për rregjistrimin e kësaj pasurie, numri i kërkesës 4324, datë 23.05.2022, ora 13:04, nëpërmjet e-albania me faturën nr. 3875, datë 23.05.2022.

Nga ana e topografit të Bashkisë Libohovë është hartuar relacioni teknik me nr. 1443 prot., datë 26.10.2022, për konstatimin e mangësive të mësipërme. Për arsyet e mësipërme kontrata nuk është zbatuar. Kontrata ndërmjet Bashkisë Libohovë dhe z. B.Q. me nr. 509/3 prot., datë 05.05.2021, është në proces gjykimi në Gjykatën e Shkallës së Parë Gjirokastër ku Bashkia është palë e tretë në këtë proces gjyqësor.

c. Kontrata për dhënie me qira të ndërtesave/objekteve.

Për periudhën nga data 01.01.2021, deri më 31.12.2022, Bashkia Libohovë ka lidhur 3 kontrata të reja për dhënie me qira të ndërtesave/objekteve. Për vitin 2021 kanë qenë aktive 2 kontrata me sipërfaqe totale 48 m² me vlerë kontrate 28,800 lekë ndërsa për vitin 2022 ka qenë aktive 1 kontratë me sipërfaqe 8 m² me vlerë kontrate 4,800 lekë. Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion konstatohet se, për këto kontrata për vitet 2021-2022 janë shlyer të gjitha detyrimet. Analiza e detajuar mbi personat të cilët kanë nënshkruar kontratë qiraje për ndërtesat/objektet

me Bashkinë Libohovë si dhe likudimet e detyrimeve për këto kontrata për vitet 2021-2022, paraqiten në aneksin nr. 2, tabela nr. 12, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

| | |
|-------------------------------|---|
| 12. Titulli i gjetjes: | Mangësi në dokumentacionit në fazën e para nënshkrimit të kontratave për marrjen e ndërtesave me qira. |
| Situata: | <p>1. Ndërmjet Bashkisë Libohovë përfaqësuar nga znj. L.M Kryetar i Bashkisë dhe subjektit “S.” është lidhur kontrata me nr. 947 prot., datë 09.07.2021, për dhënien me qira të objektit “Ndërtesë në fshatin Lobovë e Kryqit” me sipërfaqe 8 m² me numër pasurie 474/13 kundrejt vlerës 50 lekë për m² në muaj ose në vlerën 4,800 lekë për vit. Për këtë kontratë nuk ka detyrime të pa likuiduara.</p> <p>2. Ndërmjet Bashkisë Libohovë përfaqësuar nga znj. L.M. Kryetar i Bashkisë dhe subjektit “K” është lidhur kontrata me nr. 764 prot., datë 26.05.2021, për dhënien me qira të objektit “Ndërtesë në fshatin Lobovë e Kryqit” me sipërfaqe 40 m² me numër pasurie 474/1 kundrejt vlerës 50 lekë për m² në muaj ose në vlerën 24,000 lekë për vit. Për këtë kontratë nuk ka detyrime të pa likuiduara.</p> <p>3. Ndërmjet Bashkisë Libohovë përfaqësuar nga znj. L.M. Kryetar i Bashkisë dhe subjektit “S” është lidhur kontrata me nr. 860 prot., datë 20.06.2022, për dhënien me qira të objektit “Ndërtesë në fshatin Lobovë e Kryqit” me sipërfaqe 8 m² me numër pasurie 474/13 kundrejt vlerës 50 lekë për m² në muaj ose në vlerën 4,800 lekë për vit. Për këtë kontratë nuk ka detyrime të pa likuiduara.</p> <p>-Për sa trajtuar më sipër konstatohet se, përpara fazës së konkurimit për marrjen me qira të ndërtesave nga subjekti “S.” dhe “K.” nuk disponohet kërkesa e subjektit për marrjen me qira të ambientit, plani i biznesit, oferta për vlerën e detyrimit mujor të qirasë, certifikata e regjistrimit dhe certifikata historike për regjistrimin e subjektit në QKR, vërtetimi nga dega e tatimeve se subjekti ka shlyer detyrimet tatimore dhe sigurimet shoqërore vërtetimi që subjekti nuk është në ndjekje penale dhe nuk ka procese gjyqësore në lidhje me aktivitetin e tij. Veprime këto në kundërshtim me VKM nr. 54, datë 05.02.2014, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” i ndryshuar, pika 7.</p> <p>-Pas lidhjes së kontratës nga Bashkia Libohovë nuk janë marrë masat e duhura për ngritjen e një grupi pune për monitorimin e 3 (tre) kontratave të sipërpërmendura për dhënien me qira të ndërtesave/objekteve. Veprime këto në kundërshtim me VKM nr. 54, datë 05.02.2014, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” i ndryshuar, pika 1-3.</p> <p>-Në kontratat e sipërpërmendura nuk është përcaktuar mënyra e kryerjes së likuidimit për detyrimet e faturës së konsumit të energjisë elektrike dhe ujit.</p> |
| Kriteri: | VKM nr. 54, datë 05.02.2014, “Për përcaktimin e kriterëve, të |

| | |
|------------------------|--|
| | procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, pikat 1-3 dhe 7. |
| Ndikimi/Efekti: | Parregullsi në procesin e dhënies së ndërtesave me qira. |
| Shkaku: | Mos respektimi i dispozitave ligjore përkatëse. |
| Rëndësia: | E lartë. |
| Rekomandim: | Sektori i Tatim Taksave të marrë sa që para lidhjes së kontratës për dhënien e ndërtesave me qira, për subjektet që nuk paraqesin dokumentacionin sipas kërkesave të dispozitave ligjore përkatëse të bëjë skualifikimin e tyre. |
| Rekomandim: | Sektori i Tatim Taksave të marrë sa që në kontratat për dhënien me qira të ndërtesave/objekteve të përfshijë edhe detyrimet mbi likuidimin të detyrimeve së faturës së konsumit të energjisë elektrike dhe ujit. |
| Rekomandim: | Nga Kryetari i Bashkisë Libohovë të merren masa për ngritjen e një grupi pune për monitorimin e kontratave të dhënies me qira të ndërtesave në zbatim të dispozitave ligjore përkatëse. |

d. Kontrata për dhënien me qira të hapësirave/sipërfaqeve për vendosjen e antenave telefonike.

Për periudhën nga data 01.01.2021, deri më 31.12.2022, Bashkia Libohovë nuk ka lidhur asnjë kontratë të re për dhënien me qira të hapësirave/sipërfaqeve për vendosjen e antenave telefonike, por janë aktive 3 kontrata të cilat janë lidhur përpara periudhës objekt auditimi (kontratat të cilat kanë qenë aktive, janë rilidhur përsëri duke u shtuar afatin për përdorimin e tyre). Për vitin 2021 kanë qenë aktive 3 kontrata me sipërfaqe totale 440 m² me vlerë kontrate 670,000 lekë ndërsa për vitin 2022 kanë qenë aktive 3 kontrata me sipërfaqe 440 m² me vlerë kontrate 670,000 lekë. Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion konstatohet se, për këto kontrata për vitet 2021-2022 janë shlyer të gjitha detyrimet. Analiza e detajuar mbi subjektet të cilët kanë nënshkruar kontratë për dhënien me qira të hapësirave për vendosjen e antenave me Bashkinë Libohovë si dhe likuidimet e detyrimeve për këto kontrata për vitet 2021-2022, paraqiten në aneksin nr. 2, tabela nr. 13, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: znj. L.M. me detyrë Kryetar i Bashkisë Libohovë dhe z. Xh.S. me detyrë Shef i Sektorit të Tatim Taksave.

Pika 3. Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin nëse pasqyrat financiare për vitin 2022, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.

3.1. Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike.

3.2. Plotësia e shënimeve në pasqyrat financiare për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të njësisë.

3.3. Opinioni mbi pasqyrat financiare.

3.4. Auditim mbi administrimin e aseteve, procedura e inventarizimit si dhe regjistrimin tyre në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës.

➤ **Baza ligjore për mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimit të pasqyrave financiare:**

Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar; Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar; VKM nr. 783, datë 22.11.2006, “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”; Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” si dhe dispozita ligjore të tjera rregulluese.

➤ **Hartimi i pasqyrave financiare:**

Për vitin 2022 në përputhje me kërkesat e Udhëzimit të MF nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njërive të Qeverisjes së Përgjithshme”, janë përgatitur pasqyrat financiare të përbëra si më poshtë:

- Formati nr. 1. Pasqyra e pozicionit financiar.
- Formati nr. 2. Pasqyra e performancës financiare (Klasifikimi sipas natyrës ekonomike).
- Formati nr. 3. Pasqyra e flukseve monetare (Cash Flow).
- Formati nr. 4. Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto.
- Formati nr. 5. Pyetësor dhe shënimet shpjeguese.
- Formati nr. 6. Investimet dhe burimet e financimit.
- Formati nr. 7/a. Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (kosto historike).
- Formati nr. 7/b. Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto).
- Formati nr. 8. Numri i punonjësve dhe fondi i pagave.

Afatet dhe konfirmimi i pasqyrave financiare:

Pasqyrat financiare të Bashkisë Libohovë për vitin 2022 janë të nënshkruara nga znj. L.M. me detyrë Kryetar i Bashkisë Libohovë në cilësinë e nëpunësit autorizues dhe znj. E.P me detyrë Shef i Sektorit të Financës (hartuesi i llogarive vjetore) në cilësinë e nëpunësit zbatues të cilat janë depozituar pranë Degës së Thesarit Gjirokastër me shkresën nr. 427 prot., datë 30.03.2023, brenda afatit ligjor të cilat janë konfirmuar më datë 31.03.2023.

Rakordimi i pasqyrave financiare me thesarin dhe bankat e nivelit të dytë si dhe me treguesit e realizimit të buxhetit:

Për vitin 2022 nga verifikimi për çdo muaj i ditarit kontabël të bankës sipas natyrës për shpenzimet e klasës 6 dhe klasës 2 me akt rakordimin e thesarit mbi bazë ekstrakte banke (dokument i nxjerrjes së llogarisë nga thesari për çdo muaj) për shumat për çdo llogari dhe në total mujor e vjetor konstatohet se nuk ka diferenca. Për këtë është përdorur ditari i bankës i mbajtur sipas natyrës për autorizimet buxhetore (çeljet) dhe përdorimi fondeve sipas llojit të shpenzimeve.

Mënyra e mbajtjes së kontabilitetit dhe dokumentacionit bazë e justifikues si dhe sigurimi i informacionit kontabël, përgatitjen e llogarive për vlerësimin e gjendjes pasurore, financiare dhe rezultatit:

Për t’u siguruar nëse, regjistrimet kontabël janë kryer në përputhshmëri ligjore dhe me saktësi u kryen testimet në regjistrimet në ditaret kontabël në lidhje me:

-Mbështetjen në dokumente justifikuese, të verifikuara përsa i përket vlefshmërisë për t’u pranuar në kontabilitet (vlerësimi kontabël);

- Mos ndryshueshmëria e regjistrimeve tashmë të kryera dhe e mbartësve të tyre;
 - Tërësinë e regjistrimeve në mënyrë kronologjike dhe sistematike deri në mbyllje të të ushtrimit vjetor;
- Nëse informacioni kontabël mundëson, në të gjithë ciklin e tij, kontrollin rrjedhës dhe të mëvonshëm nëpërmjet:
- Shqyrtimit të vlefshmërisë së një regjistrimi fillestar duke e krahasuar me dokumentin bazë justifikues;
 - Kontrollit të vlefshmërisë të një regjistrimi të kryer me anë të një dokumenti duke e krahasuar këtë dokument me dokumentet bazë justifikuese mbi të cilat është përgatitur;
 - Verifikimit të pajtueshmërisë së shumave të nxjerra nga regjistrimet kronologjike me regjistrimet në llogari (barazimi i lëvizjeve të ditareve me ato të librit të llogarive) dhe verifikimit të pajtueshmërive të tjera aritmetike.

Pohimet e testeve të kryera rreth mbajtjes së kontabilitetit:

Si rezultat i testeve të kryera pohojmë se:

- Kontabiliteti është mbajtur i plotë për të gjitha veprimet kontabël të rezultuara nga kryerja e veprimeve ekonomike, mbi bazën e dokumentacionit bazë dhe justifikues.
- Regjistrimet kontabël nuk mbahen në programe financiare por në Excel dhe më pas hidhet me veprim ekstra-kontabël.
- Janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit, sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore për kontabilitetin.
- Azhurnimet e veprimeve ekonomike janë në mënyrë kronologjike dhe kontabilizimet e tyre janë kryer në ditarët e bankës, të arkës, magazinës, të pagave etj.,. Këto libra kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentet vërtetuese.
- Në tërësi organizimi i mbajtjes së kontabilitetit ka mundësuar nxjerrjen e gjendjeve të llogarive sipas klasave, nisur nga dokumentet bazë justifikuese, të cilat janë të dhëna bazë të hyra në kontabilitet.
- Plotësimi i dokumenteve bazë e justifikues është bërë në mënyrë të plotë, pasi përshkruajnë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiorë dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin me të dhënat të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Dokumentet vërtetues si urdhër-pagesa, fletë hyrje-daljet, mandat arkëtimet e pagesat, janë të hartuara me të gjitha elementet që kërkon formati i miratuar. Këto dokumente shoqërohen nga dokumente autorizues si kërkesat për financim për veprimet ekonomike të kryera nga drejtoritë përkatëse të miratuar sipas shkallës së hierarkisë, detyrave e përgjegjësive, duke argumentuar shkakun e veprimit të shoqëruar me urdhrat apo vendimet e organeve drejtuese, kontratat, dokumentet kryesore të procedurave të prokurimit, akt-marrëveshjet etj.,. Bashkëlidhur këtij dokumentacioni janë dokumentet vërtetues të shpenzimit si faturat, listë pagesat, situacionet e shpenzimeve, procesverbalet, shkresat etj.,.
- Informacioni kontabël është përgatitur mbi bazën e një kontabiliteti të quajtur të angazhimeve (ose në bazë të të drejtave të konstatuara), duke dhënë elementet e nevojshme për të vlerësuar gjendjen pasurore, gjendjen financiare dhe rezultatet e njësisë ekonomike.

Baza e dhënies së opinionit së Raportimit Financiar. Pohimet mbi saktësinë e paraqitjes së zërave të pasqyrave financiare:

Për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare, u analizuan treguesit e **Pasqyrave Financiare të Bashkisë Libohovë** për aktivitetin ekonomik-financiare për periudhën 01.01.2022, deri më datën 31.12.2022.

Pasqyrat financiare janë përgatitur nga Sektori i Financës. Gjatë fazës së auditimit në terren u kryhen teste të detajeve dhe testeve thelbësore ku është konstatuar se, janë mbajtur tepricat e llogarive dhe se tepricat në çelje për vitin 2022 rakordojnë me tepricat në mbyllje të vitit 2021.

Nga verifikimi i gjendjes së llogarive të bilancit të vitit ushtrimor 2022 konstatohet se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kuadrojnë me formatet anekset pjesë e pasqyrave financiare si dhe llogaritë sintetike kundrojnë me ato analitike. Nga verifikimi i akt-rakordimit vjetor të Degës së Thesarit Gjyrokastër për treguesit e realizimit të buxhetit dhe krahasuar këto me veprimet kontabël në llogarinë e 520 “Disponibilitete në Thesar” dhe në ditarin e bankës rezultojnë të jenë rakorduar, veprime të paraqitura në formatin e pasqyrës së lëvizjes në Cash viti 2022.

Procesi i inventarizimit:

Inventarizimi i aktiveve është një element i rëndësishëm kontrolli në kuadrin e menaxhimit të aktiveve të njësisë i cili kryhet për të vërtetuar saktësinë, cilësinë e gjendjes fizike të aktiveve në një kohë të caktuar si dhe përdorimin në mënyrën e duhur dhe me eficiencë të tyre. Çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementëve dhe dokumentacionit mbështetës.

Për vitin 2022, Kryetari i Bashkisë Libohovë ka nxjerr Urdhrin nr. 114, datë 12.12.2022, me objekt “Për ngritjen e komisionit të inventarizimit fizik dhe vlerësimin të aktiveve për vitin 2022” i përbërë nga znj. S.T. kryetar dhe anëtarët z. Xh.T., znj. D.H., z. E.T., z. A.Ç. si dhe Urdhrin nr. 113, datë 12.12.2022, me objekt “Për ngritjen e komisionit të nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve për vitin 2022” i përbërë nga z. Xh.S. kryetar dhe anëtarët z. E.S, znj. E.L, z. A.T, z. F.Z.

Me shkresën nr. 114/1 prot., datë 29.12.2022, komisioni i inventarizimit dhe vlerësimin ka hartuar raportin përmbledhës për inventarin fizik, së bashku me të gjithë dokumentacionin e inventarizimit të nënshkruar nga secili punonjës që disponon aktive në ngarkim sipas kartelave përkatëse, si dhe listën e aktiveve të vlerësuara për nxjerrë jashtë përdorimit, të cilat janë dorëzuar titullarit të institucionit.

-Nga auditimi konstatohet se nuk është kryer i plotë procesi i inventarizimit për vlerën totale 19,372,484 lekë konkretisht për llogarinë 202 “Studime dhe kërkime” në vlerën 5,645,745 lekë, llogarinë 212 “Ndërtime konstruksione” në vlerën 4,687,737 lekë, llogarinë 213 “Rrugë rrjete vepra ujore” në vlerën 8,296,835 lekë dhe llogarinë 214 “Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune” në vlerën 742,167 lekë të cila në kartelat analitike të secilës llogari janë të emërtuara “Vlerë tjetër” që i përkasin aktiveve të transferuara nga bilanci i ish-komunat (kjo problematikë është trajtuar në mënyrë të hollësishme në vijim të materialit sipas llogarive përkatëse).

Me shkresën nr. 430 prot., datë 30.03.2023, komisioni për nxjerrjen jashtë përdorimit ka kryer verifikimin sipas listës së dorëzuar nga komisioni i inventarit fizik dhe vlerësimin për aktivet e caktuara për jashtë përdorimit të cilat janë në vlerën totale 2,048,466 lekë.

Me Vendimin nr. 18, datë 03.04.2023, dhe shkresën nr. 469 prot., datë 06.04.2023, të Këshillit Bashkiak është miratuar nxjerrja jashtë përdorimit të inventarit të imët në vlerën 224,438 lekë dhe ekonomik në vlerën 1,824,028 lekë për vitin 2022 ose në vlerën totale 2,048,466 lekë. Deri

më datë 28.06.2023, (fundi i periudhës objket auditimi në terren) nuk ka përfunduar procesi i nxjerrjes së aktiveve jashtë përdorimit.

Gjendja e llogarive të evidentuara në bilanc në fund të periudhës raportuese ushtrimore të vitit 2022, të pozicionit financiar të Bashkisë Libohovë (pasqyrat financiare të konsoliduara), Formati nr. 1, paraqitet në pasqyrat e mëposhtme.

Nga procesi i auditimit mbi referencat e llogarive të aktivitetit dhe pasivit, në lidhje me verifikimin e vlerave të pasqyruara në llogaritë e pasqyrave të pozicionit financiar të periudhës raportuese ushtrimore 2022, të saktësisë dhe besueshmërisë së tyre paraqiten si më poshtë:

| | | Lekë |
|--|--|----------------------|
| Aktivet Neto janë të barabarta me Aktivët - Pasivë = Aktivët Neto | | 1,254,022,173 |
| Aktivet | | 1,348,550,178 |
| Pasivët | | 94,528,005 |
| Aktivet Neto | | 1,254,022,173 |

| | | Lekë |
|--|--|-------------|
| Aktivet Afatshkurtra më datë 31.12.2022 paraqiten në vlerën | | |
| Llogaritë e Klasës 5 “Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre” | | 67,060,331 |
| Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues” | | 13,758,041 |
| Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” & “Të tjera aktive afatshkurtra” | | 100,674,686 |

A. AKTIVET

I. Aktivët Afat Shkurtra

1. Llogaritë e Klasës 5 “Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre” përbëhen nga:

| | | Lekë | | |
|--------------------|---|-------------------|-------------------|----------------------------------|
| Llogaritë kontabël | Emërtimi i llogarive | 31.12.2022 | 31.12.2021 | Diferenca/Ndryshimi 2022-2021 |
| 531 | Mjete monetare ne arkë | 0 | 0 | 0 |
| 512,56 | Mjete monetare në bankë | 0 | 0 | 0 |
| 520 | Disponibilitete në thesar | 67,060,331 | 58,555,913 | 8,504,418 |
| 50 | Letra me vlerë | 0 | 0 | 0 |
| 532 | Vlera të tjera | 0 | 0 | 0 |
| 54 | Akreditiva dhe paradhënie | 0 | 0 | 0 |
| 59 | Provizjone zhvlerësimi letra me vlerë (-) | 0 | 0 | 0 |
| | Totali | 67,060,331 | 58,555,913 | 8,504,418 |

Vlera e llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar” në shumën 67,060,331 lekë përbëhet nga gjendja e llogarisë 85 “Rezultati i veprimtarisë së vitit ushtrimor” në vlerën 44,312,956 lekë dhe llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” në vlerën 22,747,375 lekë. Llogaritë e klasës 5, kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llogarive përkatëse për të ardhurat dhe grante të ndryshme, si dhe duke u kredituar për pakësimet në debi të llogarive përkatëse të klasës 4.

2. Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues”, përbëhet nga:

| | | Lekë | | |
|--------------------|--|-------------------|-------------------|----------------------------------|
| Llogaritë kontabël | Emërtimi i llogarive | 31.12.2022 | 31.12.2021 | Diferenca/Ndryshimi 2022-2021 |
| 31 | Materiale | 95,720 | 67,980 | 27,740 |
| 32 | Inventar i imët | 13,662,321 | 13,563,301 | 99,020 |
| 33 | Prodhime, punime e shërbime në proces | 0 | 0 | 0 |
| 34 | Produkte | 0 | 0 | 0 |
| 35 | Mallra | 0 | 0 | 0 |
| 36 | Kafshë në rritje e majmëri | 0 | 0 | 0 |
| 37 | Gjendje të pambrojtura ose pranë të tretëve | 0 | 0 | 0 |
| 38 | Diferenca nga çmimet e magazinimit | 0 | 0 | 0 |
| 39 | Provizjone për zhvlerësimin e inventarit (-) | 0 | 0 | 0 |
| | Totali | 13,758,041 | 13,631,281 | 126,760 |

Llogaritë e Klasës 3, sipas pasqyrës së pozicionit financiar në datën 31.12.2022, paraqitet në vlerën 13,758,041 lekë dhe përbëhet nga llogaria kontabël 31 “Materiale” në vlerën 95,720 lekë dhe llogaria 32 “Inventar i imët” 13,662,321 lekë. Diferenca me vitin e mëparshëm përfaqëson lëvizjen e inventarit në shumën 126,760 lekë e cila kuadron me llogarinë 63 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit” e cila paraqitet në vlerën -126,760 lekë.

-**Llogaria 312 “Materiale”**, ka vlerën 95,720 lekë dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2022 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

| | | Lekë |
|-------------------------------------|-------|---------------|
| Lëvizjet e llogarisë | Vlera | |
| Çelje e vitit 2022 | | 67,980 |
| Hyrje ma pagesë gjatë vitit 2022 | | 49,220 |
| Dalje nga magazina gjatë vitit 2022 | | 21,480 |
| Gjendja në 31.12.2022 | | 95,720 |

-**Llogaria 327 “Inventarë i imët”**, ka vlerën 13,662,321 lekë dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2022 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

| | | Lekë |
|-------------------------------------|-------|-------------------|
| Lëvizjet e llogarisë | Vlera | |
| Çelje e vitit 2022 | | 13,563,301 |
| Hyrje ma pagesë gjatë vitit 2022 | | 99,020 |
| Dalje nga magazina gjatë vitit 2022 | | 0 |
| Gjendja në 31.12.2022 | | 13,662,321 |

3. Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” & “Të tjera aktive afatshkurtra” përbëhet nga:

| | | | | | Lekë |
|--------------------|---|-------------------|-------------------|-------------------------------|------|
| Llogaritë kontabël | Emërtimi i llogarive | 31.12.2022 | 31.12.2021 | Diferenca/Ndryshimi 2022-2021 | |
| | Llogari të arkëtueshme | | | | |
| 411 | Klientë e llogari te ngjashme | 0 | 0 | 0 | |
| 423,429 | Personeli, paradhënie, deficite e gjoba | 0 | 0 | 0 | |
| 431 | Tatime e taksa | 0 | 0 | 0 | |
| 432 | Tatime mbledhur nga shteti për llogari Pushtetit Lokal | 0 | 0 | 0 | |
| 433 | Fatkeqësi natyrore që mbulon shteti | 0 | 0 | 0 | |
| 435 | Sigurime Shoqërore | 0 | 0 | 0 | |
| 436 | Sigurime Shëndetësore | 0 | 0 | 0 | |
| 437,438 | Organizma të tjerë shoqërore | 0 | 0 | 0 | |
| 44 | Institucione të tjera publike | 0 | 0 | 0 | |
| 465 | Efekte për t'u arkëtuar nga shitja letra me vlerë vendosjes | 0 | 0 | 0 | |
| 468 | Debitorë te ndryshëm | 36,929,950 | 35,273,211 | 1,656,739 | |
| 4342 | Operacione me shtetin (Të drejta) | 34,850,680 | 29,394,198 | 5,456,482 | |
| 45 | Marrëdhënie me institucione brenda dhe jashtë sistemit | 0 | 0 | 0 | |
| 49 | Shuma të parashikuara për zhvlerësim (-) | 0 | 0 | 0 | |
| | Totali | 71,780,630 | 64,667,409 | 7,113,221 | |
| | Të tjera aktive afatshkurtra | | | | |
| 409 | Parapagime | 0 | 0 | 0 | |
| 473 | Llogari të pritjes të marrëdhënieve me thesarin | 0 | 0 | 0 | |
| 477 | Diferenca konvertimi aktive | 0 | 0 | 0 | |
| 481 | Shpenzime për t'u shpërndarë në disa ushtrime | 0 | 0 | 0 | |
| 486 | Shpenzime të periudhave të ardhshme | 28,894,056 | 5,689,722 | 23,204,334 | |
| | Totali | 28,894,056 | 5,689,722 | 23,204,334 | |

Gjendja e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” paraqitet më datën 01.01.2022, në vlerën 35,273,211 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2022, paraqitet në vlerën 36,929,950 lekë me një rritje në vlerën lekë. Analiza e detajuar mbi listën e debitorëve, paraqitet në aneksin nr. 3, tabela nr. 1, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

| Llekë | |
|---------------------------------------|-------------------|
| Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” | |
| Çelje e vitit 2022 | 35,273,211 |
| Shtesa (K) | 1,726,739 |
| Pakësime (D) | 70,000 |
| Gjendja debitore në 31.12.2022 | 36,929,950 |

-Llogaria 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)”, në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën 34,850,680 lekë e cila nuk kuadron me llogarinë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” të Pasqyrës së Performancës Financiare e cila paraqitet në shumën 0 lekë, si dhe përbëhet nga:

| Llekë | |
|---|-------------------|
| Llogaria 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” | |
| Çelje e vitit 2022 | 29,394,198 |
| Shtesa (K) | 14,251,487 |
| Pakësime (D) | 8,795,005 |
| Gjendja debitore në 31.12.2022 | 34,850,680 |

Shënim: (Shtesa në shumën prej 14,251,487 lekë përbëhet nga shtesa për paga në vlerën 842,472 lekë + shtesa për sigurime shoqërore në vlerën 95,384 lekë + sigurime shëndetësore në vlerën 12,947 lekë dhe kreditorë të ndryshëm në vlerën 13,300,684 lekë. Pakësimet në shumën prej 8,795,005 lekë përbëhet nga pakësimet për TAP në vlerën 6,003 lekë dhe pakësime nga kreditorë të ndryshëm në vlerën 8,789,002 lekë).

| Llekë | |
|---|-------------------|
| Emërtimi i llogarive | Vlera |
| Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” | 0 |
| Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm” | 29,191,056 |
| Paga personeli llogaria 42 | 4,240,112 |
| Tatimi mbi të ardhurat llogaria 431 | 165,775 |
| Sigurime shoqërore llogaria 435 | 1,106,106 |
| Sigurime shëndetësore 436 | 147,631 |
| Totali | 34,850,680 |

| | |
|-------------------------------|--|
| 13. Titulli i gjetjes: | Pasqyrim jo i saktë i llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”. |
| Situata: | Llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” në fund të vitit 2022, paraqitet në vlerën 28,894,056 lekë, veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin nr. 5, datë 21.12.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, seksioni 3.1, sipas së cilës duhej kredituar llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” për vlerën 28,894,056 lekë në debi tek llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm” në vlerën 28,894,056 lekë. |
| Kriteri: | Udhëzimi nr. 5, datë 21.12.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, seksioni 3.1. |
| Ndikimi/Efekti: | Pasqyrim jo i saktë i kësaj llogarie. |
| Shkaku: | Mos zbatimi i dispozitave ligjore përkatëse. |
| Rëndësia: | E lartë. |
| Rekomandim: | Nga Sektori i Financës në pasqyrat financiare të vitit 2023, të bëhet sistemi i vlerës 28,894,056 lekë e cila ka të bëjë me kontabilizimin dhe paraqitje të gabuar në llogarinë 486 “Shpenzime të periudhave të |

| | |
|--|---|
| | ardhshme”, sistemit ë bëhet referuar trajtimit kontabël duke kredituar llogarinë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” për vlerën 28,894,056 lekë në debi tek llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm” në vlerën 28,894,056 lekë. |
|--|---|

Llogaritë e klasës 4, kanë funksionuar duke u debituar për njohjen e të drejtave për tu arkëtuar në kredi të llogarive të klasës 7 dhe duke u kredituar për arkëtimin e të drejtave në debi të llogarive financiare të klasës 5.

II. AKTIVET AFAT GJATA

1. Aktivet Afatgjata Jomateriale.

-Llogaria 202 “Studime dhe kërkime” më datën 01.01.2022, ka qenë në vlerën 7,017,614 lekë. Gjatë vitit 2022 për këtë llogari nuk ka pasur shtesa apo pakësime por është përlllogaritur amortizim i akumuluar në vlerën 47,500 lekë, ndërsa më datë 31.12.2022, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 7,017,614 lekë. Analiza e detajuar e kësaj llogarie, paraqitet në aneksin nr. 3, tabela nr. 2, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

| Referenca | Nr. | Llogaria 202 “Studime dhe kërkime” | Vlera |
|--------------------|-----|------------------------------------|------------------|
| Ditari i veprimeve | 1 | Kosto historike | 7,065,114 |
| | 2 | Amortizim i akumuluar | 47,500 |
| | 3 | Gjendja në 01.01.2022 | 7,017,614 |
| | 2 | Shtesa gjatë vitit 2022 (D) | 0 |
| | 3 | Pakësime gjatë vitit 2022 (K) | 0 |
| | 4 | Kosto historike | 7,017,614 |
| | 5 | Amortizim i akumuluar | 47,500 |
| | 6 | Gjendja më datë 31.12.2022 | 7,017,614 |

2. Aktivet Afatgjata Materiale

| | |
|-------------------------------|--|
| 14. Titulli i gjetjes: | Mos pasqyrim i saktë i gjendjes reale të llogarive (210; 211; 212 dhe 213) në pasqyrat financiare të vitit 2022. |
| Situata: | <p>1. Llogaria 210 “Toka, troje, terrene” më datën 31.12.2022, paraqitet në vlerën 0 lekë. Nga verifikimi dhe analiza e llogarisë 210 “Toka, troje, terrene” konstatohet se kjo llogari nuk paraqet gjendjen reale nga Sektori i Financës pas nuk janë hedhur në kartelat e kontabilitetit asnjë prej vlerave të, trojeve nën objekt të objekteve si godina e Bashkisë dhe trualli përreth saj, trojet e ndërtesave të shkollave, kopshteve e çerdheve, Shtëpisë së Kulturës, zyrave në Njësitë Administrative etj., sipas regjistrimit të aktiveve të pasqyruar në llogarinë 212 “Ndërtime e konstruksione”. Gjithashtu nuk mund të përcaktohet se vlera e pasqyruar në kontabilitet për llogarinë 212 “Ndërtime konstruksione” e cila paraqitet në vlerën 268,387,859 lekë më datë 31.12.2021, dhe në vlerën 270,454,477 lekë më datë 31.12.2022, e cila përfaqëson vlerën e objekteve apo dhe vlerën e truallit nën këto objekte. Kjo përbën një klasifikim dhe paraqitje jo të saktë të vlerës pasi, ndërtesat amortizohen sipas normave të përcaktuara në SKK nr. 5, afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jo materiale” i përmirësuar, ndërkohë që trojet nën objekte janë të pa amortizueshme.</p> <p>2. Llogaria 211 “Pyje, kullota, plantacione” më datën 31.12.2022,</p> |

paraqitet në vlerën 0 lekë. Për sa i përket kalimit të sipërfaqeve të pyjeve dhe kullotave në zbatim të VKM nr. 433, datë 08.06.2016, “Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-Komunave/Bashkive”, pika 29, shtojca nr. 27, e cila përmban listën e inventarit të pyjeve dhe kullotave që transferohen në pronësi të Bashkisë Libohovë, me numër rendor 1 deri në 215, konstatohet se ky proces nuk është i evidentuar në pasqyrat financiare në llogarinë përkatëse. Lista përkatëse është në total 12,140 ha nga të cilat 7,918 ha kullotë verore, 3,006 ha pyll, 1,027 ha kullotë dimërore, 146 ha tokë improduktive, 42 ha djerrë dhe 1 ha tokë buke.

Në këtë llogari nuk ka të reflektuar sipërfaqet të cilat i kanë kaluar Bashkisë me VKM nr. 666, datë 21.05.2008, dhe VKM nr. 750, datë 28.05.2008, “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave, pyje dhe kullota, që do të transferohen në pronësi të Qeverisjes Vendore, Komuna Qendër Libohovë, të Qarkut të Gjirokastrës”, ku përcaktohen në total 1,678 ha nga këto 413 ha + 401 ha kullotë dimërore (për secilën VKM) dhe 182 ha + 682 ha kullotë (për secilën VKM). Në llogarinë 211 “Pyje, kullota, plantacione” nuk janë pasqyruar sipërfaqet e trajtuara më sipër, në kushte të tilla kjo llogari nuk paraqet një pamje reale në pasqyrat financiare të vitit 2022.

-Procesi i përcaktimit të tokës dhe pronave shtetërore dhe ndarja e tyre në mes të agjencive shtetërore dhe njësisë të qeverisjes vendore është një proces i cili ka nisur që nga viti 2001. Ky proces duhej zbatuar në bazë të Ligjit nr. 8743, datë 22.02.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit” i ndryshuar, dhe Ligjit nr. 8744, datë 22.02.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore” i ndryshuar.

Dispozita ligjore e fundit që trajton problematikën e procesit të pronësisë për njësitë e vetëqeverisjes vendore është Ligji nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, neni 37, përcaktohet që: “Institucionet shtetërore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë për detyrë të kryejnë përditësimin e plotë të pronave të inventarizuara apo të transferuara në favor të tyre brenda 18 muajve nga data e hyrjes në fuqi e ligjit”, proces i cili duhet të përfundonte në muajin nëntor të vitit 2021.

Për asetet të cilat janë transefruar sipas VKM-ve të sipërpërmendura konstatohet se, në Bashkisë Libohovë nuk është realizuar inventarizimi i pasurive (pyje/kullota).

Pra nuk ka nisur procesi i transferimit të pronës që kalon në tre faza:

1. Identifikimi i statusit të inventarizimit, transferimit dhe regjistrimit të pronave shtetërore drejt njësisë së qeverisjes vendore, Bashkisë Libohovë;
2. Problematikat e procesit të transferimit dhe regjistrimit të pronave shtetërore;
3. Identifikimi dhe analizimi i opsioneve të përdorimit dhe menaxhimit

të pronës shtetërore.

3. Llogaria 212 “Ndërtime konstruksione” ka të evidentuara në kontabilitet një numër të konsiderueshëm objektesh nga ish-Komunat të cilat janë në verifikim për regjistrimin e tyre. Kjo vjen për arsye se një pjesë e objekteve janë të trashëguara dhe të mbartura nga njësitë që u shkrinë (ish/Komunat) në periudhat raportuese para vitit 2015 të pa shoqëruar me kartela objekti. Në këto kushte duke qënë se ka mospërputhje në administrimin për çdo objekt të “Ndërtesave e Konstruksioneve” nga Bashkia Libohovë, Sektori i Financës, Sektori Juridik, Sektori i Shërbimit Urban, në bashkëpunim ndërmjet tyre, duhet që të bëhet hedhja në kontabilitet e objekteve dhe sipërfaqeve të regjistruara saktësimi objekteve, dokumentimi me kartelë objekti, inventarizim fizik i objektit, si dhe rivlerësim me normat për secilin objekt. Për sa më sipër llogaria 212 “Ndërtime konstruksione” nuk paraqet një pamje reale për pasqyrat financiare të vitit 2022.

4. Nga auditimi i llogarisë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” konstatohet se, nuk është vlerësuar dhe evidentuar në këtë llogari vlera e rrugës prej 29 km e përbërë nga 15 km “Kthesë Libohovë-Selcke” dhe 14 km rruga “Poliçan-Nivan”, të kaluara në pronësi të Bashkisë Libohovë me VKM nr. 915, datë 11.11.2015, “Për transferimin në pronësi, nga Këshillat e Qarqeve të Bashkisë, të rrjetit të rrugëve rurale dhe aseteve të luajtshme e të paluajtshme të ndërmarrjeve të mirëmbajtjes së këtyre rrugëve”, pika 9, tabela 1, faqe 3.

5. Nga auditimi konstatohet se në llogaritë 210 “Toka, troje, terrene”, 211 “Pyje, plantacione”, 212 “Ndërtesa e konstruksione”, 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, nuk janë reflektuar të gjitha ndërtesat, trojet, terrenet, rrugë, vepra ujore etj., të kaluara pas reformës teritoriale, dhe Vendimi i Këshillit Bashkiak nr. 91, datë 14.10.2016, “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme shtetërore që kërkohen për transferim në pronësi të njësisë administrative qendër Libohovë të Bashkisë Libohovë”, në zbatim të Ligjit nr. 115/2014, “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të Ligjit nr. 8743 datë 22.02.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit, i ndryshuar, VKM nr. 840, datë 22.07.2009, “Për miratimin e inventarit të pronave të paluajtshme në Komunën Libohovë”, si dhe me Udhëzimin nr. 15, datë 30.06.2003, “Për mënyrën e paraqitjes nga Njësitë e Qeverisjes Vendore të kërkesave për transferimin në pronësi të pronave të paluajtshme publike”.

6. Për aktivet që i përkasin llogarisë 210 “Toka, troje, terrene”, 211 “Pyje, plantacione”, 212 “Ndërtesa konstruksione” dhe 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, për koston historike 935,219,591 lekë, Bashkia Libohovë posedon titull pronësie/pasuri të regjistruara në ASHK Gjirokastër sipas zonave kadastrale vetëm për tre objekte si më poshtë:

-Pasuria nr. 14/8 (Muzeu “Avni Rustemi”);

-Pasuria nr. 8/185 (Ndërtesa e Bashkisë);

| | |
|------------------------|---|
| | <p>-Pasuria nr. 2/27 (Kopështi Fëmijëve Hoxhallarë)</p> <p>Ndërsa për pjesën tjetër të llogarive të sipërpërmendura nuk posedon titull pronësie.</p> <p>7. Vlen të theksohet se në Buxhetin Vjetor të vitit 2022 të miratuar me Vendimin nr. 64, datë 29.12.2022, të Këshillit Bashkiak Libohovë nuk janë parashikuar fonde për nisjen e procedurave për regjistrimin e aseteve të institucionit.</p> |
| Kriteri: | SKK nr. 5, afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jo materiale” i përmirësuar, ndërkohë që trojet nën objekte janë të pa amortizueshme, Ligji nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, neni 37. |
| Ndikimi/Efekti: | Pasqyrat financiare të periudhës raportuese të vitit 2022 për llogaritë (210; 211; 212 dhe 213) nuk paraesin në mënyrë të drejtë pozicionin financiar dhe gjendjen reale. |
| Shkaku: | Nuk janë marrë masat e duhurat nga drejtimi i njsësisë për këto llogari për të bërë të mundur regjistrimin e investimeve, analizimin dhe saktësimin në kontabilitet të këtyre aktiveve, duke mbledhur e evidentuar të dhënat nga gjithë dokumentacioni financiar të dala dhe të trashëguara nga ish-Komunat. |
| Rëndësia: | E lartë. |
| Rekomandim: | Kryetari i Bashkisë Libohovë të marrë masa për vlerësimin e trojeve nën godina, që ka në inventar, si dhe të kryhet inventarizimi dhe vlerësimi i trojeve, të kaluara me VKM në pronësi të Bashkisë Libohovë. Po kështu për pyjet, kullotat, rrugë, vepra ujore, etj., në pronësi të Bashkisë Libohovë, të transferuara me VKM, të bëhen inventarët me përditësimet përkatëse, saktësimi i hartave dhe kufijve të tyre, si dhe të bëhet vlerësimi i tyre. Pas procesit të regjistrimit në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës Gjirokastrë dhe procesit të vlerësimit të kryhen veprimet kontabël për përfshirjen e të gjitha këtyre Aktiveve Afatgjata Materiale në gjendjen e llogarive përkatëse në pasqyrat financiare. |
| Rekomandim: | <p>Kryetari i Bashkisë Libohovë, të marrë masat e duhura që:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Të ngrejë grup pune i cili të verifikoj, vlerësoj, dhe saktësoj të gjitha aktivet e llogarive të klasës 2 dhe të dokumentoj këto aktive sipas kuadrit ligjor për regjistrimin e pasurisë. 2. Të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës për kryerjen e inventarizimit dhe vlerësimin e aktiveve të llogarinë 212 “Ndërtesa Konstruksiione” për NJA dhe nëpërmjet Drejtorisë Ekonomike të kryejë zbërthimin e dokumentacionit të trashëguar nga ish-Komunat për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra e veprimet me to në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në bilancin e vitit 2015 e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik. |

-Llogaria 212 “Ndërtime konstruksione” më datën 01.01.2022, ka qenë në vlerën 268,387,859 lekë. Gjatë vitit 2022 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 2,175,387 lekë, dhe amortizim të akumuluar në vlerën 33,103,074 lekë ndërsa më datë 31.12.2022, gjendja e kësaj llogarie

paraqitet në vlerën 270,454,477 lekë. Analiza e detajuar e kësaj llogarie, paraqitet në aneksin nr. 3, tabela nr. 3, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

| Referenca | Nr. | 212 “Ndërtime konstruksione” | Vlera |
|--------------------|-----|-----------------------------------|--------------------|
| Ditari i veprimeve | 1 | Kosto historike | 301,382,164 |
| | 2 | Amortizim i akumuluar | 32994,305 |
| | 3 | Gjendja në 01.01.2022 | 268,387,859 |
| | 2 | Shtesa gjatë vitit 2022 (D) | 2,175,387 |
| | 3 | Pakësime gjatë vitit 2022 (K) | 0 |
| | 4 | Kosto historike | 303,557,551 |
| | 5 | Amortizim i akumuluar | 33,103,074 |
| | 6 | Gjendja më datë 31.12.2022 | 270,454,477 |

-Llogaria 213 “Rrugë rrjete vepra ujore” më datën 01.01.2022, ka qenë në vlerën 633,837,427 lekë. Gjatë vitit 2022 për këtë llogari nuk ka pasur shtesa apo pakësime por është përlllogaritur amortizim i akumuluar në vlerën 151,013,379 lekë, ndërsa më datë 31.12.2022, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 482,824,048 lekë. Analiza e detajuar e kësaj llogarie, paraqitet në aneksin nr. 3, tabela nr. 4, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

| Referenca | Nr. | Llogaria 213 “Rrugë rrjete vepra ujore” | Vlera |
|--------------------|-----|---|--------------------|
| Ditari i veprimeve | 1 | Kosto historike | 633,837,427 |
| | 2 | Amortizim i akumuluar | 151,013,379 |
| | 3 | Gjendja në 01.01.2022 | 482,824,048 |
| | 2 | Shtesa gjatë vitit 2022 (D) | 0 |
| | 3 | Pakësime gjatë vitit 2022 (K) | 0 |
| | 4 | Kosto historike | 633,837,427 |
| | 5 | Amortizim i akumuluar | 151,013,379 |
| | 6 | Gjendja më datë 31.12.2022 | 482,824,048 |

-Llogaria 214 “Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune” më datën 01.01.2022, ka qenë në vlerën 12,731,445 lekë. Gjatë vitit 2022 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerë 501,600 lekë dhe amortizim të akumuluar në vlerën 4,278,772 lekë ndërsa më datë 31.12.2022, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 8,854,273 lekë. Analiza e detajuar e kësaj llogarie, paraqitet në aneksin nr. 3, tabela nr. 5, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

Lekë

| Referenca | Nr. | Llogaria 214 “Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune” | Vlera |
|--------------------|-----|--|------------------|
| Ditari i veprimeve | 1 | Kosto historike | 12,731,445 |
| | 2 | Amortizim i akumuluar | 4,253,692 |
| | 3 | Gjendja në 01.01.2022 | 8,477,753 |
| | 2 | Shtesa gjatë vitit 2022 (D) | 501,600 |
| | 3 | Pakësime gjatë vitit 2022 (K) | 0 |
| | 4 | Kosto historike | 13,233,045 |
| | 5 | Amortizim i akumuluar | 4,278,772 |
| | 6 | Gjendja më datë 31.12.2022 | 8,854,273 |

| | |
|-------------------------------|--|
| 15. Titulli i gjetjes: | Vlera të paverifikueshme dhe të pa dokumentuara në llogaritë 202 “Studime dhe kërkime”, 212 “Ndërtime konstruksione”, 213 “Rrugë rrjete vepra ujore” dhe 214 “Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune”. |
| Situata: | Nga auditimi i evidencave analitike për aktivet afatgjata materiale dhe jo materiale konstatohet se, në llogarinë 202 “Studime dhe kërkime” pasqyrohen aktive me emërtimin “Vlerë tjetër” në vlerën 5,645,745 lekë, në llogarinë 212 “Ndërtime konstruksione” pasqyrohen aktive me emërtimin “Vlerë tjetër” në vlerën 4,687,737 lekë, në llogarinë 213 “Rrugë rrjete vepra ujore” asqyrohen aktive me emërtimin “Vlerë |

| | |
|------------------------|---|
| | tjetër” në vlerën 8,296,835 lekë dhe në llogarinë 214 “Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune” pasqyrohen aktive me emërtimin “Vlerë tjetër” në vlerën 742,167 lekë. Për këto katër zëra sipas klasave respektive në shumën totale 19,372,484 lekë nuk disponohet asnjë dokumentacion kontabël, mbi origjinën e tyre të cilat mbahen të mbartura dhe trashëguara vit pas viti në kontabilitet, si dhe nuk janë të verifikueshme fizikisht dhe se çfarë pasqyrojnë këto vlera në kontabilitetin e njësisë për shkak të mos përshkrimit të aktivitetit dhe mungesës së çdo dokumentacioni tjetër kontabël për këto aktive. |
| Kriteri: | Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75 dhe Udhëzimi nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu II “Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 5. |
| Ndikimi/Efekti: | Pasqyrat financiare të periudhës raportuese nuk paraqesin në mënyrë të besueshme dhe të drejtë pozicionin financiar të llogarive (202; 212; 213 dhe 214). |
| Shkaku: | Nuk janë marrë masat e duhura për verifikimin e aktiveve në vitin korrent dhe vitet e mëparëshme duke trashëguar vlera pa dokumentacion kontabël të verifikueshëm. |
| Rëndësia: | E lartë. |
| Rekomandim: | Kryetari i Bashkisë Libohovë dhe Shefi i Sektorit të Financës të ngrejnjë një grup pune me specialistë të fushës për shqyrtimin e situatës së mosverifikimit të zërave në llogaritë kontabël (202; 212; 213 dhe 214), saktësimin e vlerave në pasqyrat financiare me dokumentacion vërtetues dhe justifikues, me qëllim evidentimin dhe raportimin e saktë në dokumentet kontabël të Njesisë. |

| | |
|-------------------------------|--|
| 16. Titulli i gjetjes: | Mos aplikim i normave të amortizimit për llogaritë 202 “Studime dhe kërkime” dhe 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”. |
| Situata: | Nga auditimi i Pasqyrës nr. 7/b “Gjendja dhe Ndryshimet e Aktiveve Afatgjata (Vlera Neto)” konstatohet se, për llogarinë 202 “Studime dhe kërkime” për vitin ushtrimor 2022 nuk është përlllogaritur normë amortizimi. Në mbyllje të gjendjes së kësaj llogarie më datë 31.12.2022, është pasqyruar vlera e amortimit të akumuluar në vlerën 47,500 lekë por kjo vlerë i përket amortizimit të akumuluar të çeljes së llogarisë më datë 31.12.2021. Ndërsa edhe për llogarinë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” për vitin ushtrimor 2022 nuk është përlllogaritur normë amortizimi. Në mbyllje të gjendjes së kësaj llogarie më datë 31.12.2022, është pasqyruar vlera e amortimit të akumuluar në vlerën 151,013,379 lekë por kjo vlerë i përket amortizimit të akumuluar të çeljes së llogarisë më datë 31.12.2021. |
| Kriteri: | Udhëzimi nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin |

| | |
|------------------------|---|
| | nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kapitulli III “Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 3.1, “Procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, nënpika 36. |
| Ndikimi/Efekti: | Pasqyrim jo i saktë i kësaj llogarie. |
| Shkaku: | Mos zbatimi i dispozitave ligjore përkatëse. |
| Rëndësia: | E lartë. |
| Rekomandim: | Nga Sektori i Financës të merren masa që gjatë hartimit të pasqyrave financiare të aplikohen normra amortizimi për llogaritë 202 “Studime dhe kërkime” dhe 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” duke përbushur njëkohësisht edhe detyrimet sipas dispozitave ligjore përkatëse. |

-Llogaria 215 “Mjete transporti” më datën 01.01.2022, ka qenë në vlerën 11,021,440 lekë. Gjatë vitit 2022 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerë 10,992,000 lekë dhe amortizim të akumuluar në vlerën 8,185,907 lekë ndërsa më datë 31.12.2022, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 13,827,533 lekë. Analiza e detajuar e kësaj llogarie, paraqitet në aneksin nr. 3, tabela nr. 6, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

Lekë

| Referenca | Nr. | Llogaria 215 “Mjete transporti” | Vlera |
|--------------------|----------|-----------------------------------|-------------------|
| Ditari i veprimeve | 1 | Kosto historike | 11,021,440 |
| | 2 | Amortizim i akumuluar | 5,987,507 |
| | 3 | Gjendja në 01.01.2022 | 5,033,933 |
| | 2 | Shtesa gjatë vitit 2022 (D) | 10,992,000 |
| | 3 | Pakësime gjatë vitit 2022 (K) | 0 |
| | 4 | Kosto historike | 22,013,440 |
| | 5 | Amortizim i akumuluar | 8,185,907 |
| | 6 | Gjendja më datë 31.12.2022 | 13,827,533 |

-Llogaria 218 “Inventar ekonomik” më datën 01.01.2022, ka qenë në vlerën 25,090,792 lekë. Gjatë vitit 2022 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerë 1,196,503 lekë dhe amortizim i akumuluar në vlerën 10,886,850 lekë ndërsa më datë 31.12.2022, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 15,400,445 lekë.

Lekë

| Referenca | Nr. | Llogaria 202 “Studime dhe kërkime” | Vlera |
|--------------------|----------|------------------------------------|-------------------|
| Ditari i veprimeve | 1 | Kosto historike | 25,090,792 |
| | 2 | Amortizim i akumuluar | 10,647,549 |
| | 3 | Gjendja në 01.01.2022 | 14,443,243 |
| | 2 | Shtesa gjatë vitit 2022 (D) | 1,196,503 |
| | 3 | Pakësime gjatë vitit 2022 (K) | 0 |
| | 4 | Kosto historike | 26,287,295 |
| | 5 | Amortizim i akumuluar | 10,886,850 |
| | 6 | Gjendja më datë 31.12.2022 | 15,400,445 |

Shënim: (Analiza e llogarisë 218 “Inventar Ekonomik” nuk është pasqyruar në aktkonstatim për arsye madhësisë si evidencë por ky dokumentacion do të jetë pjesë e dosjes së auditimit në CD).

| | |
|-------------------------------|--|
| 17. Titulli i gjetjes: | Mungesa e një regjistri kontabël për aktivet për aktivet afatgjata apo afatshkurtra. |
| Situata: | Nga auditimi i llogarisë 210 “Toka, troje, terrene”, 211 “Pyje, plantacione”, 212 “Ndërtesa e konstruksione”, 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, 214 “instalime teknike, makineri pajisje vegla pune”, janë të pa |

| | |
|------------------------|---|
| | analizuara në kontabilitet, nuk ka një regjistër kontabël ku të specifikohen analitikët e këtyre zërave si dhe nuk ka informacioni për secilin aktiv në lidhje me datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datë e skadencës, personin përgjegjës, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia, në këto kushte nuk mund të ketë informacion të saktë në lidhje me gjendjen kontabël, e cila do të krahasohet dhe me gjendjen faktike kur bëhet inventarizimi fizik çdo vit për të vërtetuar dhe sistemuar vlerën e tyre në kontabilitet, pra na japin arsye të mos kemi siguri mbi vlerat në pasqyrat e pozicionit financiar për sa i përket këtyre llogarive për pasojë të mos japim dot një opinion mbi plotësinë, saktësinë dhe përkatësinë e këtyre vlerave në kontabilitet. |
| Kriteri | Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 6, Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 26-30, pika 74, dhe Udhëzimi nr. 05, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisë të Qeverisjes së Përgjithshme”, Kreu II pika 5, 36 dhe Kreu III pika 30. |
| Ndikimi/Efekti: | Ekzistenca dhe gjendja në të cilën ndodhen aktivet fizike është një pjesë e rëndësishme në vlerësimin e riskut për arritjen e objektivave të institucionit dhe vazhdimësinë e saj. Mos plotësimi i regjistrit të aktiveve sjell risk i lartë për shpërdorime materiale të pasurisë së institucionit si humbje, vjedhje, shkatërrime dhe mos përditësim i aktiveve që ka në dispozicion. |
| Shkaku: | Mos implementimi i dispozitave ligjore përkatëse. |
| Rëndësia: | E lartë. |
| Rekomandim: | Bashkia Libohovë, Sektori i Financës të marrin masa për hartimin e regjistrit të aktiveve që Bashkia zotëron me të gjitha kërkesat e formatit të aprovuar për të ulur riskun e shpërdorimeve materiale të pasurisë së institucionit dhe mirë menaxhimin e tyre. |

3. Aktivet Afatgjata Financiare

Aktivitet Afatgjata Financiare më datë 31.12.2022, paraqiten në vlerën 76,399,726 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

| Lekë | | | | |
|--------------------|--------------------------------|-------------------|-------------------|-------------------------------|
| Llogaritë kontabël | Emërtimi i llogarive | 31.12.2022 | 31.12.2021 | Diferenca/Ndryshimi 2022-2021 |
| 25 | Huadhënie e nënhuadhënie | 0 | 0 | 0 |
| 26 | Pjesëmarrje në kapitalin e vet | 76,399,726 | 76,399,726 | 0 |
| | Totali | 76,399,726 | 76,399,726 | 0 |

4. Investimet

Gjendja e llogarisë 231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT” në mbyllje të vitit ushtrimor 2022 paraqitet në vlerën 292,179,005 lekë, ku është kontabilizuar vlera për 6 kontrata punimesh të cilat janë në proces zbatimi punimesh. Nga testimi i kontratave konstatohet se nuk

ka kontrata punimesh të cilat janë ende të pa likuiduara nga viti 2022. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

| Llogaria 231 "Për aktive afatgjata materiale" | |
|---|--------------------|
| Çelje e vitit 2022 | 211.279.053 |
| Shtesa (K) | 81.968.335 |
| Pakësime (D) | 1.068.383 |
| Gjendja debitore në 31.12.2022 | 292.179.005 |

Lekë

| Llogaria 231 "Për aktive afatgjata materiale" | Gjendja 01.01.2022 | Shtesa (D) | Pakësime (K) | Gjendja 31.12.2022 |
|---|--------------------|-------------------|------------------|--------------------|
| Ujësijllësi | | 80.899.952 | | |
| Kontenierë | | 501.600 | 501.600 | |
| Rehabilitim i murit mbajtës Nivan | | 97.200 | 97.200 | |
| Rehabilitim i çezmës së Rezervuarit Sheper | | 99.600 | 99.600 | |
| Rehabilitim i ujësijllësit Stegopul | | 99.600 | 99.600 | |
| Rehabilitim i murit mbajtës te varrezave Libohovë | | 270.382 | 270.382 | |
| Totali | 211.279.053 | 81.968.335 | 1.068.382 | 292.179.005 |

Burimi i të dhënave: Bashkia Libohovë.

B. PASIVET (DETYRIMET)

I. Pasivet Afatshkurtra

1. Llogari të pagueshme

Llogaritë e klasës 4 në Pasiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, janë llogari të pagueshme ato paraqesin detyrimet e Bashkisë Libohovë më 31.12.2022, kundrejt furnitorëve, pagat e punonjësve, detyrimet kundrejt tatimeve, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të muajit dhjetor 2022, kreditorë për mjete në ruajtje të cilat kryesisht kanë të bëjnë me garancitë e kontratave, kreditorë të ndryshëm etj., si më poshtë:

Lekë

| Llogaria | Emërtimi i llogarisë | Viti 2022 | Viti 2021 | Diferenca/Ndryshimi |
|----------|--|-------------------|-------------------|---------------------|
| 401-408 | Furnitorë e llogari të lidhura me to | 0 | 0 | 0 |
| 42 | Detyrime ndaj personelit | 4,240,112 | 3,397,640 | 842,472 |
| 16,17,18 | Hua afat shkurtra | 0 | 0 | 0 |
| 460 | Huadhënës | 0 | 0 | 0 |
| 431 | Detyrime ndaj shtetit tatim taksa | 165,775 | 171,778 | (6,003) |
| 432 | Tatime, mbledhur për llogari të pushtetit lokal | 0 | 0 | 0 |
| 433 | Detyrime, shteti fatkeqësi natyrore | 0 | 0 | 0 |
| 435 | Sigurime shoqërore | 1,106,106 | 0 | 0 |
| 436 | Sigurime shëndetësore | 147,631 | 1,010,722 | 95,384 |
| 437,438 | Organizma të tjerë shtetërore | 0 | 134,684 | 12,947 |
| 44 | Institucione të tjera publike | 0 | 0 | 0 |
| 45 | Marrëdhënie midis institucioneve apo njësisive ekonomike | 0 | 0 | 0 |
| 464 | Detyrime për tu paguar për blerjen e letrave me vlerë | 0 | 0 | 0 |
| 466 | Kreditorë për mjete në ruajtje | 22,747,375 | 18,743,982 | 4,003,393 |
| 467 | Kreditorë të ndryshëm | 29,191,056 | 22,849,095 | 6,341,961 |
| 4341 | Operacione me shtetin (detyrime) | 36,929,950 | 35,273,211 | 1,656,739 |
| 49 | Shuma të parashikuara për zhvlerësim (-) | 0 | 0 | 0 |
| | Llogari të pagueshme | 94,528,005 | 81,581,112 | 12,946,893 |

-Llogaria 401-408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to", në datën 31.12.2022, paraqitet në vlerën 0 lekë pra Bashkia Libohovë nuk ka fatura të pa likuiduara për këtë llogari.

| | |
|-------------------------------|---|
| 18. Titulli i gjetjes: | Mos kuadrimi i diferencë në llogairnë 24 "Detyrime ndaj personelit". |
| Situata: | Llogaria 42 "Detyrime ndaj personelit" referuar pasqyrave financiare vlera 4,240,112 lekë përfaqëson vlerën e pagave për muajin dhjetor të |

vitit 2022 e cila mbetet për t'u paguar në muajin janar të vitit pasardhës.

Lekë

| Llogaria 42 "Detyrime ndaj personelit" | |
|--|------------------|
| Çelje e vitit 2022 | 3,397,640 |
| Shtesa (K) | 842,472 |
| Pakësime (D) | 0 |
| Gjendja debitore në 31.12.2022 | 4,240,112 |

Konkretisht sipas dokumenteve të Thesarit të muajit Janar të vitit 2023, konstatohet se:

Lekë

| Urdhër shpenzimi | | |
|------------------|------------|------------------|
| Nr. | Datë | Vlera |
| 1 | 16.01.2023 | 174,289 |
| 2 | 16.01.2023 | 790,426 |
| 3 | 16.01.2023 | 14,208 |
| 4 | 16.01.2023 | 80,279 |
| 5 | 16.01.2023 | 318,963 |
| 6 | 16.01.2023 | 1,655,155 |
| 7 | 16.01.2023 | 59,234 |
| 8 | 16.01.2023 | 555,080 |
| Totali | | 3,647,634 |

Burimi i të dhënave: Bashkia Libohovë.

Vlera e kontabilizuar në llogarinë "Detyrime ndaj personelit" është 4,240,112 lekë ndërkohë që duke u bazuar në urdhër shpenzimet e realizuara nëpërmjet Degës së Thesarit Gjirokastrë vlera e kësaj llogarie është 3,647,634 lekë me një diferencë pak në vlerën 592,478 lekë.

| | |
|------------------------|---|
| Kriteri: | Udhëzimi nr. 5, datë 21.02.2022, "Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", Aneksi nr. 1, pika 3.3. |
| Ndikimi/Efekti: | Mos kuadrim i llogarive. |
| Shkaku: | Mos zbatimi i dispozitave ligjore përkatëse. |
| Rëndësia: | E lartë. |
| Rekomandim: | Nga Sektori i Financës të analizohet dhe të sistemohet në pasqyrat financiare diferenca në vlerën 592,478 lekë që i përket kontabilizimit të gabuar në llogarinë 42 "Detyrime ndaj personelit" për të cilën nuk disponohet dokumentacioni justifikues dhe vërtetues përkatës. |

-Llogaria 431 "Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa", paraqitet në vlerën 165,775 lekë dhe përfaqëson vlerën për t'u paguar për taksa e tatime nga Shtetit për muajin dhjetor.

Lekë

| Llogaria 431 "Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa" | |
|--|----------------|
| Çelje e vitit 2022 | 171,778 |
| Shtesa (K) | 0 |
| Pakësime (D) | 6,003 |
| Gjendja debitore në 31.12.2022 | 165,775 |

Konkretisht sipas dokumenteve të Thesarit të muajit Janar të vitit 2023 konstatohet se:

Lekë

| Urdhër shpenzimi | | |
|------------------|------------|----------------|
| Nr. | Datë | Vlera |
| 12 | 16.01.2023 | 165,775 |
| Totali | | 165,775 |

Burimi i të dhënave: Bashkia Libohovë.

-Llogaria 435 “Sigurime shoqërore” dhe llogaria 436 “Sigurime shëndetësore” paraqet vlerën e pa paguar për sigurime shoqërore e shëndetësore për pagat e muajit dhjetor të vitit 2022 që paguhen në muajin janar të vitit pasardhës dhe janë përkatësisht në vlerat 1,106,056 lekë dhe 147,631 lekë.

| Llogaria 435 “Sigurime shoqërore” | | Lekë |
|---|--|------------------|
| Çelje e vitit 2022 | | 1,010,722 |
| Shtesa (K) | | 95,384 |
| Pakësime (D) | | 0 |
| Gjendja debitoare në 31.12.2022 | | 1,106,106 |
| Llogaria 436 “Sigurime shëndetësore” | | |
| Çelje e vitit 2022 | | 134,684 |
| Shtesa (K) | | 12,947 |
| Pakësime (D) | | 0 |
| Gjendja debitoare në 31.12.2022 | | 147,631 |

Konkretisht sipas dokumenteve të Thesarit të muajit Janar të vitit 2023 konstatohet se:

| Urdhër shpenzimi | | Vlera | Lekë |
|-------------------------|------------|--------------|------------------|
| Nr. | Datë | | |
| 9 | 16.01.2023 | | 651,305 |
| 13 | 16.01.2023 | | 454,801 |
| Totali | | | 1,106,106 |

Burimi i të dhënave: Bashkia Libohovë.

| Urdhër shpenzimi | | Vlera | Lekë |
|-------------------------|------------|--------------|----------------|
| Nr. | Datë | | |
| 10 | 16.01.2023 | | 73,815 |
| 11 | 16.01.2023 | | 73,816 |
| Totali | | | 147,631 |

Burimi i të dhënave: Bashkia Libohovë.

| 19. Titulli i gjetjes: | Mbi mangësitë e konstatuara në llogarinë 466 “Kreditorë për mjetet në ruajtje”, në pasqyrat financiare. | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
|--|---|--|------------|--------------------|--------------------|------------|-----------|--------------|---|--|-------------------|-----|---------------------------------|--------------------|------------|--------------|--------------------|---|--|--|-----------|--|--|---|--|--|---------|--|--|---|--|--|-----------|--|--|---|--------------------------|--|---------|--|--|---|----------------|--|-------|--|--|---|--------------------------|--|--|---------|--|
| Situata: | <p>Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” sipas pasqyrës së pozicion financiar të Bashkisë Libohovë në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën 22,747,375 lekë dhe përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masës 5%. Vlera e mësipërme është rakorduar me Degën e Thesarit Gjirokastër.</p> <p style="text-align: right;">Lekë</p> <table border="1" style="width: 100%;"> <thead> <tr> <th colspan="2" style="text-align: right;">Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Çelje e vitit 2022</td> <td style="text-align: right;">18,743,892</td> </tr> <tr> <td>Shtesa (K)</td> <td style="text-align: right;">4,003,393</td> </tr> <tr> <td>Pakësime (D)</td> <td style="text-align: right;">0</td> </tr> <tr> <td>Gjendja debitoare në 31.12.2022</td> <td style="text-align: right;">22,747,375</td> </tr> </tbody> </table> <p>Në mënyrë analitike sipas objekteve dhe vitit që i përket paraqitet në pasqyrën, si më poshtë:</p> <p style="text-align: right;">Lekë</p> <table border="1" style="width: 100%;"> <thead> <tr> <th>Nr.</th> <th>Kreditorë për mjete nën ruajtje</th> <th>Gjendja 01.01.2022</th> <th>Shtesa (D)</th> <th>Pakësime (K)</th> <th>Gjendja 31.12.2022</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>1</td> <td>Rikonstrukcion i rrjetit të Ujësjellësit të qytetit Libohovë</td> <td></td> <td style="text-align: right;">1,365,874</td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>2</td> <td>Rikonstrukcion i rrjetit të Ujësjellësit të qytetit Libohovë</td> <td></td> <td style="text-align: right;">846,463</td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>3</td> <td>Rikonstrukcion i rrjetit të Ujësjellësit të qytetit Libohovë</td> <td></td> <td style="text-align: right;">1,787,660</td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>4</td> <td>Pullat e gjendjes civile</td> <td></td> <td style="text-align: right;">152,000</td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>5</td> <td>Sistemim vlerë</td> <td></td> <td style="text-align: right;">4,234</td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>6</td> <td>Pullat e gjendjes civile</td> <td></td> <td></td> <td style="text-align: right;">152,838</td> <td></td> </tr> </tbody> </table> | Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” | | Çelje e vitit 2022 | 18,743,892 | Shtesa (K) | 4,003,393 | Pakësime (D) | 0 | Gjendja debitoare në 31.12.2022 | 22,747,375 | Nr. | Kreditorë për mjete nën ruajtje | Gjendja 01.01.2022 | Shtesa (D) | Pakësime (K) | Gjendja 31.12.2022 | 1 | Rikonstrukcion i rrjetit të Ujësjellësit të qytetit Libohovë | | 1,365,874 | | | 2 | Rikonstrukcion i rrjetit të Ujësjellësit të qytetit Libohovë | | 846,463 | | | 3 | Rikonstrukcion i rrjetit të Ujësjellësit të qytetit Libohovë | | 1,787,660 | | | 4 | Pullat e gjendjes civile | | 152,000 | | | 5 | Sistemim vlerë | | 4,234 | | | 6 | Pullat e gjendjes civile | | | 152,838 | |
| Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Çelje e vitit 2022 | 18,743,892 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Shtesa (K) | 4,003,393 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Pakësime (D) | 0 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Gjendja debitoare në 31.12.2022 | 22,747,375 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Nr. | Kreditorë për mjete nën ruajtje | Gjendja 01.01.2022 | Shtesa (D) | Pakësime (K) | Gjendja 31.12.2022 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 1 | Rikonstrukcion i rrjetit të Ujësjellësit të qytetit Libohovë | | 1,365,874 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 2 | Rikonstrukcion i rrjetit të Ujësjellësit të qytetit Libohovë | | 846,463 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 3 | Rikonstrukcion i rrjetit të Ujësjellësit të qytetit Libohovë | | 1,787,660 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 4 | Pullat e gjendjes civile | | 152,000 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 5 | Sistemim vlerë | | 4,234 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 6 | Pullat e gjendjes civile | | | 152,838 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |

| | | Totali | 18,743,982 | 4,156,231 | 152,838 | 22,747,375 |
|---|---|-----------------|-------------------|------------------|----------------|-------------------|
| Burimi i të dhënave: Bashkia Libohovë. | | | | | | |
| Për 2 objekte të përfunduara dhe të marra në dorëzim nga Bashkia Libohovë janë ngurtësuar fonde në vlerën 99,458 lekë për të cilat nuk është bërë zhblllokimi i tyre, pasi fondet gjenden të ngurtësuar në Degën e Thesarit Gjirokastër, për të cilat është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës. Nga Sektori i Shërbimit Urban dhe Sektori i Financës nuk janë marrë masa për zhbllokimin e këtyre fondeve, nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës 99,458 lekë, ose përdorimin për interes publik të këtyre fondeve, bazuar në kushtet e kontratës të lidhur me subjektet përkatëse. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë: | | | | | | |
| | | | | | | Lekë |
| Nr. | Objekti | Subjekti | Vlera | | | |
| 1 | Gjendje më datë 01.01.2021 | | 11,116,761 | | | |
| 2 | Kreditime gjatë 2021 | | 7,812,455 | | | |
| | Rikonstruksion i rrjetit të ujësjellsit të qytetit Libohovë | E | 7,499,997 | | | |
| | Rikonstruksion i ujësjellsit Suhe | T | 58,658 | | | |
| | Restaurim i ndriçimit të pjesshëm të lagjes Marinë, Libohovë | T | 40,800 | | | |
| | Pullat e gjendjes civile | | 213,000 | | | |
| 3 | Debitime gjatë 2021 | | 181,000 | | | |
| | Pullat e gjendjes civile | | 181,000 | | | |
| 4 | Gjendja më 31.12.2021 | | 18,748,216 | | | |
| 1 | Gjendje më datë 01.01.2022 | | 18,748,216 | | | |
| 2 | Kreditime gjatë 2022 | | 4,156,231 | | | |
| | Rikonstruksion i rrjetit të ujësjellsit të qytetit Libohovë | E | 1,365,874 | | | |
| | Rikonstruksion i rrjetit të ujësjellsit të qytetit Libohovë | E | 846,463 | | | |
| | Rikonstruksion i rrjetit të ujësjellsit të qytetit Libohovë | E | 1,787,660 | | | |
| | Pullat e gjendjes civile | | 152,000 | | | |
| | Sistemim vlere | | 4,234 | | | |
| 3 | Debitime gjatë 2022 | | 152,838 | | | |
| | Pullat e gjendjes civile | | 152,838 | | | |
| 4 | Gjendja më 31.12.2022 | | 22,747,375 | | | |
| Burimi i të dhënave: Bashkia Libohovë. | | | | | | |
| Kriteri: | Udhëzimi nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kapitulli III, pikat 29, 30, 39, 50 dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011, “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kapitulli II, pika 10. | | | | | |
| Ndikimi/Efekti: | Pasqyrim jo i saktë i kësaj llogarie. | | | | | |
| Shkaku: | Mos zbatimi i dispozitave ligjore përkatëse. | | | | | |
| Rëndësia: | E lartë. | | | | | |
| Rekomandim: | Kryetari i Bashkisë Libohovë, Sektori i Financës dhe Sektori i Shërbimit Urban të marrë masa për kalimin e fondeve te secili kontraktor për të cilin ka mbaruar periudha e garancisë dhe Autoriteti Kontraktor nuk ka pretendime për cilësinë e investimin të kryer për periudhën e garancisë. | | | | | |

-Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm” paraqiten faturat e pa likuiduara për investime dhe shërbime të cilat për vitin 2022 janë në vlerën 22,849,095 lekë. Gjatë vitit 2022 për këtë llogari ka pasur rritje në vlerën 6,341,961 lekë ndërsa në datën 31.12.2022, gjendja e kësaj llogarie

paraqitet në vlerën 29,191,050 lekë. Analiza e detajuar e kësaj llogarie, paraqitet në aneksin nr. 3, tabela nr. 7, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

Lekë

| Llogaria 467 "Kreditorë të ndryshëm" | |
|--|-------------------|
| Çelje e vitit 2022 | 22,849,095 |
| Shtesa (K) | 6,341,961 |
| Pakësime (D) | 0 |
| Gjendja kreditore në 31.12.2022 | 29,191,050 |

-Llogaria 4341 "Operacione me shtetin (detyrime)" sipas pasqyrës së pozicion financiar të Bashkisë Libohovë në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerë 36,929,950 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

| Llogaria 4341 "Operacione me shtetin (detyrime)" | |
|--|-------------------|
| Çelje e vitit 2022 | 35,273,211 |
| Shtesa (K) | 1,726,739 |
| Pakësime (D) | 70,000 |
| Gjendja debitore në 31.12.2022 | 36,929,950 |

Shënim: (Shtesa në shumën prej 1,726,739 lekë i përket shtesës së debitorëve nga Tatim Taksat ndërsa pakësimi në vlerën prej 70,000 lekë i përket debitorëve ndaj Bashkisë).

TË ARDHURAT

1. Të ardhurat nga taksat dhe tatimet:

-Llogaria 70 "Të ardhurat nga taksat e tatimet", në datën 31.12.2021, ka qenë në vlerën 5,926,916 lekë ndërsa në datën 31.12.2022, gjendja e kësaj llogarie ka qenë 5,444,928 lekë me një pakësim në vlerën 481,988 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë të ardhurat nga taksat e tatimet paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

| Llogaria | Emërtimi | 31.12.2022 | 31.12.2021 |
|------------|--|------------------|------------------|
| 70 | I. TË ARDHURAT NGA TAKSAT E TATIME | 5,444,928 | 5,926,916 |
| 700 | 1. Tatimi mbi të ardhurat | 194,205 | 264,615 |
| 7000 | Tatimi mbi të ardhurat personale | 0 | 0 |
| 7001 | Tatimi mbi fitimin | 0 | 0 |
| 7002 | Tatim mbi biznesin e vogël | 194,205 | 264,615 |
| 7009 | Të tjera tatime mbi të ardhurat | 0 | 0 |
| 702 | 2. Tatimi mbi pasurinë | 3,346,249 | 3,739,688 |
| 7020 | Tatim mbi pasurinë e paluajtshme | 3,346,249 | 3,739,688 |
| 7021 | Tatim mbi shitjen e pasurisë së paluajtshme | 0 | 0 |
| 7029 | Të tjera tatime mbi pasurinë | 0 | 0 |
| 703 | 3. Tatime mbi mallrat e shërbimet brenda vendit | 1,904,474 | 1,922,613 |
| 7030 | Tatim mbi vlerën e shtuar (TVSH) | 0 | 0 |
| 7031 | Akciza | 0 | 0 |
| 7032 | Taksë mbi shërbimet specifike | 0 | 0 |
| 7033 | Taksë mbi përdorimin e mallrave dhe lejim veprimtarie | 959 | 0 |
| 7035 | Taksë vendore mbi përdorimin e mallrave e lejim veprimtarie | 1,903,515 | 1,922,613 |
| 704 | 4. Taksë mbi tregtinë dhe transaksionet ndërkombëtare | 0 | 0 |
| 7040 | Taksë doganore për mallrat e importit | 0 | 0 |
| 7041 | Taksë doganore për mallrat e eksportit | 0 | 0 |
| 7042 | Tarifë shërbimi doganor e kalipostë | 0 | 0 |
| 7049 | Të tjera taksë mbi tregtinë e transaksionet ndërkombëtare | 0 | 0 |
| 705 | 5. Taksë e rrugës | 0 | 0 |
| 708 | 6. Të tjera tatime e taksë kombëtare | 0 | 0 |
| 709 | 7. Gjoha e kamatë vonesa | 0 | 0 |

2. Të ardhurat jo tatimore:

-Llogaria 71 "Të ardhura jo tatimore", në datën 31.12.2021, ka qenë në vlerën 3,031,198 lekë ndërsa në datën 31.12.2022, gjendja e kësaj llogarie ka qenë 2,911,294 lekë me një pakësim në

vlerën 119,904 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë të ardhurat jo tatimore paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

| Lekë | | | |
|------------|--|------------------|------------------|
| Llogaria | Emërtimi | 31.12.2022 | 31.12.2021 |
| 71 | III. TË ARDHURA JO TATIMORE | 2,911,294 | 3,031,198 |
| 710 | 1. Nga ndërmarrjet dhe pronësia | 801,773 | 1,116,653 |
| 7100 | Nga ndërmarrjet publike jo financiare | 0 | 0 |
| 7101 | Nga ndërmarrjet publike financiare | 0 | 0 |
| 7109 | Të tjera nga ndërmarrjet dhe pronësia | 801,773 | 1,116,653 |
| 711 | 2. Shërbimet Administrative dhe të Ardhura Sekondare | 1,989,931 | 1,905,545 |
| 7110 | Tarifa administrative dhe rregullatore | 1,289,370 | 653,180 |
| 7111 | Të ardhura sekondare e pagesa shërbimesh | 0 | 0 |
| 7112 | Taksë për veprime gjyqësore e noteriale | 0 | 0 |
| 7113 | Të ardhura nga shitja e mallrave e shërbimeve | 685,800 | 1,087,208 |
| 7114 | Të ardhura nga biletat | 0 | 0 |
| 7115 | Gjoha, kamatëvonesa, sekuestrime e zhdëmtime | 14,761 | 165,157 |
| 7116 | Të ardhura nga transferimi i pronës, legalizimi i ndërtimeve pa leje | 0 | 0 |
| 719 | 3. Të tjera të ardhura jo tatimore | 119,590 | 9,000 |

3. Të ardhura të tjera:

-Llogaria 72 “Grante korente”, në datën 31.12.2021, ka qenë në vlerën 143,451,421 lekë ndërsa në datën 31.12.2022 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 173,714,754 lekë me një rritje në vlerën 30,263,333 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë grante korente paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

| Lekë | | | |
|------------|--|--------------------|--------------------|
| Llogaria | Emërtimi | 31.12.2022 | 31.12.2021 |
| 72 | V. GRANTE KORENTE | 173,714,754 | 143,451,421 |
| 720 | 1. Grant korent i brendshëm | 163,970,274 | 143,451,421 |
| 7200 | Nga Buxheti për NJQP (Qendrore) | 80,422,929 | 79,262,336 |
| 7201 | Nga Buxheti për NJQP (Vendore) | 0 | 0 |
| 7202 | Nga Buxheti për pagesa të posaçme të ISSH | 39,884,000 | 26,689,811 |
| 7203 | Nga Buxheti për mbulim deficiti (ISSH e ISKSH) | 0 | 0 |
| 7204 | Pjesëmarrje e institucioneve në tatime nacionale | 3,641,355 | 3,293,298 |
| 7205 | Financim shtesë për të ardhurat e krijuara brenda sistemit | 0 | 0 |
| 7206 | Financim i pritshëm nga buxheti | 0 | 0 |
| 7207 | Sponsorizime të brendshme (nga të tretët) | 210,060 | 919,180 |
| 7209 | Të tjera grante korente të brendshme | 39,811,931 | 33,277,796 |
| 721 | 2. Grant korent i huaj | 9,744,480 | 0 |
| | Nga Qeveri të huaja | 9,744,480 | 0 |
| | Nga Organizata Ndërkombëtare | 0 | 0 |

SHPENZIMET

1. Shpenzimet për pagat, përfitimet e punonjësve dhe kontributet shoqërore:

-Llogaria 600 “Pagat dhe përfitimet e punonjësve” në datën 31.12.2021, ka qenë në vlerën 51,198,878 lekë, ndërsa në datën 31.12.2022 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 51,612,376 lekë me një rritje në vlerën 413,498 lekë.

-Llogaria 601 “Kontributi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”, në datën 31.12.2021, ka qenë në vlerën 8,335,329 lekë, ndërsa në datën 31.12.2022 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 8,610,893 lekë me rritje në vlerën 275,564 lekë. Këto shpenzime janë të rakorduara me Degën e Thesarit Gjirokastër me të njëjtën vlerë. Analiza e detajuar për llogaritë e pagave dhe kontributeve për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

| Lekë | | | |
|----------|-------------------------------------|-------------------|-------------------|
| Llogaria | Emërtimi | 31.12.2022 | 31.12.2021 |
| 6001 | Paga, personel i përhershëm | 51,612,376 | 51,198,878 |
| 6010 | Kontributi i Sigurimeve Shoqërore | 7,732,705 | 7,759,327 |
| 6011 | Kontribut i Sigurimeve Shëndetësore | 878,188 | 576,002 |
| | Totali | 60,223,269 | 59,534,207 |

2. Blerje mallra dhe shërbime:

Llogari e cila përfshin të gjitha shpenzimet për blerjen e materialeve dhe kryerjen e shërbimeve të nevojshme për kryerjen e veprimtarisë së institucionit.

-Llogaria 602 “Blerje mallra dhe shërbime”, në datë 31.12.2021, ka qenë në vlerën 21,268,158 lekë ndërsa në datën 31.12.2022, gjendja e kësaj llogarie ka qenë në vlerën 21,493,916 lekë me rritje në vlerën 225,758 lekë. Këto shpenzime janë të rakorduara me Degën e Thesarit Gjirokastër me të njëjtën vlerë. Analiza e detajuar e llogarisë blerje mallra dhe shërbime paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

| Llogaria | Emërtimi | 31.12.2022 | 31.12.2021 |
|------------|--|-------------------|-------------------|
| 602 | III. BLERJE MALLRA E SHËRBIME | 21,493,916 | 21,268,158 |
| 602 | Mallra dhe shërbime të tjera | 0 | 0 |
| 6020 | Materiale zyre e të përgjithshme | 816,924 | 1,380,011 |
| 6021 | Materiale dhe shërbime speciale | 1,471,220 | 6,765,693 |
| 6022 | Shërbime nga të tretë | 4,277,582 | 2,239,275 |
| 6023 | Shpenzime transporti | 6,002,254 | 4,665,497 |
| 6024 | Shpenzime udhëtimit | 103,020 | 36,820 |
| 6025 | Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme | 0 | 0 |
| 6026 | Shpenzime për qiramarrje | 0 | 0 |
| 6027 | Shpenzime për detyrime për kompensime legale | 6,046,400 | 3,100,000 |
| 6028 | Shpenzime të lidhura me huamarrjen për hua | 0 | 0 |
| 6029 | Shpenzime të tjera operative | 2,776,516 | 3,080,862 |

Lekë

3. Subvencionet:

Përfshin ato shpenzime korrente të cilat konsiderohen si një mbështetje e qeverisë për subjekte prodhuese apo të shërbimeve, pavarësisht nga pronësia dhe përfituesi. Bashkia Libohovë nuk ka pasur subvencione.

4. Transferime korente:

Gjendja e llogarisë së fondeve 604 “Transferime korente të brendshme” paraqitet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 201,475 lekë e cila rakordon me akt rakordimin me Thesarin.

Gjendja e llogarisë së fondeve 606 “Transferime për Buxhetet familjare e Individë” paraqitet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 41,730,350 lekë, e cila rakordon me akt rakordimin me Thesarin.

| Llogaria | Emërtimi | 31.12.2022 | 31.12.2021 |
|------------|---|-------------------|-------------------|
| | V. TRANSFERIME KORENTE | 41,931,825 | 27,668,810 |
| 604 | 1. Transferita korente të brendshme | 201,475 | 100,000 |
| 6040 | Transferime korente tek nivele tjera të Qeverisë | 201,475 | 100,000 |
| 6041 | Transferime korente tek institucione qeveritare të ndryshme | 0 | 0 |
| 6042 | Transferime korente tek sigurimet shoqërore dhe shëndetësore | 0 | 0 |
| 6044 | Transferime korente tek organizata jo fitimprurëse | 0 | 0 |
| 605 | 2. Transferime korente me jashtë | 0 | 0 |
| 6051 | Transferime për organizata ndërkombëtare | 0 | 0 |
| 6052 | Transferime për qeveritë e huaja | 0 | 0 |
| 6053 | Transferime për institucionet jo fitimprurëse të huaja | 0 | 0 |
| 6059 | Transferime të tjera korente me jashtë shtetit | 0 | 0 |
| 606 | 3. Transferime për buxhetet familjare e individë | 41,730,350 | 27,568,810 |
| 6060 | Transferita të paguara nga ISSH e ISKSH | 0 | 0 |
| 6061 | Transferita të paguara nga institucione të tjera të organeve të pushtetit vendorë | 41,730,350 | 27,568,810 |

Lekë

Për vitin 2022 totali i te ardhurave në vlerë është 182,070,976 lekë dhe totali shpenzimeve është 137,758,020 lekë. Diferenca e tyre në vlerën 44,312,956 lekë kuadron me gjendjen e llogarisë 85 “Rezultati i veprimtarisë së vitit ushtrimor” në vlerën 44,312,956 lekë.

Auditim mbi administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare dhe letrave me vlerë. Rregullaritetin i veprimeve të kryera nëpërmjet bankës:

Transaksionet financiare të kryera nëpërmjet bankës janë regjistruar në mënyrë kronologjike në ditarin e bankës në bazë të urdhër-shpenzimeve të cilat ishin të nënshkruara nga nëpunësi autorizues dhe zbatues të konfirmuar nga nëpunësi i Thesarit dhe të vulosura nga të dy palët.

Në përgjithësi përpilimi i urdhër-shpenzimeve ishte i bazuar në dokumentet vërtetues dhe autorizues sipas natyrës së shpenzimit si urdhër prokurimi, procesverbale, oferta, kontrata, fatura e furnitorit, preventiva, situacione, fletëhyrje, listë pagesa, deklaratimet e tatimit mbi të ardhurat, formularët e përlogaritjeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si nga punëdhënësi dhe nga punonjësi etj.,. Vlerat e shënuara në urdhër-shpenzim përputhen me vlerat e këtyre dokumenteve financiare që mbështesin këtë shpenzim. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës është bërë sipas destinacionit dhe sipas natyrës së shpenzimeve.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: znj. L.M. me detyrë Kryetar i Bashkisë në cilësinë e Nëpunësit Autorizues dhe znj. E.P. me detyrë Shef i Sektorit të Financës në cilësinë e Nëpunësit Zbatues.

Për vitin 2022, numri i punonjësve është miratuar me Urdhrin nr. 17, datë 17.02.2022, të Kryetarit të Bashkisë dhe VKB nr. 66, datë 29.12.2021, me objekt “Për miratimin e numrit maksimal të punonjësve, të zgjedhur dhe të emëruar të Bashkisë Libohovë dhe Njësive Administrative për vitin 2022”, ndërsa niveli i pagave është miratuar me VKB nr. 60, datë 30.12.2020, me objekt “Për miratimin e nivelit të pagave dhe shpërblimeve të punonjësve të zgjedhur dhe të emëruar të Bashkisë Libohovë dhe Njësive Administrative”, për të cilat është shprehur ligjshmëria nga Prefekti Qarkut Gjirokastrë me shkresën nr. 55/1 prot., datë 15.01.2021, për vitin 2022 janë bërë ndryshimet me VKB nr. 23, datë 13.05.2022, dhe VKB nr. 56, datë 20.10.2022.

Nëpunësit e Bashkisë Libohovë i rregullojnë marrëdhëniet e punës në nivel, përgjegjës sektori apo specialist me Ligjin nr. 152/2013, datë 17.10.2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, dhe aktet nënligjore të tij, për sa i përket punonjësve administrativ dhe terrenit i rregullojnë marrëdhëniet e punës me Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar.

Planifikimi dhe realizimi i strukturës organizative së bashku me ndryshimet përkatëse paraqiten si më poshtë:

| Lekë | | | | |
|---------------|--|------------------------------|-----------|-----------|
| Nr. | Pozicionet e Punës | Nr.punonjësve të planifikuar | Fakti | Diferenca |
| 1 | Të zgjedhur | 2 | 2 | 0 |
| 2 | Pozicione Politike | 5 | 4 | 1 |
| 3 | Pozicione të shërbimit civil | 20 | 19 | 1 |
| 4 | Punonjës në mirëmbajtje | 27 | 27 | 0 |
| 5 | Pozicione të deleguara (Gjendja civile Civile) | 1 | 1 | 0 |
| 6 | Policia Bashkiake | 2 | 2 | 0 |
| 7 | Arsimi parashkollor | 6 | 6 | 0 |
| 8 | Arsimi9-vjeçar/mesëm | 5 | 5 | 0 |
| 9 | Inspektor i mbrojtjes së territorit | 1 | 1 | 0 |
| 10 | Nëpunës zyrash me arsim të mesëm | 6 | 6 | 0 |
| 11 | MZSH | 14 | 14 | 0 |
| 12 | Shofer administrate/makinerish | 3 | 3 | 0 |
| Totali | | 92 | 90 | 2 |

Burimi i të dhënave: Bashkia Libohovë.

Duke u bazuar në të dhënat e sipërpërmendura konstatohet se, për vitin 2022 për punonjësit që i rregullojnë marrëdhëniet me anë të Shërbimit Civil realizimi i strukturës është në masën 80% ndërsa për punonjësit që rregullojnë marrëdhëniet me Kod Pune realizimi i strukturës është në masën 99%. Në total realizimi i strukturës është në masën 98%.

Nga auditimi i zbatimit të strukturës organizative të Bashkisë Libohovë konstatohet se në total struktura është e përbërë nga 20 punonjës të cilët i rregullojnë marrëdhëniet e punës me Shërbim Civil dhe 72 punonjës me Kod Pune. Në strukturën e punonjësve civil janë bashkuar edhe 3 punonjës që rregullojnë marrëdhëniet e punës me Kod Pune. Kjo situatë ka ndodhur për shkak se, vendet vakante të cilat janë hapur për shërbimin civil nuk janë plotësuar si pasojë e mos aplikimit nga personat e interesuar.

Listë pagesat përfshijnë pagën e grupit (klasifikimin e diplomës së nivelit të dytë në master shkencor ose profesional sipas rastit), pagën për funksion (niveli i klasifikuar), raportet mjekësore të paguara nga punëmarrësi, shtesa vjetërsi (klasifikimi në vit, % dhe në vlerë), paga bruto, ndalesat (sipas rastit, pagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore 9.5%, pagesat e kontributeve të sigurimeve shëndetësore 1.7% tatimi mbi pagën). Listë prezencat janë hartuar sipas ditëve gjithsej të punës për çdo punonjës. Paga e aplikuar minimale dhe paga maksimale në përputhje me VKM nr. 158, datë 12.03.2022, “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”. Për sa i përket shpërblimeve për orët jashtë orarit të punës janë aplikuar vetëm për punonjësit e MZSH-së (punonjës zjarrfikës), ndërsa për punonjësit e tjerë të institucionit nuk ka, për shkak se nuk janë shfrytëzuar orët jashtë orarit zyrtar, pasi punonjësit i përmbahen 40 orëve në javë, sipas orarit të shpallur në rregulloren e brendshme të institucionit.

| | |
|-------------------------------|---|
| 20. Titulli i gjetjes: | Diferencë në klasifikimin e pagës së grupit. |
| Situata: | <p>Nga auditimi i listëpagesave konstatohet se, 2 punonjës janë trajtuar me pagë grupi në kundërshtim me VKM nr. 165, datë 02.03.2016, “Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijëve të pagave të funksionarëve të zgjedhur të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”, Lidhja nr. 9, si më poshtë:</p> <p>1. z. L.B. me detyrë Sekretar i Këshillit ka përfunduar studimet e larta Bachelor në degën “Inxhinieri Agrare” dhe Master Profesional në degën “Inxhinieri Agrare profili Mbrojtja Kimike dhe Fitofarmacia”, i cili për muajt janar-dhjetor 2022, është trajtuar me pagë grupi në vlerën 14,000 lekë, ndërkohë që referuar nivelit të diplomës në nivelit të dytë Master Profesional duhet të trajtohet me pagë grupi në vlerën 11,000 lekë me një diferencë në vlerën 36,000 lekë e cila përbën dëm ekonomik për Buxhetin e Bashkisë Libohovë. (Përlllogaritja 12 muaj * 14,000 lekë = 168,000 lekë sipas listë pagesës; 12 muaj * 11,000 lekë sipas niveli të diplomës = 132,000 lekë; 168,000 lekë totali sipas listë pagesës - 132,000 lekë sipas nivelit të diplomës = 36,000 lekë diferenca).</p> <p>2. znj. E.L. me detyrë Specialiste tek Sektori i Koordinimi të Integritimit European dhe Ndhmës së Huaj ka përfunduar studimet e larta Bachelor në degën “Mësuesi për Arsim Parashkollor” e cila për muajt janar-tetor 2022, është trajtuar me pagë grupi në vlerën 14,000 lekë, ndërkohë që referuar nivelit të diplomës Bachelor duhet të trajtohet me pagë grupi në vlerën 10,000 lekë me një diferencë në vlerën 40,000 lekë e cila përbën dëm ekonomik për Buxhetin e Bashkisë Libohovë. (Përlllogaritja 10 muaj * 14,000 lekë = 140,000 lekë sipas listë pagesës; 10 muaj * 10,000 lekë sipas niveli të diplomës = 100,000 lekë; 140,000</p> |

| | | | | |
|------------------------|---|------------------------|---------------------------|----------------------------------|
| | lekë totali sipas listë pagesës - 100,000 lekë sipas nivelit të diplomës = 40,000 lekë diferenca). Analiza e detajuar paraqitet si më poshtë: | | | |
| | Lekë | | | |
| | Punonjësit | Muaji/Viti 2022 | Sipas listëpagesës | Sipas nivelit të diplomës |
| | L.B | Janar | 14,000 | 11,000 |
| | E.L | Janar | 14,000 | 10,000 |
| | L.B | Shkurt | 14,000 | 11,000 |
| | E.L | Shkurt | 14,000 | 10,000 |
| | L.B | Mars | 14,000 | 11,000 |
| | E.L | Mars | 14,000 | 10,000 |
| | L.B | Prill | 14,000 | 11,000 |
| | E.L | Prill | 14,000 | 10,000 |
| | L.B | Maj | 14,000 | 11,000 |
| | E.L | Maj | 14,000 | 10,000 |
| | L.B | Qershor | 14,000 | 11,000 |
| | E.L | Qershor | 14,000 | 10,000 |
| | L.B | Korrik | 14,000 | 11,000 |
| | E.L | Korrik | 14,000 | 10,000 |
| | L.B | Gusht | 14,000 | 11,000 |
| | E.L | Gusht | 14,000 | 10,000 |
| | L.B | Shtator | 14,000 | 11,000 |
| | E.L | Shtator | 14,000 | 10,000 |
| | L.B | Tetor | 14,000 | 11,000 |
| | E.L | Tetor | 14,000 | 10,000 |
| | L.B | Nëntor | 14,000 | 11,000 |
| | E.L | Nëntor | 10,000 | 10,000 |
| | L.B | Dhjetor | 14,000 | 11,000 |
| | E.L | Dhjetor | 10,000 | 10,000 |
| | Totali | | 328,000 | 252,000 |
| | Burimi i të dhënave: Bashkia Libohovë. | | | |
| Kriteri: | VKM nr. 165, datë 02.03.2016, “Për grupimin e njërive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijëve të pagave të funksionarëve të zgjedhur të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njërive të vetëqeverisjes vendore”, Lidhja nr. 9. | | | |
| Ndikimi/Efekti: | Dëm ekonomik në vlerën 76,000 lekë. | | | |
| Shkaku: | Mos zbatimi i kuadrit rregullator ligjor në fuqi. | | | |
| Rëndësia: | E lartë. | | | |
| Rekomandim: | Nga Kryetari i Bashkisë Libohovë të merren masat e duhura dhe të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës totale 76,000 lekë të përfituar padrejtësisht nga punonjësit L.B. në vlerën 36,000 leke dhe E.L. në vlerën 40,000 lekë si pasojë e përlogaritjes së gabuar të pagës së grupit. | | | |

Nga auditimi me zgjedhje i 15 dosjeve të personelit për periudhën e audituar, dokumentacioni në përgjithësi është i plotë. Pjesë përbërëse e dosjes janë kartat e identitetit, certifikatat familjare, dëftesa/diplomat e studimeve të kryera (fotokopje të noterizuara), listë notash, vërtetimet shëndetësore dokumente shtesë për grada e tituj shkencorë, për kurset e trajnimit, gjuhët e huaja, dëshmi penaliteti etj.,.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: znj. E.P. me detyrë Shef i Sektorit të Financës dhe z. Xh.T. me detyrë Shef i Sektorit të Burimeve Njerëzore.

Pika 4.4. Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve.

2.4.1. Programimi i nevojave dhe përgatitja e regjistrit të prokurimeve.

2.4.2. Verifikimi i shpenzimeve të programuara me nivelin e fondeve të buxhetuara.

2.4.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të procedurave të prokurimit (vlerësimi i kriterëve kualifikuese, fondi limit, vlerësimi i ofertave dhe shpallja e fituesit etj.), si dhe për marrjen në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve, sipas specifikimeve teknike dhe kontratave të lidhura.

Në zbatim të pikës nr. 4 të, programit të auditimit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

-Dosjet shpresore të prokurimeve.

-Dokumentacioni elektronike në sistemin e Agjensisë së Prokurimit Publik.

-Regjistri i parashikimit të prokurimit publik

-Regjistri i realizimit të prokurimit publik, etj.,.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

Për periudhën objekt auditimi nga data 01.01.2021 deri më 31.12.2022, Bashkia Libohovë ka realizuar 4 procedura prokurimi me vlera të larta, me vlerë të fondit limit 17,916,172 lekë, vlerë të lidhjes së kontratës 17,286,569 lekë dhe diferencë midis tyre në vlerën 629,603 lekë.

Lekë

| Nr. | Objekti i prokurimit | Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit | Data e lidhjes së kontratës | Fondi limit | Vlera e kontratës | Diferenca midis fondit limit dhe vlerës së kontratës | OE Fitues |
|---------------|--------------------------|---|-----------------------------|-------------------|-------------------|--|-----------|
| 1 | Blerje karburant (Naftë) | 19.07.2021 | 25.08.2021 | 4,375,000 | 4,318,983 | 56,017 | “k” Shpk |
| 2 | Blerje materiale inerte | 26.03.2021 | 15.04.2021 | 3,797,500 | 3,777,586 | 19,914 | E |
| 3 | Blerje mjet pastrimi | 12.07.2022 | 19.08.2022 | 9,743,672 | 9,190,000 | 553,672 | “A” Shpk |
| 4 | Blerje karburant (Naftë) | | | | | | |
| Totali | | | | 17,916,172 | 17,286,569 | 629,603 | |

Burimi i të dhënave: Regjistri i realizimit të prokurimeve për vitet 2021-2022.

1. Mbi zbatimin e procedurave ligjore në tenderin me objekt “Blerje karburant për Bashkinë Libohovë”, vlerë të fondit limit 4,375,000 lekë, viti 2021.

| a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje karburant për Bashkinë Libohovë”. REF-00518-07-08-2021 | | |
|---|--|--|
| 1.Urdhër Prokurimi nr. 21/3, datë 30.06.2021 | 3. Njësia e Prokurimit , ngritur me urdhrin nr. 21/3, datë 30.06.2021 | 4.Komisioni i Vlerësimit të Ofertave: Urdhër nr.21/1, datë 31.03.202 |
| 2.Lloji i Procedurës së Prokurimit: “E hapur e thjeshtuar” | 1. G.Ç. 2. F.Z. 3. S.F. | 1. K.T. 2. F.Z. 3. B.P. |
| 5.Fondi Limit (pa tvsh) 4,375,000 lekë | 6.Oferta fituese:”K” Shpk me vlerë 4,318,983 (Cmimi pa TVSh: Nafta 139.916 lekë/litër. Gazi: 41.083 lekë/litër) Marzhi i fitimit 13.88 % | 7.Diferenca me fondin limit lekë (pa tvsh) |
| 8. Data e hapjes (zhvillimit) të tenderit: 19.07.2021 | 9.Burimi Financimit: Të ardhurat e veta | 10.Operatoret Ekonomik a)Pjesëmarrës në tender:1 OE b)Skualifikuar 0 c) Kualifikuar 1 OE |

| | | |
|---|--|---|
| 11.Ankimime: AK: Nuk ka patur ankesa | 12. Përgjigje ankesës nga AK: | 13.Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP: |
| b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave | | |
| 14.Lidhja e kontratës datë 13.08.2021 | 15.Vlera e kontratës: 18 lekë/litër | 16. Likuiduar deri |

Personi përgjegjës për këtë prokurim është caktuar z. F.Z., me arsim të lartë. Konstatohet se nga personi përgjegjës për këtë prokurim, procedura nuk është arkivuar ende, edhe pse është zhvilluar qysh në vitin 2021. Sipas nenit 74, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, personi përgjegjës për prokurimin duhet të administrojë në mënyrë të vazhdueshme procesin e prokurimit.

Hartimi i kriterëve të veçanta të DT

Procesverbali mbi argumentimin e hartimit të specifikimeve teknike dhe kriterëve teknike të kualifikimit për procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje karburant për nevoja te Bashkisë Libohovë”, është mbajtur më datë 08.7.2021.

Në pikën 2.4, të kapacitetit teknik, është vendosur kriteri se operatori duhet të ketë të deklaruar në listë pagesë 2 shofer për një periudhë jo më pak se 3 mujore nga dita e hapjes së tenderit.

Vendosja e kriterit se punonjësit duhet të jenë të punësuar për një periudhë 3-mujore, është i pa nevojshëm, i pa mbështetur në kuadrin ligjor në fuqi mbi të cilin zhvillohet veprimtaria e prokurimit publik. Kuadri ligjor në fuqi për prokurimin publik kërkon fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, por jo periudha kohore të punësimit të fuqisë punëtore. Vërtetimet për periudhat e mëparshme, lidhen me përvojat për punë të ngjashme e jo me fuqinë punëtore. Është e mjaftueshme listëpagesa e muajit të fundit për numrin e duhur të kërkuar të punonjësve. Pavarësisht se mangësitë e mësipërme janë të një niveli të ulët dhe nuk kanë dhënë ndonjë efekt negativ në zhvillimin e procedurës së prokurimit, pasi kriteret e vendosura janë të nivelit minimal, ato janë evidentuar, me qëllim që të korrigjohen dhe eliminohen në të ardhmen nga njësia e prokurimit.

Vlerësimi i ofertave

Kriteret e vlerësimit: Oferta ekonomike më e favorshme, bazuar në çmim

Afati i kontratës : 12 muaj kalendarik (Marrëveshje kuadër me një operatorë ekonomik)

Në tender ka marrë pjesë vetëm operatori ekonomik “K.” Shpk, i cili nga auditimi konstatohet se plotëson kriteret e DT.

| Nr. | Operatorët pjesëmarrës në tender | Vlera në lekë e ofertës pa TVSH | Kualifikimi |
|-----|----------------------------------|---------------------------------|-------------|
| 1 | K | 4,318,983 | Kualifikuar |

Nga auditimi nuk u konstatuan mangësi në plotësimin e kriterëve nga OE “K.” ShPK.

2. Mbi zbatimin e procedurave ligjore në tenderin me objekt “Blerje karburant për Bashkinë Libohovë”, vlerë të fondit limit 4,944,062 lekë, viti 2022 Nr. Ref. 39130-08-17-2022

| | | |
|--|---|--|
| a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje karburant për Bashkinë Libohovë”. Ref. 39130-08-17-2022 | | |
| 1.Urdhër Prokurimi nr.987 prot, nr. 69, datë 18.07.2022 | 3. Njësia e Prokurimit, ngritur me urdhrin nr.987 prot, nr. 69, datë | 4.Komisioni i Vlerësimit të Ofertave: Urdhër nr. 70, datë |

| | | |
|--|---|---|
| 2.Lloji i Procedurës së Prokurimit: “E hapur e thjeshtuar” | 18.07.2022: 1. S.F. 2. V.I. 3. F.B. | 18.07.2022: 1. K.T. 2. F.Z. 3. E.L. |
| 5.Fondi Limit (pa tvsh) 4,944,062 lekë | 6.Oferta fituese:”K” Shpk: 13.8/litër nafta dhe gazi | 7.Diferenca me fondin limit 0 lekë (pa tvsh) |
| 8. Data e hapjes (zhvillimit) të tenderit: 31.08.2022 | 9.Burimi Financimit: Grant | 10.Operatoret Ekonomik a)Pjesëmarrës në tender:1 OE b)S’kualifikuar 0 c) Kualifikuar 1 OE |
| 11.Ankimime: AK: Nuk ka patur ankesa | 12. Përgjigje ankesës nga AK: | 13.Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP: |
| b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave | | |
| 14.Lidhja e kontratës | 15.Vlera e kontratës: | 16. Likuiduar deri |

Kohëzgjatja e kontratës: 1 vit kalendarik nga dita e lidhjes se kontratës.

Me urdhrin nr. 65, datë 13.07.2022, të titullarit të autoritetit kontraktor znj. L.M., është ngritur komisioni për përcaktimin e akt normativës së harxhimit të karburantit për mjetet e bashkisë Libohovë. Për këtë qëllim, komisioni ka mbajtur procesverbalet përkatëse në datën 14.07.2022.

Me urdhrin nr. 68, datë 18.07.2022, është ngritur komisioni për testimin e tregut.

Me urdhrin e prokurimit nr. 69, datë 18.07.2022, është ngritur njësia e prokurimit e përbërë nga z. S.F. me detyrë jurist, z. V.I., znj. F.B.

Me urdhrin nr. 67, datë 18.07.2022, është përcaktuar z. S.F, si person përgjegjës për këtë procedurë prokurimi.

Në datën 17.08.2022, nga njësia e prokurimit është mbajtur procesverbali për hartimin e kriterëve, nga auditimi i të cilave nuk u konstatuan mangësi.

Vlerësimi i ofertave

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim.

Me urdhrin nr. 70, datë 18.07.2022, është ngritur komisioni i vlerësimit të ofertave i përbërë nga z. K.T., z. F.Z., znj. E.L.

Në tender ka marrë pjesë vetëm një operatorë ekonomik, si më poshtë vijon. Nga auditimi nuk u konstatuan mangësi në plotësimin e kriterëve.

| Nr. | Operatorët pjesëmarrës në tender | Vlera në lekë e | Kualifikimi | NIPT |
|-----|----------------------------------|-----------------|-------------|------|
| 1 | “K.” ShPK | 13.8 lekë/litër | Kualifikuar | |

3. Mbi zbatimin e procedurave ligjore në tenderin me objekt “Blerje mjet pastrimi dhe kontenier”, vlerë të fondit limit 9,743,672 lekë, REF 33032-06-15-2022.

| a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje mjet pastrimi dhe kontenier”. | | |
|--|--|---|
| 1.Urdhër Prokurimi nr.45/5, datë 15.06.2022 | 3. Njësia e Prokurimit, ngritur me urdhrin nr. 45/5, datë 15.06.2022: | 4.Komisioni i Vlerësimit të Ofertave: Urdhër nr.45/3, datë 04.04.2022: |
| 2.Lloji i Procedurës së Prokurimit: “E hapur e thjeshtuar” | 1. S.F. 2. N.K. 3. F.B. | 1. K.T. 2. E.L. 3. S.G. |
| 5.Fondi Limit (pa tvsh) 9,743,672_llekë | 6.Oferta fituese:“ “A” me vlerë 9,190,000 lekë pa TVSh | 7.Diferenca me fondin limit 553,672 lekë (pa tvsh) |
| 8. Data e hapjes (zhvillimit) | 9.Burimi Financimit: Ambasada | 10.Operatoret Ekonomik |

| | | |
|---|--|--|
| të tenderit: 12.07.2022 | Japoneze | a)Pjesëmarrës në tender:2 OE b)S'kualifikuar 1 c) Kualifikuar 1 OE |
| 11.Ankimime: AK: Nuk ka patur ankesa | 12. Përgjigje ankesës nga AK: | 13.Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP: |
| b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave | | |
| 14.Lidhja e kontratës Nr. 1129/2 datë 19.08.2022 | 15.Vlera e kontratës: 9,190,000 leke (pa tvsh) | 16. Likuiduar deri |

Me urdhrin nr. 45/2, datë 04.04.2022, është ngritur komisini për testimin e tregut.

Personi përgjegjës për këtë procedurë prokurim është caktuar z. S.F.

Sasia e mallrave për këtë procedurë prokurimi: Kamion copë 1; Koshë metalik copë 1.

Për marrjen e mjetit në dorëzim ka dalë urdhi i titullarit të AK nr. 45/7, datë 25.11.2022. Komisioni përbëhet nga z. A.S., z. Xh.T., z. G.C.

Gjithashtu ka dalë urdhi i titullarit të AK, nr. 45/6, datë 25.11.2022, për marrjen e ekspertit të jashtëm, një inxhinier mekanik, i cili do të jetë pjesë e grupit të marrjes në dorëzim të mjetit. Është urdhëruar drejtoria e financës për të realizuar këtë proces.

Në datën 25.11.2022 është lidhur kontratë shërbimi midis Bashkisë Libohovë dhe z. A.S., si ekspert i jashtëm, për vlerën e pagesës 15 mijë lekë.

Në datën 25.11.2022 është mbajtur procesverbali për marrjen e mjetit në dorëzim nga komisioni i mësipërm, i cili ka konstatuar se të dhënat e mjetit përputhen me kërkesat e vendosura në DT.

Hartimi kritereve të veçanta të DT

Me urdhrin urdhrin nr.45/5, datë 15.06.2022, të titullarit të AK znj. L.M. është ngritur njësia e prokurimit e përbërë nga S.F., N.K., F.B.

Nga auditimi i specifikimeve teknike të vendosura në DT, konstatohen anomalitë e mëposhtme:

Në shtojcën 5, “Formulari i specifikimeve teknike, është kërkuar:

a. “Dyshemeja e trupit të kamionit duhet të jetë 4 mm fletë metalike, muret anësore duhet të jenë të trasha 3 mm fletë metalike, rezistonte ndaj gërryerjes”.

Shprehja “rezistente ndaj gërryerjes”, është e përgjithshme, nuk përcakton llojin e materialit me të cilin duhet të jetë dyshemeja e trupit dhe në këtë mënyrë lë vend për dy kuptueshmëri. Gjithashtu vështirëson punën e grupit të punës për marrjen në dorëzim të mjetit, pasi nuk ka një referencë të caktuar për tu shprehur nëse dyshemeja e trupit të kamionit është ose jo rezistente ndaj gërryerjes.

b. Në specifikimet teknike është përcaktuar se “Norma e kompaktimit duhet deri 1.6”, por për këtë kërkesë nuk është caktuar se cila është njësia matëse e normës 1.6.

c. Në specifikimet teknike është përcaktuar: “1100 L Kontenier”, i cili është i pa qartë, duke vështirësuar kuptueshmërinë e tij.

d. Në specifikimet teknike është përcaktuar: Rezervuari i vajit duhet të jetë me kapacitet rreth 100 litra , mundësisht të gjenden thithës me rezervuarin, filtrin e kthimit , mbulesën e depozitimit të ventilimit , matësin e shikimit të indikatorit të temperaturës dhe valvulës.

Shprehja “mundësisht” nuk duhet të përdoret në specifikimet teknike. Nëse duhet një kërkesë e caktuar, ajo duhet të kërkohej, nëse jo, nuk duhet të kërkohej në DT.

e. Në specifikimet teknike nuk është kërkuar që nga operatorët ekonomik të paraqitet Certificate e konformitetit ose COC, si dhe Libreza origjinale (libri i mjetit), të cilat gjykojmë se janë të nevojshme.

f. Në specifikimet teknike nuk është kërkuar që gjatë dorëzimit të mallit do të ngrihet një komision me specialistët përkatës për verifikimin e specifikimeve teknike për mallin e paraqitur nga OE.

g. Në specifikimet teknike nuk është kërkuar që mjeti të ketë kryer pagesat e siguracionit dhe të ketë kryer kolaudimin.

Për sa më sipër mban përgjegjësi njësia e prokurimit: S.F., N.K., F.B.

Vlerësimi i ofertave

| Nr. | Operatorët pjesëmarrës në tender | Vlera në lekë e ofertës pa TVSH | Kualifikimi | NIPT |
|------------|---|--|---------------------|-------------|
| 1 | A. SH.P.K | 9,190,000 | Kualifikuar, fitues | |
| | T. ShPK | 9,290,260 | Skualifikuar | |

Arsyet e skualifikimit nga KVO të OE T ShPK:

- KVO: Te kapaciteti teknik pika 2.2.2 është kërkuar:

Operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy balance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

OE ka paraqitur bilancet e vitit 2020 dhe 2021. Nuk ka paraqitur bilancin e vitit 2019.

- Nga auditimi konstatohet se është kualifikuar dhe shpallur fitues oferta ekonomike më çmimin më të ulët. Pavarësisht kësaj, arsyetimi i mësipërm i KVO nuk është i sakt, sepse OE "T". ShPK, i ka paraqitur bilancet e dy viteve të njëpasnjëshëm, në të cilat nuk ka raporte negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit, duke plotësuar kriterin e vendosur, pasi qëllimi i paraqitjes së bilanceve ka qenë që autoriteti kontraktor të sigurohet se OE në bilancet e dy viteve të njëpasnjëshëm nuk ka raporte negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Kjo siguri është marrë nga dy bilancet e dorëzuara dhe nuk luan asnjë rol për autoritetin kontraktor, mos paraqitja e bilancit për vitin 2019.

KVO: OE nuk plotëson kriterin për kapacitetin ekonomik dhe financiar të pikës 2.2.1 të DT, si vijon:

2.2.1. Kopje të deklaratave të xhiros vjetore ose vërtetim nga administrata tatimore, për xhiron e realizuar në tre vitet e fundit, vlera mesatare e të cilës të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit.

OE ka paraqitur xhiron e vitit 2020 dhe 2021. Nuk ka paraqitur xhiron e vitit 2019.

Nga auditimi konstatohet se edhe ky kriter duhet të ishte konsideruar i plotësuar nga KVO, pasi mos paraqitja e xhiros vjetore të vitit 2019, është devijim i vogël.

Ky arsyetim bazohet në nenin 92 "Shqyrtimi i ofertave", pika 3, e Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik", ku thuhet:

"...Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit..."

Pavarësisht se nuk ka efekte reale në shpalljen e fituesit, pasi OE T, nuk do të ishte shpallur fitues, për shkak të vlerës së ofertës e cila është më e lartë se ajo e OE A, janë evidentuar këto anomali, me qëllim që të kihet në konsideratë nga KVO gjatë punës së tij për vlerësimin e ofertave të OE.

Mbi kualifikimin e OE "A" Shpk

Nga auditimi nuk u konstatuan mangësi në plotësimin e kriterëve të vendosura në DT.

4. Mbi zbatimin e procedurave ligjore në tenderin me objekt “**Blerje materiale ndërtimi**”, vlerë të fondit limit 3,797,500 lekë, REF-89981-03-15-2021

| a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje materiale ndërtimi”, REF-89981-03-15-2021 | | |
|---|--|---|
| 1. Urdhër Prokurimi nr.14, datë 09.03.2021 | 3. Njësia e Prokurimit , ngritur me urdhrin nr.14, datë 09.03.2021: | 4. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave: Urdhër nr.14/1, datë 09.03.2021: |
| 2. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “Kerkese per Propozim” | 1. A.Gj. 2. G.Ç. 3. F.Z. | 1. K.T. 2. B.P. 3. E.Z. |
| 5. Fondi Limit (pa tvsh) 3,797,500 lekë | 6. Oferta fituese: “E” me vlerë 3,777,586 lekë pa TVSh | 7. Diferenca me fondin limit 19,914 lekë (pa tvsh) |
| 8. Data e hapjes (zhvillimit) të tenderit: 26.03.2021 | 9. Burimi Financimit: Të ardhurat e veta | 10. Operatorët Ekonomik a) Pjesëmarrës në tender: 2 OE b) S’kualifikuar 1 c) Kualifikuar 1 OE |
| 11. Ankimime: AK: Nuk ka patur ankesa | 12. Përgjigje ankesës nga AK: | 13. Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP: |
| b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave | | |
| 14. Lidhja e kontratës datë 15.04.2021 | 15. Vlera e kontratës: 3,777,586 leke (pa tvsh), | 16. Likuiduar deri |

Personi përgjegjës për prokurimin z. F.Z.

Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin: Deri në 31.12.2021.

Hartim i kriterëve të veçanta të DT

Nga auditimi konstatohet se në pikën 2.5 të rubrikës së kapacitetit teknik së kriterëve të veçanta të DT, është vendosur kriteri si vijon:

“2.5 Operatori ekonomik ofertues duhet ketë në pronësi ose me qera një magazine jo më larg se 10 (dhjetë) km nga Bashkia Libohovë, me qëllim furnizimin e materialeve sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor për periudhën deri në datën 31.12.2021”.

Në këtë kriter duhet të ishte vendosur edhe opsioni i kontratës së furnizimit nga një operatorë tjetër.

Ky kriter është i pa argumentuar. Çështja e distancës i përket vlerësimit të operatorit ekonomik, nëse ka ose jo interes të marrë pjesë në tender. OE lëshojnë deklaratë që marrin përsipër të lëvrojnë sasinë e kërkuar të mallit dhe sipas grafikut të përcaktuar nga autoriteti kontraktor dhe në këtë mënyrë është përgjegjësi e tyre furnizimi i materialeve.

Për sa më sipër është në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, nenin 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, pika 1 dhe 2, ku thuhet:

1. Dokumentet e tenderit hartohen nga njësia e prokurimit në përputhje me këto rregulla dhe me legjisllacionin në fuqi.

2. ...Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërish, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit”.

Veprimet e mësipërme për hartimin e kriterit të kapacitetit teknik, ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e njësisë së prokurimit z. A.Gj., z. G.Ç., z. F.Z.

Vlerësimi i ofertave

Në tender kanë marrë pjesë dy operatorë ekonomik, sipas të dhënave të mëposhtme:

| Nr | Operatorët pjesëmarrës në tender | Vlera në lekë e ofertës pa TVSH | Kualifikimi |
|----|----------------------------------|---------------------------------|---------------------|
| 1 | S | 3,417,133 | Skualifikuar |
| | E | 3,777,586 | Kualifikuar, fitues |

Arsyet e skualifikimit nga KVO, të OE S

Operatori ekonomik skualifikohet nga procedura e prokurimit pasi ka paraqitur raport testimi për materialin "rërë e lare" për vitin 2020 dhe jo brenda 60 ditëve nga hapja e procedurës së prokurimit. Gjithashtu ky operator ekonomik ka paraqitur këtë raport testimi me porositetin subjektin "M" dhe jo "S".

Nga auditimi konstatohet se raporti i testimit i ngarkuar në sistem ka datën 16.02.2020 dhe ky raport është bërë për llogari të subjektit "M".

Për sa më sipër skualifikimi nga ana e KVO është i drejtë.

Mbi kualifikimin e OE E

Në DT është vendosur kriteri: *“Operatori ekonomik duhet të disponojë analiza laboratorike të materialeve jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga data e hapjes së procedurës së prokurimit”*.

Analizat për rrjet gabion, për çimenton, për hekurin, për rrjet xingato, rrjet gabioni, tel bari, tel xingato, analiza e zgarës, si dhe analiza me emërtimin analiza e lëndës nuk janë në gjuhën shqipe. Ky fakt është në kundërshtim me përcaktimin në dokumentet e tenderit, ku thuhet: *Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.*

Për mangësitë e mësipërme KVO nuk duhet të kishte kualifikuar OE E, por duhet ta kishte skualifikuar atë dhe meqenëse asnjë prej dy operatorëve që kanë marrë pjesë në tender nuk plotëson kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit, KVO duhet ti kishte propozuar titullarit të autoritetit kontraktor anulimin e tenderit.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me nenin 98, pika 1.b., të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020. “Për prokurimin publik”, ku thuhet:

Autoriteti ose enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:...b) në procedurat me një fazë nuk është dorëzuar asnjë ofertë e përshtatshme...”.

Gjithashtu veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me nenin 82, pika 2, germa (i) të VKM nr. 285, datë 23.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku thuhet:

“Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme...”

i. *“Devijimi” është shmangia e ofertuesit nga kërkesat e specifikuara në dokumentet e tenderit...”*.

Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi KVO: z. K.T, znj. B.P, z. E.Z.

Komente nga subjekti i audituar: *Për sa është trajtuar në këtë pjesë të projekt raportit të auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacion nëpërmjet postës elektronike, nga znj. B.P dhe z. E.Z, anëtarë të KVO, ku janë shprehur kundërshtitë si më poshtë:*

Nga auditimi dhe raporti paraprak i Kontrollit të Lartë të Shtetit është gjykuar se:

Kualifikimi i operatorit ekonomik E është i padrejtë pasi nuk përmbush kriteret e veçanta të kualifikimit, pikërisht raportet e testimi për materialet, të cilat janë brenda afatit të kërkuar nga AK por në gjuhë të huaj. Si rrjedhojë të dy operatorët ekonomik nuk përmbushin kriteret e kualifikimit.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se kualifikimi i OE E i plotëson kriteret e veçanta të kualifikimit pasi në Sistemin e Prokurimit Elektronik rezultojnë raporte testimi për materialet e ndërtimit në gjuhën shqipe dhe Brenda afatit të kërkuar nga AK. (Bashkëngitur po ju vendosim në dispozicion edhe raportet e sipërpërmendura). Në kriteret e kualifikimit nga ana e Njësisë së Prokurimit nuk janë përcaktuar se për cilat materiale, operatorët ekonomik duhej të dorëzonin raporte testimi, duke e lënë në vija të përgjithshme raportet të cilat do të paraqisnin operatorët ekonomik të interesuar.

Si rrjedhojë nga ana e KVO raportet e testimi në gjuhën shqipe janë marrë të mirëqena, duke vendosur dhe shpallur fitues operatorin ekonomik “E”.

Përsa i përket raporteve të testimi në gjuhë të huaj Komisioni i Vlerësimit ka gjykuar dhe i ka vlerësuar të panevojshme dhe jo arsye për skualifikim pasi ky kriter është plotësuar nga raportet e paraqitura në gjuhën shqipe për disa prej materialeve të preventivit, të cilat janë edhe brenda afateve ligjore.

Nisur dhe nga natyra e këtij objekt prokurimi është gjykuar kualifikimi i këtij operatori ekonomik, pasi materialet e përdorura në këtë procedurë janë materiale të cilat do të përdoren në shërbim të komunitetit.

Qëndrim i grupit të auditimit: *Në DT janë kërkuar raportet e testimi për materialet objekt prokurimi, lista e të cilave është te dokumenti preventivi pa çmime, i cili është bërë pjesë e DT në sistemin e prokurimit elektronik. Për këtë arsye OE duhet të paraqesin raporte testimi për çdo material të kërkuar nga AK dhe jo për një pjesë të tyre dhe pjesa tjetër merret e mirëqenë, si shprehjen në observacion. Për arsye se nuk keni paraqitur fakte dhe prova të reja, observacioni juaj nuk merret në konsideratë.*

Pika 4.4. Auditim mbi zbatimin e kontratave të punimeve në investimet publike, kolaudimi dhe marrja në dorëzim e punimeve të kryera, sipas kontratave të lidhura me operatorët ekonomik fitues.

Në zbatim të pikës nr. 4.4/4, me objekt: “Auditim mbi zbatimin e kontratave të punimeve në investimet publike, kolaudimi dhe marrja në dorëzim e punimeve të kryera, sipas kontratave të lidhura me operatorët ekonomik” të Programit të Auditimit, në Bashkinë Libohovë , nga ana e audituesve të KLSH-së, u analizuan regjistri i realizimit të investimeve që i përket periudhës së auditimit për vitin 2022.

Nga grupi i auditimit, u arsyetua, për t’u audituar kontrata për punë publike, me objektet: “Rikonstrukcion i rrjetit të ujësjellësit të qytetit Libohovë” Bashkia Libohovë, me vlerë 260,726,509.6 lekë pa TVSH ose 312,871,811.6 lekë me TVSH , mbi zbatimin e punimeve të ndërtimit në investimet publike, përputhshmërinë me projektin e zbatimit, kushteve teknike të zbatimit, kushteve të përgjithshme dhe të veçanta të kontratës, kolaudimit të punimeve, zbatimit të afateve të kontratave si dhe marrja në dorëzim e punimeve të kryera.

Nga auditimi mbi zbatimin e kontratës për punë publike, rezultoi si vijon:

1. Mbi auditimin e zbatimit të punimeve për kontratën me objekt “Rikonstruksion i rrjetit të ujësjellësit të qytetit Libohovë” Bashkia Libohovë , me këto të dhëna.

| 13. Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Rikonstruksion i rrjetit të ujësjellësit të qytetit Libohovë” Libohovë. | | |
|---|--|---|
| 14.Lidhja e kontratës Nr. 626 prot., datë 11.05.2020 E&N&F. | 15.Vlera e kontratës Vl e prev ofertues 312,871,811 lekë me TVSH Preventivi I ripunuar nr. 2 në vlerën 312,870,537 lekë me TVSH | 16.Likuiduar: Sit. 1 në vlerën 37,093,888 lekë me TVSH Sit. 2 në vlerën 22,574,224 lekë me TVSH Sit. 3 në vlerën 79,728,957 lekë me TVSH Sit. 4 në vlerën 60,996,991 lekë me TVSH Sit. 5 në vlerën 69,658,478.44 lekë me TVSH Sit. 6 në vlerën 27,317,488 lekë me TVSH Sit. 7 në vlerën 16,929,264.48 lekë me TVSH Sit. 8 në vlerën 35,928,839.88 lekë me TVSH |
| 17- Situacioni Përfundimtar -Vlera 22,310,518.68 lekë me TVSH. | 18.Afati i kontratës në dite Fillimi punimeve: 02.10.2020 Shtyhet deri më datë 12.09.2022 Përfundimi punimeve: 25.11.2022 | 19. Zgjatja e kontratës -166 ditë sipas amendimit të kontratës me nr. 297/1 prot., datë 28.02.2022. |
| 20. Mbikëqyrësi i punimeve OE Z | Licenca M | Kontratë me nr. 734 prot., datë 27.05.2020 |
| 21. Kolaudatori i punimeve O | Licenca Nr: M | Kontratë nr. 354/1 prot, datë 20.03.2023 |
| 22.Akt Kolaudimi Datë: datë 15.06.2023 protokolluar në AK me nr. 680/1 rot., datë 19.06.2023. | 23.Akt i marrjes në dorëzim: Me datë -----. Objekti është marrë në dorëzim përkohësisht nga Bashkia Libohovë, bazuar në Urdhërin nr. 40/1, me nr. 696 prot., datë 09.06.202. Komisioni i marrjes në dorëzim përbëhet nga: K.T (Kryetar) dhe anëtarët K.R dhe Xh.T. | |

ku rezultoi me gjetjet, si vijon:

| | | | | | | | | | |
|-------------------------------|--|--|----------------|------------------------|--------------------------------|-----------------------|--------------|-----------------------|--------------|
| 21. Titulli i gjetjes: | Punime ndërtimi të pa kryera në objektin “Rikonstruksion i rrjetit të ujësjellësit të qytetit Libohovë” Bashkia Libohovë. | | | | | | | | |
| Situata: | Nga auditimi i situacioneve pjesore progresive dhe situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultoi se zërat “Gërmim kanalesh në tokë të fortë, me krah, me seksion deri 0.75 m ² ” dhe “Gërmim shkëmbi mesatar me çekiç me ekskavator me zinxhir” është pasqyruar në librezën e masave jo saktësisht në volumin 591 m ³ dhe në vlerën 237,418 lekë pa TVSH, argumentuar si vijon: <u>Tabela nr. 1</u> | | | | | | | | |
| | Nr Anal | Zëri i punimeve | Njësia | Çmimi i ofertës | Situacioni përfundimtar | Libri i masave | Fakti | Diferenca në + | |
| | | | | | | | | Vol. | Vlera |
| | Rrjeti shpërndarës nga rezervuari i Zhepes. | | | | | | | | |
| | Zëri 1(3.46) | Gërmim kanalesh në tokë të fortë, me krah, me seksion deri 0.75 m ² | m ³ | 1214 | 812.13 | 812.13 | 762.13 | 50 | 60,700 |
| | Zëri 2(3.124/1a) | Gërmim shkëmbi mesatar me çekiç me ekskavator me zinxhir | m ³ | 2945.3 | 936.7 | 936.7 | 876.7 | 60 | 176,718 |

Diferencat e volumeve janë të argumentuara si më poshtë:

Nga auditimi mbi zbatimin e punimeve për “Rrjetin shpërndarës nga rezervuari i Zhepes” me rrjet shpërndarje 7923 ml tuba e rakorderi ujësjellësi me Ø 75 mm, 63 mm, 50 mm, 40 mm dhe 25 mm (5 ml për çdo pikë lidhje) u konstatua:

Zëri 1 (3.46) Gërmim kanalesh në tokë të fortë, me krah, me seksion deri 0.75 m².

Preventivi i rishikuar nr.1 dhe nr. 2, pasqyron volumin 812.13 m³ gërmim dheu, me çmim 1214 lekë. Situacioni përfundimtar pasqyron volumin 812.13 m³ gërmim dheu, me çmim 1214 lekë. Libreza e masave, pasqyron 812.13 m³ gërmim dheu, pasqyruar në mënyrë analitike.

Nga auditimi i punimeve në objekt si dhe i pasqyrimin në librin e masave rezulton se, ky zë punë është realizuar në volumin 762.13 m³ dhe jo në volumin 812.13 m³.

Sa më sipër, diferenca prej 50 m³ është librezuar dhe situacionuar më tepër, në vlerën **60,700 lekë pa TVSH.**

Zëri 2 (3.124/1a) Gërmim shkëmbi mesatar me çekiç me ekskavator me zinxhir.

Preventivi i rishikuar nr. 1 dhe nr. 2, pasqyron volumin 936.7 m³ gërmim dheu, me çmim 2945.3 lekë. Situacioni përfundimtar pasqyron volumin 936.7 m³ gërmim dheu, me çmim 2945.3 lekë. Libreza e masave, pasqyron 936.7 m³ gërmim dheu, pasqyruar në mënyrë analitike.

Nga auditimi i punimeve në objekt si dhe i pasqyrimin në librin e masave rezulton se, ky zë punë është realizuar në volumin 876.7 m³ dhe jo në volumin 936.7 m³.

Sa më sipër, diferenca prej 60 m³ është librezuar dhe situacionuar më tepër dhe është përfituar në mënyrë ta parregullt nga sipërmarrësi i punimeve, në vlerën **176,718 lekë pa TVSH.**

Nga auditimi i dokumentacionit teknik në dosjen e zbatimit të kontratës, konstatohet në Titullari i AK Bashkia Libohovë me Urdhrin nr. 40/1, me nr. 696 prot., datë 09.06.202, ka ngritur komisionin e marrjes në dorëzim të përkohshëm me përbërje: K.T (Kryetar) dhe anëtarët K.R dhe Xh.T. Komisioni sipas akt konstatimit me nr. 696/1 prot., datë 21.06.2023, nga verifikimi në terren ka konstatuar disa problematika si më poshtë:

-Riparimi i segmentit të një tubacioni në Lagjen Cuprel dhe Bulo pranë Xhamisë, ka rrjedhje.

-Mosfunksionim i gjeneratorit të pompave në të dy burimet (Zhepe dhe Agallinjë).

-Disa problematika në disa pika në hyrje dalje të qytetit.

Nga auditimi i grupit të auditimit në fakt mbi zbatimin e punimeve, konstatoi se këto problematika qëndrojnë dhe nga sipërmarrësi i punimeve duhet të riparohen deri me datë 30.06.2023. Në gjykimin e grupit të auditimit implementimi i veprës është bërë në konformitet me projektin e zbatimit dhe se ujësjellësi i realizuar është funksional. **Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:**

1. Z. A.P, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve .

D. Përfundime:

| | |
|------------------------|--|
| | <p>1. Sipërmarrësit të punimeve BOE “E” SHPK me administrator Z. A.I & “N” me administrator Z. H.H & “F” me administrator Z. Sh.F i janë likuiduar tepër në vlerën 237,418 lekë pa TVSH, për pasqyrim jo të saktë në librezën e masave, të zërave “Gërmim kanalesh në tokë të fortë, me krah, me seksion deri 0.75 m²” dhe “Gërmim shkëmbi mesatar me çekiç me ekskavator me zinxhir”.</p> <p>2. Investimi për objektin: “Rikonstruksion i rrjetit të ujësjellësit të qytetit Libohovë” Bashkia Libohovë, të merret në dorëzim në mënyrë të përkohshme vetëm pasi të jenë riparuar defektet e konstatuara.</p> |
| Kriteri: | <p>-Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998, “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12.</p> <p>-Udhëzimi nr. 3, datë 15.02.2001, “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, pika 3.</p> <p>-Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 1075 prot., datë 19.03.2020 .</p> <p>-Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 1110 prot., datë 27.03.2020.</p> |
| Ndikimi/Efekti: | Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar efekt negative në fondet e Bashkisë Libohovë. |
| Shkaku: | Mos realizim zëra pune ndërtimi në volumet e situacionuara. |
| Rëndësia: | E mesme. |
| Rekomandim: | Bashkia Libohovë të arkëtojë vlerën prej 237,418 lekë pa TVSH nga shoqëria E &N&F, për punime të pakryera, sipas kontratës me nr. 626 prot., datë 11.05.2020 me objekt “Rikonstruksion i rrjetit të ujësjellësit të qytetit Libohovë” Bashkia Libohovë. |

Pika 5. Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit

5.1. Auditimi mbi shqyrtimin e kërkesave në zbatimin e procedurave ligjore në dhënien e lejeve zhvillimore, ndërtimore si dhe miratimi i certifikatave të përdorimit.

5.2. Auditimi mbi mandat pagesat dhe ballafaqimi me fletën e përlllogaritjes së bërë nga Drejtoria e PZHT, në fazën e marrjes së lejes së ndërtimit dhe rillogaritja e pagesës së bërë në bazë të situacionit përfundimtar të punimeve të miratuar nga Drejtoria Rajonale e Tatim Taksave, etj;

Në zbatim të pikës 5 të Programit të Auditimit me nr. 425/1 prot., datë 19.05.2023, me objekt: “**Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit**”, prej datës 01.01.2021 deri më 31.12.2022, u shqyrtua dokumentacioni i mëposhtëm:

- Dokumentacioni në sistemin “E leje”;
- Dokumentacioni i disponueshëm në Sektorin e Urbanistikës;
- Dokumentacioni i disponueshëm në Sektorin e Financës;
- Dokumentacioni i disponueshëm në Sektorin Juridik;
- Dokumente të tjera nga arkiva, etj.,

Bashkia Libohovë ka të miratuar **Planin e Përgjithshëm Vendor** dhe **Rregulloren e Planit** të miratuar me **Vendimin nr. 5, të Këshillit Kombëtar të Territorit (KKT)**, datë 28.12.2020.

Auditimi konsiston në këto fusha:

1. Dhënia e Lejes së Zhvillimit, krahasimi i dokumentacionit me kriteret e vendosura.
2. Dhënia e Lejes së Ndërtimit, dokumentacioni, krahasimi dhe zbatimi i treguesve parametrik.
3. Saktësia e llogaritjes së Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë.
4. Dhënia e Çertifikatës së Përdorimit

Lejet e ndërtimit dhe zhvillimit për periudhën 01.01.2021-31.12.2022

Duke ju referuar sistemit e-Leje për lejet e ndërtimit dhe në bazë informacioneve që janë vendosur në dispozicion nga Bashkia Libohovë, gjatë periudhës 01.01.2021-31.12.2022, janë zhvilluar aplikimet dhe miratimet për lejet e ndërtimit të paraqitura në tabelat e mëposhtme:

| Lejet e ndërtimit dhe zhvillimit për vitin 2021 | | | |
|--|--------------|-----------------|-----------------|
| Lloji i lejes | Total | Miratuar | Refuzuar |
| Leje zhvillimi | 1(nje) | 1(nje) | - |
| Leje ndërtimi mbi 250m ² | - | - | - |
| Leje ndërtimi deri 250m ² | - | - | - |
| Deklaratë paraprake për kryerje punimesh | 7(shtate) | 4(kater) | 3(tre) |
| Rikonstrukcion | - | - | - |
| Çertifikatë përdorimi | - | - | - |
| Shtesë në objekt ekzistues deri në 250 m ² | 1(nje) | 1(nje) | - |
| Ndryshim projekti gjatë zbatimit | 1(nje_) | 1(nje) | - |
| Ndryshim funksioni | - | - | - |
| Njoftim fillim punimesh | 1(nje) | 1(nje) | - |
| Shtyrje afati leje ndërtimi | - | - | - |
| Leje infrastrukture | 1(nje) | 1(nje) | - |

| Lejet e ndërtimit dhe zhvillimit për vitin 2022 | | | |
|--|--------------|-----------------|-----------------|
| Lloji i lejes | Total | Miratuar | Refuzuar |
| Leje zhvillimi | 1(nje) | - | 1(nje) |
| Leje ndërtimi mbi 250m ² | - | - | - |
| Leje ndërtimi deri 250m ² | - | - | - |
| Deklaratë paraprake për kryerje punimesh | - | - | - |
| Rikonstrukcion | - | - | - |
| Çertifikatë përdorimi | - | - | - |
| Shtesë në objekt ekzistues deri në 250 m ² | 1(nje) | - | 1(nje) |
| Ndryshim projekti gjatë zbatimit | - | - | - |
| Ndryshim funksioni | - | - | - |
| Njoftim fillim punimesh | 1(nje) | 1(nje) | - |
| Shtyrje afati leje ndërtimi | 1(nje) | 1(nje) | - |
| Leje infrastrukture | - | - | - |

Duke u bazuar tek të dhënat e vëna në dispozicion nga DPKTZH e Bashkisë Libohovë për periudhën 01.01.2021-31.12.2022 është miratuar **1 leje** zhvillimi, **1 leje ndërtimi** për shtesë në ndërtim ekzistues me sipërfaqe deri në 250 m², **1 leje** infrastrukture, **1 leje ndërtimi** për ndryshim projekti gjatë zbatimit dhe janë miratuar **4 deklaratat paraprake** për kryerje punimesh.

Në bazë të analizës së riskut dhe me shqyrtimin rast pas rasti të tipologjive të ndryshme të ndërtimit, janë përzgjedhur për t'u audituar rastet e mëposhtme të lejeve të miratuara nga Bashkia Libohovë:

| Nr. | Objekti | Zhvilluesi | Data e lëshimit të lejes | Preventivi |
|-----|---|----------------------|--------------------------|-----------------|
| 1 | Leje infrastrukture për mbylljen, rehabilitimin e mbetjeve urbane nga vend-depozitimet ilegale, Libohovë | Ministria e Mjedisit | 25.11.2021 | - |
| 2 | Leje ndërtimi për rikonstruksionin e katit përdhe, shtesë anësore, shtesë kati mbi të me sipërfaqe jo më të madhe se 250 m ² përshtatje bujtinë Agroturizëm (ndryshim funksioni) | z. TH.L | 08.07.2021 | 11,834,980 lekë |

Në lidhje auditimin e procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit dhe të infrastrukturës, vërehen parregullsitë si më poshtë:

| | |
|-------------------------------|---|
| 22. Titulli i gjetjes: | Mungesa në dokumentacionin që vërteton të drejtat e pronësisë mbi pronën nën zhvillim. |
| Situata: | Në lidhje me miratimin e lejes së infrastrukturës për “Mbylljen, rehabilitimin e mbetjeve urbane nga vend-depozitimet ilegale, Libohovë”, me zhvillues Ministrinë e Mjedisit, konstatohet se dokumentacioni që vërteton të drejtat e pronësisë mbi pronën nën zhvillim nuk është i plotë. Sipas përcaktimeve të Vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 408, datë 13.05.2015 , i ndryshuar, Neni 15, pika 1, nënpika b), zhvilluesi dhe aplikanti kanë detyrimin që të ngarkojnë dokumentat që vërtetojnë të drejtat pasurore të pronës/ave që marrin pjesë në një zhvillim. Në sistemin <i>e-lejet</i> gjenden vetëm kartelat e pasurisë së paluajtshme për të dyja pronat në zhvillim (pasuria me nr. 530, vol. 1, fq. 92, ZK 2444; pasuria me nr. 527, vol. 2, fq. 73, ZK 2444), Vlen të theksohet se, referuar përcaktimeve të Ligjit nr. 111 / 2018, “Për kadastrën”, Neni 17 “Çertifikatat”, pika 4 , dokumentat e pronësisë përbëhen nga çertifikata e pronësisë, kartela e pasurisë së paluajtshme, si dhe nga harta treguese. Në dokumentacionin e kësaj procedure nuk u gjenden çertifikatat e pronësisë dhe hartat treguese për dy pasuritë në zhvillim. |
| Kriteri: | - VKM nr. 408, datë 13.05.2015, i ndryshuar, Neni 15, pika 1, nënpika b). - Ligji nr. 111 /2018, Neni 17, pika 4. |
| Ndikimi: | Mangësitë e konstatuara në dokumentacionin e pronësisë ndikojnë në mosdhënien e garancisë mbi të drejtën e pronës në zhvillim, duke cenuar një nga të drejtat kryesore të qytetarit, atë të të drejtës mbi pronën. |
| Shkaku: | Neglizhencë nga ana e DPZHT Libohovë. |
| Rëndësia: | E lartë |
| Rekomandim: | Nga DPZHT dhe Bashkia Libohovë të merren masa për të mos miratuar asnjë leje ndërtimi që nuk provon të drejtat e pronësisë sipas legjislacionit në fuqi. |

Për gjetjet e konstatuara në procedurat e miratimit të lejeve të ndërtimit të trajtuar më sipër, ngarkohen me përgjegjësi:

- **znj. L.M.**, me detyrë Kryetare e Bashkisë Libohovë;
- **z. F.M.**, në funksionin e drejtorit të DPZHT;
- **z. K.K.**, në funksionin e specialistit pranë DPZHT;
- **z. K.T.**, në funksionin e specialistit pranë DPZHT.

Lidhur me konstatimet e mësipërme, nuk është observuar nga ana e Bashkisë Libohovë dhe nga funksionarët e DPZHT Bashkia Libohovë.

| | |
|-------------------------------|---|
| 23. Titulli i gjetjes: | Mangësi dhe mungesa në projektet që përbejnë projektin ndërtimor. |
| Situata: | <p>Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit dhe të infrastrukturës u konstatua se në të dyja rastet ka mangësi dhe mungesa në projektet që përbejnë projektin ndërtimor, më konkretisht:</p> <p>a. Për lejes e infrastrukturës për “Mbylljen, rehabilitimin e mbetjeve urbane nga vend-depozitimet ilegale, Libohovë”, me zhvillues Ministrinë e Mjedisit, konstatohet se:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Mungon plani i vendosjes së ndërtimit mbi fragmentin e hartës në gjendjen ekzistuese i firmosur nga të gjithë projektuesit (një pjesë e projekteve teknike janë realizuar nga një bashkim operatorësh, por janë firmosur vetëm nga njëri prej tyre). -Mungon një pjesë e dokumentacionit shoqërues që hartuesit e projekteve teknike kanë detyrimin që të ngarkojnë në sistemi e-lejet (siç janë deklaratat e projektuesve të licencuar, polica e sigurimit, licencat e projektuesve). <p>b. Për lejen e ndërtimit për “Rikonstruksioni i katit përdhe, shtesë anësore, shtesë kati mbi të me sipërfaqe jo më të madhe se 250 m² përshtatje bujtinë Agroturizëm (ndryshim funksioni)”, me zhvillues z. TH.L, konstatohet se:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Në planvendosjen e miratuar nuk pasqyrohen distancat e objektit nga kufiri i pronës dhe distancat ndërmjet objekteve. -Në projektin arkitektonik dhe projektin konstruktiv nuk pasqyrohet gjendja ekzistuese e objektit dhe ndërhyrjet që do të realizohen pas rikonstruksionit e shtesës së katit. -Mungon Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis. |
| Kriteri: | - VKM nr. 408, datë 13.5.2015 , i ndryshuar, Neni 15, pika 1, nënpika c), e), ë), g); pika 1/1, nënpika i). |
| Ndikimi: | Mangësitë në projektet që përbejnë projektin ndërtimor, cenojnë zhvillimin e kontrolluar të territorit, standartet e sigurisë, kushtet higjeno-sanitare dhe mjedisin. |
| Shkaku: | Neglizhencë nga ana e DPZHT Libohovë. |
| Rëndësia: | E lartë. |
| Rekomandim: | Nga DPZHT Libohovë të merren masa për të mos miratuar asnjë leje ndërtimi në mungesë të dokumentacionit të detyrueshëm sipas ligjit, dokumentacionit shoqërues, si dhe ky dokumentacion duhet të jetë i saktë dhe të përmbajë gjithë informacionin e nevojshëm, sipas rregulloreve mbi të cilat hartohen. |

Për gjetjet e konstatuara në procedurat e miratimit të lejeve të ndërtimit të trajtuar më sipër, ngarkohen me përgjegjësi:

- **znj. L.M.**, me detyrë Kryetare e Bashkisë Libohovë;
- **Z. F.M.**, në funksionin e drejtorit të DPZHT;
- **Z. K.K.**, në funksionin e specialistit pranë DPZHT;
- **Z. K.T.**, në funksionin e specialistit pranë DPZHT;
- **Z. V.T.**, në funksionin e specialistit pranë DPZHT.

Lidhur me konstatimet e mësipërme, nuk është observuar nga ana e Bashkisë Libohovë dhe nga funksionarët e DPZHT Bashkia Libohovë.

| | |
|-------------------------------|---|
| 24. Titulli i gjetjes: | Nuk është kërkuar mendimi i të gjitha autoriteteve të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit. |
| Situata: | Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit dhe të infrastrukturës u konstatua se në të dyja rastet ka mangësi në kërkesat për dhënie mendimi ndaj autoriteteve të cilat duhet të shprehen, si dhe në respektimin e tyre, më konkretisht: a. Për lejes e infrastrukturës për “Mbylljen, rehabilitimin e mbetjeve urbane nga vend-depozitimet ilegale, Libohovë”, me zhvillues Ministrinë e Mjedisit, konstatohet se: - Nuk i është kërkuar mendim OST. - MBZHR ka cituar se nuk mund të shprehet, gjithsesi DPZHT ka vazhduar procedurat. b. Për lejen e ndërtimit për “Rikonstruksioni i katit përdhe, shtesë anësore, shtesë kati mbi të me sipërfaqe jo më të madhe se 250 m2 përshtatje bujtinë Agroturizëm (ndryshim funksioni)”, me zhvillues z. TH.L., konstatohet se: - Nuk i është kërkuar mendim Ministrisë së Mjedisit (MM). |
| Kriteri: | VKM nr. 408, datë 13.05.2015 , i ndryshuar, Neni 10/1. |
| Ndikimi/Efekti: | Miratimi i lejeve të ndërtimit në mungesë të mendimit të të autoriteteve të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit, duke mos respektuar mendimin e tyre, krijon kushte të favorshme për një zhvillim të pakontrolluar, duke cenuar zhvillimin e kontrolluar urban, standardet higjieno-sanitare, mjedisore dhe sigurinë. |
| Shkaku: | Neglizhencë nga ana e DPZHT Libohovë |
| Rëndësia: | E lartë. |
| Rekomandim: | Nga DPZHT Libohovë të merren të gjitha masat për marrjen dhe respektimin e mendimit dhe vendimeve të të gjitha autoriteteve të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit. |

Për gjetjet e konstatuara në procedurat e miratimit të lejeve të ndërtimit të trajtuar më sipër, ngarkohen me përgjegjësi:

- **znj. L.M.**, me detyrë Kryetare e Bashkisë Libohovë;
- **Z. F.M.**, në funksionin e drejtorit të DPZHT;
- **Z. K.K.**, në funksionin e specialistit pranë DPZHT;
- **Z. K.T.**, në funksionin e specialistit pranë DPZHT;

- **Z. V.T.**, në funksionin e specialistit pranë DPZHT.

Lidhur me konstatimet e mësipërme, nuk është observuar nga ana e Bashkisë Libohovë dhe nga funksionarët e DPZHT Bashkia Libohovë.

Pika 6. Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore (IMTV)

6.1. Auditimi mbi vendimet e marra nga IMTV për prishjen e objekteve pa leje zhvillimi.

6.2. Auditimi mbi ekzekutimin e vendimeve të IMTV; Për subjektet të cilët kanë kryer kundërvajtje administrative dhe procedura e ndjekur për vendimet e gjobave të pa arkëtuara nga IMTV.

6.3. Auditimi mbi procedurat e ndjekura nga IMTV lidhur me zbatueshmerin e kushteve të lejeve të ndërtimit si dhe bashkëveprimi me Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit Territorit.

Në zbatim të pikës 6 të Programit të Auditimit nr. 425/1, datë 19.05.2023, me objekt: “**Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore (IMTV)**, prej datës 01.01.2021 deri më 31.12.2022, u shqyrtua dokumentacioni i mëposhtëm:

-Auditim mbi plotësimi i kriterëve arsimore për punonjësit e IMTV, sipas përcaktimeve të Nenin 11 të **Ligjit nr. 183/2014 datë 24.12.2014**, “*Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit në ndërtimet e kundërligjshme*” etj.

-Auditimi mbi vendimet e marra nga IMTV për prishjen e objekteve pa leje zhvillimi.

-Auditimi mbi ekzekutimin e vendimeve të IMTV, për subjektet të cilët kanë kryer kundërvajtje administrative dhe procedura e ndjekur për vendimet e gjobave të pa arkëtuara nga IMTV.

-Auditimi mbi procedurat e ndjekura nga IMTV lidhur me zbatimin në terren të kushteve të lejeve të ndërtimit si dhe bashkëveprimi me Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit Territorit të Bashkisë etj, sipas dispozitave ligjore në fuqi (Neni 81- *Inspektimi*, pika 3, të **Ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009**, “*Për planifikimin e territorit*”, i ndryshuar, etj.,).

| | |
|-------------------------------|--|
| 25. Titulli i gjetjes: | Struktura organizative e IMTV është e pa formuar. |
| Situata: | Në lidhje me funksionimin e organizimin e Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, Bashkia Libohovë, shprehemi se kjo strukturë nuk është organizuar sipas përcaktimeve ligjore të Ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, neni 51 “Inspektimi”, Ligjit nr. 9780, datë 06.07.2007, “Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme”, i ndryshuar, neni 3 “Organizimi i inspektimit ndërtimor”, neni 11 “Arsimimi i kryeinspektorëve dhe inspektorëve të inspektoratit të mbrojtjes së territorit”, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 894, datë 04.11.2015, “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i Njësisë Vendore”, pasi, nga informacioni i marrë nga Bashkia Libohovë kjo strukturë ka qenë e paplotësuar, pozicioni i kryeinspektorit ka qenë vakant, gjithashtu nuk ka pas punonjës në pozicionin e inspektorëve. Nga |

| | <p>informacioni i vendosur në dispozicion, struktura aktuale përbehet vetëm nga një punonjës në pozicionin e inspektorit, me datë fillimi pune 13.12.2022.</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Nr.</th> <th>Emër Mbiemër</th> <th>Pozicioni</th> <th>Lloji i Diplomimit</th> <th>Data e fillimit</th> <th>Data e largimit</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>1</td> <td>V.I</td> <td>Inspektor</td> <td>Bachelor, Bio-Kimi</td> <td>13.12.2022</td> <td>në vazhdim</td> </tr> </tbody> </table> <p>IMTV Libohovë nuk ka pasur aktivitet për periudhën nën auditim, për shkak të mungesës së strukturës, nuk ka automjete në dispozicion, dhe si rrjedhim nuk ka plane mujore, nuk ka korespondencë me Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit dhe Inspektoriatin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit.</p> | Nr. | Emër Mbiemër | Pozicioni | Lloji i Diplomimit | Data e fillimit | Data e largimit | 1 | V.I | Inspektor | Bachelor, Bio-Kimi | 13.12.2022 | në vazhdim |
|------------------------|--|-----------|--------------------|-----------------|--------------------|-----------------|-----------------|---|-----|-----------|--------------------|------------|------------|
| Nr. | Emër Mbiemër | Pozicioni | Lloji i Diplomimit | Data e fillimit | Data e largimit | | | | | | | | |
| 1 | V.I | Inspektor | Bachelor, Bio-Kimi | 13.12.2022 | në vazhdim | | | | | | | | |
| Kriteri: | <p>-Ligji nr. 107/2014, datë 31.07.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, Neni 51 “Inspektimi”.</p> <p>-Ligji nr. 9780, datë 06.07.2007, “Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme”, i ndryshuar, Neni 3 “Organizimi i inspektimit ndërtimor”, Neni 11 “Arsimimi i kryeinspektorëve dhe inspektorëve të inspektoratit të mbrojtjes së territorit”.</p> <p>Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 894, datë 04.11.2015, “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i Njësisë Vendore”.</p> | | | | | | | | | | | | |
| Ndikimi/Efekti: | Mungesa e strukturës organizative të IMTV ndikon në zhvillimin e kontrolluar dhe të qëndrueshëm të territorit, mungesa e inspektimit në terren krijon kushtet e nevojshme për zhvillimin e objekteve të pamiruar, duke cenuar në mënyrë flagrante standartet e ndërtimit, kriteret higjeno-sanitare, ato të sigurisë dhe të mjedisit. | | | | | | | | | | | | |
| Shkaku: | Mos plotësimi i strukturës me kapacitet të plotë. | | | | | | | | | | | | |
| Rëndësia: | E lartë. | | | | | | | | | | | | |
| Rekomandim: | Nga ana e Bashkisë Libohovë të merren të gjitha masat për ngritjen e strukturës organizative të IMTV, të merren masat për plotësimin e të gjitha pozicioneve, duke respektuar kriteret e arsimit, si dhe funksionimi i tij sipas rregulloreve dhe parashikimeve ligjore. | | | | | | | | | | | | |

Lidhur me gjetjet e mësipërme, nuk është dërguar observacion nga ana e IMTV dhe Bashkisë Libohovë.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. znj. L.M., me detyrë kryetare e Bashkisë Libohovë.

Pika 7. Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

7.1. Hartimi i programit (Plan veprimit) me persona përgjegjës dhe respektimi i afatit 20 ditore për zbatimin e rekomandimeve.

7.2. Realizimi i programit (plan veprimi) e raportimi në KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6/mujor.

7.3 Statusi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

| | |
|-------------------------------|--|
| 26. Titulli i gjetjes: | Mos zbatimi i plotë i rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH. |
| Situata: | Raporti Përfundimtar dhe rekomandimet janë dërguar me shkresën nr. 801/1 |

| | |
|------------------------|---|
| | <p>prot., datë 19.12.2022, protokolluar në Bashkinë Libohovë me nr. 1181/10 prot., datë 22.12.2022, ku janë lënë për zbatim 11 masa organizative, dhe 1 masë për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimit e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, efizienzë dhe efektivitet të fondeve publike në vlerën 23,317,720 lekë.</p> <p>a. Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 11 masa organizative të cilat janë pranuar plotësisht, nga masat e pranuar 3 masa janë zbatuar, 1 masë është në proces zbatimi dhe 7 masa nuk janë zbatuar.</p> <p>b. Për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimit e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, efizienzë dhe efektivitet të fondeve publike është rekomanduar 1 masë në vlerën 23,317,720 lekë e pranuar plotësisht, nga masat e pranuar e cila konsiderohet në proces zbatimi, pasi është arkëtuar vlera 1,671,753 lekë dhe subjekti është duke vazhduar përpjekjet për zbatimin e rekomandimit dhe vlerësohet në mundësinë e realizimit.</p> <p>-Gjithashtu nga Bashkia Libohovë nuk janë marrë masat e duhura për raportimin e ecurisë së zbatimit të rekomandimeve në KLSH duke mos respektuar kështu edhe afatin 6 mujor.</p> |
| Kriteri: | Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15, gërma “c”, neni 30, pika 2. |
| Ndikimi/Efekti: | Mos zbatimi i rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e mëparshëm ka sjellë që strukturat e Bashkisë Libohovë në fusha dhe aspekte të caktuara vijnë veprimtarinë në kundërshtim me kuadrin rregullator ligjor. |
| Shkaku: | Mos angazhim sa duhet i strukturave të Bashkisë Libohovë. |
| Rëndësia: | E lartë. |
| Rekomandim: | <p>Strukturat drejtuese të Bashkisë Libohovë të analizojnë dhe të nxjerrë përgjegjësinë për moszbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e mëparshëm. Të marrë masa të menjëhershme për zbatimin e rekomandimeve që janë ende të zbatuara pjesërisht, në proces zbatimi dhe të pa zbatuara si vijon:</p> <p>-Për 1 masë organizative në proces zbatimi dhe 7 masa të pa zbatuara.</p> <p>-Për 1 masë për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimit e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, efizienzë dhe efektivitet të fondeve publike e cila është në proces zbatimi për vlerën 21,645,967 lekë.</p> |
| Rekomandim: | Nga Bashkia Libohovë të merren masat e duhura për raportimin në KLSH të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve duke respektuar njëkohësit edhe afatin e raportimit. |

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi: znj. L.M. me detyrë Kryetar i Bashkisë Libohovë.

I. Respektimi i afatit prej 20 ditësh, për informimin e KLSH-së mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve të lëna:

Në zbatim të nenit 15, gërma “j”, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”, Bashkia Libohovë ka kthyer përgjigje në KLSH

me shkresën nr. 1181/13 prot., datë 27.12.2022, duke respektuar kështu afatin 20 ditor të informimit në lidhje me planin e veprimeve të ndërmarra për zbatimin e rekomandimeve.

II. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna:

Duke u bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion konstatohet se nga Bashkia Libohovë nuk janë marrë masat e duhura për raportimin e ecurisë së zbatimit të rekomandimeve duke mos respektuar kështu edhe afatin 6 mujor, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30, pika 2, ku përcaktohet që:

2. Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna.

III. Rekomandimet e KLSH-së: Sipas shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit për auditimin e ushtruar në “Bashkinë Libohovë” administruar në KLSH me nr. 801/1 prot., datë 19.12.2022, dhe protokolluar në Bashkinë Libohovë me nr. 1181/10 prot., datë 22.12.2022, janë rekomanduar gjithsej:

- 11** masa organizative.
- 1** masë për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, efizienz dhe efektivitet të fondeve publike në vlerën 23,317,720 lekë.

IV. Statusi i pranimit të rekomandimeve të KLSH-së:

Me shkresën nr. 1181/13 prot., datë 27.12.2022, të Kryetarit të Bashkisë znj. L.M. është paraqitur plani i veprimit dhe statusi i pranueshmërisë së rekomandimeve si më poshtë:

| Masat | Rekomanduar | Pranuar | Lekë Pa pranuar |
|---|----------------|----------------|--------------------|
| Masa organizative | 22 | 29 | 0 |
| Masa për eliminimin e efekteve negative | 1 (23,317,720) | 1 (23,317,720) | 0 |
| Totali | 12 | 12 | 0 |

V. Statusi i zbatimit të rekomandimeve të pranuar nga ana e Bashkisë Libohovë:

| Masat | Rekomanduar | Të zbatuara | Të zbatuara pjesërisht | Në proces zbatimi | Të pa zbatuara | Lekë Vlera e arkëtuar |
|---|----------------|-------------|------------------------|-------------------|----------------|--------------------------|
| Masa organizative | 11 | 3 | 0 | 1 | 7 | 0 |
| Masa për eliminimin e efekteve negative | 1 (23,317,720) | 0 | | 1 | 0 | 1,671,753 |
| Totali | 12 | 3 | 1 | 2 | 7 | 1,671,753 |

Më hollësisht rezultatet e auditimit paraqiten si më poshtë:

B. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Bashkia Libohovë nuk ka ngritur një sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos hartuar një kuadër të plotë rregullash të shkruara për këtë qëllim. Punonjësit në përgjithësi nuk kanë njohuri të mjaftueshme mbi kuadrin ligjor në fuqi për menaxhimin financiar dhe kontrollin.

Nuk është hartua rregjistër i riskut, duke mos marrë masa për evidentimin e rrisqeve që rrezikojnë realizimin e objektivave të njësisë vendore dhe për monitorimin e tyre, me qëllim minimizimin e rrisqeve. Nuk është miratuar gjurma e auditimit për proceset kryesore të punës.

Njësia nuk ka përgatitur rregullore për shërbimin IT dhe nuk ka sistem rezervë për ruajtjen e të dhënave (back-up). Njësia nuk ka bërë vlerësimin vjetor të rezultateve të punës për punonjësit të cilët janë me statusin e nëpunësit civil. Veprimet e mësipërme janë jo në përputhje me ligjin nr.10296, datë 8.7.2010, i ndryshuar, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 4 pika 16, dhe 19, ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 32, ligji nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” neni 62, VKM nr. 109, datë 26.02.2014, “Për vlerësimin e rezultateve në punë për nëpunësin civil”, Kreu I, pika 3, dhe Kreu IV, pika 11, Udhëzimit nr. 28, datë 15.12.2011, shtojca nr.2, i “Njesisë Qendrore të Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit”.

1.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Libohovë të marrë masat e duhura për njohjen nga stafi të kuadrit ligjor në fuqi për MFK, për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve, hartimin e regjistrit të riskut, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë efekt negativ në arritjen e objektivave të institucionit. Të hartohet gjurma e auditimit për të gjitha proceset kryesore të aktivitetit të institucionit.

Deri më 31.03.2023

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se, kjo problematikë është hasur edhe përgjatë vitit 2022 konkretisht nuk është hartuar dhe miratuar strategjia e riskut, regjistri i riskut dhe gjurma e auditimit.

Rekomandimi nuk është zbatuar.

2. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i evidencave analitike të llogarive të aktiveve afatgjata, u konstatohet se në llog. 210 “Toka, troje, terene”, rezulton aktiv me emërtim “Vlerë tjetër” në shumën 5,645,745 lekë, në llog. 212 “Ndërtime e konstruksione” rezulton aktiv me emërtim “Vlerë tjetër” në shumën 4,687,737 lekë, në llog. 213 “Rrugë, rrjete dhe vepra ujore, rezulton aktiv me emërtim “Vlerë tjetër” në shumën 8,296,835 lekë, si dhe në llog. 214 “Instalime teknike, pajisje, instrumente dhe vegla pune”, rezulton aktiv me emërtim “Vlerë tjetër” në shumën 742,167 lekë. Vlerat e mësipërme janë përfshirë në llogaritë përkatëse pa dhënë shpjegime se çfarë përfaqësojnë, si dhe nuk disponohet dokumentacion kontabël mbi origjinën e tyre. Referuar procesit të inventarizimit të kryer për vitin 2021, komisioni i verifikimit është shprehur se këto tre aktive nuk gjenden pasi nuk ka dokumentacion kontabël në pasqyrat financiare të Bashkisë Libohovë, të cilat paraqiten në shumën totale 19,372,484 lekë për të cilat mungojnë të dhënat e rregjistrimit të ngjarjeve ekonomike. Veprime këto jo në përputhje me Ligjin nr. 25/2018, datë 10.05.2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, kreu II, neni 6, 7.

2.1. Rekomandim: Nëpunësi zbatues të marrë masa për identifikimin e aktiveve që përfaqësojnë shumën e rregjistruara në kontabilitet me emërtimin “Vlerë tjetër”, dhe kjo vlerë të shtohet në vlerën e aktivitetit përkatës, në mënyrë që llogaritë përkatëse të pasqyrave financiare të jenë të mbështetura me dokumentacion të qartë vërtetues.

Në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2022

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Nga auditimi i pasqyrave financiare dhe procesit të inventarizimit për vitin 2022 konstatohet e njëjta situatë me pasqyrat e mëparshme konkretisht për llogarinë 202 “Studime dhe projekte” në vlerën 5,645,745 lekë, llogarinë 212 “Ndërtesa dhe konstruksione” në vlerën 4,687,737 lekë, llogarinë 213 “Rrugë, rrjete dhe vepra ujore” në vlerën 8,296,835 lekë dhe llogarinë 214 “Instalime teknike, pajisje, instrumente dhe vegla pune” në vlerën 742,167 lekë janë të emërtuara me “Vlerë tjetër”.

Rekomandimi nuk është zbatuar.

3. Gjetje nga auditimi: Llog.210 “Toka, troje, terrene” nuk paraqet gjendjen reale sepse nuk janë hedhur në kartelat e kontabilitetit asnjë prej vlerave të trojeve nën objekt, si trualli i godinës së bashkisë, trojet e ndërtesave të shkollave, kopshteve e çerdhe, shtëpisë së kulturës, të zyrave në NjA, etj.

- Llog.211 “Pyje, Kullota, Plantacione” e cila është në vlerën 0 lekë, nuk paraqet gjendjen reale pasi në këtë llogari nuk pasqyrohet vlera e 12,140 hektarë, e cila përfaqëson sipërfaqe të pyjeve dhe kullotave të përfituara nga kjo bashki sipas VKM nr. 433, datë 08.06.2016. “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/ bashkive”, i ndryshuar, pika 29, shtojca nr.27, e cila përmban listën e inventarit të pyjeve dhe kullotave që transferohen në pronësi të Bashkisë Libohovë, me numrin rendor 1 (një) deri 215 (dyqind e pesëmbëdhjetë). Gjithashtu në këtë llogari nuk është pasqyruar sipërfaqja prej 1,678 hektarë, e cila i ka kaluar bashkisë me VKM nr. 666, datë 21.05.2008 dhe VKM nr. 750, datë 28.05.2008 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave, pyje dhe kullota, që do të transferohen në pronësi të qeverisjes vendore, Komuna Qendër Libohovë, të Qarkut të Gjirokastrës”.

-Llog.212 “Ndërtime e Konstruksione” ka vlerën 268,387,859 lekë, por kjo llogari nuk paraqet gjendjen reale të pasurisë së njësisë vendore, sepse për një pjesë e objekteve të mbartura nga ish komunat nuk disponohet dokument pronësie.

- Llog.213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, nuk paraqet vlerën reale pasi nuk është vlerësuar dhe evidentuar në këtë llogari vlera e rrugës prej 29 kilometra e përbërë nga 15 km “Kthesë Libohovë-Selcke”, dhe 14 km rruga “Polican-Nivan”, kaluar në pronësi të Bashkisë Libohovë me VKM nr. 915, datë 11.11.2015 “Për transferimin në pronësi, nga Këshillat e Qarqeve të Bashkitë, të rrjetit të rrugëve rurale dhe aseteve të luajtshme e të paluajtshme të ndërmarrjeve të mirëmbajtjes së këtyre rrugëve”, pika 9, tabela 1, faqe 3.

Në katër llogaritë e mësipërme nuk janë pasqyruar të gjitha ndërtesat, trojet, terrenet, rrugë, vepra ujore etj., të kaluara pas reformës territoriale në Bashkinë Libohovë, me vendimi i Këshillit Bashkiak me nr. 91, datë 14.10.2016, “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme shtetërore që kërkohen për transferim në pronësi të njësisë administrative qendër Libohovë të Bashkisë Libohovë”, në zbatim të ligjit nr. 115/2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësisë të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr. 8743 datë 22.02.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit, i ndryshuar, VKM nr. 840, datë 22/07/2009 “Për miratimin e inventarit të pronave të paluajtshme në Komunën Libohovë”, si dhe udhëzimit nr. 15, datë 30.06.2003 “Për mënyrën e paraqitjes nga Njësitë e Qeverisjes Vendore të kërkesave për transferimin në pronësi të pronave të paluajtshme publike”. Veprimet e mësipërme janë jo në përputhje me ligjin nr. 68/2017 "Për financat e qeverisjes vendore", neni 34, pika 1, VKM nr. 510, datë 10.06.2015, Kreu (VI) “Transferimi pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme”, pika (1); (2), VKM nr 433 datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive”, pika 29, shtojca me nr.27, udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kreu II pika 5 dhe Kreu III pika 30, udhëzimin e MFE nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 101.

3.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Libohovë të ngrejë grup pune me specialist të fushës për inventarizimin dhe vlerësimin e aktiveve të llogarisë 210, 211, 212 dhe 213 të administruara nga Bashkia Libohovë, si dhe të kryhet saktësimi i të dhënave në teren për këto prona (vendndodhja,

sipërfaqja, statusi etj.). Në vijim të kryhet regjistrimi i tyre në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës. Në vijim të kryhen veprimet kontabël për përfshirjen e të gjitha këtyre aktiveve në llogaritë përkatëse të pasqyrave financiare.

Në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2022

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit:

1. Nga auditimi i pasqyrave financiare dhe procesit të inventarizimit për vitin 2022 konstatohet e njëjta situatë me pasqyrat e mëparshme konkretisht llogaria 210 “Toka, troje, terrene” në vlerën 0 lekë dhe llogaria 211 “Pyje, plantacione” në vlerën 0 lekë.

2. Nga auditimi i pasqyrave financiare dhe procesit të inventarizimit për vitin 2022 konstatohet e njëjta situatë me pasqyrat e mëparshme konkretisht për llogarinë 212 “Ndërtime e konstruksione” ka vlerën 270,454,477 lekë nuk paraqet gjendjen reale të pasurisë së njësisë vendore, sepse për një pjesë e objekteve të mbartura nga ish komunat nuk disponohet dokument pronësie.

3. Nga auditimi i pasqyrave financiare dhe procesit të inventarizimit për vitin 2022 konstatohet e njëjta situatë me pasqyrat e mëparshme konkretisht në llogarinë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, nuk paraqet vlerën reale pasi nuk është vlerësuar dhe evidentuar në këtë llogari vlera e rrugës prej 29 kilometra e përbërë nga 15 km “Kthesë Libohovë-Selcke”, dhe 14 km rruga “Polican-Nivan”, kaluar në pronësi të Bashkisë Libohovë me VKM nr. 915, datë 11.11.2015 “Për transferimin në pronësi, nga Këshillat e Qarqeve të Bashkitë, të rrjetit të rrugëve rurale dhe aseteve të luajtshme e të paluajtshme të ndërmarrjeve të mirëmbajtjes së këtyre rrugëve”, pika 9, tabela 1, faqe 3.

4. Për llogaritë 210 “Toka, troje, terrene”, 211 “Pyje, plantacione”, 212 “Ndërtime e konstruksione” dhe 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” konstatohet se njëjta situatë konkretisht nuk janë pasqyruar të gjitha ndërtesat, trojet, terrenet, rrugë, vepra ujore etj., të kaluara pas reformës teritoriale në Bashkinë Libohovë sipas dispozitave ligjore përkatëse.

Rekomandimi nuk është zbatuar.

4. Gjetje nga auditimi: Bashkia Libohovë në datën 31.12.2021 ka një vlerë të detyrimeve të prapambetura prej 17,361,662 lekë, por në MFE ka raportuar si detyrime të prapambetura vetëm vlerën 5,698,722 lekë, duke mos përfshirë në këtë raportim detyrimet e prapambetura për zbatimin e vendimeve gjyqësore të cilat kanë vlerën 16,852,000 lekë. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me udhëzimin plotësues nr.1, datë 25.01.2021 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2021”, udhëzimin nr.37, datë 06.10.2020 “Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme”, pika 1, si dhe aneksi 1, tabela 1, aneksi 2, tabela 4.

4.1. Rekomandim: Nëpunësi zbatues të marrë masa për përfshirjen në listën e detyrimeve të prapambetura që raportohen në MFE, të të gjitha detyrimeve që Bashkia Libohovë ka ndaj të tretëve sipas natyrës së tyre, përfshirë edhe vendimet gjyqësore.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Me shkresën nr. 427 prot., datë 30.03.2023, janë dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë vlera e detyrimeve të prapambetura duke përfshirë edhe vendimet gjyqësore në vlerën 28,894,056 lekë.

Rekomandimi është zbatuar.

5. Gjetje nga auditimi: Referuar të dhënave analitike të llog. 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” dhe nga verifikimi dhe kryqëzimi i të dhënave sipas sistemit të pagesave nga Dega e Thesarit dhe sistemit SIFQ, u konstatua se gjatë vitit 2021 në tre raste janë likuiduar tre fatura në vlerën 2,333,542 lekë të cilat nuk i përkasin vitit buxhetor 2021, por periudhës së mëparshme, ndërsa rregjistrimi i tyre në kontabilitet është bërë gjatë vitit 2021 dhe jo në momentin e ardhjes së tyre. Konkretisht këto fatura janë: një faturë e vitit 2018 në vlerën 2,176,214, një faturë e vitit 2019 në vlerën 106,000 lekë dhe një faturë e vitit 2020 në vlerën 51,328 lekë. Veprimet e

mësipërme të cilat kanë sjellë që njohja e shpenzimeve të mos bëhet në momentin e ndodhjes së tyre, por në momentin e pagesës, janë në kundërshtim me nenin 61 “Standardet dhe procedurat e kontabilitetit” të ligjit 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Udhëzimin nr. 9, datë 20.07.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 164.

5.1. Rekomandim: Nëpunësi zbatues të marrë masa për regjistrimin në kontabilitet të të gjitha faturave të furnitorve, në momentin e lindjes së detyrimit, pra të ardhjes së faturës dhe jo në momentin e pagesës së saj.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Nga auditimi i llogarisë 468 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” konstatohet se, faturat e pa likuidura të vitit 2022 janë njohur në kontabilitet si detyrim i prapambetur.

Rekomandimi është zbatuar.

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se nëpunësi zbatues i njësisë publike nuk ka hartuar regjistër kontabël të përditësuar të aktiveve që zotëron apo ka në administrim Bashkia Libohovë, i cili në varësi të llojit duhet të përmbajë kërkesat minimale si datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpashme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, etj. Veprimet e mësipërme janë jo në përputhje me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pikat 26-33.

6.1. Rekomandim: Nëpunësi zbatues të marrë masa për hartimin dhe plotësimin e regjistrit të aktiveve me të gjithë elementët e tij të domosdoshëm, me qëllim identifikimin në këtë dokument të të gjitha aktiveve të njësisë vendore, si dhe uljen e riskut nga humbjet dhe keq menaxhimin e tyre.

Deri më 28.02.2023

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Nga auditimi i pasqyrave financiare dhe procesit të inventarizimit për vitin 2022 konstatohet e njëjta situatë pra nga Bashkia Libohovë nuk është marrë asnjë masë për hartimin e regjistrit të aktiveve.

Rekomandimi nuk është zbatuar.

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të procedurës së kryerjes së procesit të inventarizimit, vlerësimit dhe asgjësimit u konstatua se:

-Komisioni i vlerësimit në përbërje të tij nuk ka asnjë prej anëtarëve si specialistë të fushës për aktivet që janë vlerësuar për nxjerrje jashtë përdorimit;

-Disa fletë inventari nuk janë të nënshkruara nga punonjësi me përgjegjësi materiale dhe nga anëtarë të komisionit të inventarizimit.

-Në komisionin e inventarizimit janë caktuar persona të cilët kanë aktive në ngarkim;

-Procesi i vlerësimit nuk është kryer në përputhje me kriteret e UMF pasi në listën e aktiveve të nënshkruara për vlerësim nga komisioni, mungojnë elementët e normave të amortizimit, riaftësisimit, shkalla e riparimit, arsyet e mos riparimit, niveli i dëmtimit, etj.;

-Nga komisioni i cili ka kryer procesin e vlerësimit për nxjerrje jashtë përdorimit, nuk është argumentuar për çdo aktiv arsyeja e daljes nga përdorimi;

Veprimet e mësipërme janë jo në përputhje me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, kreu II, neni 8, pika 8/ç, neni 9, neni 12,

neni 16, pika 2, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, pikat 81, 82, 103, 121 e 122.

7.1. Rekomandim: Bashkia Libohovë të marrë masa që gjatë kryerjen e procesit të inventarizimit, në komision të vendosen punonjës të cilët nuk kanë aktive në ngarkim, në procesin e vlerësimit të aktiveve për dalje nga përdorimi, të argumentohen arsyet e propozimit të aktiveve për dalje jashtë përdorimit, duke zbatuar të gjitha kriteret e nevojshme në procesin e vlerësimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Me shkresën nr. 114 prot., datë 12.12.2022, është ngritur komisioni për inventarizimin fizik dhe vlerësimin për vitin 2022, ku konstatohet se punonjësit kanë aktive në ngarkim. Ndërsa procedura për vlerësimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit ka mbetur në fazën e miratimit nga Këshilli Bashkiak.

Rekomandimi është në proces zbatimi.

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se nuk janë zbatuar detyrimet ligjore për hartimin e raporteve të monitorimit të zbatimit të buxhetit për vitin 2021, pasi nuk janë hartuar raporte 4 muajor gjatë vitit, por është hartuar vetëm raporti vjetor, duke mos informuar këshillin bashkiak dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për situatën e zbatimit të buxhetit gjatë vitit buxhetor. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me udhëzimin nr. 22, datë 30.07.2018 "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e vetëqeverisjes vendore", pika 19, 22 dhe 23.

8.1. Rekomandim: Nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues të marrin masa për hartimin e raporteve periodike 4 muajor të monitorimit të zbatimit të buxhetit dhe këto raporte t'i paraqiten për njohje këshillit bashkiak, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Duke u bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga Sektori i Financës është hartuar vetëm raporti vjetor mbi zbatimin e buxhetit sipas shkresës nr. 300 prot., datë 28.02.2023.

Rekomandimi nuk është zbatuar.

9. Gjetje nga auditimi: Bashkia Libohovë nuk ka miratuar në paketën fiskale numrin e kësteve të pagimit për taksat vendore dhe afatet e kryerjes së tyre, për taksapaguesit privat dhe familjar. Afati i pagesës duhet të jetë pjesë e paketës fiskale, pasi është një element i rëndësishëm i taksave dhe tarifave vendore dhe si i tillë duhet të miratohet nga këshilli bashkiak. Mos përcaktimi i pagesës në paketën fiskale nuk garanton mbledhjen e të ardhurave brenda një afati të caktuar të vitit buxhetor dhe në këtë mënyrë rrezikohet të sigurohet në kohën e duhur burimi i financimit të shpenzimeve të miratuara në planin vjetor të buxhetit.

Këto afate janë përcaktuar me daljen e njoftim vlerësimit tatimor, e cila do të thotë se afati i përcaktimit të pagesës së detyrimeve për taksat vendore, përcaktohet nga zyra e taksave vendore, (duke tejkaluar kompetencat e saj) dhe jo nga këshilli bashkiak.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kërkesat e nenit 5, pika (c) të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar.

9.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Libohovë dhe zyra e taksave dhe tarifave vendore, të marrin masa për përcaktimin në paketën fiskale të afateve të pagimit për taksat vendore për taksapaguesit privat dhe familjar.

Në hartimin e paketës fiskale për vitin 2023

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 57, datë 20.10.2022, është përcaktuar afati

mbi shlyerjen e taskave dhe tarifave vendore.

Rekomandimi është zbatuar.

10. Gjetje nga auditimi: Bashkia Libohovë nuk ka përcaktuar mënyra efektive për arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore për taksapaguesit familjar. Edhe pse është aksionere e shoqërisë “Ujësjetllës Kanalizime Libohovë” Sh A dhe bazuar në pikën (ii), neni 5 të ligjit 9642 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, ka të drejtën dhe detyrimin e përcaktimit të mënyrës së mbledhjes së taksës dhe zgjedhjen e agjentit fiskal, nuk ka realizuar përfshirjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore familjare në faturën mujore të ujit të pijshëm, veprim i cili do të përmirësonte nivelin e arkëtimeve.

Nga sektori i taksave dhe tarifave vendore u paraqit relacioni nr.1800 prot, datë 11.11.2019, nëpërmjet të cilit i propozohet këshillit bashkiak për lidhjen e akt marrëveshjes midis Bashkisë Libohovë dhe “Ujësjetllës Kanalizime Libohovë” Sh A, për caktimin e këtij të fundit si agjent tatimor, por ky propozim nuk është miratuar nga këshilli, por gjithashtu prej vitit 2019 nuk është vijuar më me këtë propozim në këshillin bashkiak.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 5 të ligjit 9642 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, pika (ii).

10.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë dhe zyra e taksave dhe tarifave vendore të paraqesin për miratimin në Këshillin Bashkiak aktmarrëveshjen me shoqërinë “Ujësjetllës Kanalizime Libohovë” Sh A, duke kërkuar prej saj të kryej rolin e agjentit tatimor, me përfshirjen në faturën e ujit edhe të detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore për kategorinë familjare.

Deri më 28.02.2023

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Referuar përgjigjeve të pyetësorit mbi zbatimin e rekomandimeve konkretisht për rekomandimin nr. 10.1, citohet se: “Duke qenë se në fund të muajit dhjetor 2022 Shoqëria e “Ujësjetllës Kanalizime” kaloi në varësi të Ujësjetllës Kanalizime Gjirokastër, kemi pritur që të hedhim serish një projekt-vendim për votim në Këshill për të përfshirë detyrimet e taksave dhe tarifave vendore”.

Rekomandimi nuk është zbatuar.

11. Gjetje nga auditimi: Bashkia Libohovë nuk ka marrë masa të plota për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e mëparshëm.

Nga 20 masa organizative të rekomanduara dhe të pranuar nga subjekti, janë zbatuar plotësisht 6 masa, pjesërisht 2 masa, në proces zbatimi 10 masa, ndërsa 2 masa janë të pa zbatuara.

Janë dhënë dy masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficence dhe efektivitet të tyre, të cilat rezultojnë në proces zbatimi.

Gjithashtu në auditimin e mëparshëm është ri kërkuar zbatimi i masave për shpërblim dëmi në vlerën 4,615,166 lekë, si dhe marrja e masave administrative për një mbikëqyrësi të punimeve në tenderin me objekt “Rikonstruksion i rrugës kthesa – ura e Suhes (loti I)”, por këto rekomandime të ri kërkuara nuk janë zbatuar.

Veprime jo në përputhje me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, nenet 15 dhe 30.

11.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Libohovë të analizojë situatën dhe të nxjerrë përgjegjësitë për mos zbatimin e plotë të rekomandimeve të dërguara nga KLSH. Të merren masa të menjëhershme si dhe të hartohet një plan pune i veçantë për zbatimin e rekomandimeve të pa zbatuara dhe atyre në proces.

Menjëherë

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e

mëparshëm konstatohet se, nga Bashkia Libohovë nuk është marrë asnjë masë për zbatim e tyre.

Rekomandimi nuk është zbatuar.

C.MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË TYRE.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se vlera e debitorëve për taksat dhe tarifat vendore në datën 31.12.2021 është 23,317,720 lekë, të cilat janë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Libohovë. Nga vlera e mësipërme vlera prej 1,889,310 lekë është krijuar gjatë vitit 2021 nga mos shlyerja e detyrimeve të këtij viti, ndërsa vlera prej 21,428,410 lekë i përket detyrimeve të trashëguara përpara vitit 2021.

Në vlerën e detyrimit progresiv në fund të vitit buxhetor 2021 prej 23,317,720 lekë, peshën kryesore e zënë detyrimet nga taksapaguesit familjarë, të cilat kanë vlerën 19,232,492 lekë, ose në masën 82%. Krahasuar me vlerën e debitorëve në datën 31.12.2020, e cila është 23,203,393 lekë, konstatohet se vlera e debitorëve në vitin 2021 është pothuaj e njëjtë me gjendjen në vitin 2020, e cila tregon se nuk janë marrë masa të plotë për arkëtimin e debitorëve.

Nga auditimi i masave shtrënguese për arkëtimin e debitorëve u konstatua se këto masa nuk janë të plota në rend shterues, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në Kreun XI-Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

1.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Libohovë, zyra e taksave vendore dhe zyra juridike, të marrin të gjitha masat e duhura ligjore për arkëtimin e detyrimeve të pa paguara nga kategoria e taksapaguesve privat dhe familjar në vlerën 23,317,720 lekë.

Deri më 31.03.2023

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Nga auditimi i situatës debitorë për abonimet familjarë dhe biznesi i vogël dhe i madh mbi taksat dhe tarifat vendore konstatohet se, përgjatë vitit 2022 është arkëtuar shuma 1,671,753 leke nga të cilat shuma 527,210 lekë nga biznesi i vogël dhe i madh dhe shuma 1,144,543 lekë nga abonimet familjaret.

Rekomandimi është në proces zbatimi pasi është arkëtuar vlera 1,671,753 lekë dhe subjekti është duke vazhduar përprjekjet për zbatimin e rekomandimit dhe vlerësohet në mundësinë e realizimit.

D. MASA DISIPLINORE

Bazuar në nenin 15, ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, nenin 57, 58 dhe 59 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil, i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Libohovë t’i kërkojë Komisionit Disiplinor pranë Institucionit, që bazuar në shkeljet e konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë dhe të kryej marrjen e masave disiplinore përkatëse, në zbatim të nenit 58, “Llojet e masave disiplinore” të ligjit nr. 152/2013 datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, për punonjësit e ngarkuar me përgjegjësi në raportin përfundimtar të auditimit.

Koment i grupit të auditimit: Nga Kryetari i Bashkisë znj. L.M. është ngritur Komisioni i Disiplinës Urdhrit nr. 13, datë 17.01.2022, sipas shkresës me nr. 93 prot., datë 17.01.2022. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion ky proces ka mbetur në fazën e e ngritjes së urdhrin pra nuk është marrë asnjë masë disiplinore.

Pika 8. Të ndryshme të dala gjatë auditimit

Shqyrtimi i ankesës me nr. 512, datë 02.06.2023, paraqitur nga z. K.L.

Me shkresën pa datë dhe pa numër protokollit, z. K.L. ka paraqitur pranë KLSH ankesën e cila është administruar me praktikën nr. 512 prot., datë 02.06.2023. Bashkëlidhur ankesës ndodhet një kërkesë në të cilën citohet se: “Unë i nënshkruari K.L. kërkojë nga ana e KLSH hetim për fondin kullor të fshatit Stegopul Bashkia Libohovë sipas ZAZR Gjirokastër”, dhe shkresa me nr. 619 prot., datë 02.06.2023, Këshillit të Qarkut Gjirokastër, Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës miratuar nga Drejtori z. B.S. me objekt dërgim informacioni pranë Bashkisë Libohovë dhe për dijeni banorëve të fshatit Stegopul Gjirokastër në të cilën citohet se:

“Inspektoriati i Mbrojtjes së Tokës në qark ju bëjmë me dije se u shqyrtua kërkesa e banorëve të fshatit Stegopul mbi problematikën e ngritur. Sipas plan rivelimt bashkëngjitur kërkesës u evidentua se dhënia me qira e sipërfaqeve për kullotë nga Bashkia Libohovë ka shkaktuar probleme.

Si pasojë e ndryshimeve të numrit nga gabimet e bëra gjatë regjistrimit fillestar, ndryshimin e kufijve në terren të ndryshme nga AMTP, kontratave të qiradhënies, ndryshimin e zërave kadastral, në disa raste edhe të kalimeve nga një kategori në tjetrën, shfrytëzimi i sipërfaqeve të tokës për shumë vite duke krijuar idenë se është e tyre, pretendimet i ish-pronarë jo vetëm pa vendime të ATP po edhe të Gjykatës.

Nga verifikimi i numrave kadastralë të parcelave tokë bujqësore dhënia me qira ka shkaktuar:

1. Cënimin e pronësisë për parcelat me nr. Kadastral 209-2012 dhe 218-225 janë toka bujqësore të ndara nga Ligji nr. 7501/1911, “Për tokën”.
2. Shkelje të ligjit dhe udhëzimeve “Për dhënien e tokave me qira”, për parcelat me nr. Kadastral 214-20146, 205, 81/2, 24, 25, 147, 148, etj., janë toka bujqësore të ndara me Ligj 7501/1991, “Për tokën” që janë trajtuar si kullotë.
3. Shkelje e ligjit dhe udhëzimeve “Për dhënien e tokave me qira” pasi parcelat me nr. kadastral të pafrytshme të cilat nuk mund të jepen me qira, por janë trajtuar si kullotë.
4. Në shkelje të VKM 770/2014, “Për sipërfaqet e tokave bujqësore të pandara të cilat janë në fondin e kompesimit fizik të ATP” për parcelat nr. 21, 22, 29, 31, 28, 143, 144, 150.
5. Ligji 8312/1998, “Për tokat bujqësore të pandara” ku sipërfaqet e tokave bujqësore të pandara kur ka pretendime pronësie nuk jepen me qira”.

Bashkëlidhur ju përcjellim hartën kadastrale 1:5000 të zk 3523 Stegopul”.

Shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur bashkëlidhur në ankesë.

Me kërkesën e administruar në Kontrollin e Lartë të Shtetit, z. K.L. ka bërë prezent kërkesën duke ngritur shqetësimin lidhur me fondin kollosor të fshatit Stegopul Bashkia Libohovë, në mungesë të plotë të dokumentacionit tekniko ligjor konkretisht:

-Hartat e Zonës Kadastrale 209-2012 dhe 218-225 nuk janë origjinale apo kopje të noterizuara, dhe jo në formatin tekniko ligjor dhe në këto kushte grupi i auditimit nuk mund të dalë në një konkluzion mbi pretendimin e paraqitur me kërkesën protokolluar në KLSH me nr. 512 prot., datë 01.06.2023.

-Mungon Planimetria e Përgjithshme.

-Certifikatë e pronësisë me emërtimin e parcelës përkatëse së pretenduar për parcelat me numër pasuri sipas pikës 1 dhe 2 të kërkesës të ndodhur në zonën kadastrale.

-Mungon certifikata e pronësi lëshuar nga organi kompetent ASHK për parcelat me numër sipas pikë 2 të ankesës.

Grupi i auditimit të KLSH-së, duke vlerësuar kërkesë Tuaj, por në kushtet e mos vënies në dispozicion të dokumentacionit të plotë dhe të saktë tekniko ligjor nga ana Juaj, trajtimi i kërkesës mbi mbivendosijet në zonat kadastrale nuk mund të shqyrtohet nga KLSH.

Mbi shqyrtimin e bazës ligjore mbi pajisjen me certifikatë pronësie apo transferimet sipas dispozitave ligjore përkatëse të pyjeve dhe kullotave në fshatin Stegopul Bashkia Libohovë.

Parcela nr. 51, me sipërfaqe 73.91 ha, parcela nr. 50, me sipërfaqe 44.5 ha, parcela nr. 55, me sipërfaqe 19.49 ha, parcela nr. 57, me sipërfaqe 70.21 ha si dhe parcela nr. 88, me sipërfaqe 21.47 ha në EK-Lunxhëri janë në listën e fondit pyjor kullor që i transferohen Bashkisë Libohovë sipas VKM nr. 398, datë 13.05.2020, “Për disa ndryshime në Vendimin nr. 433, datë 08.06.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe kullotave publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-Komunave/Bashkive”, shtojca nr. 27.

Sipërfaqja jashtë fondit kullor është dhënë sipas VKM nr. 272, datë 21.04.2010, “Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Qendër Libohovë të Qarkut Gjirokastrë”, konkretisht:

- Pasuria me nr. 481, zona kadastrale nr. 3513, e llojit “Arë” me sipërfaqe 406,400 m² ose 40.64 ha;
- Pasuria me nr. 482, zona kadastrale nr. 3513, e llojit “Vresht” me sipërfaqe 11,700 m² ose 1.17 ha;
- Pasuria me nr. 483, zona kadastrale nr. 3513, e llojit “Pemtari” me sipërfaqe 2,200 m² ose 0.22 ha;
- Pasuria me nr. 490. zona kadastrale nr. 3513, e llojit “E pa frytshme” me sipërfaqe 570,000 m² ose 57 ha.

Në lidhje me sipërfaqet e trajtuara më sipër të cilat i përkasin fshatit Stegopul, Bashkia Libohovë nuk posedon certifikata pronësie, por për dhënien e tyre me qira, si titull pronësie kanë shërbyer VKM e sipërpërmendura për transferimin e pyjeve dhe kullotave si pjesë e inventarit të bashkisë.

Mbi ndjekjen e procedurave për dhënien me qira të kontratave për kullotë për vitin 2022 në fshatin Stegopul, Bashkia Libohovë.

| | |
|-------------------------------|---|
| 27. Titulli i gjetjes: | Nga Bashkia Libohovë janë dhënë me qira toka të pa frutshme për kullotë jashtë fondit pyjor kullor pa marrë më parë miratimin nga Këshilli Bashkiak. |
| Situata: | Për vitin 2022 në fshatin Stegopul, Bashkia Libohovë janë nënshkruar tre kontrata dimërore për ushtrimin e aktivitetit “Për kullotë” ndërsa kontrata verore nuk ka të nënshkruara. Në mënyrë të detajuar të dhënat paraqiten si më poshtë: Për dhënien me qira të kullotave Bashkia Libohovë nëpërmjet Agjencisë së Shërbimeve Bujqësore, Veterinare dhe Mjedisore me shkresën nr. 1056 prot., datë 01.08.2022, ka nxjerrë njoftimin ku në të citohet se: “Ju njoftojmë se afati për paraqitjen e kërkesave për marrje me qira ngastra të fondit pyjor kullor nga fermerët e bashkisë tonë për sezonin dimëror nga data 01.12.2023-31.05.2023, do të jetë deri në 31.08.2022. Sipërfaqja që do të kontraktohet është 820 ha. Ftojme të gjithë fermerët që janë të interesuar të paraqesin kërkesat e tyre pranë Zyrës së Informacionit dhe Marrëdhëniet me |

Qytetarët”.

1. Me shkresën me nr. 1678 prot., datë 13.12.2022, ndërmjet Bashkisë Libohovë përfaqësuar nga znj. L.M. Kryetar i Bashkisë dhe z. K.L. banor i fshatit Segopul sipas vërtetimit me shkresën nr. 135 prot., datë 21.06.2023, të Gjendjes Civile Bashkia Libohovë, është nënshkruar kontrata kullotë me nr. 16, dimërore për parcelën me nr. 57, me sipërfaqe 70.21 ha me kapacitet mbajtës 220 krerë bagëti të llojit “Dhi”. Vlera totale e kontratës është 22,200 lekë me afat zbatimit e saj nga data 01.06.2022, deri më 30.11.2022. Më datë 13.12.2022, i ndërmjet z. F.Z. me detyrë inspektor i Agjencisë së Shërbimeve Veterinare dhe Mjedisore përfaqësues i Bashkisë Libohovë dhe z. K.L. banor i fshatit Stegopul është mbajtur procesverbali i dorëzimit të kullotës sipas kontratës me shkresën nr. 1678 prot., datë 13.12.2022. Kjo kontratë është nënshkruar duke u bazuar në vërtetimin e lëshuar më datë 01.06.2022, nga AKVMB Sektori Gjirokastër Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, ku vërtetohet se z. K.L. disponon 130 krerë bagëti.

2. Me shkresën me nr. 1583 prot., datë 01.12.2022, ndërmjet Bashkisë Libohovë përfaqësuar nga znj. L.M. Kryetar i Bashkisë dhe z. P.K. banor i fshatit Segopul sipas vërtetimit me shkresën nr. 135 prot., datë 21.06.2023, të Gjendjes Civile Bashkia Libohovë, është nënshkruar kontrata kullotë me nr. 22, dimërore për parcelën me nr. 51, nr. 55, nr. 88, me sipërfaqe 114.8 ha me kapacitet mbajtës 291 krerë bagëti të llojit “Dhën”, me afat zbatimit e saj nga data 01.12.2022, deri më 31.05.2023. Vlera totale e kontratës është 29,100 lekë. Më datë 01.12.2022, i ndërmjet z. F.Z. me detyrë inspektor i Agjencisë së Shërbimeve Veterinare dhe Mjedisore përfaqësues i Bashkisë Libohovë dhe z. P.K. banor i fshatit Stegopul është mbajtur procesverbali i dorëzimit të kullotës sipas kontratës me shkresën nr. 1583 prot., datë 01.12.2022. Kjo kontratë është nënshkruar duke u bazuar në vërtetimin e lëshuar më datë 01.06.2022, nga AKVMB Sektori Gjirokastër Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, ku vërtetohet se z. P.K. disponon 280 krerë bagëti.

3. Me shkresën me nr. 1477 prot., datë 02.11.2022, ndërmjet Bashkisë Libohovë përfaqësuar nga znj. L.M. Kryetar i Bashkisë dhe znj. TH.D. e cila nuk është banor i fshatit Segopul sipas vërtetimit me shkresën nr. 135 prot., datë 21.06.2023, të Gjendjes Civile Bashkia Libohovë, është nënshkruar kontrata kullotë me nr. 16, dimërore për parcelën me nr. 50 ose (B) me sipërfaqe 44.5 ha së bashku me dy sipërfaqe të cilat janë jashtë fondit pyjor kullosor të pa frytshme konkretisht sipërfaqja në anën e majtë të pacelës me nr. 50, (A) 29.6 ha dhe sipërfaqja në anën e djatht (C) 9.5 ha, me një sipërfaqe totale 83.6 ha me kapacitet mbajtës 270 krerë bagëti të llojit “Dhën”, me afat zbatimit e saj nga data 01.12.2022, deri më 31.05.2023. Vlera totale e kontratës është 27,000 lekë. Më datë 02.11.2022, i ndërmjet z. F.Z. me detyrë inspektor i Agjencisë së Shërbimeve Veterinare dhe Mjedisore përfaqësues i Bashkisë Libohovë dhe znj. TH.D. është mbajtur procesverbali i dorëzimit të kullotës sipas kontratës me shkresën nr. 1477 prot., datë 02.11.2022. Kjo kontratë është nënshkruar duke u bazuar në vërtetimin e lëshuar më datë 13.05.2022, nga AKVMB Sektori Gjirokastër

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, ku vërtetohet se znj. TH.D. disponon 400 krerë bagëti.

Konkluzioni:

-Referuar kontratave të nënshkruara ndërmjet Bashkisë Libohovë përfaqësuar nga znj. L.M. Kryetar i Bashkisë dhe z. K.L. kontrata me nr. 1678 prot., datë 13.12.2022, dhe z. P.K kontrata me nr. 1583 prot., datë 01.12.2022, sipërfaqja e kullotës së dhënë me qira është në përputhje me numrin e krerëve të bagëtisë, duke i dhënë edhe njëkohësisht prioritet banorëve vendas të fshtatit Segopul, në zbatim të Udhëzimit të Ministrisë së Mjedisit nr. 2, datë 20.07.2016, “Kiteret teknike të klasifikimit të kullotave e livadheve dhe procedurat për dhënien e tyre për kullotë e kositje bari”, Kreu I “Kriteret teknike për klasifikimin e kullotave dhe livadheve”, pika 6, ku përcaktohet që:

6. Kërkesat për marrjen e kullotave e livadheve për kullotjen e bagëtive, paraqiten në strukturën përgjegjëse për pyjet dhe kullotat në bashkinë përkatëse të cilat i shqyrtojnë dhe i miratojnë sipas radhës:

- a. Fillimisht plotësohen kërkesat e kërkuësve që janë nga fshatrat më afër vendodhjes së kullotës apo livadhit;
- b. Pataj plotësohen kërkesat e kërkuësve që banojnë brenda territorit të njësisë administrative, në afërsi të vendodhjes së kullotës dhe livadhit;
- c. Pastaj plotësohen kërkesat e kërkuësve që janë brenda territorit të Qarkut dhe që shtegëtojnë tufa e tyre në njësitë administrative të tjera.
- d. Së fundi, plotësohen kërkesat e kërkuësve që tradicionalisht janë shtegëtues të tufave të tyre nga njësi administrative/bashki/të tjera.

Brenda çdo radhe, përparësi kanë fermerët kërkuës që mbarështojnë një numër më të madh bagëtish.

-Referuar kontratës të nënshkruar ndërmjet Bashkisë Libohovë përfaqësuar nga znj. L.M. Kryetar i Bashkisë dhe znj. TH.D. kontrata me nr. 1477 prot., datë 02.11.2022, sipërfaqja e kullotës së dhënë me qira nuk përputhet me numrin e krerëve të bagëtisë.

Sipërfaqja e parcelës me nr. 50 ose (B) është dhënë në përputhje me dispozitat ligjore konkretisht duke u bazuar në Vendimin nr. 9, datë 25.02.2022, të Këshillit Bashkiak sipas shkresës me nr. 322 prot., datë 01.03.2022, me objekt “Për miratimin e listës të fondit kulloror që do të jepet me qira për vitin 2022”, ku pjesë e listës janë edhe parcelat me nr. 50, nr. 51, nr. 57, dhe nr. 88.

Pjesa tjetër e sipërfaqes të cilat janë jashtë fondit pyjor kulloror të pa frytshme si pjesë e kësaj kontrate konkretisht, sipërfaqja në anën e majtë të pacelës me nr. 50, (A) 29.6 ha dhe sipërfaqja në anën e djathtë (C) 9.5 ha shkon në total 39.1 ha.

Nga sipërfaqja totale 39.1 ha jashtë fondit pyjor kulloror të pa frytshme e cila i përket kontratës me nr. 1477 prot., datë 02.11.2022, vetëm sipërfaqja 88,585 m² ose 8.85 ha e cila është tokë bujqësore është dhënë në përputhje me dispozitat ligjore konkretisht duke u bazuar në Vendimin nr. 55, datë 26.11.2021, të Këshillit Bashkiak sipas shkresës me nr. 1635 prot., datë 01.12.2021, me objekt “Për miratimin e sipërfaqes së tokës bujqësore me që do të jepet me qira”, sipas listës:

| Numri rendor | Numri i pasurisë | Zona kadastrale | Sipërfaqe në m ² |
|--------------|------------------|-----------------|-----------------------------|
| 1 | 179 | 3513 Stegopul | 273 |
| 2 | 180 | | 108 |
| 3 | 181 | | 228 |
| 4 | 182 | | 1362 |
| 5 | 183 | | 432 |
| 6 | 184 | | 144 |
| 7 | 185 | | 1685 |
| 8 | 186 | | 771 |
| 9 | 187 | | 1470 |
| 10 | 188 | | 1795 |
| 11 | 189 | | 558 |
| 12 | 190 | | 529 |
| 13 | 191 | | 3037 |
| 14 | 193 | | 1581 |
| 15 | 144 | | 12286 |
| 16 | 143/1 | | 17836 |
| 17 | 148/1 | | 9658 |
| 18 | 150/1 | | 21108 |
| 19 | 152/1 | | 13724 |

Sipërfaqja e mbetur prej 30.25 ha nga totali e cila i përket sipërfaqes në anën e majtë të parcelës me nr. 50, (A) 29.6 ha dhe sipërfaqja në anën e djatht (C) 9.5 ha jashtë fondit pyjor kullësor të pa frytshme, nuk kanë marrë miratimin nga Këshilli Bashkiak për dhënien me qira të tyre, por këto sipërfaqe janë dhënë me miratim vetëm nga Kryetari i Bashkisë znj. L.M., veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 54, gërma “e”, ku përcaktohet që:

| |
|---|
| Neni 54. “Detyrat dhe kompetencat e Këshillit Bashkiak”. Këshilli bashkiak ka këto detyra dhe kompetenca: e) miraton tjetërsimin ose dhënien në përdorim të pronave të tretëve; |
|---|

| | |
|------------------------|--|
| Kriteri: | Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 54, gërma “e”. |
| Ndikimi/Efekti: | Mos kalimi në Këshillin Bashkiak për miratim për dhënien me qira të kontratave në fshatin Stegopul, është shmangie e detyrimeve ligjore dhe bën që ky proces të mos ketë kaluar në të gjitha hallkat e nevojshme të miratimit të tij. |
| Shkaku: | Mos zbatim si duhet i dispozitave ligjore. |
| Rëndësia: | E lartë. |
| Rekomandim: | Kryetari i Bashkisë Libohovë të marrë masa që përpara dhënies me qira të sipërfaqeve për kullotë dimërore apo verore në teritorin e Bashkisë Libohovë, të cilat janë jashtë fondit pyjor kullësor, të klasifikuara si të pa frytshme, apo në çdo rast tjetër për dhënien në përdorim të pronave të tretët, të marrë më parë miratimin nga Këshilli Bashkiak. |

IV. GJETJE DHE REKOMANDIME

Për përmirësimin e gjendjes, rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Bashkia Libohovë nuk ka ngritur një sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos hartuar një kuadër të plotë rregullash dhe procedurash të shkruara për këtë qëllim.

-Nuk ka hartuar programe trajnimi për ngritjen dhe zhvillimin profesional të stafit.

-Nuk ka kryer procesin e vlerësimit të punonjësve për periudhën në auditim.

-Në procedurat e marrjes në punë të punonjësve, marrëdhëniet e punës të së cilëve rregullohet me Kodin e Punës, u konstatua se nuk janë hartuar kriteret e nevojshme për përzgjedhjen e tyre në punë.

- Nuk është hartuar rregjistër i rrishtit, duke mos marrë masa për evidentimin e rrishtit që rrezikojnë objektivat e institucionit dhe minimizimin e efekteve negative të tyre.

Nuk është hartuar, miratuar dhe arkivuar harta (lista) e proceseve të punës, si dhe gjurma e auditimit për këto procese, e cila përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to.

-Nuk ka të përcaktuara në rregulloren e brendshme të institucionit procedurat anti-korrupsion dhe të sinjalizimit të parregullsive.

-Në raportin vjetor për funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm nuk janë përfshirë të gjithë elementët e menaxhimit financiar dhe kontrollit. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 4, pika 20, neni 16, pikat 2-3, neni 17, pika 1, neni 18, pika 1, neni 21, pika 2, Ligjin nr. 152/2013, datë 17.10.2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, VKM nr. 109, datë 26.02.2014, “Për vlerësimin e rezultateve në punë” dhe Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, Udhëzimin nr. 16, datë 20.07.2016, “Përgjegjësitë dhe detyrat e Koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të rrishtit në njësitë publike”, Aneksi 2, Udhëzimin nr. 28, datë 15.12.2011, “Mbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike”, Shtojca nr. 2, Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin i miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 108, datë 17.11.2016, Kapitulli III, pika 3.1, pika 3.2 dhe pika 3.3. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 14-27 të raportit përfundimtar të auditimit).*

1.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Libohovë të marrë masa që nga secili sektor të hartohet rregjistri i rrishtit, për evidentimin e rrishtit që rrezikojnë objektivat e institucionit dhe minimizimin e efekteve negative të tyre dhe, mbi bazën e tyre të hartohet rregjistri i rrishtit për institucionin. Të hartohet harta e proceseve të punës dhe gjurma e auditimit për këto procese. Këto dokumente të miratohen nga Kryetari i Bashkisë.

1.2. Rekomandim: Nga Bashkia Libohovë, Sektori i Burimeve Njerëzore të hartohen rregulla të shkruara lidhur me zhvillimin dhe administrimin e procesit të rekrutimeve të reja për punonjësit, marrëdhëniet e punës së të cilëve rregullohen me Kodin e Punës.

Deri më 30.11.2023

2. Gjetje nga auditimi: Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm për vitet 2022-2024 nuk janë ngritur Ekipet e Menaxhimit të Programeve (EMP) për Bashkinë Libohovë të cilat përfaqësojnë nivelin teknik menaxherial të procesit të planifikimit të Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA), ku fokusohen në dy çështje kryesore së pari, roli i ri i stafit teknik në procesin buxhetor (përgatitje e PBA) dhe së dyti aspektet konceptuale të programeve buxhetore, përcaktimi i objektivave specifike për tre vitet e PBA-së, produktet dhe shërbimet konkrete që duhen realizuar për arritjen e tyre, si dhe treguesit përkatës të performancës. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 23, datë 30.07.2018, “Për procedurat

standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njëjësive të vetëqeverisjes vendore”, pikat 34-41. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1-2.5, faqe 27-39 të raportit përfundimtar të auditimit).*

2.1. Rekomandim: Nga Kryetari i Bashkisë Libohovë të merren masa që për hartimin dhe planifikimin e programit afatmesëm buxhetor, të ngrihen Ekippet e Menaxhimit të Programeve.

Në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2022, buxheti bazë fillestar vjetor (në bazë të vlerësimit të të ardhurave dhe të transfertave të pakushtëzuara, të përcaktuara në ligjin e buxhetit vjetor), është në vlerën 146,407,000 lekë, i miratuar me VKB nr. 64, datë 29.12.2021, “Për miratimin e buxhetit për vitin 2022”, por jashtë afateve të parashikuara në Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 41, “Përgatitja dhe miratimi i buxhetit vjetor”, pika 3, ku përcaktohet data 25 dhjetor, si datë e fundit për miratimin e buxhetit.

Gjithashtu projektvendimi dhe relacionin e hartuar nga përgjegjësi i Sektorit të Financës dhe miratuar nga ish Kryetari i Bashkisë, sipas shkresës me nr. 1729 Prot., datë 22.12.2021, “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Libohovë për vitin 2022 dhe PBA përfundimtare 2022-2024”, është dërguar pranë Këshillit Bashkiak jashtë afateve ligjore të parashikuara në Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 41, “Përgatitja dhe miratimi i buxhetit vjetor”, pika 1, ku përcaktohet si datë e fundit, data 30 nëntor. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 41, pika dhe 3. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1-2.5, faqe 27-39 të raportit përfundimtar të auditimit).*

3.1. Rekomandim: Nga Kryetari i Bashkisë Libohovë dhe Sektori i Financës të merren masa që projektvendimi dhe relacioni për buxhetin vjetor të dërgohet për miratim pranë Këshillit Bashkiak brenda afateve ligjore.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Realizimi i shpenzimeve buxhetore me të ardhurat e veta të Bashkisë Libohovë së bashku me transfertat e pa kushtëzuara për vitin 2022, ka diferenca të dukshme me vlerën e planifikuar. Për vitin 2022 planifikimi i shpenzimeve është në vlerën 266,228 mijë lekë ndërsa realizimi në vlerën 218,784 mijë lekë ose në masën 82.1%, me mosrealizim të fondeve në vlerën 47,444 mijë lekë.

Zërat kryesor që kanë ndikuar në këtë mos realizim janë:

- Zëri 600 “Paga dhe përfitimet e punonjësve”, është planifikuar në vlerën 78,611 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 51,612 mijë lekë, ose në masën 65.6%. Nga auditimi i zbatimit të strukturës organizative konstatohet se struktura është e përbërë nga 92 punonjës ndërsa realizimi është mesatarisht 90 punonjës. Ky mos realizim vjen kryesisht nga anomalitë në fazën e planifikimit, pasi struktura organizative funksionon pothuajse me kapacitet të plotë.

- Zëri 601 “Kontributi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”, është planifikuar në vlerën 12,059 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 8,611 mijë lekë, ose në masën 71.4%.

- Zëri 602 “Blerje mallra dhe shërbime” dhe zëri 230-231 “Investime”, është planifikuar në vlerën 33,309 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 21,494 mijë lekë ose në masën 64.5%

Kjo situatë vjen si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave, pasi Bashkia Libohovë në fillim të vitit buxhetor planifikon angazhime buxhetore, duke mos u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifatat vendore. Planifikimi nuk korrigjohet gjatë vitit, duke mos u përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat reale të realizuara.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar me Ligjin nr.

114/2012, datë 07.12.2012, dhe Ligjin nr. 57/2016, datë 02.06.2016, nenet 2, 3, 6, 9, 10, 15, 27 dhe 32, Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 9 pika 1.3 germa “c” dhe “ç”, Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore” nenet 3-4, neni 46, UMFE nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, nenet 79, 80 dhe 81, UMFE nr. 22, datë 30.07.2018, “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njërive të vetëqeverisjes vendore”; UMFE nr. 23, datë 22.11.2016, “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm” dhe VKB përkatëse. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1-2.5, faqe 27-39 të raportit përfundimtar të auditimit).*

4.1. Rekomandim: Bashkia Libohovë, nëpërmjet Sektorit të Financës dhe Sektorit të Tatim Taksave, të marrë masa për një planifikim të studiuar të të ardhurave të veta, duke u mbështetur mbi parashikime të studiuara dhe realiste. Mbi bazën e këtyre të ardhurave të parashikohet edhe plani i shpenzimeve, me qëllim që shpenzimet e planifikuara në buxhet të kenë burime financimi të sigurta për tu realizuar. Nëse gjatë vitit ka mosrealizim të të ardhurave të planifikuara, atëherë me vendim të këshillit bashkiak, duhet të korrigjohet edhe plani i shpenzimeve, brenda afateve që përcakton kuadri rregullator në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se nuk janë zbatuar detyrimet ligjore për hartimin e raporteve të monitorimit të zbatimit të buxhetit për vitin 2022, pasi nuk janë hartuar raporte 4 mujore gjatë vitit, por është hartuar vetëm raporti vjetor sipas shkresës nr. 300 Prot., datë 28.02.2023, duke mos informuar Këshillin Bashkiak dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për situatën e zbatimit të buxhetit gjatë vitit buxhetor. Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin nr. 22, datë 30.07.2018 “ Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e vetëqeverisjes vendore”, pika 19 dhe pikat 22-23. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1-2.5, faqe 27-39 të raportit përfundimtar të auditimit).*

5.1. Rekomandim: Nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues të marrin masa që gjatë vitit buxhetor të hartohen raporte 4 mujore të monitorimit të zbatimit të buxhetit për performancën financiare, me të cilat të njihet këshilli bashkiak dhe njëkohësisht të dërgohen edhe në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Bashkia Libohovë nuk ka marrë masa të plota për likuidimin e detyrimeve të prapambetura, pasi niveli i shlyerjes së tyre gjatë vitit buxhetor 2022 është i ulët krahasuar me vlerën e planifikimin në buxhet, si dhe janë krijuar gjatë vitit detyrime të reja të prapambetura. Vlera progresive e detyrimeve të prapambetura në datën 01.01.2022, si çelje e vitit ushtrimor, me burim financimi nga të ardhurat e veta, duke përfshirë edhe transfertën e pa kushtëzuar, është 5,698,722 lekë, e cila është planifikuar e gjithë për likuidim në planin e buxhetit vjetor 2022, por në fakt është likuiduar gjatë këtij viti vetëm vlera 2,782,599 lekë, ose 49% e vlerës së planifikuar, ngelur pa u likuiduar më 31.12.2022 vlera 2,916,123 lekë. Gjithashtu gjatë vitit 2022 janë krijuar detyrime të reja të prapambetura prej 25,977,933 lekë, duke e çuar në total këtë vlerë më 31.12.2022 në 28,894,056 lekë. Peshën kryesore të këtyre detyrimeve e zënë detyrimet për vendimet gjyqësore në vlerën 14,585,976 lekë, detyrimet për shërbime në vlerën 10,918,618 lekë dhe detyrimet për investime në vlerën 2,653,642 lekë. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 52, Udhëzimin nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 153-162, Rubrika-Marrja e angazhimit

dhe kryerja e shpenzimeve publike, detyrimet kontraktuale midis palëve dhe Udhëzimin Nr. 5, datë 27.12.2014, “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, pikat 82-91. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1-2.5, faqe 27-39 të raportit përfundimtar të auditimit).*

6.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Libohovë dhe Sektori i Financës të marrin masa që të eliminohet fenomeni i krijimit të detyrimeve të reja të prapambetura gjatë vitit buxhetor. Për këtë të bëhet likuidimi i vlerës së kontratës të lidhur midis Bashkisë Libohovë dhe kontraktorëve, sipas afateve të përcaktuar në kontratë, duke eliminuar në këtë mënyrë shkakun e krijimit të detyrimeve të prapambetura. Lidhja e kontratës të bëhet vetëm pasi fondi që parashikon procedura e prokurimit do të jetë në dispozicion (në llogarinë e thesarit) të autoritetit kontraktor. Gjithashtu të marrë masa që gjatë planifikimit dhe zbatimit të buxhetit, prioritet të kenë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës.

Menjëherë dhe në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i paketës fiskale u konstatua se në këtë dokument nuk janë përcaktuar afate për pagesën e kësteve për taksat dhe tarifave vendore për taksapaguesit privat dhe familjar. Afati i pagesës duhet të jetë pjesë e paketës fiskale, pasi është një element i rëndësishëm i taksave dhe tarifave vendore dhe si i tillë duhet të miratohet nga këshilli bashkiak. Mos përcaktimi i pagesës në paketën fiskale nuk garanton mbledhjen e të ardhurave brenda një afati të caktuar të vitit buxhetor dhe në këtë mënyrë nuk garantohej të sigurohet në kohën e duhur burimi i financimit të shpenzimeve të miratuara në planin vjetor të buxhetit.

Këto afate janë përcaktuar me daljen e njoftim vlerësimit tatimor, e cila do të thotë se afati i përcaktimit të pagesës së detyrimeve për taksat vendore, përcaktohet nga zyra e taksave vendore, (duke tejkaluar kompetencat e saj) dhe jo nga këshilli bashkiak.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kërkesat e nenit 5, pika (c) të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 39-49 të raportit përfundimtar të auditimit).*

7.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Libohovë dhe zyra e taksave dhe tarifave vendore, të marrin masa për të përcaktuar në paketën fiskale, afatet e pagesës për taksat dhe tarifave vendore për taksapaguesit privat dhe familjar.

Deri më datën 31.12.2023

8. Gjetje nga auditimi: Bashkia Libohovë nuk ka përcaktuar mënyra efektive për arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore për taksapaguesit familjar. Edhe pse në vijimësi ka qenë aksionere e vetme e shoqërisë “Ujësjellës Kanalizime Libohovë” Sh A dhe bazuar në pikën (ii), neni 5 të ligjit 9642 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, ka të drejtën dhe detyrimin e përcaktimit të mënyrës së mbledhjes së taksës dhe zgjedhjen e agjentit fiskal, nuk ka realizuar përfshirjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore familjare në faturën mujore të ujit të pijshëm, veprim i cili do të përmirësonte nivelin e arkëtimeve.

Nga sektori i taksave dhe tarifave vendore u paraqit relacioni nr.1800 prot, datë 11.11.2019, nëpërmjet të cilit i propozohet këshillit bashkiak për lidhjen e akt marrëveshjes midis Bashkisë Libohovë dhe “Ujësjellës Kanalizime Libohovë” Sh.A., për caktimin e këtij të fundit si agjent tatimor, por ky propozim nuk është miratuar nga këshilli, por gjithashtu prej vitit 2019 nuk është vijuar më me këtë propozim në këshillin bashkiak nga ana e zyrës së taksave.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 5 të Ligjit nr. 9642, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, pika (ii). *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 39-49 të raportit përfundimtar të auditimit).*

8.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Libohovë, të vijojë punën për arritjen e një aktmarrëveshjeje me shoqërinë “Ujësjellës Kanalizime Libohovë” SHA, me qëllim që kjo e fundit

të kryhej rolin e agjentit tatimor, për taksat dhe tarifata vendore për kategorinë e taksapaguesve familjare. Për këtë të merret miratimi i Këshillit Bashkiak.

Deri më datën 31.12.2023

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i tre kontratave të cilat i përkasin viteve 2021-2022 për dhënien me qira të ndërtesave/objekteve, janë konstatuar mangësi në dokumentacionin e paraqitur nga subjektet në fazën para lidhjes së kontratave si më poshtë:

- Nuk disponohet kërkesa e subjektit për marrje me qira të pasurisë shtetërore;
- Nuk disponohet plan biznesi në mënyrë të hollësishme për vënien në funksionim të objektit, ku të përshkruhen qartë: plani i punësimit, plani i investimeve, si dhe treguesit që do të realizohen;
- Nuk disponohet oferta për vlerën e detyrimit mujor të qirasë;
- Nuk disponohet certifikata e regjistrimit të subjektit në QKR;
- Nuk disponohet NUIS-i dhe vërtetimi nga dega e tatimeve se subjekti ka shlyer detyrimet tatimore dhe sigurimet shoqërore;
- Nuk disponohet vërtetimi nga institucionet përkatëse që subjekti nuk është në ndjekje penale, nuk ka procese gjyqësore në lidhje me aktivitetin.
- Nuk është përcaktuar në kontratë se pala qiramarrëse ka detyrimin për pagesën e energjisë elektrike dhe të ujit, sipas faturës mujore të gjeneruar nga shitësit e këtyre mallrave.
- Gjithashtu pas lidhjes së kontratës nga Bashkia Libohovë nuk është ngritur grup pune për monitorimin e tre kontratave për dhënien me qira të ndërtesave/objekteve. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM nr. 54, datë 05.02.2014, “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, pikat 1-3 dhe 7. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 39-49 të Raportit përfundimtar të auditimit).

9.1. Rekomandim: Bashkia Libohovë të marrë masa që gjatë procesit të dhënies së ndërtesave me qira, të bëjë skualifikimin e të gjithë subjekteve konkurruese të cilët nuk vërtetojnë se plotësojnë dokumentacionin e kërkuar nga Bashkia Libohovë.

9.2. Rekomandim: Bashkia Libohovë të marrë masa që në hartimin e kontratave për dhënien me qira të ndërtesave/objekteve, të përcaktojë se detyrimet për konsumin mujor të energjisë elektrike dhe të ujit, janë të qiramarrësit. Të përcaktohet person apo strukturë për monitorimin e kontratave të dhënies me qira të ndërtesave

Menjëherë dhe në vijimësi.

10. Gjetje nga auditimi: 1. Për llogaritë 210 “Toka, troje, terrene”, 211 “Pyje, plantacione”, 212 “Ndërtesa e konstruksione”, 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, 214 “instalime teknike, makineri pajisje vegla pune”, nuk ka një regjistër kontabël të aktiveve, në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 26-30, pika 74.

2. Në pasqyrat financiare llogaria 210 “Toka, troje, terrene” në datën 31.12.2022, paraqitet në vlerën 0 lekë. Kjo llogari nuk pasqyron situatën e duhur, pasi Bashkia Libohovë ka në administrim pasuri të kësaj natyre.

3. Llogaria 211 “Pyje, kullota, plantacione” më datën 31.12.2022, paraqitet në vlerën 0 lekë. Për sa i përket kalimit të sipërfaqeve të pyjeve dhe kullotave në zbatim të VKM nr. 433, datë 08.06.2016, “Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të Ish-Komunave/Bashkive”, pika 29, shtojca nr. 27, e cila përmban listën e inventarit të pyjeve dhe kullotave që transferohen në pronësi të Bashkisë Libohovë, me numër rendor 1 deri në 215, konstatohet se këto pasuri nuk janë evidentuar në pasqyrat financiare në llogarinë përkatëse.

Sasia e tyre është në total 12,140 ha nga të cilat 7,918 ha kullotë verore, 3,006 ha pyll, 1,027 ha kullotë dimërore, 146 ha tokë inproduktive, 42 ha djerrë dhe 1 ha tokë buke. Në këtë llogari nuk janë pasqyruar sipërfaqet të cilat i kanë kaluar Bashkisë Libohovë me VKM nr. 666, datë 21.05.2008, si dhe VKM nr. 750, datë 28.05.2008, “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave, pyje dhe kullota, që do të transferohen në pronësi të Qeverisjes Vendore, Komuna Qendër Libohovë, të Qarkut të Gjirokastrës”, ku përcaktohen në total 1,678 ha, nga këto 413 ha + 401 ha kullotë dimërore (për secilën VKM) dhe 182 ha + 682 ha kullotë (për secilën VKM). Në llogarinë 211 “Pyje, kullota, plantacione” nuk janë pasqyruar sipërfaqet e trajtuara më sipër, në kushte të tilla kjo llogari nuk paraqet një pamje reale në pasqyrat financiare të vitit 2022.

Dispozita ligjore e fundit që trajton problematikën e procesit të pronësisë për njësitë e vetëqeverisjes vendore është Ligji nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, neni 37, përcaktohet që: “Institucionet shtetërore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë për detyrë të kryejnë përditësimin e plotë të pronave të inventarizuara apo të transferuara në favor të tyre brenda 18 muajve nga data e hyrjes në fuqi e ligjit”, proces i cili duhet të përfundonte në muajin nëntor të vitit 2021.

Për asetet të cilat janë transferuar sipas VKM-ve të sipërpërmendura, konstatohet se në Bashkinë Libohovë nuk është realizuar inventarizimi i tyre (pyje/kullota).

4. Llogaria 212 “Ndërtime konstruksione” nuk paraqet një pamje reale për pasqyrat financiare të vitit 2022 për arsye se nuk janë të pasqyruara të gjitha pasuritë e kësaj llogarie. Gjithashtu nuk është bërë inventarizimi i pasurive të kësaj llogarie në teren për të përcaktuar statusin real të tyre.

5. Nga auditimi i llogarisë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” konstatohet se, nuk është vlerësuar dhe evidentuar në këtë llogari vlera e rrugës prej 29 km e përbërë nga 15 km “Kthesë Libohovë-Selcke” dhe 14 km rruga “Poliçan-Nivan”, të kaluara në pronësi të Bashkisë Libohovë me VKM nr. 915, datë 11.11.2015, “Për transferimin në pronësi, nga Këshillat e Qarqeve të Bashkisë, të rrjetit të rrugëve rurale dhe aseteve të luajtshme e të paluajtshme të ndërmarrjeve të mirëmbajtjes së këtyre rrugëve”, pika 9, tabela 1, faqe 3.

Nga auditimi konstatohet se në llogaritë 210 “Toka, troje, terrene”, 211 “Pyje, plantacione”, 212 “Ndërtesa e konstruksione”, 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, nuk janë reflektuar të gjitha ndërtesat, trojet, terrenet, rrugë, vepra ujore etj., të kaluara pas reformës territoriale, dhe Vendimi i Këshillit Bashkiak nr. 91, datë 14.10.2016, “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme shtetërore që kërkohen për transferim në pronësi të njësisë administrative qendër Libohovë të Bashkisë Libohovë”, në zbatim të Ligjit nr. 115/2014, “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësisive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të Ligjit nr. 8743 datë 22.02.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit, i ndryshuar, VKM nr. 840, datë 22.07.2009, “Për miratimin e inventarit të pronave të paluajtshme në Komunën Libohovë”, si dhe me Udhëzimin nr. 15, datë 30.06.2003, “Për mënyrën e paraqitjes nga Njësitë e Qeverisjes Vendore të kërkesave për transferimin në pronësi të pronave të paluajtshme publike”.

6. Bashkia Libohovë nuk ka marrë masa për rregjistrimin e aseteve në ASHK. Për aktivet që i përkasin llogarisë 210 “Toka, troje, terrene”, 211 “Pyje, plantacione”, 212 “Ndërtesa konstruksione” dhe 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, për koston historike 935,219,591 lekë, Bashkia Libohovë posedon titull pronësie të regjistruara në ASHK Gjirokastrë sipas zonave kadastrale, vetëm për tre objekte si më poshtë:

- Pasuria nr. 14/8 (Muzeu “Avni Rustemi”);
- Pasuria nr. 8/185 (Ndërtesa e Bashkisë);
- Pasuria nr. 2/27 (Kopshti Fëmijëve Hoxhallarë)

Ndërsa për pjesën tjetër të llogarive të sipërpërmendura nuk posedon titull pronësie. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 49-73 të raportit përfundimtar të auditimit).*

10.1. Rekomandim: Nga Nëpunësi Zbatues të hartohet rregjistri kontabël i aktiveve sipas llogarive kontabël, duke evidentuar të gjithë elementët e nevojshëm si vendndodhjen e pronës, sipërfaqen e saj etj., për të gjitha pronat që administron Bashkia Libohovë.

10.2. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Libohovë të marrë masa për ngritjen e grupit të punës për inventarizimin në teren e të gjitha pronave që administron Bashkia Libohovë, për të përcaktuar dhe verifikuar situatën faktike, nëse ekzistojnë në teren të gjitha pronat ashtu si ato paraqiten në VKM përkatëse nëpërmjet të cilave janë transferuar në Bashkinë Libohovë. Në përfundim të procesit të inventarizimit të informohet Kryetari i Bashkisë për rezultatet e këtij procesi.

10.3. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Libohovë të marrë masa që nga strukturat përkatëse të përgatiten dosjet me dokumentacionin e duhur për regjistrim në ASHK të të gjitha pronave që administron. Sektori i Financës të përlllogaritë kostot për kryerjen e këtij shërbimi, me qëllim pajisjen sa më parë të pasurive të paluajtshme me titull pronësie.

Menjëherë

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i evidencave analitike për aktivet afatgjata materiale dhe jo materiale konstatohet se në llogarinë 202 “Studime dhe kërkime” pasqyrohen aktive me emërtimin “Vlerë tjetër” në vlerën 5,645,745 lekë, në llogarinë 212 “Ndërtime konstruksione” pasqyrohen aktive me emërtimin “Vlerë tjetër”, në vlerën 4,687,737 lekë, në llogarinë 213 “Rrugë rrjete vepra ujore” pasqyrohen aktive me emërtimin “Vlerë tjetër” në vlerën 8,296,835 lekë dhe, në llogarinë 214 “Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune” pasqyrohen aktive me emërtimin “Vlerë tjetër”, në vlerën 742,167 lekë. Për këto katër zëra sipas klasave respektive në shumën totale 19,372,484 lekë nuk disponohet asnjë dokumentacion kontabël, mbi origjinën e tyre, të cilat mbahen të mbartura dhe trashëguara vit pas viti në kontabilitet, si dhe nuk janë të verifikueshme fizikisht dhe se çfarë pasqyrojnë këto vlera në kontabilitetin e njësisë, për shkak të mos përshkrimit të aktivitetit dhe mungesës së çdo dokumentacioni tjetër kontabël për këto aktive. Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75 dhe Udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu II “Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 5. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 49-73 të raportit përfundimtar të auditimit).*

11.1. Rekomandim: Nëpunësi Zbatues të ngrejë grup pune me specialistë të fushës për saktësimin e:

- Vlerës 5,645,745 lekë, me emërtimin “Vlerë tjetër” në llogarinë 202 “Studime dhe kërkime”;
- Vlerës 4,687,737 lekë, me emërtimin “Vlerë tjetër” në llogarinë 212 “Ndërtime konstruksione”;
- Vlerës 8,296,835 lekë, me emërtimin “Vlerë tjetër” në llogarinë 213 “Rrugë rrjete vepra ujore”;
- Vlerës 742,167 lekë, me emërtimin “Vlerë tjetër” në llogarinë 214 “Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune”.

Deri në datën 31.12.2023

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrës nr. 7/b “Gjendja dhe Ndryshimet e Aktiveve Afatgjata (Vlera Neto)”, konstatohet se për llogarinë 202 “Studime dhe kërkime” për vitin ushtrimor 2022 nuk është përlllogaritur normë amortizimi. Në mbyllje të gjendjes së kësaj

llogarie më datës 31.12.2022, është pasqyruar vlera e amortizimit të akumuluar në vlerën 47,500 lekë, por kjo vlerë i përket amortizimit të akumuluar të çeljes së llogarisë më datë 31.12.2021. Për llogarinë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” për vitin ushtrimor 2022 nuk është përlllogaritur normë amortizimi. Në mbyllje të gjendjes së kësaj llogarie më datës 31.12.2022, është pasqyruar vlera e amortizimit të akumuluar në vlerën 151,013,379 lekë, por kjo vlerë i përket amortizimit të akumuluar të çeljes së llogarisë më datë 31.12.2021. Veprime këto në kundërshtim Udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kapitulli III “Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 3.1, “Procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, nënpika 36. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 49-73 të raportit përfundimtar të auditimit).*

12.1. Rekomandim: Nga Sektori i Financës të merren masa që për llogaritë 202 “Studime dhe kërkime” dhe llogarinë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, të bëhet llogaritja e vlerë së amortizimit, sipas normave që përcakton kuadri ligjor në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se vlera e kontabilizuar në llogarinë “Detyrime ndaj personelit”, që përfaqëson vlerën e pagave për muajin dhjetor të vitit 2022 e cila mbetet për t’u paguar në muajin janar të vitit pasardhës, është 4,240,112 lekë, ndërkohë që duke u bazuar në urdhër shpenzimet e realizuara nëpërmjet Degës së Thesarit Gjirokastër vlera e kësaj llogarie është 3,647,634 lekë me një diferencë pak në vlerën 592,478 lekë. Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Aneksi nr. 1, pika 3.3. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 49-73 të raportit përfundimtar të auditimit).*

13.1. Rekomandim: Nga Sektori i Financës të analizohet dhe të sistemohet në pasqyrat financiare diferenca në vlerën 592,478 lekë që i përket kontabilizimit të gabuar në llogarinë 42 “Detyrime ndaj personelit”, për të cilën nuk disponohet dokumentacioni justifikues dhe vërtetues përkatës.

Në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2023

14. Gjetje nga auditimi: Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” sipas pasqyrës së pozicion financiar të Bashkisë Libohovë në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerë 22,747,375 lekë dhe përfaqëson vlerën e garancisë së punimeve në masës 5%.

Për 2 objekte të përfunduara dhe të marra në dorëzim nga Bashkia Libohovë të cilat i përkasin llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”, janë ngurtësuar fonde në vlerën 99,458 lekë, për të cilat është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës. Për këto fonde nuk janë marrë masa për xhirimin e tyre te kontraktori, apo për verifikimin e investimit nëse ka patur problematika gjatë periudhës së garancisë, me qëllim rakordimin dhe mbajtjen e vlerës që lidhet me problematikën e konstatuar. Nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për këtë qëllim. Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kapitulli III, pikat 29, 30, 39, 50 dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011, “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kapitulli II, pika 10. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 49-73 të raportit përfundimtar të auditimit).*

14.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Libohovë, Sektori i Financës dhe Sektori i Shërbimit Urban të marrin masa për evidentimin e situatës reale për fondet e ngurtësuar në vlerën 99,458 lekë, për garanci punimesh për dy objekte. Të njoftohen subjektet për këtë qëllim dhe bazuar në kontratën e nënshkruar të përcaktohet nëse subjektet kanë ose jo detyrime për periudhën e garancisë. Nëse këto subjekte nuk kanë detyrime për periudhën e garancisë së investimit, të bëhet xhirimi i fondeve në llogari të tyre dhe, nëse kanë detyrime, në vlerën përkatëse të detyrimit, fondet të kalojnë në llogarinë e njësisë vendore, sipas përcaktimeve të bëra në kontratën dypalëshe..

Menjëherë

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së miratimit të lejes së infrastrukturës, konstatohet se dokumentacioni që vërteton të drejtat e pronësisë mbi pronën nën zhvillim nuk është i plotë. Sipas përcaktimeve të VKM nr. 408, datë 13.05.2015, i ndryshuar, neni 15, pika 1, nënpika b), zhvilluesi dhe aplikanti kanë detyrimin që të ngarkojnë dokumentet që vërtetojnë të drejtat pasurore të pronës që marrin pjesë në një zhvillim. Në dokumentacionin e kësaj procedure nuk u gjenden çertifikatat e pronësisë dhe hartat treguese për dy pasuritë në zhvillim. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 83-88 të raportit përfundimtar të auditimit).*

15.1. Rekomandim: Nga DPZHT dhe Bashkia Libohovë të merren masa për të mos miratuar asnjë leje ndërtimi që nuk provon të drejtat e pronësisë sipas legjislacionit në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit dhe të infrastrukturës u konstatua se në dy raste ka mangësi dhe mungesa në projektet që përbëjnë projektin ndërtimor, siç janë plani i vendosjes së ndërtimit mbi fragmentin e hartës në gjendjen ekzistuese i firmosur nga të gjithë projektuesit, deklaratat e projektuesve të licencuar, polica e sigurimit, licencat e projektuesve, në plan vendosjen e miratuar nuk pasqyrohen distancat e objektit nga kufiri i pronës dhe distancat ndërmjet objekteve, në projektin arkitektonik dhe projektin konstruktiv nuk pasqyrohet gjendja ekzistuese e objektit dhe ndërhyrjet që do të realizohen pas rikonstruksionit e shtesës së katit, vlerësimi i ndikimit në mjedis. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 83-88 të raportit përfundimtar të auditimit).*

16.1. Rekomandim: Nga DPZHT Libohovë të merren masa për të mos miratuar asnjë leje ndërtimi në mungesë të dokumentacionit të detyrueshëm sipas ligjit, dokumentacionit shoqërues, si dhe ky dokumentacion duhet të jetë i saktë dhe të përmbajë gjithë informacionin e nevojshëm, sipas rregulloreve mbi të cilat hartohen.

Menjëherë dhe në vijimësi

17. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit dhe të infrastrukturës u konstatua se në dy raste ka mangësi në kërkesat për dhënie mendimi nga autoriteteve të cilat duhet të shprehen. Konkretisht nuk i është kërkuar mendim OST, , nuk i është kërkuar mendim Ministrisë së Mjedisit (MM), ndërsa MBZHR ka cituar se nuk mund të shprehet. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 83-88 të raportit përfundimtar të auditimit).*

17.1. Rekomandim: Nga DPZHT Libohovë të merren të gjitha masat për marrjen dhe respektimin e mendimit dhe vendimeve të të gjitha autoriteteve të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

18. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i strukturës organizative të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, konstatohet se kjo strukturë nuk është e plotësuar me punonjës, pasi pozicioni i kryeinspektorit dhe pozicioni e inspektorëve janë vakant. Në këtë mënyrë nuk garantohet kontrolli i territorit dhe zbatimi i ligjshmërisë dhe standardeve teknike në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 82-84 të Raportit përfundimtar të*

auditimit).

18.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Libohovë të marrë të gjitha masat për ngritjen e strukturës së Inspektoratit të Mbrojtjes së Teritorit Vendor, duke respektuar kriteret e arsimit, sipas kuadrit ligjor në fuqi.

Deri më datën 31.10.2023

19. Gjetje nga auditimi: Gjetje nga auditimi: Për vitin 2022 në fshatin Stegopul, Bashkia Libohovë janë nënshkruar tre kontrata dimërore për ushtrimin e aktivitetit “Për kullotë”, për sezonin dimëror nga data 01.12.2023-31.05.2023, për të cilat me shkresën nr. 1056 prot., datë 01.08.2022, është nxjerrë njoftim për informimin e qytetarëve. Afati për paraqitjen e kërkesave është lënë 1 muaj, pra data 31.08.2022.

-Referuar kontratave të nënshkruara ndërmjet Bashkisë Libohovë përfaqësuar nga Znj. L.M. Kryetar i Bashkisë dhe Z. K.L., kontrata me nr. 1678 prot., datë 13.12.2022 dhe Z. P.K., kontrata me nr. 1583 prot., datë 01.12.2022, sipërfaqja e kullotës së dhënë me qira është në përputhje me numrin e krerëve të bagëtisë, duke i dhënë edhe njëkohësisht prioritet banorëve vendas të fshatit Stegopul, në zbatim të Udhëzimit të Ministrisë së Mjedisit nr. 2, datë 20.07.2016, “Kriteret teknike të klasifikimit të kullotave e livadheve dhe procedurat për dhënien e tyre për kullotë e kositje bari”, Kreu I “Kriteret teknike për klasifikimin e kullotave dhe livadheve”, pika 6.

-Referuar kontratës të nënshkruar ndërmjet Bashkisë Libohovë përfaqësuar nga Znj. L.M. Kryetar i Bashkisë dhe Znj. TH.D. kontrata me nr. 1477 prot., datë 02.11.2022, sipërfaqja e kullotës së dhënë me qira nuk përputhet me numrin e krerëve të bagëtisë.

Sipërfaqja e parcelës me nr. 50 ose (B) është dhënë në përputhje me dispozitat ligjore konkretisht duke u bazuar në Vendimin Nr. 9, datë 25.02.2022, të Këshillit Bashkiak sipas shkresës me Nr. 322 Prot., datë 01.03.2022, me objekt “Për miratimin e listës të fondit kulloror që do të jepet me qira për vitin 2022”, ku pjesë e listës janë edhe parcelat me nr. 50, nr. 51, nr. 57, dhe nr. 88.

Pjesa tjetër e sipërfaqes të cilat janë jashtë fondit pyjor kulloror të pa frytshme si pjesë e kësaj kontrate konkretisht, sipërfaqja në anën e majtë të parcelës me nr. 50, (A) 29.6 ha dhe sipërfaqja në anën e djathtë (C) 9.5 ha shkon në total 39.1 ha. Nga sipërfaqja totale 39.1 ha jashtë fondit pyjor kulloror të pa frytshme, e cila i përket kontratës me nr. 1477 prot., datë 02.11.2022, vetëm sipërfaqja 88,585 m² ose 8.85 ha e cila është tokë bujqësore është dhënë në përputhje me dispozitat ligjore konkretisht duke u bazuar në Vendimin nr. 55, datë 26.11.2021, të Këshillit Bashkiak sipas shkresës me nr. 1635 prot., datë 01.12.2021, me objekt “Për miratimin e sipërfaqes së tokës bujqësore me që do të jepet me qira”.

Sipërfaqja e mbetur prej 30.25 ha nga totali, e cila i përket sipërfaqes në anën e majtë të parcelës me nr. 50, (A) 29.6 ha dhe sipërfaqja në anën e djathtë (C) 9.5 ha jashtë fondit pyjor kulloror të pa frytshme, nuk kanë marrë miratimin nga Këshilli Bashkiak për dhënien me qira të tyre, por këto sipërfaqe janë dhënë me miratim vetëm nga Kryetari i Bashkisë Znj. L.M., veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 54, germa “e”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8, faqe 94-98 të Raportit përfundimtar të auditimit).

19.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Libohovë të marrë masa që përpara dhënies me qira të sipërfaqeve për kullotë dimërore apo verore në teritorin e Bashkisë Libohovë, të cilat janë jashtë fondit pyjor kulloror, të klasifikuara si të pa frytshme, apo në çdo rast tjetër për dhënien në përdorim të pronave të tretët, të marrë më parë miratimin nga Këshilli Bashkiak.

Menjëherë

A.1. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM.

Bashkia Libohovë është audituar nga KLSH në vitin 2022 dhe në përfundim të procesit të auditimit, me shkresën Nr. 801/1 Prot., datë 19.12.2022 është dërguar raportit përfundimtar i auditimit, si dhe rekomandimet për përmirësimin e gjendjes. Rekomandimet e dhëna nga KLSH, si dhe statusi i zbatimit të tyre nga Bashkia Libohovë është si vijon:

20. Gjetje nga auditimi: a. Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 11 masa organizative të cilat janë pranuar plotësisht, prej të cilave tre masa janë zbatuar, një masë është në proces zbatimi dhe shtatë masa nuk janë zbatuar.

b. Për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimit e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet të tyre (të ardhura të munguara) është rekomanduar 1 masë në vlerën 23,317,720 lekë, e pranuar nga subjekti, e cila konsiderohet në proces zbatimi, pasi është arkëtuar vlera 1,671,753 lekë dhe subjekti është duke vazhduar përpjekjet për zbatimin e rekomandimit dhe vlerësohet në mundësinë e realizimit. Gjithashtu nga Bashkia Libohovë nuk janë marrë masat e duhura për raportimin e ecurisë së zbatimit të rekomandimeve në KLSH duke mos respektuar afatin 6 mujor. Veprime këto në kundërshtim me Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15, germa “c”, neni 30, pika 2. (Më hollësisht trajtuar në pikën 7, faqe 90-99 të raportit përfundimtar të auditimit).

20.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë të analizojë situatën e moszbatimit plotësisht të rekomandimeve të dërguara nga KLSH-ja me shkresën Nr. 801/1 Prot., datë 19.12.2022, duke nxjerrë përgjegjësitë e personave të ngarkuar për zbatimin e tyre. Të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për të përshpejtuar punën për zbatimin e rekomandimeve në proces zbatimi, si dhe për zbatimin e plotë të rekomandimeve të pa zbatuara dhe të zbatuara pjesërisht, si vijon:

Masa Organizative

1.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Libohovë të marrë masat e duhura për njohjen nga stafi të kuadrit ligjor në fuqi për MFK, për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve, hartimin e regjistrit të riskut, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë efekt negativ në arritjen e objektivave të institucionit. Të hartohet gjurma e auditimit për të gjitha proceset kryesore të aktivitetit të institucionit.

2.1. Rekomandim: Nëpunësi zbatues të marrë masa për identifikimin e aktiveve që përfaqësojnë shumatat e regjistruara në kontabilitet me emërtimin “Vlerë tjetër”, dhe kjo vlerë të shtohet në vlerën e aktivitetit përkatës, në mënyrë që llogaritë përkatëse të pasqyrave financiare të jenë të mbështetura me dokumentacion të qartë vërtetues.

3.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Libohovë të ngrëjë grup pune me specialist të fushës për inventarizimin dhe vlerësimin e aktiveve të llogarisë 210, 211, 212 dhe 213 të administruara nga Bashkia Libohovë, si dhe të kryhet saktësimi i të dhënave në teren për këto prona (vendndodhja, sipërfaqja, statusi etj.). Në vijim të kryhet regjistrimi i tyre në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës. Në vijim të kryhen veprimet kontabël për përfshirjen e të gjitha këtyre aktiveve në llogaritë përkatëse të pasqyrave financiare.

6.1. Rekomandim: Nëpunësi zbatues të marrë masa për hartimin dhe plotësimin e regjistrit të aktiveve me të gjithë elementët e tij të domosdoshëm, me qëllim identifikimin në këtë dokument të të gjitha aktiveve të njësisë vendore, si dhe uljen e rrishtit nga humbjet dhe keq menaxhimin e tyre.

8.1. Rekomandim: Nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues të marrin masa për hartimin e raporteve periodike 4 mujor të monitorimit të zbatimit të buxhetit dhe këto raporte ti paraqiten për njohje këshillit bashkiak, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

10.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë dhe zyra e taksave dhe tarifave vendore të paraqesin për miratimin në Këshillin Bashkiak aktmarrëveshjen me shoqërinë “Ujësjellës Kanalizime Libohovë” Sh

A, duke kërkuar prej saj të kryej rolin e agjentit tatimor, me përfshirjen në faturën e ujit edhe të detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore për kategorinë familjare.

11.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Libohovë të analizojë situatën dhe të nxjerrë përgjegjësitë për mos zbatimin e plotë të rekomandimeve të dërguara nga KLSH. Të merren masa të menjëhershme si dhe të hartohet një plan pune i veçantë për zbatimin e rekomandimeve të pa zbatuara dhe atyre në proces.

Menjëherë

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI.

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 germa (b) dhe (c) –Të drejtat e KLSH dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 21-33, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe pikën 93, të udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nga **Titullari i Njesisë Publike**, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. **Nëpunësi zbatues** të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabël përfundimtare, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **313,418 lekë**, si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i listëpagesave për vitin 2022 konstatohet se 2 punonjës janë trajtuar me pagë grupi në kundërshtim me VKM nr. 165, datë 02.03.2016, “Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”, Lidhja nr. 9, konkretisht:

a. Z. L.B me detyrë Sekretar i Këshillit ka përfunduar studimet e larta Bachelor në degën “Inxhinieri Agrare” dhe Master Profesional në degën “Inxhinieri Agrare profili Mbrojtja Kimike dhe Fitofarmacia”, i cili për muajt janar-dhjetor 2022, është trajtuar me pagë grupi në vlerën 14,000 lekë, ndërkohë që referuar nivelit të diplomës në nivelit të dytë Master Profesional, duhet të trajtohet me pagë grupi në vlerën 11,000 lekë. Pra punonjësi ka përfituar padrejtësisht **vlerën 36,000 lekë e cila përbën dëm ekonomik për Buxhetin e Bashkisë Libohovë.**

b. Znj. E.L me detyrë Specialiste në Sektorin e Koordinimi të Integritit Europian dhe Ndhimës së Huaj, ka përfunduar studimet e larta Bachelor në degën “Mësuesi për Arsim Parashkollor”, e cila për muajt janar-tetor 2022, është trajtuar me pagë grupi në vlerën 14,000 lekë, ndërkohë që referuar nivelit të diplomës Bachelor, duhet të trajtohet me pagë grupi në vlerën 10,000 lekë. Pra punonjësi ka përfituar padrejtësisht **vlerën 40,000 lekë e cila përbën dëm ekonomik për Buxhetin e Bashkisë Libohovë.** (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 49-73 të raportit përfundimtar të auditimit).

1.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Libohovë dhe Nëpunësi Zbatues, të ndjekin të gjitha procedurat e duhura ligjore, për arkëtimin e vlerës **76,000 lekë të përfituar padrejtësisht nga paga e grupit, përkatësisht vlerës 36,000 leke nga Z. L.B. dhe vlerës 40,000 lekë nga Znj. E.L.**

Deri në 31.12.2023

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt: “Rikonstruksion i rrjetit të ujësjellësit të qytetit Libohovë” Bashkia Libohovë, me vlerë 312,871,811 lekë me TVSH, fituar nga E&N&F, rezultuan punime ndërtimi

të pakryera për zërat e punëve: “Gërmim kanalesh në tokë të fortë, me krah, me seksion deri 0.75 m²” dhe “Gërmim shkëmbi mesatar me çekiç me ekskavator me zinxhir” në vlerën **237,418 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 626 prot., datë 11.05.2020 të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Libohovë dhe E&N&F. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4.4, faqe 80-83 të raportit përfundimtar të auditimit).*

2.1. Rekomandimi: Bashkia Libohovë të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, për arkëtimin e vlerës **237,418 lekë pa TVSH** nga shoqëria C, për volume punimesh të likuiduara, por të pakryera në fakt sipas kontratës Nr. 626 prot., datë 11.05.2020, me objekt “Rikonstruksion i rrjetit të ujësjellësit të qytetit Libohovë” Bashkia Libohovë. Vlera e mësipërme përbën dëm ekonomik në buxhetin e shtetit dhe njësisë vendore.

Deri më 30.11.2023

C. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR, PËR TË RRITUR PERFORMANCËN NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TAKSAT DHE TARIFAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA.

1. Gjetje nga auditimi: Bashkia Libohovë nuk ka marrë masa të plota për arkëtimin e debitorëve. Mbështetur në të dhënat e sektorit të taksave dhe tarifave vendore, **vlera e debitorëve** në datën 31.12.2022 është 25,044,459 lekë, e cila është e ardhur e planifikuar por e pa arkëtuar nga Bashkia Libohovë, nga e cila vlera prej 3,342,835 lekë është krijuar gjatë vitit 2022 nga mos shlyerja e detyrimeve të këtij viti, ndërsa vlera prej 21,701,624 lekë i përket detyrimeve të trashëguara përpara vitit 2022.

Krahasuar me vlerën e debitorëve në datën 31.12.2021, e cila është 23,317,720 lekë, konstatohet se vlera e debitorëve në vitin 2022 është rritur, e cila tregon se nuk janë marrë masa të plota për arkëtimin e debitorëve, si dhe masat e marra kanë patur rezultate jo shumë të mira.

Në vlerën e detyrimit progresiv në fund të vitit buxhetor 2022 prej 25,044,459 lekë, peshën kryesore e zënë detyrimet nga taksapaguesit familjarë, të cilat kanë vlerën 19,273,554 lekë, ose në masën 77% të detyrimit total.

Nga auditimi i masave shtrënguese për arkëtimin e debitorëve u konstatua se këto masa nuk janë të plota në rend shterues, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në Kreun XI-Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar, të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.6, faqe 39-49 të raportit përfundimtar të auditimit).*

1.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Libohovë, zyra e taksave vendore dhe zyra juridike, të marrin të gjitha masat e duhura ligjore për arkëtimin e detyrimeve të pa paguara nga kategoria e taksapaguesve privat dhe familjar në vlerën 25,044,459 lekë.

Deri më datën 31.12.2023

2. Gjetje nga auditimi: Për periudhën nga data 01.01.2021, deri më 31.12.2022, Bashkia Libohovë ka lidhur 2 kontrata për dhënie me qira të tokave bujqësore, si dhe janë aktive 10 kontrata të cilat janë lidhur përpara periudhës objekt auditimi. Kontratat të cilat kanë qenë aktive, janë rilidhur përsëri duke u shtuar afatin për përdorimin e tyre. Për vitin 2021 kanë qenë aktive 12 kontrata me sipërfaqe totale 59,659 m², me vlerë totale vjetore të qirasë prej 358,170 lekë, ndërsa për vitin 2022 kanë qenë aktive 11 kontrata me sipërfaqe 51.975 m² dhe me vlerë totale vjetore të qirasë prej 311,850 lekë. Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion konstatohet se deri më datë 31.12.2022, për 5 kontrata nuk janë shlyer **detyrimet në vlerën totale 319,330 lekë, e cila konsiderohet detyrim i pa arkëtuar nga debitorët e Bashkisë**

Libohovë. Nga vlera e mësipërme, 261,960 lekë përbën detyrimin principal, ndërsa vlera 57,370 lekë përbënë kamatëvonesë.

Detyrimi i mësipërm, është prej 5 qiramarrësve, si vijon:

- 1.K.K. për vlerën 26,62 lekë;
- 2.A.K. për vlerën 127,995 lekë;
- 3.A.K. për vlerën 7,095 lekë;
- 4.S.P. për vlerën 55440 lekë;
5. V.V., për vlerën 13,019 lekë.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim kontratën e lidhur midis Bashkisë Libohovë dhe qiramarrësit. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.6, faqe 39-49 të raportit përfundimtar të auditimit).*

2.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkia Libohovë, të ndjek të gjitha procedurat e duhura ligjore, për arkëtimin e vlerës **319,330 lekë**, të cilat janë detyrime kontraktuale të pa paguara nga 5 qiramarrësit e tokës bujqësore, si vijon:

- 1.K.K. për vlerën 26,62 lekë;
- 2.A.K. për vlerën 127,995 lekë;
- 3.A.K. për vlerën 7,095 lekë;
- 4.S.P. për vlerën 55440 lekë;
- 5.V.V., për vlerën 13,019 lekë.

Deri më 30.11.2023

D. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË TYRE.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimeve të kryera me bankë konstatohet se për zbatimin e vendimeve gjyqësore për periudhën janar-dhjetor 2022 nga Bashkia Libohovë është shpenzuar vlera **5,962,000 lekë**, e cila konsiderohet efekt negativ financiar në buxhet. Kjo vlerë i përket likuidimit të tre vendimeve gjyqësore me objekt dëmshpërblime për dëmtim prone apo humbje jete. Vendimet gjyqësore nuk janë analizuar nga Kryetari i Bashkisë dhe nuk është kërkuar prej Tij nxjerrja e përgjegjësive administrative për këto vendime. Analizimi i arsyeve të humbjeve të vendimeve gjyqësore dhe nxjerrja e përgjegjësive administrative për to, ndikon pozitivisht në korrigjimin e praktikave të gabuara të ndjekura nga njësia vendore, praktika të cilat kanë sjellë humbjen e proceseve gjyqësore, bënë evidentimin e procedurave të bëra gabim, e si rezultat shmangien e tyre në të ardhmen dhe uljen e shpenzimeve financiare negative në buxhet. Mos kryerja e kësaj analize nga Titullari është në kundërshtim me pikën nr. 60, të UMFE nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1-2.5, faqe 27-39 të raportit përfundimtar të auditimit)*

1.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Libohovë të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatojë, me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kane sjellë humbjen e çështjes gjyqësore. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen të procedurave të gabuara të ndjekura për çështjen e dëmshpërblimit, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet.

Menjëherë dhe në vijimësi

MASA DISIPLINORE.

I . Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil.

Në mbështetje të shkronjës (c) neni 15 -Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të nenit 58, “llojet e masave disiplinore” të ligjit nr. 152/2013 datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar me ligjin nr. 178/2014, datë 18.12.2014, VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil” dhe, nenin 64 shkronjën g, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Libohovë, që ti kërkojë Komisionit Disiplinor, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore nga “Vërejtje”, deri në “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet”, në proporcion me shkeljen, për punonjësit e mëposhtëm:**

1. Z. XH.S., me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore, për mos marrjen e masave të plota për arkëtimin e debitorëve, në kundërshtim me nenin 93, 94, 95, 131 të parashikuara në Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar (Trajtuar më hollësisht në pikën 2.6 të raportit përfundimtar të auditimit).

II . Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës.

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Ligjin 139/2015” Për vetëqeverisjen vendore”, pika 4 e nenit 15, si dhe në pikën 1, germa (i), si dhe kontratë individuale të punës, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Libohovë, që bazuar në shkeljet e konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH dhe në proporcion me shkeljen e kryer, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore nga “Vërejtje”, deri në “Zgjidhje të kontratës së punës”, për punonjësit e mëposhtëm:**

1. Znj. E.P. me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Financës, për anomalitë e konstatuara në hartimin e pasqyrave financiare dhe zbatimin e buxhetit, veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Udhëzimi nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e vetëqeverisjes vendore”, pika 19 dhe pikat 22-23, etj. (Trajtuar më hollësisht në pikën 2.1 – 2.5 dhe pikën 3 të raportit përfundimtar të auditimit).

NJOFTIMI I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË MBIKËQYRJES TË SHËRBIMIT CIVIL.

Për punonjësit që do të jepen masa disiplinore, Bashkia Libohovë pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, të **ndërmarrë veprimet si më poshtë:**

a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 ”Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.

b. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 ”Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.

Në zbatim të nenit 15, shkronja (j), të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe

funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për masat e marra nga ana Juaj, të përgatiten programe me afate dhe persona përgjegjës dhe, për zbatimin e rekomandimeve të njoftohet Kontrolli i Lartë i Shtetit **brenda 20 ditëve** nga marrja e kësaj kërkesë. Në vijim e në zbatim të nenit 30, pika 2 e këtij ligji, kërkohet ndjekja e realizimit të tyre në vazhdimësi, duke nxjerrë aktet e nevojshme administrative dhe nisjen e procedurave disiplinore e administrative, apo hartimin e padive gjyqësore për shpërblimin e demit dhe mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna, nga ana Juaj të raportohet (*me shkrim*) pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit **brenda 6 muajve** nga marrja e njoftimit të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe rekomandimeve.

V. ANEKSE

Aneksë të drejtimit nr. 1, “Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik”.

Tabela nr. 1, nënpika 2.1.3. “Përbërja e dokumentacionit të dosjeve sipas angazhimeve të realizuara për vitin 2022 nga NJAB”.

| Nr. | Viti | Objektet e audituara | Përshkrimi i punës së NJAB |
|--|------|---|---|
| 1 | 2022 | Shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Libohovë | Autorizimi me shkresën nr. 60 prot., datë 13.01.2022 |
| | | | Njoftim për fillimin e angazhimit të auditimit me shkresën nr. 60/1 prot., datë 13.01.2022 |
| | | | Deklarata e pavarësisë së audituesit me shkresën nr. 60/2 prot., datë 17.01.2022 |
| | | | Vlerësimi i riskut për mjedisin e përgjithshëm të kontrollit |
| | | | Vlerësimi i risqeve për sistemet/fusha të veçanta të llogarisë |
| | | | Vlerësimi i përgjithshëm i riskut |
| | | | Takimi fillestar me organizatën me shkresën nr. 60/3 prot., datë 21.01.2022 |
| | | | Programi i angazhimit të auditimit me shkresën nr. 60/4 prot., datë 21.01.2022 |
| | | | Testet individuale të Auditimit të Brendshëm (Pyetësorët) |
| | | | Shkresa përcjellëse e projekt raportit me nr. 60/5 prot., datë 05.04.2022 |
| | | | Projektraporti i auditimit |
| | | | Plani i veprimit i sugjeruar |
| | | | Kundërshtitë (observacionet) |
| | | | Shkresa përcjellëse e raportit përfundimtar me nr. 60/6 prot., datë 20.04.2022 |
| | | | Raporti përfundimtar |
| | | | Memorandumi me shkresën nr. 60/6 prot., datë 20.04.2022 |
| | | | Vlerësimi i subjektit të audituar (Aneksi 2) |
| | | | Plani i veprimit i dërguar nga subjekti i audituar |
| | | | Aneksi 1: Lista e kontrollit për monitorimin e aktivitetit të AB-së |
| | | | Aneksi 1/1: Lista e kontrollit për monitorimin e aktivitetit të AB-së; Vëtvlerësim nga çdo auditues |
| Evidenca të tjera të auditimit; Fotokopje të dokumentacionit të Shoqërisë; Shënime të audituesve | | | |
| 2 | 2022 | Detyrimet e prapambetura Bashkia Libohovë | Autorizimi me shkresën nr. 1163 prot., datë 30.08.2022 |
| | | | Njoftim për fillimin e angazhimit të auditimit me shkresën nr. 1163/1 prot., datë 30.08.2022 |
| | | | Programi i angazhimit të auditimit me shkresën nr. 1163/2 prot., datë 30.08.2022 |
| | | | Deklarata e pavarësisë së audituesit me shkresën nr. 1163/3 prot., datë 30.08.2022 |
| | | | Gjurmët standarte të auditimit me shkresën nr. 1163/4 prot., datë 30.08.2022 |
| | | | Takimi fillestar me organizatën me shkresën nr. 1163/5 prot., datë 30.08.2022 |
| | | | Vlerësimi i riskut për mjedisin e përgjithshëm të kontrollit |
| | | | Vlerësimi i risqeve për sistemet/fusha të veçanta të llogarisë |
| | | | Vlerësimi i përgjithshëm i riskut |
| | | | Ndarja e detyrave midis grupit të auditimit |
| | | | Testet individuale të Auditimit të Brendshëm (Pyetësorët) |
| | | | Shkresa përcjellëse e projekt raportit me nr. 1163/6 prot., datë 19.09.2022 |
| | | | Projekt raporti i auditimit |
| | | | Plani i veprimit i sugjeruar |
| | | | Kundërshtitë (observacionet) |
| | | | Shkresa përcjellëse e raportit përfundimtar me nr. 1163/7 prot., datë 23.09.2022 |
| | | | Raporti përfundimtar |
| Memorandumi me shkresën nr. 1163/8 prot., datë 26.09.2022 | | | |
| Vlerësimi nga subjekti i audituar (Aneksi 2) | | | |

| | | | |
|---|------|---|--|
| | | | Plani i veprimit i dërguar nga subjekti i audituar |
| | | | Aneksi 1: Lista e kontrollit për monitorimin e aktivitetit të AB-së |
| | | | Aneksi 1/1: Lista e kontrollit për monitorimin e aktivitetit të AB-së Vetëvlerësim nga çdo auditues |
| | | | Evidenca të tjera të auditimit; Fotokopje të dokumentacionit të shoqërisë; Shënime të audituesve |
| 3 | 2022 | Zbatim rekomandimesh Bashkia Libohovë | Autorizimi me shkresën nr. 1162 prot., datë 30.08.2022 |
| | | | Njoftim për fillimin e angazhimit të auditimit me shkresën nr. 1162/1 prot., datë 30.08.2022 |
| | | | Programi i angazhimit të auditimit me shkresën nr. 1162/2 prot., datë 30.08.2022 |
| | | | Shkresa përcjellëse e projekt raportit me nr. 1162/3 prot., datë 30.08.2022 |
| | | | Projektraporti i auditimit |
| | | | Kundërshtitë (observacionet) |
| | | | Shkresa përcjellëse e raportit përfundimtar me nr. 1162/4 prot., datë 14.10.2022 |
| | | | Raporti përfundimtar |
| | | | Evidenca të tjera të auditimit; Fotokopje të dokumentacionit të institucionit; Shënime të audituesve |
| 4 | 2022 | Detyrimet e prapambetura Shoqëria Ujësjellës Kanalizime Sh.a Libohovë | Autorizimi me shkresën nr. 9 prot., datë 13.01.2022 |
| | | | Njoftim për fillimin e angazhimit të auditimit me shkresën nr. 9/1 prot., datë 13.01.2022 |
| | | | Deklarata e pavarësisë së audituesit me shkresën nr. 9/2 prot., datë 17.01.2022 |
| | | | Takimi fillestar me organizatën me shkresën nr. 9/3 prot., datë 21.01.2022 |
| | | | Gjurmët standarte të auditimit me shkresën nr. 9/4 prot., datë 21.01.2022 |
| | | | Vlerësimi i riskut për mjedisin e përgjithshëm të kontrollit |
| | | | Vlerësimi i risqeve për sistemet/ fusha të veçanta të llogarisë |
| | | | Vlerësimi i përgjithshëm i riskut |
| | | | Ndarja e detyrave midis grupit të auditimit |
| | | | Programi i angazhimit të auditimit me shkresën nr. 9/5 prot., datë 21.01.2022 |
| | | | Testet individuale të Auditimit të Brendshëm (Pyetësorët) |
| | | | Shkresa përcjellëse e projekt raportit me nr. 9/6 prot., datë 21.01.2022 |
| | | | Projektraporti i auditimit |
| | | | Shkresa përcjellëse e raportit përfundimtar me nr. 9/7 prot., datë 20.04.2022 |
| | | | Raporti përfundimtar |
| | | | Memorandumi me shkresën nr. 9/8 prot., datë 26.04.2022 |
| | | | Plani i veprimit i sugjeruar |
| | | | Kundërshtitë (observacionet) |
| | | | Vlerësimi nga subjekti i audituar (Aneksi 2) |
| | | | Plani i veprimit i dërguar nga subjekti i audituar |
| | | | Aneksi 1: Lista e kontrollit për monitorimin e aktivitetit të AB-së |
| | | | Aneksi 1/1: Lista e kontrollit për monitorimin e aktivitetit të AB-së Vetëvlerësim nga çdo auditues |
| | | | Evidenca të tjera të auditimit; Fotokopje të dokumentacionit të institucionit; Shënime të audituesve |
| 5 | 2022 | Zbatim rekomandimesh Ujësjellës Kanalizime Sh.a Libohovë | Autorizimi me shkresën nr. 10 prot., datë 13.01.2022 |
| | | | Njoftim për fillimin e angazhimit të auditimit me shkresën nr. 10/1 prot., datë 13.01.2022 |
| | | | Programi i angazhimit të auditimit me shkresën nr. 10/2 prot., datë 21.01.2022 |
| | | | Shkresa përcjellëse e projekt raportit me nr. 10/3 prot., datë 15.03.2022 |
| | | | Projektraporti i auditimit |
| | | | Kundërshtitë (observacionet) |
| | | | Shkresa përcjellëse e raportit përfundimtar me nr. 10/4 prot., datë 25.03.2022 |
| | | | Raporti përfundimtar |
| | | | Evidenca të tjera të auditimit; Fotokopje të dokumentacionit të shoqërisë; Shënime të audituesve |

Burimi i të dhënave: Bashkia Libohovë.

Aneksë të drejtimit nr. 2, “Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit”.

Tabela nr. 1, nën-pika nr. 2.2.1. “Lista e investimeve të reja parashikuar në buxhetin vjetor të vitit 2022 nga të ardhurat e veta dhe granti”.

Në mijë lekë

| Nr. | Emërtimi i investimit | Numri dhe data e VKB | Burimi financimit | Vlera e miratuar në VKB | Vlera e realizuar e investimit (me TVSh) |
|-----|---|----------------------|--------------------|-------------------------|--|
| 1 | Hartim projektesh | 64 datë 29.12.2022 | Të ardhurat e veta | 250 | 250 |
| 2 | Mbikëqyrje dhe kolaudim projektesh | 64 datë 29.12.2022 | Të ardhurat e veta | 526 | 526 |
| 3 | Rikonstrukcion i vatrës së kulturës së fshatit Ndëran | 64 datë 29.12.2022 | Të ardhurat e veta | 500 | 500 |

| | | | | | |
|---------------------------------|---|-----------------------|--------------------|---------------|---------------|
| 4 | Restaurim i shtëpisë së Kulturës Libohovë | 64 datë 29.12.2022 | Të ardhurat e veta | 100 | 100 |
| 5 | Blerje pajisje zyra | 64 datë 29.12.2022 | Të ardhurat e veta | 50 | 50 |
| 6 | Blerje mjet pastrimi | 64 datë 29.12.2022 | Të ardhurat e veta | 9,744 | 9,744 |
| Total të ardhurat e veta | | | | 11,170 | 11,170 |
| 1 | Restaurim i çezmës së fshatit Nepravishtë | | Nga granti | 400 | 400 |
| 2 | Blerje tabelash sinjalistike vertikale | | Nga granti | 200 | 200 |
| Total nga granti | | | | 600 | 600 |

Burimi i të dhënave: Bashkia Libohovë.

Tabela nr. 2, nënpika nr. 2.2.1. “Planifikimi i detyrimeve të prapambetura në planin e vitit buxhetor 2022”.

Lekë

| Kodi i detyrimit të prapambetur | Emërimi i detyrimit të prapambetur | Deyrimi i prapambetur progresiv më 31.12.2021 | Planifikimi për likujdim në planin e buxhetit 2022 i vlerës së detyrimit të prapambetur | Pagesa në fakt gjatë vitit 2022 e detyrimit të prapambetur të planifikuar në planin e buxhetit |
|---------------------------------|---------------------------------------|---|---|--|
| 4864100 | Për vendime gjyqësore | - | - | - |
| 4864200 | Për shërbime | 77,081 | 77,081 | - |
| 4864300 | Për mirëmbajtje | 351,600 | 351,600 | - |
| 4864400 | Për investime | 5,270,041 | 5,270,041 | 2,782,599 |
| 4864400 | Për investime nga Ministritë e Linjës | - | - | - |
| 4865600 | Për mallra | - | - | - |
| 4864900 | Të tjera | - | - | - |
| Totali | | 5,698,722 | 5,698,722 | 2,782,599 |

Burimi i të dhënave: Bashkia Libohovë.

Tabela nr. 3, nënpika nr. 2.2.1. “Lista analitike e detyrimeve të prapambetura për investime më 31.12.2022 dhe planifikimi për likujdim në planin e këtij buxheti”.

Lekë

| Nr. | Emërtimi i objektit kontratës së pa likujduar | Data e lidhjes së kontratës | Vlera e pa likujduar e kontratës | Vlera e kontratës planifikuar për likujdim në planin e buxhetit 2022 | Pagesa në fakt gjatë vitit 2022 e detyrimit të kontratës | Vlera e pa likujduar më 31.12.2022 | Burimi i financimit |
|-----|--|-----------------------------|----------------------------------|--|--|------------------------------------|---------------------|
| 1 | Rikonstruksion dhe ndërtim palestre në shkollën 9-vjeçare Avni Rustemi, Libohovë | 07.12.2018 | 4,402,429 | 2,175,387 | 2,175,387 | 2,227,042 | Granti |
| 2 | Rehabilitimi i çezmës të rezervuarit Sheper, Zagorie | 30.12.2020 | 99,600 | 99,600 | 99,600 | 0 | Granti |
| 3 | Rehabilitimi i çezmës të rezervuarit Stegopol | 30.12.2020 | 99,600 | 99,600 | 99,600 | 0 | Granti |
| 4 | Rehabilitimi i murit mbajtës të çezmës Gugumi, Nivan, Zagorie | 31.12.2020 | 97,200 | 97,200 | 97,200 | 0 | Granti |
| 5 | Rikonstruksion i murit të varrezave Libohovë | 21.12.2020 | 270,382 | 270,382 | - | 270,382 | Granti |
| 6 | Rikonstruksion i murit mbajtës të shkollës 9-vjeçare Labovë e Poshtme | 21.12.2020 | 48,000 | 48,000 | - | 48,000 | Granti |
| 7 | Rikonstruksion banese | 28.12.2021 | 166,200 | 166,200 | - | 166,200 | Të ardhura të veta |

Burimi i të dhënave: Bashkia Libohovë.

Tabela nr. 4, nënpika nr. 2.2.4. Të dhëna për detyrimet e prapambetura më 31.12.2022, për Bashkinë Libohovë, e darë sipas burimit të financimit të planifikuar për shlyerje:

a) me burim financimi të planifikuar për shlyerje nga të ardhurat e veta (taksat dhe tarifat vendore, qiratë)ë b) të planifikuar për shlyerje me burim financimi nga transfertat e pa kushtëzuar:

Lekë

| Kodi i detyrimit të prapambetur | Emërimi i detyrimit të prapambetur | Detyrimi prapambetur progresiv më 31.12.2021 | Vlera e planifikuar për likuidim në planin e buxhetit 2022 për detyrimet e prapambetura | Vlera e paguar gjatë vitit 2022 për detyrimin e prapambetur (vlera e paguar për kolonën 3) | Vlera e detyrimeve të trashëguara të pa paguara më 31.12.2022 (pa detyrimet e krijuara gjatë 2022) | Detyrim i prapambetur i krijuar vetëm gjatë vitit 2021 (situata më 31.12.2022) | Vlera totale e detyrimeve të prapambetura më 31.12.2022 |
|--|--|--|---|--|--|--|---|
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6=3-5 | 7 | 8=6+7 |
| I. Detyrime që kanë si burim financimi nga të ardhurat e veta nga taksat dhe tarifat vendore, qiratë. | | | | | | | |
| 4864100 | Detyrime për vendime gjyqësore | 0 | 0 | 0 | 0 | 600,000 | 600,000 |
| 4864200 | Detyrime për shërbime | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 4864300 | Detyrime për mirëmbajtje | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 4864400 | Detyrime për investime | 0 | 0 | 0 | 0 | 166,200 | 166,200 |
| 4865600 | Detyrime për mallra | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 4864900 | Detyrime të tjera | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | Totali i detyrimeve që kanë si burim financimi të ardhurat e veta | 0 | 0 | 0 | 0 | 766,200 | 766,200 |
| II. Detyrime të prapambetura me burim financimi transfertat e pa kushtëzuara | | | | | | | |
| | | 0 | 0 | 0 | 0 | 13,985,976 | 13,985,976 |
| 4864200 | Detyrime për Investime nga Ministrinë e Linjës MIE | 77,081 | 77,081 | 0 | 77,081 | 10,841,537 | 10,918,618 |
| 4864300 | Detyrime për vendime gjyqësore (MB për punonjës të Gjendjes Civile) | 351,600 | 351,600 | 0 | 351,600 | 384,220 | 735,820 |
| 4864400 | Detyrime për investime | 5,270,041 | 5,270,041 | 2,782,599 | 2,487,442 | 0 | 2,487,442 |
| | Totali i detyrimeve që kanë si burim financimi Grantin | 5,698,722 | 5,698,722 | 2,782,599 | 2,916,123 | 25,211,733 | 28,127,856 |
| Detyrime në total nga të ardhurat e veta + granti | | 5,698,722 | 5,698,722 | 2,782,599 | 2,916,123 | 25,977,933 | 28,894,056 |

Burimi i të dhënave: Bashkia Libohovë.

Tabela nr. 5, nënpika nr. 2.2.4. “Të dhëna për detyrimet e prapambetura më 31.12.2022, për Bashkinë Libohovë, në mënyrë të përmblëdhur, me burim financimi të planifikuara për shlyerje nga të ardhurat e veta (taksat dhe tarifat vendore, qiratë), si dhe nga transfertat e pa kushtëzuara:

| Kodi i detyrimit të prapambetur | Emërimi i detyrimit të prapambetur | Detyrimi prapambetur progresiv më 31.12.2021 | Vlera e paguar gjatë vitit 2022 për detyrimin e prapambetur (vlera e paguar për kolonën 3) | Vlera e detyrimeve të trashëguara të pa paguara më 31.12.2022 (pa detyrimet e krijuara gjatë 2022) | Detyrim i prapambetur i krijuar vetëm gjatë vitit 2021 (situata më 31.12.2022) | Vlera totale e detyrimeve të prapambetura më 31.12.2022 |
|--|------------------------------------|--|--|--|--|---|
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5=3-4 | 6 | 7=5+6 |
| Detyrimet me burim financimi nga të ardhurat e veta, përfshirë dhe transfertat e pa kushtëzuara | | | | | | |
| | Shërbime | 77,081 | | 77,081 | 10,841,537 | 10,918,618 |
| | Mirëmbajtje | 351,600 | | 351,600 | 384,220 | 735,820 |
| | Vendime gjyqësore | - | - | - | 14,585,976 | 14,585,976 |

| | | | | | | |
|---|--------------------------|------------------|------------------|------------------|-------------------|-------------------|
| | Investime | 5,270,041 | 2,782,599 | 2,487,442 | 166,200 | 2,653,642 |
| | Shërbime | 77,081 | | 77,081 | 10,841,537 | 10,918,618 |
| | Detyrime ne total | 5,698,722 | 2,782,599 | 2,916,123 | 25,977,933 | 28,894,056 |
| Shënim: Bashkia Libohovë nuk ka detyrime të cilat financohen nga granti i kushtëzuar qeveritar | | | | | | |

Lekë

Burimi i të dhënave: Bashkia Libohovë.

Tabela nr. 6, nënpika nr. 2.2.4. “Faturat e pa likuiduara në datën 31.12.2022 për investimet nga të ardhurat e veta”.

Lekë

| Nr. | Emërtimi i i Objektivit | Emërtimi i Subjektit | Data e lidhjes së kontratës | Numri dhe data e faturës | Numër serial fature | Vlera e kredisë (detyrimit) në 31.12.2021 | Shtesat gjatë vitit 2022 | Shlyerjet gjatë vitit 2022 | Vlera e detyrimit me 31.12.2022 |
|---------------|-------------------------|----------------------|-----------------------------|--------------------------|---------------------|---|--------------------------|----------------------------|---------------------------------|
| 1 | Rikonstruksion Banese | V | 28.12.2021 | 28.12.2021 | - | 0 | 166,200 | 0 | 166,200 |
| Totali | | | | | | | 166,200 | 0 | 166,200 |

Burimi i të dhënave: Bashkia Libohovë.

Tabela nr. 7, nënpika nr. 2.2.4. “Faturat e pa likuiduara në datën 31.12.2022 për investimet nga granti”.

Lekë

| Nr. | Emërtimi i i Objektivit | Emërtimi i Subjektit | Data e lidhjes së kontratës | Numri dhe data e faturës | Numër serial fature | Vlera e kredisë (detyrimit) në 31.12.2021 | Shtesat gjatë vitit 2022 | Shlyerjet gjatë vitit 2022 | Vlera e detyrimit me 31.12.2022 |
|---------------|---|----------------------|-----------------------------|--------------------------|---------------------|---|--------------------------|----------------------------|---------------------------------|
| 1 | Rikonstruksion i rrugëve të brendshme të fshatit Suhe | B | 04.12.2017 | - | - | 138,000 | 0 | 0 | 138,000 |
| 2 | Rikonstruksion i ujësjellësave Zagorie | | 13.11.2017 | - | - | 74,400 | 0 | 0 | 74,400 |
| 3 | Rikonstruksion i rrugës “Kthesë e Nepravishtës-Fushë Nepravishtë” | A | 03.09.2018 | - | - | 40,430 | 0 | 40,430 | 0 |
| 4 | Rikonstruksion dhe ndërtim palestere në shkollën 9-vjeçare Avni Rustemi, Libohovë | BOE | 07.12.2018 | - | - | 4,402,429 | 0 | 2,176,387 | 2,227,042 |
| 5 | Rehabilitimi i çezmës të rezervuarit Sheper, Zagorie | T | 30.12.2020 | - | - | 99,600 | 0 | 99,600 | 0 |
| 6 | Rehabilitimi i çezmës të rezervuarit Stegopol | T | 30.12.2020 | - | - | 99,600 | 0 | 99,600 | 0 |
| 7 | Rehabilitimi i murit mbajtës të çezmës Gugumi, Nivan, Zagorie | T | 31.12.2020 | - | - | 97,200 | 0 | 97,200 | 0 |
| 8 | Rikonstruksion i murit të varrezave Libohovë | T | 21.12.2020 | - | - | 270,382 | 0 | 270,382 | 0 |
| 9 | Rikonstruksion i murit mbajtës të shkollës 9-vjeçare Labovë e Poshtme | C | 21.12.2020 | - | - | 48,000 | 0 | 0 | 48,000 |
| 10 | Rikonstruksion Banese | V | 28.12.2021 | - | - | 0 | 166,200 | 0 | 166,200 |
| Totali | | | | | | 5,270,041 | 166,200 | 2,783,599 | 2,653,642 |

Burimi i të dhënave: Bashkia Libohovë.

Tabela nr. 8, nënpika nr. 2.2.6. “Kontrata për dhënie me qira të pyjeve dhe kullotave për vitin 2021”.

Lekë

| Viti 2021 | | | | | | | | | |
|-----------|--------------|-----------------------------|-------------------|----------|------------------|--------------|--------|-----------|-----------|
| Nr. | Emër Mbiemër | Data e lidhjes së kontratës | Afati i kontratës | Vendi | Numri i parcelës | Sipërfaqe ha | Çmimi | Likuiduar | Diferencë |
| 1 | P.G | 14.05 | 01.06-30.11 | Libohovë | 6 | 184.06 | 66,500 | 66,500 | 0 |
| 2 | L.D | 31.05 | 01.06-30.11 | Libohovë | 18, 19, 20 | 280.78 | 53,050 | 53,050 | 0 |
| 3 | M.N | 08.06 | 01.06-30.11 | Zagori | JFK | 105 | 67,900 | 67,900 | 0 |
| 4 | P.Z | 15.06 | 01.06-30.11 | Libohovë | 4 | 85.52 | 1,600 | 1,600 | 0 |
| 5 | V.M | 15.06 | 01.06-30.11 | Libohovë | 3 | 73.85 | 24,900 | 24,900 | 0 |
| 6 | TH.D | 06.07 | 01.06.-30.11 | Lunxhëri | 54,56 | 240,38 | 67,100 | 67,100 | 0 |

124

| | | | | | | | | | |
|---------------|------|-------|----------------|----------|-------------|-----------------|----------------|----------------|----------|
| 7 | P.K | 15.07 | 01.06-30.11 | Lunxhëri | 92a, 92b | 43.39 | 4,300 | 4,300 | 0 |
| 8 | L.H | 17.09 | 01.12-31.05.22 | Libohovë | J.F.K | 7 | 4,100 | 4,100 | 0 |
| 9 | E.N | 22.09 | 01.12-31.05 | Lunxhëri | 52, 1/3 | 15 | 4,000 | 4,000 | 0 |
| 10 | E.I | 01.11 | 01.12-31.05 | Libohovë | JFK | 10 | 5,000 | 5,000 | 0 |
| 11 | M.M | 02.11 | 01.12-31.05 | Libohovë | 5, 1/3 | 12 | 4,300 | 4,300 | 0 |
| 12 | K.Z | 02.11 | 01.12-31.05 | Libohovë | 5, 1/3 | 12 | 4,300 | 4,300 | 0 |
| 13 | P.Z | 02.11 | 01.12-31.05 | Libohovë | 5, 1/3 | 11.94 | 2,200 | 2,200 | 0 |
| 14 | R.B | 02.11 | 01.12-31.05 | Libohovë | 13 | 145.46 | 14,600 | 14,600 | 0 |
| 15 | V.L | 08.11 | 01.12-31.05 | Lunxhëri | JFK,182/2/1 | 46.15 | 44,500 | 44,500 | 0 |
| 16 | N.T | 08.11 | 01.12-31.05 | Libohovë | 21a | 17.7 | 2,000 | 2,000 | 0 |
| 17 | Th.D | 04.11 | 01.12-31.05 | Lunxhëri | 50 | 74.5 | 32,000 | 32,000 | 0 |
| 18 | Kh.I | 09.11 | 01.12-31.05 | Lunxhëri | Jfk | 12 | 3,600 | 3,600 | 0 |
| 19 | R.L | 09.11 | 01.12-31.05 | Libohovë | 8 | 30.98 | 15,500 | 15,500 | 0 |
| 20 | P.Ç | 16.11 | 01.12-31.05 | Libohovë | JFk | 10 | 1,000 | 1,000 | 0 |
| 21 | A.T | 16.11 | 01.12-31.05 | Libohovë | 11 | 18 | 5,400 | 5,400 | 0 |
| 22 | A.T | 16.11 | 01.12-31.05 | Libohovë | 11 | 36 | 10,800 | 10,800 | 0 |
| 23 | V.R | 17.11 | 01.12-31.05 | Libohovë | 11 | 63 | 29,000 | 29,000 | 0 |
| 24 | J.P | 17.11 | 01.12-31.05 | Libohovë | 9 | 15 | 7,000 | 7,000 | 0 |
| 25 | Z.I | 19.11 | 01.12-31.05 | Libohovë | JFK | 39.7 | 11,200 | 11,200 | 0 |
| 26 | P.K | 04.12 | 01.12-31.05 | Lunxhëri | 51, 55, 88 | 114.8 | 29,100 | 29,100 | 0 |
| 27 | I.L | 16.12 | 01.12-31.05 | Libohovë | Jfk | 4.3 | 1,300 | 1,300 | 0 |
| 28 | V.M | 27.12 | 01.12-31.05 | Libohovë | 1, 1/3 | 17 | 8,400 | 8,400 | 0 |
| 29 | K.Q | 24.12 | 01.12-31.05 | Libohovë | 1, 2/3 | 33.4 | 16,800 | 16,800 | 0 |
| 30 | K.L | 30.12 | 01.12-31.05 | Lunxhëri | 57 | 50.21 | 12,800 | 12,800 | 0 |
| Totali | | | | | | 1,690.52 | 554,250 | 554,250 | 0 |

Burimi i të dhënave: Bashkia Libohovë.

Tabela nr. 9, nënpika nr. 2.2.6. “Kontrata për dhënie me qira të pyjeve dhe kullotave për vitin 2022”.

Lekë

| Viti 2022 | | | | | | | | | |
|---------------|--------------|-----------------------------|-------------------|----------|------------------|--------------------------|----------------|----------------|-----------|
| Nr. | Emër Mbiemër | Data e lidhjes së kontratës | Afati i kontratës | Vendi | Numri i parcelës | Sipërfaqe m ² | Çmimi | Likuiduar | Diferencë |
| 1 | G.T | 02.12 | 01.12-31.05 | Libohovë | 12 | 40 | 6,400 | 6,400 | 0 |
| 2 | V.M | 16.05 | 01.06-30.11 | Libohovë | 3 | 73.85 | 24,100 | 24,100 | 0 |
| 3 | P.K | 13.06 | 01.06-30.11 | Lunxhëri | 92a92b | 43.39 | 4,300 | 4,300 | 0 |
| 4 | M.N | 27.06 | 01.06-30.11 | Zagorie | J.F.K | 115 | 53,050 | 53,050 | 0 |
| 5 | TH.D | 13.07 | 01.06-30.11 | Lunxhëri | 54,56,58 | 240.38 | 67,100 | 67,100 | 0 |
| 6 | A.R | 20.07 | 01.06-30.11 | Libohovë | 6 | 184.06 | 66,000 | 66,000 | 0 |
| 7 | L.H | 21.09 | 01.12-31.05 | Libohovë | J.F.K | 7 | 4,100 | 4,100 | 0 |
| 8 | A.T | 05.10 | 01.12-31.05 | Libohovë | 11 | 36 | 10,800 | 10,800 | 0 |
| 9 | A.T | 05.10 | 01.12-31.05 | Libohovë | 11 | 18 | 5,400 | 5,400 | 0 |
| 10 | A.R | 14.10 | 01.12-31.05 | Libohovë | JFK | 39.7 | 11,200 | 11,200 | 0 |
| 11 | G.T | 31.10 | 01.12-31.05 | Libohovë | 12 | 40 | 6,400 | 6,400 | 0 |
| 12 | E.I | 31.10 | 01.12-31.05 | Libohovë | JFK | 10 | 5,000 | 5,000 | 0 |
| 13 | K.Z | 31.10 | 01.12-31.05 | Libohovë | 5 | 12 | 4,300 | 4,300 | 0 |
| 14 | P.Z | 31.10 | 01.12-31.05 | Libohovë | 5 | 10 | 2,200 | 2,200 | 0 |
| 15 | M.M | 31.10 | 01.12-31.05 | Libohovë | 5 | 12 | 4,300 | 4,300 | 0 |
| 16 | TH.D | 02.11 | 01.12-31.05 | Lunxhëri | 50 JFK | 83.6 | 27,000 | 27,000 | 0 |
| 17 | V.R | 02.11 | 01.12-31.05 | Libohovë | 11 | 63 | 29,000 | 29,000 | 0 |
| 18 | V.R | 03.11 | 01.12-31.05 | Libohovë | 11 | 7 | 2,100 | 2,100 | 0 |
| 19 | J.P | 03.11 | 01.12-31.05 | Libohovë | 9 | 15 | 7,000 | 7,000 | 0 |
| 20 | R.B | 03.11 | 01.12-31.05 | Libohovë | 13 | 145.46 | 14,600 | 14,600 | 0 |
| 21 | V.M | 21.11 | 01.12-31.05 | Libohovë | 1 | 17 | 8,400 | 8,400 | 0 |
| 22 | P.K | 21.11 | 01.12-31.05 | Lunxhëri | 51,55,88 | 114.08 | 29,100 | 29,100 | 0 |
| 23 | V.L | 22.11 | 01.12-31.05 | Lunxhëri | J.F.K | 46.15 | 44,500 | 44,500 | 0 |
| 24 | P.G | 24.11 | 01.12-31.05 | Libohovë | J.F.K | 11.05 | 13,300 | 13,300 | 0 |
| 25 | Nj.T | 07.12 | 01.12-31.05 | Libohovë | J.F.K | 96 | 10,800 | 10,800 | 0 |
| 26 | K.L | 13.12 | 01.12-31.05 | Lunxhëri | 57 | 70.21 | 22,200 | 22,200 | 0 |
| 27 | A.C | 13.12 | 01.12-31.05 | Lunxhëri | JFK | 4.6 | 2,000 | 2,000 | 0 |
| 28 | K.Q | 27.12 | 01.12-31.05 | Libohovë | 1 | 33.4 | 16,800 | 16,800 | 0 |
| 29 | S.I | 28.12 | 01.12-31.05 | Libohovë | JFK | 6 | 1,500 | 1,500 | 0 |
| 30 | I.L | 22.12 | 01.12-31.05 | Libohovë | JFK | 4.3 | 1,300 | 1,300 | 0 |
| Totali | | | | | | 1598.23 | 504,250 | 504,250 | 0 |

Burimi i të dhënave: Bashkia Libohovë.

Tabela nr. 10, nënpika nr. 2.2.6. “Kontrata për dhënie me qira të tokave bujqësore për vitin 2021”.

Lekë

| Viti 2021 | | | | | | | | | | | |
|---------------|--------------|----------|-----------------------------|--------------------------|-------|----------------|----------------|----------------|---------------|---------------|------------------|
| Nr. | Emër Mbiemër | NJA | Data e lidhjes së kontratës | Sipërfaqe m ² | Çmimi | Shuma në vite | Viti 2021 | Likuiduar | Debitor | Kamatëvonesa | Debitor në total |
| 1 | E.D | Zagori | 23.10.2017 | 13.29 | 6,000 | 79,740 | 79,740 | 79,740 | 0 | 0 | 0 |
| 2 | V.S | Zagori | 21.11.2018 | 0.92 | 6,000 | 5,520 | 5,520 | 5,520 | 0 | 0 | 0 |
| 3 | K.K | Zagori | 21.01.2019 | 3.64 | 6,000 | 21,840 | 21,840 | 0 | 21,840 | 4,783 | 26,623 |
| 4 | J.Z | Zagori | 07.05.2019 | 3.7 | 6,000 | 22,200 | 22,200 | 22,200 | 0 | 0 | 0 |
| 5 | A.K | Zagori | 02.01.2020 | 17.5 | 6,000 | 105,000 | 105,000 | 105,000 | 0 | 0 | 0 |
| 6 | A.K | Zagori | 27.01.2020 | 0.97 | 6,000 | 5,820 | 5,820 | 0 | 5,820 | 1,275 | 70,95 |
| 7 | S.P | Zagori | 13.02.2020 | 7.58 | 6,000 | 45,480 | 45,480 | 0 | 45,480 | 9,960 | 55,440 |
| 8 | V.V | Qendër | 31.07.2020 | 1.78 | 6,000 | 10,680 | 10,680 | 10,680 | 0 | 0 | 0 |
| 9 | M.T | Libohovë | 10.11.2020 | 0.44 | 6,000 | 2,640 | 2,640 | 2,640 | 0 | 0 | 0 |
| 10 | P.M | Qendër | 07.12.2020 | 2 | 6,000 | 12,000 | 12,000 | 12,000 | 0 | 0 | 0 |
| 11 | S.I | Qendër | 29.12.2020 | 0.155 | 6,000 | 930 | 930 | 930 | 0 | 0 | 0 |
| 12 | B.Q | Zagori | 05.05.2020 | 7.72 | 6,000 | 46,320 | 46,320 | 46,320 | 0 | 0 | 0 |
| Totali | | | | 59,659 | | 358,170 | 358,170 | 285,030 | 73,140 | 16,017 | 89,157 |

Burimi i të dhënave: Bashkia Libohovë.

Tabela nr. 11, nënpika nr. 2.2.6. “Kontrata për dhënie me qira të tokave bujqësore për vitin 2022”.

Lekë

| Viti 2022 | | | | | | | | | | | |
|-------------------------|--------------|----------|-----------------------------|--------------------------|-------|----------------|----------------|----------------|----------------|---------------|------------------|
| Nr. | Emër Mbiemër | NJA | Data e lidhjes së kontratës | Sipërfaqe m ² | Çmimi | Shuma në vite | Viti 2022 | Likuiduar | Debitor | Kamatëvonesa | Debitor në total |
| 1 | E.D | Zagori | 23.10.2017 | 13.29 | 6,000 | 79,740 | 79,740 | 79,740 | 0 | 0 | 0 |
| 2 | V.S | Zagori | 21.11.2018 | 0.92 | 6,000 | 5,520 | 5,520 | 5,520 | 0 | 0 | 0 |
| 3 | K.K | Zagori | 21.01.2019 | 3.64 | 6,000 | 21,840 | 21,840 | 0 | 21,840 | 4,783 | 26,623 |
| 4 | J.Z | Zagori | 07.05.2019 | 3.7 | 6,000 | 22,200 | 22,200 | 22,200 | 0 | 0 | 0 |
| 5 | A.K | Zagori | 02.01.2020 | 17.5 | 6,000 | 105,000 | 105,000 | 0 | 105,000 | 22,995 | 127,995 |
| 6 | A.K | Zagori | 27.01.2020 | 0.97 | 6,000 | 5,820 | 5,820 | 0 | 5,820 | 1,275 | 7,095 |
| 7 | S.P | Zagori | 13.02.2020 | 7.58 | 6,000 | 45,480 | 45,480 | 0 | 45,480 | 9,960 | 55,440 |
| 8 | V.V | Qendër | 31.07.2020 | 1.78 | 6,000 | 10,680 | 10,680 | 0 | 10,680 | 2,339 | 13,019 |
| 9 | M.T | Libohovë | 10.11.2020 | 0.44 | 6,000 | 2,640 | 2,640 | 2,640 | 0 | 0 | 0 |
| 10 | P.M | Qendër | 07.12.2020 | 2 | 6,000 | 12,000 | 12,000 | 12,000 | 0 | 0 | 0 |
| 11 | S.I | Qendër | 29.12.2020 | 0.155 | 6,000 | 930 | 930 | 930 | 0 | 0 | 0 |
| Totali 2022 | | | | 51,975 | | 311,850 | 311,850 | 123,030 | 188,820 | 41,352 | 230,172 |
| Totali 2021 | | | | | | 358,170 | 358,170 | 285,030 | 73,140 | 16,017 | 89,157 |
| Totali 2021-2022 | | | | | | 670,020 | 670,020 | 408,060 | 261,960 | 57,369 | 319,329 |

Burimi i të dhënave: Bashkia Libohovë.

Tabela nr. 12, nënpika nr. 2.2.6. “Kontrata për dhënie me qira të ndërtesave/objekteve për vitet 2021-2022”.

Lekë

| Nr. | Emër Mbiemër | NJA | Data e lidhjes së kontratës | Sipërfaqe m ² | Çmi mi | Viti 2021 | Likuiduar | Debitor | Kamatëvonesa | Debitor në total |
|-------------------------|--------------|--------|-----------------------------|--------------------------|-------------------|---------------|---------------|----------|--------------|------------------|
| 1 | S.L | Qendër | 09.07.2021 | 8m ² | 50/m ² | 4,800 | 4,800 | 0 | 0 | 0 |
| 2 | K.M | Qendër | 26.05.2021 | 40m ² | 50/m ² | 24,000 | 24,000 | 0 | 0 | 0 |
| Totali 2021 | | | | 48m² | | 28,800 | 28,800 | 0 | 0 | 0 |
| Nr. | Emër Mbiemër | NJA | Data e lidhjes së kontratës | Sipërfaqe m ² | Çmi mi | Viti 2022 | Likuiduar | Debitor | Kamatëvonesa | Debitor në total |
| 2 | S.L | Qendër | 20.06.2022 | 8m ² | 50/m ² | 4,800 | 4,800 | 0 | 0 | 0 |
| Totali 2022 | | | | 8m² | | 4,800 | 4,800 | 0 | 0 | 0 |
| Totali 2021-2022 | | | | | | 33,600 | 33,600 | 0 | 0 | 0 |

Burimi i të dhënave: Bashkia Libohovë.

Tabela nr. 13, nënpika nr. 2.2.6. “Kontrata për dhënie me qira të hapësirave/sipërfaqeve për vendosjen e antenave telefonike për vitet 2021-2022”.

Lekë

| Nr. | Kompani telefonike | NJA | Data e lidhjes së kontratës | Sipërfaqe m ² | Çmimi | Viti 2021 | Likuiduar | Debitor | Kamatëvonesa | Debitor në total |
|-------------------------|--------------------|--------|-----------------------------|--------------------------|------------------|------------------|------------------|----------|--------------|------------------|
| 1 | T | Zagori | 29.01.2016 | 200m ² | 300,000 | 300,000 | 300,000 | 0 | 0 | 0 |
| 2 | A | Zagori | 01.04.2017 | 200m ² | 220,000 | 220,000 | 220,000 | 0 | 0 | 0 |
| 3 | V | Zagori | 09.12.2021 | 20m ² | 150,000 | 150,000 | 150,000 | 0 | 0 | 0 |
| Totali 2021 | | | | 440m² | 670,000 | 670,000 | 670,000 | 0 | 0 | 0 |
| Nr. | Kompani telefonike | NJA | Data e lidhjes së kontratës | Sipërfaqe m ² | Çmimi | Viti 2022 | Likuiduar | Debitor | Kamatëvonesa | Debitor në total |
| 1 | T | Zagori | 29.01.2016 | 200m ² | 300,000 | 300,000 | 300,000 | 0 | 0 | 0 |
| 2 | A | Zagori | 01.04.2017 | 200m ² | 220,000 | 220,000 | 220,000 | 0 | 0 | 0 |
| 3 | V | Zagori | 09.12.2021 | 20m ² | 150,000 | 150,000 | 150,000 | 0 | 0 | 0 |
| Totali 2022 | | | | 440m² | 670,000 | 670,000 | 670,000 | 0 | 0 | 0 |
| Totali 2021-2022 | | | | 880m² | 1,340,000 | 1,340,000 | 1,340,000 | 0 | 0 | 0 |

Burimi i të dhënave: Bashkia Libohovë.

Tabela nr. 14, Lista e debitorve progresiv per bizneset deri 31.12.2022:

| Nr. | Emer Mbiemer | Nipti | Aktiviteti | Adresa | Debia deri 31.12.2022 Shuma ne leke |
|-----|--------------|-------|-----------------------|----------|--|
| 1 | V.R | | Tregeti ushqimore | Libohove | 375157 |
| 2 | H.T | | Furre buke | Libohove | 153600 |
| 3 | K.H | | Dyqan ushqimor | Libohove | 50650 |
| 4 | B.R | | Berber | Libohove | 167000 |
| 5 | Dh.L | | Klub | Libohove | 224569 |
| 6 | E.T | | Bar Kafe | Libohove | 182983 |
| 7 | F.H | | Floktore | Libohove | 186135 |
| 8 | T.I | | Tregeti me pakice | Libohove | 160672 |
| 9 | B.T | | Qender interneti | Libohove | 105100 |
| 10 | O.M | | Floktore | Libohove | 175250 |
| 11 | Sh.B | | Dyqan ushqimore | Libohove | 252201 |
| 12 | A.F | | Autoservis | Libohove | 261900 |
| 13 | K.B | | Bar-kafe | Libohove | 180350 |
| 14 | S.B | | Dyqan ushqimor | Libohove | 177625 |
| 15 | A.R | | Tregeti me pakice | Libohove | 178936 |
| 16 | F.B | | Kovacan | Libohove | 185375 |
| 17 | H.Sh | | Bime Medicinale | Libohove | 16060 |
| 18 | D.Sh | | Bar-kafe | Libohove | 17518 |
| 19 | D.B | | Bar-kafe | Libohove | 12120 |
| 20 | D.K | | Dyqan ushqimor | Libohove | 141725 |
| 21 | Sh.B | | Punime duralumini | Libohove | 214327 |
| 22 | S | | Baxho | Libohove | 299593 |
| 23 | M.K | | Trasport mater nderti | Libohove | 16361 |
| 24 | L.K | | Furre buke | Libohove | 31514 |
| 25 | A. | | Qender interneti | Libohove | 20382 |
| 26 | E.M | | Bar kafe | Libohove | 50000 |
| 27 | F.R | | Bar kafe | Libohove | 50000 |
| 28 | S.P | | Bar kafe | Libohove | 41660 |
| 29 | H.Z | | Fur buke | Libohove | 50000 |
| 30 | S.C | | Dyqan ushqimor | Libohove | 47800 |
| 31 | I. | | Marangozi | Libohove | 236600 |
| 32 | N.H | | Kafene | Libohove | 115575 |
| 33 | V.R | | Rrobaqepsi | Libohove | 147409 |
| 34 | S.H | | Rrobaqepsi | Libohove | 64300 |
| 35 | D.B | | Floktore | Libohove | 55829 |

| | | | | | |
|----|------|--|---------------------|-----------|------------------|
| 36 | L.B | | Industriale | Libohove | 155392 |
| 37 | L.B | | Bilardo | Libohove | 138957 |
| 38 | E.M | | Marangozi | Libohove | 50244 |
| 39 | T.P | | Dyqan ushqimor | Libohove | 50000 |
| 40 | A.I | | | Libohove | 25000 |
| 41 | A.P | | Duralumin | Libohove | 50000 |
| 42 | A.R | | Bar-kafe | Libohove | 50000 |
| 43 | G.C | | Bar-kafe | Libohove | 29167 |
| 44 | A.Sh | | Materiale ndertimi | Libohove | 25000 |
| 45 | L.I | | Tregeti e pergjith. | Libohove | 25000 |
| 46 | P.S | | Farmaci | Libohove | 12500 |
| 47 | F.R | | Bar-resorant | Libohove | 25000 |
| 48 | A.F | | Auto-servis | Libohove | 25000 |
| 49 | E.I | | Bar-Kafe | Libohove | 25000 |
| 50 | S.S | | Farmaci | Libohove | 7745 |
| 51 | A.B | | | NJ.Qender | 32587 |
| 52 | K.M | | | NJ.Qender | 6000 |
| 53 | G.P | | Kultivim peshku | NJ.Qender | 32587 |
| 54 | G.Zh | | Kultivim peshku | NJ.Qender | 32587 |
| 55 | R.D | | Klub | NJ.Qender | 5400 |
| 56 | A.D | | Baxho | NJ.Zagori | 115000 |
| 57 | V.D | | Baxho | NJ.Zagori | 142900 |
| 58 | E.K | | Baxho | NJ.Zagori | 67254 |
| | | | | | 5,770,905 |

Burimi i të dhënave: Bashkia Libohovë.

Anekse të drejtimit nr. 3, “Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin nëse pasqyrat financiare për vitin 2022, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi”.

Tabela nr. 1, nën-pika 2.3.2. “Lista e debitorëve për llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm”.

Lekë

| Emër Mbiemër | Detyrimi më 31.12.2021 | Paguar gjatë 2022 | Detyrimi me 31.12.2022 | Arsyeja |
|--------------|------------------------|-------------------|------------------------|--------------------|
| L.T | 8,500 | | 8,500 | Diferencë arke |
| L.J | 789 | | 789 | |
| P.B | 1,451 | | 1,451 | |
| L.Zh | 11,502 | | 11,502 | |
| S.B | 1,600 | | 1,600 | |
| A.A | 8,587 | | 8,587 | |
| D.Z | 138 | | 138 | Tatim në burim |
| R.T | 2,400 | | 2,400 | Tatim në burim |
| K.Z | 600 | | 600 | Tatim në burim |
| L.I | 7,500 | | 7,500 | Tatim në burim |
| B.B | 3,525 | | 3,525 | Tatim në burim |
| T.P | 150 | | 150 | Tatim në burim |
| N.L | 225 | | 225 | Tatim në burim |
| A | 166,530 | | 166,530 | Punime të pakryera |
| K.K | 10,000 | | 10,000 | Gjobë |
| N.Sh | 10,000 | | 10,000 | Gjobë |
| J.Q | 10,000 | | 10,000 | Gjobë |
| H.H | 10,000 | | 10,000 | Gjobë |
| P.P | 11,070 | | 11,070 | |
| F.K | 1,010 | | 1,010 | |
| A.B | 26,410 | | 26,410 | |
| R.H | 10,000 | | 10,000 | |
| F.Sh | 4,749 | | 4,749 | |

| | | | | |
|-----------------|---------|--|---------|--|
| A.K | 1,337 | | 1,337 | |
| B | 979,622 | | 979,622 | |
| K.P | 838 | | 838 | |
| A.K | 1,000 | | 1,000 | |
| G.A | 739 | | 739 | |
| B.K | 1,000 | | 1,000 | |
| S.S | 1,000 | | 1,000 | |
| L.Ç | 1,000 | | 1,000 | |
| N.Gj | 1,000 | | 1,000 | |
| A.G | 1,000 | | 1,000 | |
| J.K | 1,000 | | 1,000 | |
| J.Xh. | 1,000 | | 1,000 | |
| T.B | 13,825 | | 13,825 | |
| V.Ç | 2,000 | | 2,000 | |
| J.Xh | 8,250 | | 8,250 | |
| I.Dh | 1,000 | | 1,000 | |
| E | 27,600 | | 27,600 | |
| D.Z | 14,149 | | 14,149 | |
| V.N | 24,752 | | 24,752 | |
| V.N | 1,000 | | 1,000 | Diferencë në pagesat e kryera për marrje me qira të sipërfaqeve kullosore |
| Posta Shqiptare | 15,600 | | 15,600 | Mos firmosja e listëpagesave nga J.C, Th.Q, Th.D, L.P, J.Q |
| | 41,200 | | 41,200 | Shumë e xhiruar më tepër në vitin 2012, Komuna Zagorie |
| L.B | 13,416 | | 13,416 | Pagesë për pritje e përcjellje në kundërshtim me VKM nr. 243, për aktivitete kulturore |
| F.C | 369,800 | | 369,800 | Detyrime të kontartave kullosore Zagorie |
| B.B | 222,000 | | 222,000 | Detyrime të kontartave kullosore Zagorie |
| I.N | 240,000 | | 240,000 | Detyrime të kontartave kullosore Zagorie |
| Th.G | 156,000 | | 156,000 | Detyrime të kontartave kullosore Zagorie |
| Sh.H | 58,350 | | 58,350 | Detyrime te kontartave kullosore Zagorie |
| M.C | 34,848 | | 34,848 | Përfitim të padrejtë të pagës së këshilltarit për punë të pakryer |
| F.M | 49,336 | | 49,336 | Përfitim të padrejtë të pagës së këshilltarit për punë të pakryer |
| D.P | 44,550 | | 44,550 | Përfitim të padrejtë të pagës së këshilltarit për punë të pakryer |
| M.Ç | 19,899 | | 19,899 | Përfitim të padrejtë të pagës së këshilltarit për punë të pakryer |
| Li.Q | 34,568 | | 34,568 | Përfitim të padrejtë të pagës së këshilltarit për punë të pakryer |
| H.H | 19,899 | | 19,899 | Përfitim të padrejtë të pagës së këshilltarit për punë të pakryer |
| A.Sh | 19,356 | | 19,356 | Përfitim të padrejtë të pagës së këshilltarit për punë të pakryer |
| F.T | 10,098 | | 10,098 | Përfitim të padrejtë të pagës së këshilltarit për punë të pakryer |
| P.F | 15,147 | | 15,147 | Përfitim të padrejtë të pagës së këshilltarit për punë të pakryer |
| A.H | 56,907 | | 56,907 | Përfitim të padrejtë të pagës së këshilltarit për punë të pakryer |
| L.T | 12,564 | | 12,564 | Përfitim të padrejtë të pagës së këshilltarit për punë të pakryer |
| M.M | 41,166 | | 41,166 | Përfitim të padrejtë të pagës së këshilltarit për punë të pakryer |
| P.N | 33,444 | | 33,444 | Përfitim të padrejtë të pagës së këshilltarit për punë të pakryer |
| V.V | 43,065 | | 43,065 | Përfitim të padrejtë të pagës së këshilltarit për punë të pakryer |
| J.K | 33,561 | | 33,561 | Përfitim të padrejtë të pagës së këshilltarit për punë të pakryer |
| K.K | 33,561 | | 33,561 | Përfitim të padrejtë të pagës së këshilltarit për punë të pakryer |
| Dh.V | 24,651 | | 24,651 | Përfitim të padrejtë të pagës së këshilltarit për punë të pakryer |
| S.P | 30,294 | | 30,294 | Përfitim të padrejtë të pagës së këshilltarit për punë të pakryer |
| A.R | 34,947 | | 34,947 | Përfitim të padrejtë të pagës së këshilltarit për punë të pakryer |
| B.B | 3,336 | | 3,336 | Përfitim të padrejtë të pagës së këshilltarit për punë të pakryer |
| E.B | 23,995 | | 23,995 | Përfitim të padrejtë të pagës së këshilltarit për punë të pakryer |
| P.K | 24,948 | | 24,948 | Përfitim të padrejtë të pagës së këshilltarit për punë të pakryer |
| A.D | 44,665 | | 44,665 | Përfitim të padrejtë të pagës së këshilltarit për punë të pakryer |
| A.I | 19,717 | | 19,717 | Përfitim të padrejtë të pagës së këshilltarit për punë të pakryer |
| A.Z | 29,898 | | 29,898 | Përfitim të padrejtë të pagës së këshilltarit për punë të pakryer |
| A.B | 34,837 | | 34,837 | Përfitim të padrejtë të pagës së këshilltarit për punë të pakryer |
| A.H | 4,768 | | 4,768 | Përfitim të padrejtë të pagës së këshilltarit për punë të pakryer |
| A.K | 27,028 | | 27,028 | Përfitim të padrejtë të pagës së këshilltarit për punë të pakryer |
| A.C | 761,176 | | 761,176 | 499852-diferencë në fondin limit paguar tepër në tenderin e pastrimit 2013; 163504-paguar më tepër në dhjetor 2013; 97320-paguar tepër korrik 2015 |
| B | 547,264 | | 547,264 | 476217-vonesë në dorëzim; 36047-vonesë në dorëzim; 35000-punime të pakryera |
| D | 599,896 | | 599,896 | 474711-diferencë në fondim limit për pastrimin në 2014; 125185-paguar më tepër në dhjetor 2014 |
| P | 119,416 | | 119,416 | Vonesa në dorëzimin e autoveturës |
| A.C | 24,671 | | 24,671 | Përfitim i padrejtë i pushimeve vjetore të pakryera |

| | | | | |
|---------|-----------|--|-----------|--|
| A.M | 20,325 | | 20,325 | Përfitim i padrejtë i pushimeve vjetore të pakryera |
| G.K | 132,075 | | 132,075 | 20325-përfitim i padrejtë i pushimeve vjetore të pakryera; 81750-shpenzime të pajustificuar në tender mirëmbajtjeje; 30000-dieta të përfituara padrejtësisht |
| E.T | 81,750 | | 81,750 | Shpenzime të pajustificuara në tender mirëmbajtjeje rrugësh |
| A.B | 57,450 | | 57,450 | 45450-tërheqje nga magazina të pjesëve të këmbimit të pajustificuara; 12000-dieta të përfituara padrejtësisht |
| Th.K | 73,740 | | 73,740 | 34740-tërheqje nga magazina të pjesëve të këmbimit të pajustificuara; 39000-dieta të përfituara padrejtësisht |
| A.M | 9,000 | | 9,000 | Dieta të përfituara padrejtësisht |
| A.B | 90,750 | | 90,750 | 81750-shp të pajustificuara në tender mirëmbajtjeje; 9000-dieta të përfituara padrejtësisht |
| V.Gj | 3,512 | | 3,512 | Diferencë midis ofertës fituese dhe jofituese |
| L.H | 5,000 | | 5,000 | Përfitim i shpërblimit të lindjes me certifikatë lindjeje të pavlefshme |
| E.M | 5,000 | | 5,000 | Përfitim i shpërblimit të lindjes me certifikatë lindjeje të pavlefshme |
| M.S | 5,000 | | 5,000 | Përfitim i shpërblimit të lindjes me certifikatë lindjeje të pavlefshme |
| J.S | 5,000 | | 5,000 | Përfitim i shpërblimit të lindjes me certifikatë lindjeje të pavlefshme |
| S.Ç | 5,000 | | 5,000 | Përfitim i shpërblimit të lindjes me certifikatë lindjeje të pavlefshme |
| A.F | 5,000 | | 5,000 | Përfitim i shpërblimit të lindjes me certifikatë lindjeje të pavlefshme |
| Dh.I | 5,000 | | 5,000 | Përfitim i shpërblimit të lindjes me certifikatë lindjeje të pavlefshme |
| A.R | 5,000 | | 5,000 | Përfitim i shpërblimit të lindjes me certifikatë lindjeje të pavlefshme |
| E.R | 5,000 | | 5,000 | Përfitim i shpërblimit të lindjes me certifikatë lindjeje të pavlefshme |
| F.K | 5,000 | | 5,000 | Përfitim i shpërblimit të lindjes me certifikatë lindjeje të pavlefshme |
| M.LI | 5,000 | | 5,000 | Përfitim i shpërblimit të lindjes me certifikatë lindjeje të pavlefshme |
| I.K | 5,000 | | 5,000 | Përfitim i shpërblimit të lindjes me certifikatë lindjeje të pavlefshme |
| K.R | 5,000 | | 5,000 | Përfitim i shpërblimit të lindjes me certifikatë lindjeje të pavlefshme |
| A.F | 5,000 | | 5,000 | Përfitim i shpërblimit të lindjes me certifikatë lindjeje të pavlefshme |
| G.R | 10,000 | | 10,000 | Përfitim i shpërblimit të lindjes me certifikatë lindjeje të pavlefshme |
| I.A | 5,000 | | 5,000 | Përfitim i shpërblimit të lindjes me certifikatë lindjeje të pavlefshme |
| F.K | 5,000 | | 5,000 | Përfitim i shpërblimit të lindjes me certifikatë lindjeje të pavlefshme |
| E.Ç | 10,000 | | 10,000 | Përfitim i shpërblimit të lindjes me certifikatë lindjeje të pavlefshme |
| E.M | 5,000 | | 5,000 | Përfitim i shpërblimit të lindjes me certifikatë lindjeje të pavlefshme |
| G | 1,462,344 | | 1,462,344 | Dëm ekonomik për mosrealizim të disa zërave në objektin "Rehabilitimi si dhe rikonstruksioni i rrugës "Kthesa e Labovës-Labovë e Kryqit" |
| A | 1,377,896 | | 1,377,896 | Dëm ekonomik për mosrealizim të disa zërave në objektin "Rikualifikimi urban i qendrës së qytetit Libohovë" |
| M | 1,285,386 | | 1,285,386 | Dëm ekonomik për mosrealizim të disa zërave në objektin "Rikonstruksion i rrugës kthesa-ura e Suhës (loti I)" |
| BOE | 545,357 | | 545,357 | Dëm ekonomik për diferenca në volume pune të pakryera në objektin "Rikonstruksion dhe ndërtim palestere në shkollën 9-vjeçare "Avni Rustemi" |
| N | 485,640 | | 485,640 | Dëm ekonomik për mosrealizim të disa zërave në objektin "Rikonstruksion i kanalit ujitës fusha e Suhës (Ushqyes i rezervuarit të Cinit) Loti I" |
| BOE A&B | 221,376 | | 221,376 | Dëm ekonomik për mosrealizim të disa zërave në objektin "Rikonstruksion ë rrugës "Kthesa e Nepravishtës-Fushë Nepravishtë" |
| T&C | 160,200 | | 160,200 | Dëm ekonomik për mosrealizim të disa zërave në objektin |

| | | | | |
|---------------|-------------------|---------------|-------------------|--|
| | | | | “Rikonstruksion i rrugëve të brendshme” |
| I.K | 150,000 | | 150,000 | Gjobë nga APP |
| K.K | 150,000 | | 150,000 | Gjobë nga APP |
| A.LI | 110,000 | | 110,000 | Gjobë nga APP |
| F.M | 35,000 | 35,000 | - | Gjobë nga APP |
| F.Z | 35,000 | 35,000 | - | Gjobë nga APP |
| Totali | 11,955,491 | 70,000 | 11,885,491 | Debitorët |
| | | | 25,044,459 | Debitorët nga taksat dhe tarifat vendore |
| | | | 36,929,950 | Shuma e debitorëve e kontabilizuar në pasqyrat financiare |

Burimi i të dhënave: Bashkia Libohovë.

Tabela nr. 2, nënpika 2.3.2. “Analiza e llogarisë 202 “Studime dhe kërkime”.

Lekë

| Studime-Projektme(kosto historike) | Gjendja 01.01.2022 | Shtesa (D) | Pakësime (K) | Gjendja 31.12.2022 |
|---|-----------------------|---------------|-----------------|-----------------------|
| Projekte. Objekte inventari | | | | |
| Studim Projektimi “Rikonstruksioni i murit të jashtëm Zyrave Njëisa Zagorie” | 16,000 | | | 16,000 |
| VNM “Rikonstruksion rruga Autostrada-Fshati Bulo” | 35,600 | | | 35,600 |
| Projekti “Rikonstruksioni i Shkollës Nepravishtë” | 100,000 | | | 100,000 |
| Projekti “Rikonstruksioni i rrugës Nepravishtë” | 100,000 | | | 100,000 |
| Projekti “Rikonstruksioni i qendrës së fshatit Nepravishtë” | 398,000 | | | 398,000 |
| Projekti “Gjelbërim i Shkollës Nepravishtë” | 22,200 | | | 22,200 |
| Projekti “Gjelbërim Lab Poshtme” | 22,200 | | | 22,200 |
| Oponencë teknike për objektin “Rikonstruksioni i rrjetit të Ujësjellësit Libohovë” | 262,325 | | | 262,325 |
| Vlerë tjetër | 5,645,745 | | | 5,645,745 |
| Hartim projekti “Rikonstruksioni i Ujësjellësit Suhe” | 52,800 | | | 52,800 |
| Oponencë teknike për objektin “Rikonstruksioni i rrjetit të Ujësjellësit të pompimit dhe depove të ujit fshati Nepravishtë” | 410,244 | | | 410,244 |
| Projekti “Rehabilitimi i skemës ujitëse të Bulos si dhe Kanali Kullues K-I-76” | 0 | | | 0 |
| Projekti “Rikonstruksioni i rrjetit të Ujësjellësit të Qytetit Libohovë” | 0 | | | 0 |
| TOTALI | 7,065,114 | 0 | 0 | 7,065,114 |

Burimi i të dhënave: Bashkia Libohovë.

Tabela nr. 3, nënpika 2.3.2. “Analiza e llogarisë 212 “Ndërtime konstruksione”.

Lekë

| Ndërtesa konstruksione (kosto historike) sipas inventarit fizik | Gjendja 01.01.2022 | Shtesa (D) | Pakësi me (K) | Gjendja 31.12.2022 |
|--|-----------------------|------------|------------------|-----------------------|
| Godina e shkollës mesme | 23,785,562 | | | 23,785,562 |
| Godina e shkollës | 21,220,827 | | | 21,220,827 |
| Godina e kopshtit | 2,500,000 | | | 2,500,000 |
| Godina Shtëpia e Kulturës | 5,356,602 | | | 5,356,602 |
| Godina e bashkisë | 10,057,250 | | | 10,057,250 |
| Thertore | 1,308,201 | | | 1,308,201 |
| Varrezat publike | 197,485 | | | 197,485 |
| Muri Marinë | 1,160,665 | | | 1,160,665 |
| Këndi Sportiv (Avni Rustemi) | 155,752 | | | 155,752 |
| Rikualifikimi Urban i Qendrës së Qytetit Libohovë | 136,496,966 | | | 136,496,966 |
| Rikonstruksion dhe ndërtim palestere i shkollës 9-vjeçare “Avni Rustemi” | 6,833,055 | 2,175,387 | | 70,508,442 |
| Vlerë tjetër | 4,687,737 | | | 4,687,737 |
| Tualetet Labovë e Sipërme | 128,144 | | | 128,144 |
| Shkolla Labovë e Sipërme | 186,650 | | | 186,650 |
| Dyqan Labovë e Poshtme | 284,642 | | | 284,642 |
| Shkolla Labovë e Poshtme | 689,774 | | | 689,774 |
| Shkolla Nepravishtë e Poshtme | 10,647,853 | | | 10,647,853 |
| Shkolla Suhe | 1,400,000 | | | 1,400,000 |
| Shkolla Drino | 1,500,000 | | | 1,500,000 |
| Shkolla Bulo | 1,050,928 | | | 1,050,928 |
| Kryesia Bulo | 11,356 | | | 11,356 |
| Kopësht Çerdhe | 129,684 | | | 129,684 |
| Godina e shkollës 8 vjeçare Zhej | 832,668 | | | 832,668 |
| Godina e shkollës 8 vjeçare Hoshteve | 500,000 | | | 500,000 |

| | | | | |
|---|--------------------|------------------|----------|--------------------|
| Godina e shkollës 8 vjeçare Nderan | 420,000 | | | 420,000 |
| Godina e shkollës 8 vjeçare Sheper | 763,897 | | | 763,897 |
| Shtëpi Kulture Sheper | 3,200,000 | | | 3,200,000 |
| Godina e Shkollës | 120,000 | | | 120,000 |
| Godina e Shkollës | 60,000 | | | 60,000 |
| Godina e Shkollës | 201,161 | | | 201,161 |
| Restaurim i ambienteve të brendshme të godinës së Bashkisë | 775,340 | | | 775,340 |
| Restaurim i murit mbajtës të varrezave | 1,504,017 | | | 1,504,017 |
| Rikonstruksioni i shkollave të Bashkisë | 306,520 | | | 306,520 |
| Rikonstruksioni i hyrjes së godinës së Bashkisë | 523,582 | | | 523,582 |
| Rikonstruksioni i murit mbajtës të shkollës 9-vjeçare Labovë e Poshtme 9120 (1) | 788646 | | | 788646 |
| Rehabilitimi i murit mbajtës të çezmës Gugumi, Nivan Zagorie | 97200 | | | 97200 |
| Totali | 301,382,164 | 2,175,387 | 0 | 303,557,551 |

Burimi i të dhënave: Bashkia Libohovë.

Tabela nr. 4, nënpika 2.3.2. “Analiza e llogarisë 213 “Rrugë rrjete vepra ujore”.

| Rrugë rrjete vepra ujore (kosto historike) sipas inventarit fizik | Lekë | | | |
|---|-----------------------|---------------|-----------------|-----------------------|
| | Gjendja 01.01.2022 | Shtesa (D) | Pakësime (K) | Gjendja 31.12.2022 |
| Kolektor i ujërave të Zeza | 1,776,956 | | | 1,776,956 |
| Ujësjellësi Lagjia Kodër | 2,054,335 | | | 2,054,335 |
| Sistemim Asfaltim Qendra e Qytetit | 32,025,644 | | | 32,025,644 |
| Sistemim Asfaltim Rruga Hoxhallarë | 15,058,535 | | | 15,058,535 |
| Rruga e Lagjes Teqe | 5,930,000 | | | 5,930,000 |
| Rruga e Lagjes Marinë | 11,745,572 | | | 11,745,572 |
| Rruga Çuprel | 5,648,339 | | | 5,648,339 |
| Rruga Krakull-Agallinj | 1,495,505 | 1,495,505 | | 1,495,505 |
| Kendi Sportiv | 585,000 | | | 585,000 |
| Rruga Lagjia Kalista | 3,976,810 | | | 3,976,810 |
| Ndërtim Ure | 49,630 | | | 49,630 |
| Pikë grumbullimit mbeturina | 170,744 | | | 170,744 |
| Pikë grumbullimi | 44,884 | | | 44,884 |
| Rruga Shkolla e mesme Kala | 31,875,761 | | | 31,875,761 |
| Murr Mbajtës Rruga Hoxhallarë | 75,984 | | | 75,984 |
| Rikonstruksioni i Kapitazhi Zhepës | 4,975,663 | | | 4,975,663 |
| Rikonstruksioni i Ujësjellës Bulo | 950,739 | | | 950,739 |
| Varrezat Publike | 1,273,605 | | | 1,273,605 |
| Varrezat e dëshmorëve | 894,589 | | | 894,589 |
| Kanali ujërave të bardha lagja Krakull | 2,872,247 | | | 2,872,247 |
| Rruga Kroi i Hoxheve | 144,000 | | | 144,000 |
| Rruga Hoxhallare Kroi Shtogjeve | 1,994,681 | | | 1,994,681 |
| Rruga Teqemehallë - Gjataj | 447,996 | | | 447,996 |
| Rruga Loçan | 10,792,572 | | | 10,792,572 |
| Rruga te Kisha | 196,900 | | | 196,900 |
| Depo Uji | 4,413,578 | | | 4,413,578 |
| Rikonstruksion i pjesshëm i Ujësjellësit | 663,120 | | | 663,120 |
| Rruga te Fane Beqo | 197,400 | | | 197,400 |
| Rruga te përroi i Sinan Ruçit | 146,000 | | | 146,000 |
| Rruga Teqemehallë | 4,967,399 | | | 4,967,399 |
| Ujësjellësi Hoxhallarë | 233,000 | | | 233,000 |
| Rruga Çaushtin | 399,818 | | | 399,818 |
| Urë te Varrezat Marine | 21,000 | | | 21,000 |
| K.U.B te Bujo Isufati | 40,100 | | | 40,100 |
| Rikonstruksion rruge të brendshme | 5,678,924 | | | 5,678,924 |
| Rikonstruksion rrjeti të brendshëm elektrik | 1,198,890 | | | 1,198,890 |
| Rrugë rurale Labovë e Poshtme | 2,540,362 | | | 2,540,362 |
| Ura Labovë e Poshtme | 1,279,040 | | | 1,279,040 |
| Rruge rurale Nepravisht i sipërm | 1,728,740 | 1,728,740 | | 1,728,740 |
| Rrugë të brendshme Nepravisht i sipërm | 2,659,019 | | | 2,659,019 |
| Çesma Nepravisht e Poshtme | 434,276 | | | 434,276 |
| Rruge rurale Nepravisht e Poshtme | 32,310,651 | | | 32,310,651 |
| Ujësjellësi Nepravisht | 222,880 | | | 222,880 |

| | | | |
|---|--------------------|--|--------------------|
| Ujësjetllësi Stegopul | 9,172,088 | | 9,172,088 |
| Rrugë të brendshëm Stegopul | 598,412 | | 598,412 |
| Rruga Suhe-Stegopul | 20,768,035 | | 20,768,035 |
| Ujësjetllësi Suhe | 961,664 | | 961,664 |
| Rrugë të brendshme Suhe | 1,802,951 | | 1,802,951 |
| Rrjeti i ndriçimit rrugor Suhe | 192,000 | | 192,000 |
| KUZ Drino | 167,000 | | 167,000 |
| Ujësjetllësi Drino | 7,904,100 | | 7,904,100 |
| Rrugë të brendshme Drino | 363,105 | | 363,105 |
| Rikonstruksioni i rrjetit të ndriçim rrugor | 636,000 | | 636,000 |
| Ura Bullo | 16,210,935 | | 16,210,935 |
| Rrugë rurale Bullo | 1,026,285 | | 1,026,285 |
| Rrugë të brendshme Bullo | 1,282,298 | | 1,282,298 |
| Rrjeti i ndriçimit rrugor Bullo | 372,727 | | 372,727 |
| Rrugë të brendshme | 485,389 | | 485,389 |
| Rrugë të brendshme | 335,327 | | 335,327 |
| Kanali Ujitës i Cinit | 6,548,126 | | 6,548,126 |
| Rikonstruksion Rruga Kthesa e Lab-Lab e Kryqit | 142,221,948 | | 142,221,948 |
| Rezervuari Suhe | 3,538,925 | | 3,538,925 |
| Suhe Valare Gjiokastër (Rezervuari, Suhe Cine, Dofti) | 21,311,788 | | 21,311,788 |
| Ujitja me Rezervuari Labovë | 986,540 | | 986,540 |
| Ujitja me lumin Suhe | 4,362,142 | | 4,362,142 |
| Rikonstruksioni i KUB Stegopul | 345,600 | | 345,600 |
| Rikonstruksioni i rruga e kthesës-Ura e Suhes Lot I | 58,216,850 | | 58,216,850 |
| Rikonstruksioni Depo Uji Bullo | 200,533 | | 200,533 |
| Rehabilitim i kanaleve Rezervuari Lot II | 15,202,065 | | 15,202,065 |
| Rrugë të brendshme Labovë e Sipërme | 974,601 | | 974,601 |
| Rikonstruksioni rrugës kthesa e Nepravishtës - Fushë Nepravishtë | 12,739,770 | | 12,739,770 |
| Skema Ujitëse Suhe Vazhdim Mbarim | 20,362,890 | | 20,362,890 |
| Rruga Nivan-Hoshteve | 5,000,000 | | 5,000,000 |
| Rruga Nivan-Topovë | 5,000,000 | | 5,000,000 |
| Ujësjetllësi Sheper | 3,500,000 | | 3,500,000 |
| Ujësjetllësi Nivan | 2,500,000 | | 2,500,000 |
| Kanalizim Ujrash të Zeza/Bardha | 3,703,464 | | 3,703,464 |
| Rezervuari Sheper | 4,542,274 | | 4,542,274 |
| Kanalet Ujitëse Sheper | 4,689,740 | | 4,689,740 |
| Kanalet Ujitëse Polican | 986,790 | | 986,790 |
| Vlerë Tjetër | 8,296,835 | | 8,296,835 |
| Rikonstruksion Qendra e Fshatit Sheper | 1,846,320 | | 1,846,320 |
| Rikonstruksion i rrugëve të brendshme | 3,822,913 | | 3,822,913 |
| Rikonstruksioni i ujësjetllësive | 623,340 | | 623,340 |
| Rikonstruksion i Çezmës Libohovë | 108,626 | | 108,626 |
| Shërbime tek kanale kulluese të dyta | 246,164 | | 246,164 |
| Rikonstruksioni i ujësjetllësit të fshatit Bullo | 490,560 | | 490,560 |
| Rikonstruksion i vatrave të kulturës Zagori | 990,296 | | 990,296 |
| Rikonstruksion i rrjetit të jashtëm të ujësjetllësit Libohovë dhe Suhë | 1,257,780 | | 1,257,780 |
| Sistemim i ujërave të zeza të fshatit Drino | 602,171 | | 602,171 |
| Rikonstruksioni i rrjetit të ndriçimit publik në lagjen Hoxhallarë dhe Çuprel Libohovë 1110 (1) | 541,639 | | 541,639 |
| Rehabilitimi i skemës ujitëse të Bulos si dhe kanalit kullues K-1-76 Fushë Nepravishtë 1110 (1) | 37,213,245 | | 37,213,245 |
| Ndërtim hidranti | 99920 | | 99920 |
| Rehabilitimi i një pjesë të ujësjetllësit Stegopul | 99600 | | 99600 |
| Rehabilitimi i çezmes së rezervuarit Sheper | 99600 | | 99600 |
| Rikonstruksioni i ujësjetllësit Suhe | 1,173,168 | | 1,173,168 |
| Mbikëqyrje punimesh "Sistemimi i ujërave të zeza dhe të bardha fshati Nivan Zagori" | 106,000 | | 106,000 |
| Ndriçimi marine | 816,000 | | 816,000 |
| Totali | 633,837,427 | | 633,837,427 |

Burimi i të dhënave: Bashkia Libohovë.

Tabela nr. 5, nënpika 2.3.2. “Analiza e llogarisë 214 “Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune”.

Lekë

| Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune (kosto historike) sipas inventarit fizik | Gjendja 01.01.2022 | Shtesa (D) | Pakësime (K) | Gjendja 31.12.2022 |
|---|-----------------------|----------------|--------------|--------------------|
| Fikëse zjarri | 3,500 | | | 3,500 |
| Fikëse zjarri | 3,500 | | | 3,500 |
| Amplifikator | 65,000 | | | 65,000 |
| Mikrofon + stativ | 70,000 | | | 70,000 |
| Organo elektrike | 123,000 | | | 123,000 |
| Bateri | 150,000 | | | 150,000 |
| Saksofon | 25,098 | | | 25,098 |
| Prozhektor pistolette | 12,558 | | | 12,558 |
| Mjet Skrep | 4,018,800 | | | 4,018,800 |
| Aparat Ripërsëritës | 250,000 | | | 250,000 |
| Ripërsëritës Televiziv Satelitor | 380,000 | | | 380,000 |
| Elektro pompë | 170,000 | | | 170,000 |
| Çisterne Plastike | 40,000 | | | 40,000 |
| Çisterne 5 KË | 60000 | | | 60000 |
| Pomp Uji | 118800 | | | 118800 |
| Elektropompë ujësjellës NP | 1,296,048 | | | 1,296,048 |
| Panel elektrik NP | 217,600 | | | 217,600 |
| Pompa Suhe | 1,002,250 | | | 1,002,250 |
| Fikëse zjarri | 35,880 | | | 35,880 |
| Vlerë Tjetër | 742,167 | | | 742,167 |
| Kontenier | 930,000 | | | 930,000 |
| Set i kuzhinës (sobë furrë, pjekje lavaman lavastovilje) | 432,000 | | | 432,000 |
| Frigorifer banak | 211,200 | | | 211,200 |
| Frigorifer të mëdhenj | 408,000 | | | 408,000 |
| Lavatrice profesionale | 576,000 | | | 576,000 |
| Kaldaj pa kalorifer dhe tubacion shpërndarës | 810,444 | | | 810,444 |
| Kontenier mbeturinash | 280,800 | | | 280,800 |
| Kontenier mbeturinash | 298,800 | | | 298,800 |
| Kosha plastik | 36,000 | 36,000 | | 36,000 |
| Kosha metalik | 465600 | 465600 | | 465600 |
| Totali | 13,233,045 | 501,600 | | 13,233,045 |

Burimi i të dhënave: Bashkia Libohovë.

Tabela nr. 6, nënpika 2.3.2. “Analiza e llogarisë 215 “Mjete transporti”.

Lekë

| Nr. | Emërtimi | Personi përgjegjës | Sipas të dhënave kontabël | |
|---------------|--------------------------|------------------------------|---------------------------|-------------------|
| | | | Sasia | Vlera |
| 1 | Autoveturë B | Policia Bashkiake | 1 | 1,188,000 |
| 2 | Autoveturë H | Shoferi i Bashkisë | 1 | 778,800 |
| 3 | Autoveturë A | Njësia Administrative Qendër | 1 | 997,300 |
| 4 | Autoveturë B | Njësia Administrative Qendër | 1 | 720,000 |
| 5 | Traktor T | Libohovë | 1 | 167,100 |
| 6 | Rimorkio Metalike | Libohovë | 1 | 111,000 |
| 7 | Motokultivator komplet | Libohovë | 1 | 86,100 |
| 8 | Rimorkio motokultivatori | Libohovë | 1 | 37,140 |
| 9 | Kamion TIP ... | Albert Feri | 1 | 1,728,000 |
| 10 | Kamion M | - | 1 | 10,992,000 |
| 11 | Ë | Libohovë | 1 | 1,440,000 |
| 12 | I | MZSH | 1 | 3,768,000 |
| Totali | | | 12 | 22,013,440 |

Burimi i të dhënave: Bashkia Libohovë.

Tabela nr. 7, nënpika 2.3.2. “Analiza e llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm”.

Lekë

| Nr. | Emërtimi Objekti | Vlera |
|-----|--|-------------------|
| 1 | Supervizor (panjohur nga ish-Komuna Zagorie) | 11,280 |
| 2 | Supervizim “Hidroizolimi i godinës ekzistuese të Bashkisë Libohovë” | 3,300 |
| 3 | Supervizim “Ndërtim i murit mbajtës në lagjen Marinë, shtrim me beton i rrugës së Pajenive, i KUZ në lagjen Linua” | 4,800 |
| 4 | Supervizim “Rikonstruksion i depos së ujit te fshatit Bulo” | 4,200 |
| 5 | Kolaudim “Hidroizolimi i godinës ekzistuese të Bashkisë Libohovë” | 1,199 |
| 6 | Kolaudim “Ndërtim i murit mbajtës në lagjen Marinë, shtrim me beton i rrugës së Pajenive, i KUZ në lagjen Linua” | 1,200 |
| 7 | Kolaudim “Rikonstruksion i Kanalit Ujitës Fusha Suhe (ushqyes i Rezervuarit të Cinit)” | 9,360 |
| 8 | Supervizim “Rikonstruksion i ambienteve të brendshme të godinës së bashkisë” | 9,600 |
| 9 | Kolaudim “Rehabilitim si dhe rikonstruksion i rrugës “Kthesa e Labovës - Labovë e Kryqit”” | 5,700 |
| 10 | Supervizim “Kanaleve kulluese” | 2,750 |
| 11 | Supervizim “Rehabilitimi i kanaleve të rezervuarit të Cinit loti II” | 9,500 |
| 12 | Supervizim “Rikonstruksion i rrugës Kthesa-Ura e Suhës” | 51,720 |
| 13 | Supervizim “Rikonstruksion i qendrës së fshatit Sheper” | 29,570 |
| 14 | Mbikëqyrje “Rikonstruksion i rrugëve të brendshme” | 25,982 |
| 15 | Kolaudim “Rikonstruksion i qendrës së fshatit Sheper” | 3,479 |
| 16 | Kolaudim “Rikonstruksion i rrugës Kthesa-Ura e Suhës” | 5,940 |
| 17 | Kolaudim “Rikonstruksion i rrugëve të brendshme” | 3,600 |
| 18 | VNM “Rikonstruksion dhe ndërtim palestere i shkollës 9-vjeçare “A. Rustemi”” | 4,800 |
| 19 | Kolaudim “Rikonstruksion i Kanalit Ujitës Fusha Suhe (ushqyes i Rezervuarit të Cinit)” | 9,360 |
| 20 | Rikonstruksion i rrugëve të brendshme të fshatit Suhe | 138,000 |
| 21 | Rikonstruksion i ujësllsave Zagorie | 74,400 |
| 22 | Rikonstruksion i rrugës “Kthesë e Nepravishtës - Fushë Nepravishtë” | - |
| 23 | Rikonstruksion dhe ndërtim palestere në shkollën 9-vjeçare Avni Rustemi, Libohovë | 2,243,879 |
| 24 | Rehabilitimi i çezmës të rezervuarit Sheper, Zagorie | - |
| 25 | Rehabilitimi i çezmës të rezervuarit Stegopol | - |
| 26 | Rehabilitimi i murit mbajtës të çezmës Gugumi, Nivan, Zagorie | - |
| 27 | Rikonstruksion i murit të varrezave Libohovë | - |
| 28 | Mbikëqyrje punimesh për objektin “Mirëmbajtje kanale kulluese” | 38,128 |
| 29 | Mbikëqyrje punimesh për objektin “Rikonstruksion i murit mbajtës të shkollës 9-vjeçare Labovë e Poshtme” | 16,787 |
| 30 | Mbikëqyrje punimesh për objektin “Rikonstruksion i murit të varrezave Libohovë” | 22,166 |
| 31 | Rikonstruksion i murit mbajtës të shkollës 9-vjeçare Labovë e Poshtme | 48,000 |
| 32 | F | 37,775 |
| 33 | Shtypshkronja “A” | 1,800 |
| 34 | V (fatura qershor 16) | 7,820 |
| 35 | Posta Shqiptare (Detyrime nga ish-Komuna Zagorie) | 35,428 |
| 36 | Mirëmbajtje ura e Bulos | 276,000 |
| 37 | Mirëmbajtje e kanaleve kulluese | 75,600 |
| 38 | Rikonstruksion Banese | 166,200 |
| 39 | Akt Marreveshjes | 10,841,536 |
| 40 | K | 384,220 |
| 41 | Dëmshpërblim për dëmin e shkaktuar në kullotë | 7,940,037 |
| 42 | Dëmshpërblim si pasojë aksident në punë me pasojë vdekje | 5,437,212 |
| 43 | A | 1,208,727 |
| | Totali | 29,191,056 |

Burimi i të dhënave: Bashkia Libohovë.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

